


PARIME TË  
UDHËHEQJES

MANUAL I MËSUESIT

RELIGION 180R



# PARIME TË UDHËHEQJES MANUAL I MËSUESIT

---

Religion 180R

Përgatitur nga  
Sistemi Arsimor i Kishës

Botuar nga  
Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme  
Solt-Lejk-Siti, Juta

Dërgoni komente dhe korrigjime,  
përfshirë gabime tipografike, në  
CES Editing, 50 E. North Temple Street,  
Floor 8, Salt Lake City, UT 84150-2722, USA.  
E-mail: <ces-manuals@ldschurch.org>

© 2009 nga Intellectual Reserve, Inc.  
I rezervohen të gjitha të drejtat.  
Shtypur në Gjermani

Miratuar për anglisht: 5/99  
Miratuar për përkthim: 5/99  
Përkthimi i *Principles of Leadership Teacher Manual: Religion 180R*  
Albanian

# PËRMBAJTJA

---

Hyrje .....	v
Mësimi 1 Udhëheqësit dhe Potenciali Ynë Hyjnor .....	1
Plaku Van J. Fedhërstoun, Fragmente nga <i>The Incomparable Christ: Our Master and Model</i> (Krishti i Pakrahasueshëm: Mësuesi dhe Modeli ynë) .....	3
Mësimi 2 Respektimi i Lirisë së Zgjedhjes së Atyre që Udhëheqim .....	7
Vëllai Nill A. Maksiuell, “Looking at Leadership” .....	9
Mësimi 3 Të Bëhesh një Bari i Mirë .....	14
Plaku Xhejms E. Faust, “These I Will Make My Leaders” .....	16
Mësimi 4 Dhënia e një Shembulli të Mirë .....	21
Presidenti Gordon B. Hinkli, “A Prophet’s Counsel and Prayer for Youth” .....	22
Mësimi 5 Mësimi i Detyrave Tona si Udhëheqës .....	30
Plaku Dallin H. Ouks, “Parental Leadership in the Family” .....	31
Mësimi 6 Shërbimi për Ata që Udhëheqim .....	36
Plaku Van J. Fedhërstoun, Fragmente nga <i>More Purity Give Me</i> .....	39
Plaku M. Rasëll Ballard, Fragmente nga “The Greater Priesthood: Giving a Lifetime of Service in the Kingdom” .....	39
Mësimi 7 Mësimi për të Udhëhequr me Dashuri Hyjnore .....	41
Vëllai Stiven D. Nadold, Fragmente nga <i>Principles of Priesthood Leadership</i> .....	43
Mësimi 8 Udhëheqja Shpesh Kërkon Sakrificë .....	47
Plaku Gordon B. Hinkli, <i>The Loneliness of Leadership</i> .....	48
Mësimi 9 Qasja Gëzueshëm në Udhëheqje .....	52
Plaku Xhozef B. Uirthlin, “Lessons Learned in the Journey of Life” .....	53
Mësimi 10 Të Vëmë të Parat Gjërat Parësore .....	62
Plaku M. Rasëll Ballard, “Keeping Life’s Demands in Balance” .....	65
Mësimi 11 Nderimi i Priftërisë dhe i Grarisë .....	70
Plaku Rasëll M. Nelson, “Honoring the Priesthood” .....	72
Mësimi 12 Ndihma që të Tjerët të Përfshihen me Zell .....	78
Plaku Hju B. Braun, “The Currant Bush” .....	80
Motra Margaret D. Nadold, “The Joy of Womanhood” .....	82
Mësimi 13 Puna e Udhëheqjes .....	86
Plaku Mark E. Petersen, “The Image of a Church Leader” .....	87
Mësimi 14 Udhëheqja dhe Këshillat .....	93
Plaku M. Rasëll Ballard, “Strength in Counsel” .....	96
Plaku M. Rasëll Ballard, “Counseling with Our Councils” .....	99

Mësimi 15	Rëndësia e Delegimit .....	103
	Plaku N. Eldon Taner, “The Message: Leading as the Savior Led” .....	105
Mësimi 16	Parime të Vendimmarrjes .....	109
	Presidenti Ezra Taft Benson, “Suggestions on Making Decisions” .....	109
Mësimi 17	Drejtimi i Mbledhjeve të Suksesshme .....	115
	Presidenti Boyd K. Paker, “The Unwritten Order of Things” .....	116
Mësimi 18	Shqyrtimi i Vetvetes .....	124
	Presidenti Spenser W. Kimball, “Jesus: The Perfect Leader” .....	125

# HYRJE

## QËLLIMI I FESË 180R

Feja 180R, *Parime të Udhëheqjes*, u paraqet studentëve parime dhe metoda të udhëheqjes që do t'i ndihmojnë ata të udhëheqin në një mënyrë që është e kënaqshme për Jezu Krishtin, udhëheqësin e përsosur. Siç ka shpjeguar Presidenti Spenser W. Kimball: “Ne do të na duket shumë e vështirë të jemi udhëheqës të rëndësishëm nëse nuk njohim vërtetësinë e udhëheqësit të përsosur, Jezu Krishtit, dhe nuk lejojmë që ai të jetë drita me të cilën ne shohim rrugën!” (“Jesus: The Perfect Leader”, *Ensign*, gusht 1979, f. 7).

Me rritjen e Kishës, nevoja për të përgatitur udhëheqës rritet. Anëtarët e Kishës mund të mësojnë të jenë udhëheqës. Presidenti Gordon B. Hinkli citoi deklaratën e mëposhtme nga Gjenerali i Armatës së Shteteve të Bashkuara Mark W. Klark: “Në kundërshtim me thënien e vjetër se udhëheqësit lindin, nuk bëhen, arti i udhëheqjes mund të mësohet dhe ai mund të zotërohet” (në *Teachings of Gordon B. Hinckley* [1997], f. 306).

*Parimet e Udhëheqjes* është një kurs me një kredit për një orë mësimore në javë. Ai mund të ofrohet për të gjithë studentët ose të përshtatet për grupe të veçanta, të tilla si udhëheqës të këshillit të studentëve të instituteve të fesë. Nëse kursi po i jepet një grupi të veçantë, sigurohuni që të përfshini një shënim pas emrit të kursit në orarin e mësimave (për shembull, “Për udhëheqësit e këshillit të studentëve”). Megjithatë *Parimet e Udhëheqjes* është hartuar si një kurs me afat 18-javor ose me dy periudha 9-javore, ju mund t'i plotësoni mësimet me materiale shtesë për t'iu përgjigjur nevojave vendore, me qëllim që të siguronit materiale mësimore për një vit për një këshill studentësh të institutit.

*Manuali i Mësuesit për Parime të Udhëheqjes* përfshin më shumë mësim sesa mund të jepen me një sistem semestri 15-javor. Mësimet shtesë u lejojnë mësuesve njëfarë lehtësie në caktimin e çështjeve për mësim në klasë. Në një sistem 9-javor mësimet mund të rregullohen në dy grupe me nga nëntë tema për paraqitje në dy sezona. Kursi i periudhës së

parë, Feja 180R dhe kursi i periudhës së dytë, Feja 181R, mund të quhen të dy *Parime të Udhëheqjes*.

## PARIME TË UDHËHEQJES - MANUALI I MËSUESIT

*Parime të Udhëheqjes – Manuali i Mësuesit* përfshin një mësim për secilin nga tetëmbëdhjetë parimet e udhëheqjes të nxjerra nga shkrimet e shenjta. Radha me të cilën i paraqisni mësimet, mund të përshtatet në përputhje me rrethanat tuaja. Mund të nevojitet më shumë se një orë mësimi për të diskutuar si duhet disa nga parimet. Organizojini mësimet në mënyrë të tillë që të mund të diskutoni parimet që ju i ndieni se janë më të rëndësishme për studentët tuaj, kur ata përgatiten për rolet udhëheqëse në Kishë, shkollë, komunitet dhe shtëpi.

Çdo mësim fillon me një shkrim të shenjtë nga i cili nxirret një parim i përgjithshëm i udhëheqjes. Përveç kësaj, çdo mësim përfshin:

- *Koncepte për Mësimin* – Parime të posaçme për të ndihmuar studentët të zbatojnë parimin e përgjithshëm të udhëheqjes.
- *Koment* – Shpjegime të koncepteve për mësimin, përfshirë shkrime të shenjta shtesë dhe deklarata nga Autoritetet e Përgjithshme.
- *Ide mësimore* – Metoda të sugjeruara për mësimdhënien e koncepteve.
- *Burime për mësuesin* – Fjalime ose shkrime nga Autoritetet e Përgjithshme lidhur me parimet e udhëheqjes. Këto ndiqen nga pyetje studimore.

Fjalimet në seksionin e burimeve të mësuesit dhe pyetjet shoqëruese janë për ju, mësuesit, kur përgatitni mësimet. Ju mundet gjithashtu të zgjidhni t'i përdorni fjalimet dhe pyetjet në klasë apo t'ua jepni ato studentëve si shënime të shtypura. Mbani parasysh se disa nga fjalimet lidhen drejtpërdrejt me mësimet që ato ndjekin, ndërsa të tjera janë mbi udhëheqjen në përgjithësi.

Ndihmoftë ky manual i mësuesit që të përgatitni udhëheqësit e nesërm dhe të plotësohet shpresa e Presidentit Ezra Taft Benson: “Të rinj

të dashur, ju do të keni sprovat dhe tundimet tuaja nëpër të cilat duhet të kaloni, por ka momente të mëdha të përjetësisë që gjenden përpara jush. Ju keni dashurinë tonë dhe mirëbesimin tonë. Ne lutemi që ju të jeni të përgatitur për frerët e udhë-

heqjes. Ne ju themi: 'Ngrihuni e shkëlqeni' (DeB 115:5) dhe jini dritë për botën, flamur për të tjerët" ("To 'the Rising Generation' ", *New Era*, qershor 1986, f. 8).

# UDHËHEQËSIT DHE POTENCIALI YNË HYJNOR

“Kujtoni që vlera e shpirttrave është e madhe në sytë e Perëndisë” (DeB 18:10).

## PARIM I UDHËHEQJES

Kuptimi i forcës sonë hyjnore i ndihmon udhëheqësit të drejtojnë të tjerët tek Jezu Krishti.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Ne kemi forcë hyjnore sepse jemi fëmijë të Atit Qiellor.
2. Jezu Krishti është Shpëtimtari ynë.
3. Udhëheqësit duhet të ndjekin Rregullën e Artë.

## KONCEPTI 1. NE KEMI FORCË HYJNORE SEPSE JEMI FËMIJË TË ATIT QIELLOR.

### KOMENT

Psalmisti pyeti: “Çfarë është njeriu, që ta mbash mend?” (Psalmet 8:4). Disa njerëz besojnë se njeriu është thjesht një kafshë me arsye i motivuar nga instinkte, forca shoqërore-ekonomike apo agresivitet i lindur. Disa njerëz besojnë se sjellja e njeriut kontrollohet nga shpërblime të premtuara apo nga ndëshkime kërcënuese. Disa njerëz thonë se ekzistenca jonë është e pakuptimtë.

Në të kundërtën, shenjtorët e ditëve të mëvonshme kuptojnë se të gjithë njerëzit janë fëmijë të Atit Qiellor dhe kanë forcën të bëhen si Ai (shih Veprat e Apostujve 17:29; Efesianëve 4:6; Hebrejve 12:9). Nxitja e Shpëtimtarit që të bëhemi të përsosur sikurse është Ai, është një fakt për forcën tonë hyjnore.

Ne besojmë se të gjithë njerëzit kanë vlerë të madhe (shih DeB 18:10, 15), që ata janë në gjendje të dallojnë të drejtën nga e gabuara (shih 2 Nefi 2:5), që ata, në saxe të Shlyerjes së Jezu Krishtit, janë të lirë të zgjedhin midis të mirës dhe të keqes (shih vargjet 26–27) dhe se ata, për këtë arsye, kanë përgjegjësi për zgjedhjet e tyre (shih vargun 10). Ne themi se qëllimi i Perëndisë në krijimin e planit të shpëtimit është që ne të mund të kemi gëzim (shih vargun 25).

### IDE MËSIMORE

Hiqni një vijë vertikale në mes të tabelës. Në anën e majtë shkruani titullin *Disa Pikëpamje Laike për Natyrën Njerëzore*. Në anën e djathtë shkruani titullin *Besimet e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme mbi Natyrën Njerëzore*. Diskutoni komentin më sipër dhe nën titullin e duhur shkruani përmbledhje të pikëpamjeve laike dhe të njohurive të zbuluara lidhur me natyrën dhe potencialin tonë. Tërhiqni vëmendjen e studentëve mbi kuptimin që kemi si shenjtorë të ditëve të mëvonshme se ne jemi fëmijë të Atit Qiellor me forcë për t’u bërë si Ai.

Diskutoni se në ç’mënyrë dija jonë mbi atë se kush jemi dhe çfarë mund të bëhemi, na ndihmon të jemi udhëheqës më të mirë. Nxitini studentët të kultivojnë një kuptim më të thellë të natyrës njerëzore dhe të planit të shpëtimit. U tregoni studentëve se duke bërë këtë do të rritet dëshira dhe aftësia e tyre për të sjellë njerëz tek Jezu Krishti.

Diskutoni se në ç’mënyrë kuptimi ynë për natyrën tonë hyjnore mund të ndikojë në planifikimin e programeve të Kishës dhe të familjes.

I vini studentët të lexojnë Moisiu 1:27–39. Diskutoni pyetje si këto:

- Çfarë na tregojnë këto vargje lidhur me atë se cilët jemi?



- Çfarë na tregojnë këto vargje mbi potencialin tonë?
- A mendoni se Moisiu ishte më i aftë të udhëhiqte popullin e tij pas vegimit që përshkruhet në këto vargje? Pse?
- Çfarë të vërtetash shihni në këto vargje, që mund t'ju ndihmojnë të jeni udhëheqës më i mirë?

Ndajeni klasën në grupe të vogla. I thoni secilit grup të përfytyrojë se ata janë thirrur të planifikojnë një konferencë të rinisë së kунjit. U thoni të skicojnë konferencën dhe të planifikojnë veprimtaritë që do të ndihmojnë të rinjtë të dinë se ata janë fëmijë të Atit Qiellor dhe kanë potenciale hyjnore. I ftoni grupet të shqyrtojnë se në ç'mënyrë veprimtaritë e konferencës mund të ndryshonin, nëse ato do të ishin bërë nga një institucion laik për një grup të ngjashëm të rinjsh. U jepni kohë të mbarojnë dhe pastaj u thoni të tregojnë idetë e tyre përpara klasës.

## **KONCEPTI 2. Jezu Krishti është Shpëtimtari ynë.**

### **KOMENT**

Pikëpamja jonë për natyrën njerëzore ndikohet nga kuptimi ynë mbi natyrën dhe misionin e Jezu Krishtit. Ungjilli mëson se Jezusi është Mesia, Shpëtimtari ynë dhe Biri Hyjnor i Perëndisë Atë.

Nefiti i foli engjëlli: “Këto anale të fundit [Libri i Mormonit], ... do të vendosin të vërtetën e të parit [Bibla] ... dhe do t'u bëjnë të njohur të gjitha racave, gjuhëve dhe njerëzve, se Qengji i Perëndisë është Biri i Atit të Amshuar dhe Shpëtimtari i botës; dhe se të gjithë njerëzit duhet të vijnë tek ai ose ata nuk mund të shpëtohen” (1 Nefi 13:40).

Shpëtimtari e dinte qysh në fëmijëri se misioni i Tij ishte pjesë e planit të Atit të Tij Qiellor. Siç ka shpjeguar Plaku Nil A. Maksiuell i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve: “Ai dinte aq shumë, aq i ri” (*Men and Women of Christ* [1991], f. 115). Apostulli Gjon shënoi se Jezusi “nuk e mori plotësinë që në fillim, por vazhdoi nga hiri në hir, derisa mori një plotësi” (shih DeB 93:13). Kur shërbesa e Krishtit u shpalos, Ai u foli të tjerëve

mbi identitetin dhe misionin e Tij. “Unë dhe Ati jemi një”, u tha Ai dishepujve të Tij (Gjoni 10:30). Gruas samaritane te pusi i Jakobit i zbuloi se Ai ishte Mesia i shumëpritur (shih Gjoni 4:19–26, 42). Plaku Brus R. Mek-Konki, që ishte anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, përmbledhi dëshminë e Zotit për Vetën tek pellgu i Betesdas: “Ai punoi nëpërmjet fuqisë së Atit; ai do të bënte të ndodhte ringjallja; ai do të nderohej krahas Atit; ai do të gjykonte të gjithë njerëzit; ai do t'u predikonte shpirtave në burg dhe do të hapte varret e atyre që kishin vdekur; ai kishte jetë në vetvete, madje ashtu si Ati – gjithë këtë dhe shumë-shumë më tepër [shih Gjoni 5]” (*The Promised Messiah: The First Coming of Christ* [1978], f. 154).

Amuleku u shpjegoi Zoramitëve: “Pasi është e nevojshme që një shlyerje duhet bërë; pasi, sipas planit të madh të Perëndisë së Amshuar, duhet të bëhet një shlyerje, përndryshe i tërë njerëzimi do të mbarojë patjetër...

Pasi është e nevojshme të bëhet një flijim i madh dhe i fundit; po, jo një flijim i njeriut, as i kafshës, as i ndonjë lloji shpendi, pasi nuk do të jetë një flijim njerëzor; por duhet të jetë një flijim i pafundëm dhe i përjetshëm...

Dhe vini re, ky është i tërë kuptimi i ligjit, çdo pjesë e vogël duke vënë në dukje atë flijim të madh dhe të fundit; dhe ai flijim i madh dhe i fundit do të jetë Biri i Perëndisë, po, i pafund dhe i përjetshëm” (Alma 34:9–10, 14).

### **IDE MËSIMORE**

I vini studentët të gjejnë pjesë nga shkrimet e shenjta që përshkruajnë aspekte të personalitetit apo qëllimit hyjnor të Jezu Krishtit. I ftoni disa t'i lexojnë klasës një pjesë që kanë gjetur. Diskutoni çfarë na mësojnë shkrimet e shenjta dhe profetët modernë mbi atë se cili është Jezu Krishti dhe çfarë bëri Ai për secilin nga ne nëpërmjet flijimit të Tij shlyes.

Shpjegoni se Shlyerja është thelbi i planit të shpëtimit. Ajo bën të mundur ringjalljen tonë dhe rikthimin në shtëpinë tonë qiellore. Diskutoni përse është e rëndësishme që familja dhe udhëheqësit e Kishës të kuptojnë rolin e Jezu Krishtit në plan.

### KONCEPTI 3. UDHËHEQËSIT DUHET TË NDJEKIN RREGULLËN E ARTË.

#### KOMENT

Udhëheqësit duhet t'i trajtojnë njerëzit me mirësi dhe respekt. Çdo njeri është fëmijë i Atit Qiellor me potenciale Hyjnore, për të cilin Shpëtimtari vuajti dhe vdiq. Ka më shumë gjasa që njerëzit t'u përgjigjen pozitivisht udhëheqësve që shfaqin dashuri dhe respekt për ta.

Shpëtimtari na mësoi: “Gjithçka, pra, që ju dëshironi t'ju bëjnë njerëzit, ua bëni edhe ju atyre, sepse ky është ligji dhe profetët” (Mateu 7:12). Ky mësim është bërë i njohur si Rregulla e Artë.

Alma na mësoi: “Zoti ... u jep të gjitha kombeve, nga kombi dhe gjuha e tyre, për të mësuar fjalën e tij, po, në dituri gjithçka që ai e shikon të përshtatshme se ata duhet ta kenë” (Alma 29:8). Nuk duhet të na befasojë kur, njerëz të cilëve nuk u ishte dhënë ungjilli, kuptojnë shumë të vërteta të ungjillit.

Shumë fe kanë rregulla të ngjashme me këtë mësim të Shpëtimtarit. Tabela shoqëruese rendit disa.

Judaizmi	“Ajo që është e urryer për ju, mos ua bëni bashkënjerezve tuaj. Ky është i gjithë Ligji; të gjitha të tjerat janë komente” Talmud, Shabbat, 31a).
Budizmi	“Mos i dëmto të tjerët në mënyra që ju vetë do t'ju dukeshin të dëmshme” (Udana-Varga, 5, 18).
Konfucianizmi	“Sigurisht është parimi i dashurisë së përzemërt: Mos u bëni të tjerëve atë që ju nuk doni që ata t'ju bëjnë juve” (Analects, 15, 23).
Islamizmi	“Asnjë nga ju nuk është besimtar gjersa të dëshirojë për vëllanë e tij atë që ai dëshiron për veten” (Sunnah).

Përshtatur nga David Wallechinsky dhe Irving Wallace, *The People's Almanac* (1975), 1314–1315.

#### IDE MËSIMORE

Pyesni nëse ndonjë në klasë mund të recitojë Rregullën e Artë. Nëse askush nuk përgjigjet, u thoni studentëve të lexojnë Mateu 7:12 dhe shpjegoni se ky mësim nga Shpëtimtari shpesh quhet Rregulla e Artë. U kujtoni studentëve se

Zoti frymëzon mësues të drejtë në çdo komb (shih Alma 29:8) dhe shpjegoni se një version i kësaj rregulle ekziston në shumë fe. Presidenti Ezra Taft Benson na mësoi se Rregulla e Artë është “formula për marrëdhënie të suksesshme me të tjerët” (*The Teachings of Ezra Taft Benson* [1988], f. 447).

Diskutoni me klasën karakteristikat e udhëheqësve që e jetojnë Rregullën e Artë dhe renditni idetë e tyre në tabelë. Shembujt e mëposhtëm mund të jenë të dobishëm:

#### Udhëheqësit që jetojnë Rregullën e Artë:

- I shohin njerëzit dhe detyrat në lidhje me synimin final që duhet arritur.
- Janë optimistë për njerëzit të cilëve u shërbejnë dhe detyrat që marrin përsipër.
- Zhvillojnë një aftësi dhe dëshirë më të madhe për t'u shërbyer të tjerëve.

(Shih gjithashtu listën nga Plaku Van J. Fedhërstoun në seksionin e Burimeve për Mësuesin më poshtë.)

Lexoni Lluca 10:25–37 dhe diskutoni çfarë na mëson kjo shëmbëlltëri mbi Rregullën e Artë. Shqyrtoni pyetje të tilla si:

- Çfarë mund t'i kushtojë një personi që të jetë një “samaritan i mirë”? A është ndonjëherë tepër e lartë kostua për udhëheqësit? Shpjegoni.
- A duhet ta jetojnë Rregullën e Artë udhëheqësit edhe nëse nuk presin trajtim të ngjashëm nga të tjerët? Përse?
- Si mendoni se do të ndryshonte vendi ynë nëse udhëheqësit dhe qytetarët do të jetonin Rregullën e Artë?

#### BURIME PËR MËSUESIN



**Plaku Van J. Fedhërstoun**

*Nga të Shtatëdhjetët*

*Fragmente nga The Incomparable Christ: Our Master and Model (1995), f. 106–8, 110–11, 113–16, 119–20, 123–25, 128–32*

[Kapiten Moroni e mbylli letrën drejtuar Ammoronit], “Tani po e mbyll letrën time. Unë

jam Moroni; unë jam një udhëheqës” [Alma 54:14; korsivet shtuar].

Në kopjen time të Librit të Mormonit unë kam shkruar në anë të fletës: “Kurrë nuk janë thënë fjalë më të vërteta sesa kur Moroni deklaroi: ‘Unë jam një udhëheqës’”. Çfarë udhëheqësi!

Shumë vite më vonë, Moronin e përshkruan me këto fjalë: “Në qoftë se të gjithë njerëzit kishin qenë dhe ishin, ose do të jenë ndonjëherë, sikurse Moroni, vini re, fuqitë e vërteta të ferrit do të ishin tundur përgjithnjë; po, djalli nuk do të kishte kurrë më fuqi mbi zemrat e fëmijëve të njerëzve”. (Alma 48:17.)

Kur Moroni ishte kryekomandant i ushtrive nefite:

“Ai grisi pelerinën e tij dhe mori një copë të saj e shkroi mbi të – Në kujtim të Perëndisë tonë, fesë sonë, lirisë sonë dhe të paqes sonë, të bashkëshorteve tona dhe të fëmijëve tanë – dhe e nguli në majë të një shtize.

Dhe vuri përkrenaren e tij dhe parzmoren e tij dhe mburojat e tij dhe ngjeshi në ije armët, dhe mori shtizën, në majë të së cilës kishte pelerinën e tij të grisur (dhe ai e quajti titulli i lirisë), dhe u përkul gjer në tokë, dhe iu lut me fuqi Perëndisë së tij që bekimet e lirisë të qëndronin mbi vëllezërit e tij, përderisa të mbejtin një grup të Krishterësh që të zotërojnë tokën.” (Alma 46:12, 13.)

Nuk kishte asnjë dyshim në mendjen e Moronit se ai ishte një udhëheqës. Ai e dinte rolin e tij dhe synonte ta përmbushte atë. Ai u rreshtua në drejtimin e duhur me të gjithë shpirtin e tij. Ai vuri besimin e tij në punë nëpërmjet veprimit e duke u gjunjëzuar në lutje dhe ai nuk turpërohej t’i bënte këto edhe publikisht.

Moroni ishte një udhëheqës i patrembur me një shpirt të pamposhtur. Zemra dhe shpirti i tij ishin në një kauzë më të madhe se vetja e tij; ai nuk ndiente aspak frikë. Kurdoherë që lexoj mbi Kapiten Moronin, një zjarr më ndizet thellë deri në palcën e kockave. Çfarë do të jepnit ju për të luftuar krah për krah me një burrë të tillë si ky?

Burra, gra dhe të rinj gjithnjë do të bashkohen me një kauzë kur kanë një udhëheqës; sidoqoftë, është e vështirë për Perëndinë apo

çfarëdo organizate të përdorë një udhëheqës të lëkundur...

Unë jam i sigurt që Moroni nuk e dinte me të vërtetë se sa i madh ishte. S’besoj se ai studioi ndonjëherë një parim udhëheqëje nga një libër i përhapur apo seminar i kushtueshëm. Thjesht lindi një nevojë e madhe dhe Moroni, në pastërtinë dhe mirëbesimin e tij, doli përpara dhe i dha mundësinë Zotit që ta përdorë.

Në Kishë ne të gjithë jemi udhëheqës dhe pasues. Kisha është e organizuar në mënyrë të tillë që edhe më i vogli midis nesh udhëheq gjatë jetës së vet. Kjo udhëheqje mund të marrë formën e disa familjeve për t’u dhënë mësim shtëpie ose mund të jetë një thirrje në kunj, rajon apo madje në zonë; ajo mund të jetë një klasë e Të Rejave apo mund të jetë për të gjitha të rejat e Kishës...

Presidenti Harold B. Li sugjeroi se vetëm kur vihemi tërësisht në dispozicion, ne mund të bëhemi dishepuj të denjë të Krishtit. Çuditërisht, mungesa e besimit tek vetja apo ndjesia e padënjësisë nuk e kundërshtojnë këtë mendim. Moisiu dhe Enoku ishin të dy “të ngadaltë në të folur” dhe u befasuan nga thirrja. Ne mund të ndihemi si të papërshtatshëm, por kur ka një punë për t’u bërë, dikush duhet të dalë dhe ta bëjë.

Seksioni i katërt i Doktrinës dhe Besëlidhjeve thotë: “Nëse keni dëshirë t’i shërbeni Perëndisë, ju thirrreni për veprën”. (Vargu 3.) ...

Të gjithë ata që vihen në dispozicion dhe kanë zemra të gatshme do të thirren për të udhëhequr. Kjo është pjesë e planit të ungjillit...

Një udhëheqës duhet të jetë në gjendje të ketë një ëndërr për punën...

“Kur nuk ka një vizion profetik, populli bëhet i shfrenuar”, por ata gjithashtu nuk kryejnë. (Fjalët e Urta 29:18.) Ata nuk kanë zemër për punë dhe, pashmangësisht, pengojnë më shumë sesa ndihmojnë. Po kështu, një udhëheqës pa vizion do ta kufizojë në mënyrë tronditëse efektshmërinë e tij...

Nëse një vizion është aq i rëndësishëm, si mund ta kemi atë? Ata që kanë vizion, kanë shumë gjëra të përbashkëta:

- Ata e shohin të gjithë punën që kanë përpara.

- Ata shohin çfarë duhet të bëhet me qëllim që të arrihen përfundimet që dëshirojnë.
- Ata mbajnë parasysh të gjitha burimet, potencialet dhe aftësitë e tyre së bashku.
- Ata shohin me mendjen e tyre se çfarë gjërash të mrekullueshme dhe madhështore mund të ndodhin kur e gjithë forca e punës mobilizohet e bashkuar.
- Ata pastaj shkojnë të punojnë për të përmbushur qëllimin e tyre.
- Ata kanë aftësinë ta komunikojnë bindshëm vizionin e tyre tek ata që kanë përreth vetes, në mënyrë që të tjerët gjithashtu të përfshihen.
- Ata e shohin atë që po bëjnë si kauzë, jo si projekt.
- Udhëheqësit fetarë ndiejnë një “dorë të shenjtë” që i ndihmon në punë...

Përfytyroni me mua lartësinë e kauzës në të cilën jemi përfshirë. Neve na janë dhënë çelësat, priftëria dhe programi për kauzën më të madhe në përjetësi. Vetëm ne, nga të gjithë fëmijët e Perëndisë, kemi çelësat e dijes së shpëtimit dhe të ekzaltimit...

Kauza është më e madhe se njerëzit apo profetët. Ajo është kauza e Shpëtimtarit. Ajo është kauza e Perëndisë, Atit të Përjetshëm. Duke u përfshirë në kauzën e Tij dhe duke duruar besnikërisht, ne do të jemi përfitues të të gjitha gjërave që po ua mësojmë dhe tregojmë të tjerëve. Një varg që ne e citojmë kaq shpesh, ndonjëherë pa shumë mendim, është: “Kjo është vepra ime dhe lavdia ime – të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut”. (Moisiu 1:39.) Përfytyroni një kauzë me efekte dhe rrjedhime përjetësie, një kauzë kaq të madhe, sa e gjithë përjetësia vihet në pikëpyetje kur ne e pranojmë apo e kundërshtojmë. Ne nuk e kuptojmë plotësisht se çfarë privilegj madhështor është të jesh plotësisht i përfshirë...

Një kuorum apo klasë mund të ketë një kauzë — punën misionare, veprimtarinë për mirëqenie, aktivizimin e të gjithë anëtarëve të kuorumit, përgatitjen për në tempull, lidhjet e vëllazërisë apo të motërisë (uniteti) dhe dhjetëra të tjera. Kur jemi të përfshirë në mënyrë të bashkuar, ne arrijmë rezultate që vështirë se guxojmë t'i ëndërrojmë.

Gjërat që duam më shumë, kanë aftësinë të bëhen vërtet kauza të mëdha. Familjet, feja, vendi, të drejtat, liritë, çlirimi, liria e zgjedhjes dhe puna – shumë nga ne i vlerësojnë këto si gjëra të shtrenjta...

Kauza tek e cila ne e përkushtojmë veten, duhet të jetë reale dhe me vlerë të madhe; ajo nuk mund të sajohet. Zoti na ofron shumë kauza vetjake, si pagëzimi në të vetmen Kishë të vërtetë, vulosjet në tempull, lidhjet e përjetshme familjare, punën misionare, kujdesin për nevojtarët dhe vetë ndjesinë tonë të fatit, me mundësinë e ekzaltimit...

... Udhëheqësi duhet të jetë shembullor...

Shembulli është në gjithçka që bëjmë. Në këtë gjë udhëheqësi nuk ndryshon. Ai nuk mund të jetë karakter i një niveli në fushëbetejë dhe i një tjetër niveli kur është vetëm...

Kjo është puna e Zotit. Ajo duhet të shkojë përpara. Zoti i bekon burrat dhe gratë me talente dhe ato talente dhe aftësi udhëheqëse duhet të vihen në përdorim atje ku mund të sjellin rezultate më të mëdha...

Gjithnjë udhëheqësit do të bëjnë që puna të kryhet. Ata i ngrënë të gjithë përreth tyre...

Ne duhet të lutemi për udhëheqës shpirtërorë që do të ngrënë dhe motivojnë njerëzit, që do të rrisin nivelet e veprimtarisë dhe përmbushjet...

Ne do të shohim se ata që kanë ndikimin më të thellë në jetën tonë, janë ata që i përdorin rolet e tyre udhëheqëse për të shërbyer. Ata që janë egoistë, arrogantë apo krenarë, urrejnë të shërbejnë dhe shpejtojnë të zënë pushtet. Ata e duan kontrollin, sundimin dhe bindjen me detyrim...

Udhëheqja shërbyese bazohet në një respekt të thellë për fëmijët e njerëzve. Ajo kërkon tipare udhëheqëse që nuk poshtërojnë, ulin apo shkaktojnë me mënyra të tjera që ata që udhëheqim të ndihen inferiorë. Udhëheqja shërbyese ngre, bekon dhe ndryshon jetën në një mënyrë pozitive...

Udhëheqësit-shërbëtorë ushtrojnë tiparet dhe praktikatat vijuese në rolet e tyre. Ata:

- Kuptojnë vlerën e çdo shpirti njerëzor.
- Kanë një ndjesi të lindur apo të zhvilluar të kujdesit për të tjerët.
- Janë të shpejtë për të dalë vullnetarë për t'i hequr ngarkesën një tjetri.

- Nguten të ndihmojnë dikë që po kalon nëpër një përjetim sikleti apo poshtërimi.
- I trajtojnë të gjithë njerëzit mbi bazë barazie.
- Nuk ndihen sikur detyrat që ata presin t'i bëjnë të tjerët, janë tepër poshtëruese për ata vetë.
- Nuk ofendohen nga prishjet e njerëzve që janë vetë duke kaluar trauma emocionale apo stres.
- Presin më shumë nga vetja, se nga kushdo tjetër.
- Janë të shpejtë në komplimente, dhënie merite dhe ngritje morale të atyre që kryejnë një detyrë të dhënë.
- I gjykojnë njerëzit nga forca e tyre dhe jo domos nga një përvojë e vetme negative.
- Nuk marrin meritë nga arritjet e dikujt tjetër dhe duan ta ndajnë me të tjerë meritën për cilëndo nga realizimet e veta.
- Sigurojnë faktet përpara se të përcaktojnë fajin apo të kritikojnë një person tjetër.
- Ndihmojnë të gjithë njerëzit që të ndiejnë se kanë pasur një rol të vërtetë në suksesin e një projekti.
- Urrejnë krijimin e situatave apo deklaratimet që përqendrohen në poshtërimin apo vëmendjen mbi një shpirt të vetëm.
- Gjithnjë kritikojnë në mënyrë konstruktive privatisht dhe bëjnë komplimente publikisht.
- Janë absolutisht të ndershëm në punën e tyre.
- Janë njësoj korrekt me të gjithë ata që janë nën drejtimin e tyre.
- Janë gjithnjë të gatshëm për të dëgjuar të dyja palët e një grindjeje, diskutimi apo çështjeje. Ata e dinë se është një pankejk (lloj petulle anglosaksone) shumë e hollë pjekur vetëm nga njëra anë...
- Janë të disponueshëm për të gjithë, jo vetëm për ata me pozitë apo pushtet.

Udhëheqësit-shërbyes të vërtetë nuk kanë nevojë për një listë kontrolli të këtyre tipareve, sepse ata i jetojnë ato përditë...

Udhëheqësit-shërbyes gjithashtu kuptojnë veçantinë dhe individualitetin e çdo personi. Vite

përpara më kujtohet që dëgjova legjendën greke të Prokrustit. Legjenda përmendte një "Shtrat të Prokrustit". Shtrati ishte një metër e tetëdhjetë centimetra i gjatë. Ata që nuk ishin një metër e tetëdhjetë centimetra të gjatë, i tendosnin për t'ia përshtatur shtratit. Atyre që ishin më shumë se një metër e tetëdhjetë centimetra, u priteshin centimetrat e tepërta. Çdokush duhej të përputhej me Shtratin e Prokrustit. Lumturisht, kjo nuk është mënyra e Zotit apo e mbretërisë së Tij. Ai ka thirrur gjithnjë burra dhe gra jo të zakonshme me ndershmëri, dëshirë, disiplinë dhe besim të madh në Krisht. Jo të gjithë do të përshtaten në të njëjtën masë shtrati as do të përshtaten të gjithë në të njëjtat thirrje.

Jo çdokush do të jetë – dhe nuk duhet të jetë – në majën absolute si udhëheqës në lagje, kunj apo në nivelin e përgjithshëm të Kishës, por çdokush mund të japë ndihmesat e veta më të mëdha si udhëheqës-shërbyes në një thirrje dhe rrethanë të veçantë. Dhe kjo është gjithçka që Shpëtimtari pret nga ne – më të mirën tonë, kudo që jemi.

#### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Cili është shembulli i një udhëheqësi ideal për Plakun Fedhërstoun Çfarë cilësish e bënë atë një udhëheqës të tillë?
- Përveç zemrës së gatshme, çfarë duhet të kemi tjetër për t'u bërë udhëheqës të mirë?
- Çfarë mund të bëjmë për të zhvilluar cilësitë që udhëheqësit vizionarë kanë të përbashkëta?
- Në çfarë kauzash mund të angazhohemi kur udhëheqim dhe shërbejmë në familjet tona, në organizatat e lagjes dhe të kunjit?
- Përse është e rëndësishme që një udhëheqës të jetë një shembull i mirë?
- Çfarë cilësie e udhëheqësve-shërbyes ndieni se është më e rëndësishme që ju të filloni ta zhvilloni? Si mund të filloni ta zhvilloni këtë cilësi? (Shënim: Nëse përdorni këtë pyetje në klasë, u thoni studentëve të shqyrtojnë përgjigjet e tyre në heshtje.)
- Si lidhet "Shtrati Prokrustian" me udhëheqjen?

# RESPEKTIMI I LIRISË SË ZGJEDHJES SË ATYRE QË UDHËHEQIM

*“Kështu që, gëzoni zemrat tuaja dhe kujtoni se ju jeni të lirë të veproni nga vetja juaj—të zgjidhni udhën e vdekjes së pafundme, ose udhën e jetës së përjetshme” (2 Nefi 10:23).*

## PARIM I UDHËHEQJES

Udhëheqësit duhet të shërbejnë në mënyra që i lejojnë të tjerët të ushtrojnë lirinë e tyre të zgjedhjes.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Udhëheqësit e Kishës dhe të familjes duhet të respektojnë lirinë e zgjedhjes së atyre që udhëheqin.
2. Sipas rastit, udhëheqësit duhet edhe të japin drejtim edhe të lejojnë të tjerët të marrin pjesë në vendime.

## KONCEPTI 1. UDHËHEQËSIT E KISHËS DHE TË FAMILJES DUHET TË RESPEKTOJNË LIRINË E ZGJEDHJES SË ATYRE QË UDHËHEQIN.

### KOMENT

Plaku Bojd K. Parker, i cili ishte atëherë anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, tha: “E vetmja liri zgjedhjeje për të cilën është folur [në shkrimet e shenjta] është liria e zgjedhjes në moral” (në Conference Report, prill 1992, f. 92; ose *Ensign*, maj 1992, f. 67; shih DeB 101:78). Kjo liri zgjedhjeje është aftësia për të zgjedhur midis së mirës dhe së keqes. Lehi shpjegoi se ne jemi “të lirë të [zgjedhim] lirinë dhe jetën e përjetshme, nëpërmjet Ndërmjetësit të madh të të gjithë njerëzve, ose të zgjedhim robërinë dhe vdekjen, sipas robërisë dhe fuqisë së djallit” (2 Nefi 2:27). Jezu Krishti e respektoi gjithmonë lirinë e zgjedhjes së atyre të cilëve u dha mësim gjatë shërbesës së Tij në vdekshmëri. Ai nuk i detyroi kurrë ata që t'i bindeshin Atij. (Shih Mateu 22:15–22; Lluca 18:18–30; Gjoni 6:28–71.)

Plani i përjetësisë i Atit Qiellor na lejon të kemi liri zgjedhjeje. Liria e zgjedhjes është e rëndësishme që ne të bëhemi si Ai. Kjo është arsyeja përse Luçiferi tentoi të shkatërronte lirinë tonë të zgjedhjes dhe Perëndia “[bëri] që ai të flakej tutje;

Dhe ai u bë Satani, po, madje djalli” (Moisiu 4:3–4).

Lehi na mësoi se, që ne të ushtrojmë lirinë tonë të zgjedhjes, duhet të ketë “një kundërshtim në të gjitha gjërat” (2 Nefi 2:11). Adami dhe Eva e përdorën lirinë e tyre të zgjedhjes në Kopshtin e Edenit për të përshpejtuar Rënien. Kur ushtrojmë lirinë tonë të zgjedhjes për të zgjedhur të drejtën, ne bëhemi më të drejtë dhe, kur ne e përdorim atë për të zgjedhur të gabuarën, bëhemi më të këqinj. Ne jemi përgjegjës për zgjedhjet tona në atë masë që ne i bëjmë lirisht ato. Pa lirinë e zgjedhjes nuk mund të ketë drejtësi apo ligësi.

Udhëheqësit duhet të udhëheqin tek e drejta dhe të nxisin të tjerët ta përdorin lirinë e tyre të zgjedhjes për kauzën e së drejtës.

### IDE MËSIMORE

Diskutoni kuptimin e fjalëve liri e zgjedhjes siç përdoret në kuadrin e ungjillit. Ndhmoni studentët të kuptojnë përse është e rëndësishme që udhëheqësit ta kuptojnë këtë parim.

Diskutoni me studentët Doktrina e Besëlidhje 121:41 dhe i ndihmoni të kuptojnë termat bindje, durim, mirësjellje, zemërbutësi dhedashuri e pashtirur. I ftoni studentët të gjejnë dhe të

tregojnë shembuj nga shkrimet e shenjta për njerëzit që i shfaqën këto cilësi kur udhëhiqnin.

Pyesni se si mund të tundohen udhëheqësit për të mos respektuar lirinë e zgjedhjes së të tjerëve. Ju mund të përdorni pyetje si këto që vijojnë:

- Nëse një udhëheqës përdor fajësimin për të motivuar një person të bëjë diçka, a po e respekton udhëheqësi lirinë e zgjedhjes së atij personi? Shpjegoni përgjigjen tuaj.
- Si lidhet përdorimi i konkurrencës për të motivuar njerëzit, me respektimin e lirisë së zgjedhjes? Për shembull, a mendoni se do të ishte një ide e mirë që pleqtë dhe priftërinjtë e lartë të shohin kush mund të marrë përqindjen më të lartë për mësimet shtëpie? Përse po ose përse jo?
- Si lidhet dhënia e shpërblimeve për vepra të mira me respektimin e lirisë së zgjedhjes së personit? (Një shembull do të ishte një prind që i ofron një fëmijë para për të marrë nota të mira.)

## **KONCEPTI 2. SIPAS RASTIT, UDHËHEQËSIT DUHET EDHE TË JAPIN DREJTIM, EDHE TË LEJOJNË TË TJERËT TË MARRIN PJESË NË VENDIME.**

### **KOMENT**

Shkrimet e shenjta na mësojnë se si të sillemi pa cënuar lirinë e zgjedhjes të të tjerëve. Profeti Jozef Smith, kur ishte i burgosur në Burgun e Libërtisë, u frymëzua që të shkruajë këto fjalë: “Kur përpiqemi t’i mbulojmë mëkatet tona ose të kënaqim krenarinë tonë, ambicien tonë të kotë ose të ushtrojmë kontroll apo sundim, apo detyrim mbi shpirtrat e fëmijëve të njerëzve, në çfarëdo shkallë padrejtësie, vini re, qiejt tërhiqen; Shpirti i Zotit hidhërohet; dhe kur ai tërhiqet, Amen priftërisë ose autoritetit të atij njeriu...”

Asnjë fuqi apo ndikim nuk mund ose nuk duhet të mbahet me anë të priftërisë, veçse nëpërmjet bindjes, nëpërmjet durimit, nëpërmjet mirësjelljes e zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pashtirur” (DeB 121:37, 41).

Plaku Van J. Fedhërstoun, anëtar i Të Shtatëdhjetëve, për këto vargje të shkrimit të shenjtë tha: “Kur analizojmë parimet në këtë

këshillë të mrekullueshme, ne shohim se ajo është në kontrast të madh me pikëpamjen e zakonshme të botës për udhëheqjen. Të udhëheqësh njerëzit nëpërmjet bindjes, është një porosi e shenjtë e Perëndisë. Bindja sugjeron një rive-ndosje, një ndryshim zemre, bindje apo përtëritje. Bindja i sjell ata që udhëheqim tek i njëjti nivel kuptimi që ne kemi. Ajo nuk i detyron njerëzit kundër vullnetit të tyre, por i ndihmon dishepujt e gatshëm që të ndryshojnë; kështu, vullneti i bindësit dhe vullneti i të bindurit bëhen një.

Durimi na sugjeron se Perëndia do që ne të kuptojmë se mënyra e Tij e të udhëhequrit nuk është një rregullim i shpejtë. Ne mësojmë, trajnojmë e ritrajnojmë dhe pastaj me durim presim për rezultatet që dëshironim. Durimi është më i thellë sesa thjeshtë të jesh i duruar. Ai kërkon ndjenja zemërdhembshura dhe kuptimin që çdo person është i ndryshëm. Disave mund të mos ua kapë mendja një koncept apo parim; të tjerë mund të mos bien dakord dhe kështu kanë nevojë për bindje; ndërsa të tjerë mund të mos kenë motivim. Udhëheqësi i duruar është më i interesuar për zhvillimin dhe trajnimin e shpirtave, sesa për ta përfunduar punën më shpejt ose në një mënyrë tjetër apo me dikë tjetër.

Presidenti Harold B. Li shpesh na tërhiqte vëmendjen mbi fjalën paralajmëruese të Zotit: ‘çdo njeri duhet ta mësojë detyrën e tij’. (DeB 107:99.) Fjala ishte duhet. Jeta si ajo e Krishtit kërkon përpjekje të përhershme dhe rritje” (*The Incomparable Christ: Our Master and Model* [1995], f. 125–126).

Nil A. Maksuell, që më vonë u thirr në Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve, shkroi se udhëheqësit në thelb ndjekin një nga tre stilet e të udhëhequrit: *manipulues*, *drejtues* dhe *pjesëmarrës*. Në udhëheqjen manipuluese, udhëheqësi manipulon njerëzit dhe rrethanat për të arritur qëllimet e grupit. Në udhëheqjen drejtuese, udhëheqësi merr vendime, me apo pa mendimin e grupit. Në udhëheqjen pjesëmarrëse, grupi ndan përgjegjësinë në marrjen e vendimeve. Lexoni diskutimin e Vëllait Maksuell mbi këto parime në burime për mësimin në seksionin më poshtë. Vini re se Vëllai Maksuell rekomandoi një kombinim të stileve udhëheqëse drejtuese dhe pjesëmarrëse.

## IDE MËSIMORE

Diskutoni tre stilet e udhëheqjes të përcaktuara nga Nil A. Maksiuell (manipulues, drejtues e pjesëmarrës) dhe i shkruani në tabelë. Nën secilin stil, rendisni anët e forta dhe të dobëta të tij. Lexoni nga deklarata e Vëllait Maksiuell fragmentin që vijon:

“Edhe përvoja, edhe shkrimet e shenjta sugjerojnë nevojën për një kombinim të stileve të udhëheqjes – *drejtues* dhe *pjesëmarrës*, në të cilat këto stile përdoren në ato rrethana që janë më të përshtatshme për to. Ne kemi në Kishë një kombinim unik të udhëheqjes drejtuese dhe të udhëheqjes pjesëmarrëse, në të cilën secili rritet dhe secili ecën përpara në aspektin e qëllimeve të përjetshme” (“... *A More Excellent Way: Essays on Leadership for Latter-day Saints*” [1967], f. 26).

I ftoni studentët të mendojnë për udhëheqës të suksesshëm të Kishës apo të familjes dhe i pyesni se çfarë i bën ata të suksesshëm. Diskutoni se në ç’mënyrë këta udhëheqës kombinojnë stilet udhëheqëse të përcaktuara nga Vëllai Maksiuell.

## BURIME PËR MËSUESIN



**Vëllai Nil A. Maksiuell**

*Ish-Anëtar i Ndjerë i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve*

“*Looking at Leadership*”, in “... *A More Excellent Way*”: *Essays on Leadership for Latter-day Saints*” (1967), f. 15–29.

... Udhëheqja [përfshin bashkëpunim]. Ajo përfshin gjithashtu rrezikim. E fshehta e udhëheqjes qëndron në kompleksitetin e një personaliteti njerëzor të shumëfishuar nga kompleksiteti i të gjitha palëve plotësuese të përfshira. Të përpjeksh të përshkruash udhëheqjen, është si të kesh disa shikues që përpiqen të krahasojnë atë që ata shohin në një kaleidoskop, ndërsa thjesht kalimi i kaleidoskopit nga njëri te tjetri e trondit figurën.

Në kërkim të përshkrimit të së fshehtës së udhëheqjes, përpjekje të panumërta janë bërë nga studiues dhe kërkues për të gjetur disa tipare kyçe që, nëse zotërohen nga udhëheqësit, mendohet se do t'i bënte ata të efektshëm në saje të këtyre dhuntive të epërme.

Ndërsa shumë nga ne mund të dallojnë udhëheqjen e mirë, kur ne e përjetojmë apo e vërejmë atë, është e vështirë që ne të veçojmë tiparet vendimtare në një mënyrë të qartë ...

Ndoshta është më mirë t'u largohesh pemëve, me qëllim që të shohësh pyllin. Veçoria është si një “pemë” që qartazi ka një rëndësi të vetën, por të gjitha pemët formojnë një pyll apo një model te personaliteti i udhëheqësit, madje edhe pse ne nuk mund të dallojmë qartë midis të gjitha pemëve apo të shohim rëndësinë e ndërvarësive të tyre.

Stili i udhëheqjes që zbaton një njeri (edhe pse jo doemos me vetëdije), buron nga idetë dhe ndjenjat e tij mbi natyrën e njeriut. Tomas Xheferson i tha një korrespondenti: “Ne të dy i konsiderojmë njerëzit si fëmijët tanë dhe i duam ata me dashuri atërore, por ju i doni ata si fëmijë të cilëve ju keni frikë t'u besoni pa dado dhe unë si të rritur të cilët i lë lirisht të vetëqeverisen”. Për disa, pikëpamjet e Xhefersonit kanë optimizëm të tepëruar. Profeti Jozef Smith, duke folur për qeverisjen e anëtarëve të Kishës, tha: “Unë u mësoj atyre parime të drejta dhe ata qeverisin veten”. Përsëri, shpirti nevojitet për të na ndihmuar të vetëqeverisemi.

Modelet më të larta për ne janë, sigurisht, Perëndia Atë dhe Jezu Krishti. Jozef Smithi na bën të ditur në librin e tij *Lectures on Faith* [Leksione mbi Besimin] se Perëndia ka përsosur secilin nga tiparet që e bëjnë atë Perëndi. Domethënë, ai është i përsosur në njohuri, forcë besimi, drejtësi, gjykim, mëshirë, të vërtetë dhe dashuri. Kur profeti përshkruan përsosmërinë e tij në secilën nga këto cilësi, ne mund të shohim qartë se, nëse ai nuk do të ishte i përsosur në secilën nga ato, ai nuk do të mund të ishte Perëndi. Njohuria e përsosur, pa dashuri të përsosur, do të ishte një gjendje e rrezikshme. Të ishim absolutë në fuqi, pa mëshirë të përsosur, do të ishte e padurueshme dhe, të ishim të përsosur në dashuri, pa qenë të përsosur në të vërtetë, do të na jepte sentimentalizëm të pakontrolluar. Çdo udhëheqës në këtë botë të afërt të vdekshmërisë, i cili nuk kërkon të punojë mbi po këto cilësi, nuk mund të jetë plotësisht i efektshëm apo plotësisht i sigurt në kuptimin e forcës që zotëron për të ndikuar dhe drejtuar jetën e të tjerëve...

... Është e vështirë për grupe dhe organizata që të ngrihen mbi nivelin e udhëheqjes së tyre dhe,



ndërsa udhëheqja jonë më e lartë është hyjnore, udhëheqja jonë e afërt formohet nga njerëz jo të përsosur, dobësitë e të cilëve kanë një ndikim të pashmangshëm mbi familjen, grupin dhe kishën, dhe mbi individët brenda këtyre mjediseve.

Duket se janë tre stile bazë udhëheqjeje, secili me kufizimet, epërsitë, variacionet dhe devijimet e veta. Ka, para së gjithash, udhëheqje manipuluese, që shkon në formën e saj më të ligë nga tipi makiavelian dhe vijon deri te tipi i manipulimit modest që secili nga ne, kohë pas kohe, me ose pa vetëdije, mund ta praktikojë ndaj atyre që janë përreth nesh.

Udhëheqja manipuluese ka disa epërsi: Ajo mund të japë ndonjëherë rezultate afatshkurtra, të zgjidhë një problem apo të kalojë një krizë duke manipuluar njerëz, ndjenja dhe kauza. Ajo herë-herë mund t’u japë pasuesve një ndjesi veprimi dhe realizimi, por përsëri nuk kërkon që udhëheqësi të marrë parasysh ndjenjat dhe idetë e anëtarëve të grupit të tij, gjersa ai është i lirë t’i manipulojë ata, t’i anashkalojë apo të përdorë naivitetin e tyre.

Dobësitë e kësaj forme udhëheqjeje janë: ajo mund të jetë, dhe zakonisht është, shtypëse; ajo kërkon të realizojë dëshirat e udhëheqësit dhe të plotësojë nevojat e tij, jo doemos nevojat e grupit. Ajo mund të dështojë keqas me një udhëheqës të lig apo të përfundojë në kaos me një udhëheqës që nuk është i stërholluar në manipulimin e tij dhe kështu më i prirur të zbulohet herët. Ajo përdor apo shpërfill njerëzit dhe ndjenjat e tyre, pa patur synim rritjen e tyre.

Një model i dytë bazë i udhëheqjes është udhëheqja drejtuese, në të cilën udhëheqësi kërkon të ruajë “përmasën psikologjike” më të madhe të tij në raport me anëtarët e grupit. Ai është figura mbizotëruese dhe, edhe pse mund të jetë shumë i sinqertë dhe i përkushtuar, ai qartazi deklaron çfarë i pëlqen dhe merr vendimet më jetike.

Kjo lloj udhëheqjeje ka këto lloje epërsish: shpesh ajo arrin rezultate me shpejtësi të konsiderueshme. Ajo u jep ndjekësve një ndjesi veprimi dhe realizimi. Ajo u jep atyre një ndjesi sigurie, veçanërisht me një udhëheqës që është një pikë grumbullimi rreth të cilit ata mund të mblidhen. Ajo shmang disa kufizime prej pazotësive si grup, gjersa udhëheqësi mund t’u drejtohet për ndihmë

anëtarëve të grupit atje ku është e përshtatshme, por nuk ka nevojë të detyrohet të ndajë gjithë vendimmarrjen me ta.

Ne të gjithë kemi parë shembuj të kësaj lloj udhëheqjeje në një krizë. Nuk është sot një formë e dashur udhëheqjeje në disa zona, por ne duhet të kujtojmë që ajo ka epërsi të vërteta. [Ish-Presidenti i Shteteve të Bashkuara] Herbert Huver vërejti se, ndërsa amerikanët pëlqejnë “njeriun e zakonshëm”, kur janë në krizë, të tillë si lufta, ata duan “gjenralin e pazakontë”. ...

Por ekzistojnë dobësi në udhëheqjen drejtuese: ajo mund të krijojë ndjekës shumë të varur që mbështeten tek udhëheqësi gjatë një teprie kohe, për një tepri gjërash, në një tepri rrethanash. Pa dyshim që Brigam Jangu foli prej këtij shqetësimi kur shprehte keqardhjen:

“Unë kam më shumë frikë se mos ky popull ka kaq shumë besim tek udhëheqësit e tij, saqë nuk do të kërkojë vetë nga Perëndia nëse ata udhëhiqen prej Tij. Kam frikë se mos ata kënaqen me një gjendje vetësigurie të verbër, duke e lënë të ardhmen e vet në duart e udhëheqësve të tyre me një mirëbesim të papërgjegjshëm, që në vetvete do të pengonte qëllimet e Perëndisë për shpëtimin e tyre dhe do të dobësonte atë ndikim që ata mund të ushtronin mbi udhëheqësit e tyre, nëse do ta dinin vetë, nëpërmjet zbulesave të Jezusit, se ata udhëhiqen në rrugë të drejtë.” [*Discourses of Brigham Young*, zgjedhur nga John A. Widtsoe (1941), f. 135.] ...

Presidenti Jang prekte një parim thelbësor të ndjekjes dhe udhëheqjes, në këtë rast të posaçëm. Nuk është e rëndësishme vetëm për rritjen e anëtarëve të përfshirë, që t’i drejtojnë kërkesat e tyre Perëndisë për t’u siguruar mbi drejtimin e mbretërisë, por është gjithashtu e rëndësishme për ndjekësit që të përgatiten për të ndjekur në mënyrë të tillë, që ndikimi i tyre të mund të jetë shumë më i dobishëm për udhëheqësit për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Jo vetëm që ndjekësit të cilët veprojnë, siç tha Brigam Jangu, “me besim të papërgjegjshëm” dështojnë të zhvillohen vetë në forcat dhe burimet që kanë, por gjithashtu privojnë udhëheqësit nga ajo lloj mbështetjeje që meritojnë dhe për të cilën kanë nevojë kohë pas kohe nga ndjekësit që janë duke zhvilluar vetë aftësitë që kërkohen. Seksioni 58 i

Doktrinës dhe Besëlidhjeve tregon se Zoti pret që anëtarët e Kishës të realizojnë shumë gjëra vetë, pa këmbënguljen apo shtytjen e pareshtur institucionale. Nuk është as realiste, as e urtë të presësh që udhëheqësit të japin gjithë kohës të gjitha përgjigjet, të japin zgjidhje për të gjitha problemet që do të lindin. Kjo do të kërkonte që udhëheqësit të ishin të gjithëdijshëm; më tej, do të kërkonte prej tyre atë lloje energjie dhe kohe të pandërprerë që thjesht nuk është e mundur për njeriun që ta japë për një periudhë kohe të tejzgjatur.

Këshilla nga Brigam Jangu është po aq e përshtatshme për sot, sa ishte edhe kur ai e dha. Është posaçërisht e nevojshme në një Kishë që po rritet në numër, në shtrirje dhe në planet strategjike në botën e sotme.

Ka një parim tjetër të mençur në këtë çështje. Ai lidhet me këshillën që Jethro i dha Moisiut kur i sugjeroi mënyrat me të cilat Moisiu mund ta udhëhiqte popullin e tij më me efektshmëri. Jethro e nxiti Moisiun të delegonte detyra, jo vetëm për shpëtimin e popullit, por gjithashtu për shpëtimin e vetë atij, sepse, siç vërejt Jethro: “Do të rraskapitesh më në fund, ti dhe ky popull që është me ty, sepse detyra që ke marrë përsipër është shumë e vështirë. Nuk mund t’ia dalësh në krye vetëm.” (Eksodi 18:18.)

Edhe me aftësitë e tij më të mëdha dhe hyjnore, kishte raste kur Jezusi kishte nevojë ta nxirrte veten nga gjendje të ngutshme ku ndodhej, për të komunikuar drejtpërdrejt me Atin e tij në qiell. Ai kishte nevojë që të mund të merrte forcë shpirtërore, sidomos ngaqë ishte gjithmonë duke dhënë. Ka një lodhje të vërtetë nga njerëzit, që mund t’i bllokojë udhëheqësit në disa situata; pikërisht në këto rrethana ata dëshpërimisht kërkojnë të kenë ndjekës të efektshëm, jo ndjekës që janë të varur prej tyre për këshilla në çdo çast.

Varësia e tepërt mund të pengojë qëllimet e Perëndisë, që dëshiron rritjen dhe zhvillimin tonë vetjak, dhe ndjekësit të cilët mund të jenë shumë më të efektshëm dhe mbështetës për udhëheqësit duke u bërë pjesë e përkushtimit të udhëheqësit.

Udhëheqja drejtuese gjithashtu ka dobësinë e mundshme që udhëheqësi shpesh nuk i ka parasysh të gjitha faktet dhe ndjenjat e ndjekësve të tij. Talentet e ndjekësve dhe të anëtarëve të grupit nuk mund të zhvillohen në mënyrë aq të plotë, veç nëse ata ndajnë më gjerësisht vendi-

mmarrjen dhe zbatimin. Ky lloj udhëheqjeje mund të dështojë edhe me një udhëheqës drejtues të sinqertë dhe të përkushtuar, sepse ai nuk përpiqet të mobilizojë burimet e plota të grupit të tij dhe edhe vetë nuk është gjithnjë mjaft i informuar për të shmangur gabimin.

Udhëheqja drejtuese, me të gjitha epërsitë që ka, mund të nxisë një qëndrim kërkues tek disa udhëheqës ndaj ndjekësve, kur ata përpiqen t’u japin urgjentisht udhëzime dhe informacion. Ajo është gati sikur këta udhëheqës në situata të tilla të donin të përhapnin me shpejtësi gjithçka që kishin për të thënë – udhëzuese apo informuese – dhe të lanin duart me të! Këto janë situata në të cilat ne ndershmërisht mund të kalojmë përgjegjësi shpirtërore thjesht duke ua thënë të tjerëve, por kjo nuk duhet të bëhet një stil i plotë udhëheqjeje. Në vend që të shfaqim atë lloj dashurie që është “tërësisht shkencë e durimit”, disa nga ne janë të gatshëm të sakrifikojnë për njerëzimin, sikurse shkroi Dostojevski, nëse “vuajtja nuk zgjat shumë dhe mbaron shpejt, ndërsa të gjithë na vështrojnë dhe duartrokin”.

Shumë shpesh një person drejtues i talentuar bëhet shumë i paduruar nga ngathtësia dhe mediokriteti i të tjerëve. Personi i talentuar gjithashtu mund të nervozohet nën mbikëqyrjen e dikujt që ai mendon se është inferior ndaj tij. Abraham Maslou ka vërejtur: “Kur pëllumbi sundon shqiponjën, shqiponja është e dërrmuar”. Por në një Kishë të shqiponjave dhe të pëllumbave, njerëzit duhet të mësojnë të ndjekin po ashtu si edhe të udhëheqin dhe ka raste kur pëllumbat përkohësisht udhëheqin shqiponjat dhe shqiponja ka një përgjegjësi të mësojë nga kjo përvojë ashtu siç bën pëllumbi. Por të talentuarit kanë gjithashtu barrë të tjera, siç e ka vërejtur edhe Maslou. Ata mund kenë aq shqetësim lidhur me epërsinë e tyre, saqë e frenojnë ndikimin e plotë të talentit të tyre nga frika se mos shihen nga të tjerët sikur janë tepër dominues dhe tepër kompetentë. Ajo që ndodh në situata të tilla, është një lloj demonstrimi i rremë i përlësisë. Nëse, sidoqoftë, “pëllumbat dhe shqiponjat” kanë një angazhim ndaj njëri-tjetrit dhe mirëqenies së ndërsjelltë, ka një mënyrë që ata mund të përfitojnë nga njëri-tjetri aftësi, talente dhe ndihmë të përshtatshme – por kjo kërkon një sistem hapjeje dhe besimi...

Një lloj i tretë i udhëheqjes është udhëheqja pjesëmarrëse, në të cilën anëtarët e grupit marrin pjesë gjerësisht në vendimmarrje, ku grupi drejtohet në mënyrë demokratike, si dhe zbatohen procedura dhe krijohen tradita për të garantuar që të jetë kështu. Kjo lloj udhëheqjeje ka këto lloj epërsish: ajo përdor shpesh talentet, ndjenjat dhe të dhënat e anëtarëve të grupit me shumë efektshmëri. Ajo u jep një mundësi anëtarëve të grupit që të investojnë në qëllimet dhe zgjidhjen e problemeve, në mënyrë që grupi të ketë më shumë përputhje dhe punë së bashku për arritjen e objektivave. Ajo shpesh krijon kushte të shkëlqyera për rritje vetjake.

Udhëheqja pjesëmarrëse përpiqet të aktivizojë burimet maksimale të anëtarëve të grupit. Kur ka sukses, kjo lloj udhëheqjeje rezulton në një arritje më të madhe sesa mund të japë individi i vetëm. Udhëheqja pjesëmarrëse paraprakisht pranon që secili ka diçka për të dhënë, gjë që përputhet me mësimin: “Sepse të gjithë nuk e kanë çdo dhuratë të dhënë atyre; sepse ka shumë dhurata dhe çdo njeriu i jepet një dhuratë me anë të Shpirtit të Perëndisë”. (DeB 46:11.)

Udhëheqja mbështetet në shkallë të madhe në atë lloj vendimmarrjeje që bën të efektshëm përdorimin e reagimit (komunikimi një personi apo grupi tjetër që i jep atij personi informacion se si i ka ndikuar të tjerët dhe si perceptohet në raport me qëllimet dhe synimet e tij). Udhëheqja pjesëmarrëse u jep liri atyre që duan të japin reagime të dobishme, ndërsa udhëheqja drejtuese shpesh vuan nga fakti se, kur udhëheqësi fiton më shumë autoritet dhe fuqi, mund të ketë gjithmonë e më pak gjasa që pasuesit t'i flasin hapur a tij, edhe pse ai do të donte të mos ishte kështu.

Dobësitë e udhëheqjes pjesëmarrëse janë se, kohë pas kohe, grupet përqendrohen me tepri tek ndjenjat dhe bëhen tepër të çmobilizuara për të ndërmarrë veprimin e nevojshëm. Një grup mund të mbajë vesh dhe të dëgjojë vetëm sinjalin e “një trumpete të pasigurt”. Zgjidhja e problemeve në grup, kur dështon, mund të rezultojë në shtypjen e krijimtarisë vetjake dhe në prodhimin e një mase të madhe mediokriteti.

Duke kujtuar punën e tij për teorinë e relativitetit, Albert Ajnshtajni vërejti “një ndjesi orientimi për të shkuar drejtpërdrejt tek diçka konkrete”. Kjo lloj qasjeje krijuese – “për të

shkuar drejtpërdrejt tek diçka konkrete” – në disa rrethana, mund të shtypet nga udhëheqja pjesëmarrëse. Edhe pse diskutimet me kolegët mund të kenë qenë të dobishme për Ajnshtajnin, qasjet krijuese shpesh arrihen në vetmi.

Një kritik i udhëheqjes pjesëmarrëse ka pyetur: “A mund të ishte pikturuar Mona Liza nga një komitet?” I njëjti kritik i procesit të grupit thotë se ai shpesh çon në “fshirjen e sigurive të brendshme të njëri-tjetrit”. Udhëheqja pjesëmarrëse ka gjithashtu dobësinë që, herë-herë, të përfundojë me manipulim të pavetëdijshëm dhe padashur të anëtarëve të grupit nga një figurë dominuese, ndërsa secili mendon me cektësi se po merr pjesë në vendimmarrje, gjë që nuk është e vërtetë.

Secili nga këto stile udhëheqjeje është në konflikt me problemet qendrore dhe periodike të udhëheqjes, të tilla si balancimi i nevojës për të kryer punën dhe nevojës për t’u kujdesur për ndjenjat e kolegëve dhe të pasuesve të vet. Ne të gjithë kemi qenë anëtarë të grupeve ku udhëheqësi ishte aq shumë i orientuar nga detyra, aq në ankth për kryerjen e punës, saqë, kur më në fund ajo ishte kryer, me një kosto të madhe emocionale, ajo nuk qëndronte si e tillë, sepse mospranimi i grupit për t’u pajtuar, në fund të fundit, e shkatërronte atë që dukej si një përpjekje e suksesshme. Ne kemi parë, gjithashtu, se si anëtarë të grupit mund të ndihen të fyer apo të tërhiqen, për shkak se udhëheqësit kanë qenë të orientuar me tepri nga detyra.

Ne kemi parë gjithashtu udhëheqës që çmobilizohen për shkak të kujdesit të tyre për ndjenjat e anëtarëve të grupit. Grupi mund të vuajë vërtet nga një zbrazëti e tillë udhëheqjeje. Ka disa rrethana në të cilat veprimi duhet të ndërmerret ...

Një lexim i vargjeve në Librin e Mormonit, që përshkruajnë lirinë e vërtetë të zgjedhjes, duke vepruar për veten në vend që të “detyrohen të veprojnë”, (2 Nefi 2:26) tregon se kjo e fundit lidhet me mjerimin ...

Edhe përvoja, edhe shkrimet e shenjta sugjerojnë nevojën për një kombinim të stileve të udhëheqjes – drejtuese dhe pjesëmarrëse – në të cilin këto stile përdoren në ato rrethana që janë më të përshtatshme për to. Ne kemi në Kishë një kombinim unik të udhëheqjes drejtuese dhe të udhëheqjes pjesëmarrëse në të cilën çdonjëri

rritet dhe çdonjëri ecën përpara në aspektin e qëllimeve të përgjithshme.

Do të ishte një këshillë e mirë për një president kuorumi të pleqve që po ndërton mbështetjen e kuorumit për një projekt ndihme dhe që nuk është i sigurt nëse grupi duhet të mbjellë misër apo bizele, veçanërisht nëse ai nuk është ekspert bujqësor, që të dëgjonte anëtarët e kuorumit të cilët mund ta këshillojnë se për cilën nga dy të mbjellat toka do të ishte më e përshtatshme për prodhim. Do të ishte gjithashtu këshillë e mirë që të përfshinte anëtarë të grupit në vendimmarrjen, meqë ata duhet të prashisin misrin apo të tëharrin bizelet – veç nëse presidenti do që ta bëjë gjithë këtë vetë! Udhëheqja pjesëmarrëse na ndihmon të shkojmë tek faktet dhe tek ndjenjat, që janë një formë tjetër e faktit, për të cilat ne duhet të interesohe mi thëllësisht.

Ka raste kur, sidoqoftë, udhëheqja drejtuese është qartas lloji i duhur i udhëheqjes. Brigam Jangu ndoshta do të kishte humbur vite duke punuar me disa anëtarë të vakët të Kishës, pas martirizimit të Profetit Jozef Smith, duke i nxitur ata që të bashkoheshin me të dhe të shkonin në perëndim. Por shenjtorët përfundimisht duhej të kalonin lumin Misisipi; ata duhej ta linin Navunë. Koha për veprim kishte ardhur. Në disa kushte, udhëheqësit duhet “ta kalojnë lumin”.

Një udhëheqës është më afër aftësisë së kombinimit të udhëheqjeve drejtuese dhe pjesëmarrëse, nëse ai personalisht dhe seriozisht është i angazhuar në procesin e synuar hyjnisht të përmirësimit të tipareve të tij të njohjes, besimit, drejtësisë, gjykimit, mëshirës, së vërtetës dhe dashurisë. Ai do të jetë atëherë më i efektshëm dhe mund t'i besohet më shumë fuqi dhe ndikim. Nëse ai do më përsosmërisht, ai do të ketë ndjeshmëri më të madhe ndaj ndjenjave të anëtarëve të grupit dhe do ta dijë kur është me vend t'i vërë theks udhëheqjes pjesëmarrëse. Nëse ai e rrit vazhdimisht bagazhin e tij të njohjes dhe të së vërtetës, ai do të ketë njohuri më të mira se ku mund të mbështetet, kur do t'i duhet të veprojë në mënyrë drejtuese. Anëtarët e grupit janë shumë më të prirur të kenë besim tek një udhëheqës, kur ata e shohin atë të përpjeket aktivisht që të zhvillojë këto lloj tiparësh. Një udhëheqës që është i shkujdesur për pushtetin, i pandjeshëm ndaj ndjenjave të anëtarëve të

grupit, apo që është tepër i sigurt për pikëpamjet e veta pa njohuri apo informacionin e duhur, nuk mund t'i frymëzojë pasuesit shumë gjatë. Një udhëheqës që përdor pozitën dhe autoritetin për të mbuluar mëkatet e tij, për të kënaqur krenarinë apo ambicien e tij, apo për të ushtruar kontroll apo sundim, do të dështojë si nga ana organizative, ashtu edhe shpirtërore.

Doktrina e Kishës që kemi është hyjnore. Ne kemi të gjitha përparësitë e të qenit pjesë e një mbretërie të ndërtuar, në të cilën Jezu Krishti është Mbreti i mbretërve dhe ligjvënësi, me një profet të gjallë si zëdhënësi i tij tokësor. Kjo na jep epërsinë e një qëllimi, njohurie dhe udhëzimi hyjnor më të lartë dhe epërsitë e autoritetit që mund të prodhojë veprim në rrethana që kërkojnë shpejtësi dhe reagim. Por Kisha është gjithashtu pjesëmarrëse, në atë që puna e Perëndisë është vërtet e jona. Ka mundësi të bollshme për ne – shumë më tepër nga sa përdorim – që të përfshihemi si udhëheqës dhe ndjekës në veprimtari që do të ndërtojnë mbretërinë dhe gjithashtu do të na ndihmojnë të rritemi. Ne kemi më shumë mundësi sesa do të njohim ndonjëherë, për të përdorur talentet tona dhe për t'i përfshirë ndjenjat e të dhënat tona në procesin e vendimmarrjes të Kishës në ato situata ku udhëheqja pjesëmarrëse është e përshtatshme...

Nëse do ta nderonim Perëndinë në stilin e veçantë të udhëheqjes që secili nga ne merr përsipër, ne do ta nderonim Atë më mirë duke marrë si shembull Atë në zhvillimin e atyre tipareve që sigurojnë një udhëheqje të urtë, të efektshme dhe të sigurt...

#### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Sipas Vëllait Maksuell, në çfarë kuptimi udhëheqja është, të paktën pjesërisht, një e fshehtë?
- Cilët janë tre stilet bazë të udhëheqjes që dallon Vëllai Maksuell? Cilat janë anët e forta dhe të dobëta të secilit?
- Cilin stil rekomandoi Vëllai Maksuell për udhëheqësit e Kishës?
- A mendoni se udhëheqësit mund ta përmirësojnë më shumë udhëheqjen e tyre duke punuar për aftësitë organizative apo duke punuar për kuptimin dhe zbatimin e parimeve bazë të udhëheqjes? Shpjegoni.

# TË BËHESH NJË BARI I MIRË

*“Unë jam bari i mirë, dhe i njoh delet e mia dhe ato më njohin mua, ashtu siç më njeh Ati mua dhe unë e njoh Atin dhe lë jetën time për delet” (Gjoni 10:14–15).*

## PARIM I UDHËHEQJES

Udhëheqësit duhet të shfaqin dashuri dhe interesim për ata që udhëheqin.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Jezu Krishti është Bari i Mirë.
2. Udhëheqësit e familjes dhe të Kishës duhet të përpiqen të ndjekin modelin e udhëheqjes të vendosur nga Zoti.

## KONCEPTI 1. JEUZU KRISHTI ËSHTË BARI I MIRË.

58–60; Halamani 7:18; 15:13; Mormoni 5:17; DeB 50:44.)

### KOMENT

Në Bibël, barinjte janë përdorur për të përfaqësuar udhëheqësit e popullit të Perëndisë (shih Isaia 63:11; Jeremia 23:2). Barinjte vrojtojnë për armiq që mund të sulmojnë delet dhe, kur është e nevojshme, i mbrojnë ato. Ata kujdesen për delet e sëmura apo të plagosura dhe kërkojnë e shpëtojnë ato që kanë humbur apo ngecur. Në mësimet e Krishtit barinjte i duan delet e tyre dhe përpiqen të fitojnë besimin e tyre. Delet i njohin, i duan dhe u besojnë barinjve më shumë se kujtdo tjetër. Një bari i mirë madje do të vdiste për delet e tij. Krishti krahason bariun me rrogëtarin, që i braktis delet në kohë rreziku, sepse nuk i do ato (shih Gjoni 10:11–13; *The Life and Teachings of Jesus and His Apostles* [Religion 211 dhe 212 manual i studentit, 1979], f. 108–109).

Jezu Krishti është Bari i Mirë. Tek Gjoni 10:14–15 Jezusi shpjegon se Ai dhe delet e Tij e njohin njëri-tjetrin, ashtu si Ai dhe Ati i Tij e njohin njëri-tjetrin. Kjo lloj marrëdhënieje zhvillohet me kohë dhe kërkon përvojë vetjake. (Për referenca të tjera mbi Krishtin si bari, shih Zanafilla 49:24; Psalmet 23; 80:1; Gjoni 10:1–30; Hebrejve 13:20; 1 Pjetri 2:25; 5:4; Alma 5:37–38,

Plaku Henri B. Ajring nga Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve komentoi: “Një bari mbikëqyr dele. Në tregimet në shkrimet e shenjta delet janë në rrezik; ato kanë nevojë për mbrojtje dhe ushqim. Shpëtimtari na paralajmëron se duhet të mbikëqyrim delet ashtu siç bën Ai. Ai dha jetën e Tij për ato. Ato janë të Tijat. Ne nuk mund t’i afrohem standardit të Tij nëse, si shërbëtori me pagesë, ne vrojtojmë vetëm kur na vjen mbarë dhe vetëm për një shpërblim...

Anëtarët e Kishës janë delet. Ata janë të Tijet dhe ne jemi thirrur nga Ai për t’i mbikëqyruar ata. Ne duhet të bëjmë më shumë sesa t’i paralajmërojmë ndaj rrezikut. Ne duhet t’i ushqejmë ato” (në Conference Report, mars–prill 2001, f. 49; ose *Ensign*, maj 2001, f. 38).

### IDE MËSIMORE

U thoni disa studentëve të lexojnë për klasën shkrimet e shenjta të cituara në paragrafin e dytë të komentit, duke u kushtuar vëmendje titujve të Jezu Krishtit në këto fragmente.

Drejtoni pyetje si më poshtë. Përdorni informacionin te komenti për të ndihmuar diskutimin tuaj.

- Përse janë kaq të rëndësishëm barinjtë?
- Çfarë bëjnë barinjtë?
- Si ndryshojnë rrogëtarët nga barinjtë?
- Sa ndryshe mund të reagojnë delet nën kujdesin e një bari dhe nën atë të një rrogëtari?
- Çfarë bëri Jezusi gjatë shërbesës së Tij tokësore, që na mëson se çfarë do të thotë bari?

## **KONCEPTI 2. UDHËHEQËSIT E FAMILJES DHE TË KISHËS DUHET TË PËRPIQEN TË NDJEKIN MODELIN E UDHËHEQJES TË VENDOSUR NGA ZOTI.**

### **KOMENT**

Zoti u thotë udhëheqësve të Kishës dhe të familjes të jenë barinj. Presidenti Xhejms E. Faust na mësoi: “Sonte do të dëshiroja t’i flisja priftërisë së Perëndisë në cilësinë e tyre si barinj të Zotit. Plaku Brus R. Mek-Konki deklaroi: ‘Kushdo që shërben në çfarëdo cilësie në Kishën ku ai është përgjegjës për mirëqenien shpirtërore apo materiale të cilitdo prej fëmijëve të Zotit, është një bari për ato dele. Zoti i mban përgjegjës barinjtë e tij për sigurinë [domethënë shpëtimin] e deleve të tij’ [Mormon Doctrine, botimi i 2-të (1966), f. 710]. Mbajtësit e priftërisë kanë këtë përgjegjësi të madhe, qoftë si baba, gjysh, mësues shtëpie, president i kuorumit të pleqve, peshkop, president kunji, apo thirrje tjetër e Kishës” (në Conference Report, prill 1995, f. 62; ose *Ensign*, maj 1995, f. 45–46).

Ne mund të bëhemi barinj të mirë vetëm kur afrohemi tek Zoti. Plaku Henri B. Ajring shpjegoi: “Ai që i sheh të gjitha gjërat, dashuria e të cilit është pa fund dhe që nuk fle kurrë – Ai mbi-këqyr me ne. Ai e di për çfarë kanë nevojë delet në çdo çast. Me fuqinë e Frymës së Shenjtë, Ai mund të na tregojë dhe të na dërgojë tek ato...”

Dashuria është ajo që duhet të motivojë barinjtë e Izraelit. Kjo mund të duket e vështirë në fillim, sepse ne madje mund të mos e njohim mirë Zotin. Por nëse fillojmë qoftë edhe me një besim sa një kokërr sinapi tek Ai, shërbimi ynë për delet do të rrisë dashurinë tonë për Të dhe për ato. Ajo vjen nga gjërat e vogla që çdo bari

duhet të bëjë. Ne lutemi për delet, për çdonjë-rën për të cilën ne jemi përgjegjës. Kur pyesim: ‘Të lutem më thuaj kush ka nevojë për mua’, do të vijmë përgjigje. Një fytyrë apo një emër do të na vijë në mendje. Ne ose mund të kemi një takim të rastit që ne e ndiejmë se nuk është një rastësi. Në ato çaste ne do të ndiejmë dashurinë e Shpëtimtarit për ato dhe për ne. Ndërsa mbi-këqyrni delet e Tij, dashuria juaj për Të do të rritet. Dhe kjo do të rrisë besimin tuaj dhe kurajën tuaj” (në Conference Report, mars–prill 2001, f. 51; ose *Ensign*, maj 2001, f. 39–40).

### **IDE MËSIMORE**

Tregoni figurat në fund të këtij mësimi. Cilën prej tyre Shpëtimtari e bëri shembull? Pse?

Lexoni si klasë Moroni 7:47. Diskutoni dashurinë hyjnore dhe theksoni se, gjersa dashuria hyjnore është dashuri e pastër e Krishtit, kur ne kemi dashuri hyjnore për të tjerët, ne i duam ata ashtu si Ai na do neve. Diskutoni përse ky qëndrim është i rëndësishëm për udhëheqësit e familjes dhe të Kishës.

Diskutoni përse udhëheqësit e familjes dhe të Kishës duhet të jenë barinj për ata që udhëheqin (shih komentin).

Lexoni deklaratën nga Plaku Ajring te komentin. Diskutoni pyetje të tilla si:

- Sipas Plakut Ajring, çfarë mund të rrisë besimin dhe kurajën tonë si udhëheqës?
- Si lidhet shërbimi me dashurinë?
- Cilat kushte në botë kërkojnë që udhëheqësit tanë të jenë barinj të mirë?
- Si mund të përcaktojmë se cilat shprehje të dashurisë dhe interesimit janë të përshtatshme në rolin tonë si udhëheqës?

U thoni studentëve të lexojnë Alma 56:3–11, 17, 43–49, 55–56 dhe i diskutoni vargjet si klasë.

Drejtoni pyetje të tilla si:

- A mendoni se Helamani ishte një bari i mirë? Pse?
- Si iu përgjigjen dy mijë të rinjtë e udhëhequr nga Helamani udhëheqjes së tij?

- A mendoni se këta dy mijë të rinj do të ishin më pak të suksesshëm nën një stil tjetër udhëheqjeje? Pse?

I nxitni studentët të zhvillojnë për çdo njeri dashuri si ajo e Krishtit, në mënyrë që të jenë të përgatitur për të qenë barinj të mirë kur vjen rasti.

## BURIME PËR MËSUËSIN



### **Plaku Xhejms E. Faust**

*Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve*

*“These I Will Make My Leaders”, në Conference Report, tetor 1980, f. 50–54; ose Ensign, nëntor 1980, f. 34–37*

Unë jam i përlur për mundësinë që më jepet t'i drejtohem priftërisë këtë mbrëmje. Do të dëshiroja t'ia drejtoja vërejtjet e mia udhëheqësve të Kishës dhe veçanërisht udhëheqësve të ardhshëm, të rinjve të Priftërisë Aarone. Shumë nga ju të rinj do të kenë përgjegjësi udhëheqëse më herët nga sa e përfytyroni. Nuk duket shumë kohë e gjatë që kurse unë isha president i kuorumi të dhjakëve. Për sa i përket rritjes së Kishës në mbarë botën me ritme të shpejta, udhëheqja është një nga sfidat tona më të mëdha.

### **Udhëheqësit marrin dhe japin detyra**

Rreth një vit përpara unë mora pjesë në një mbledhje kuorumi të pleqve. Anëtarët e presidencisë ishin të rinj të aftë të mrekullueshëm; por, kur shkonin tek ndarja e përgjegjësive të kuorumi dhe kryerja e punës, ata e kufizonin atë tek ata që ishin të pranishëm dhe që do të dilnin vullnetarë. Asnjë detyrë nuk u dha.

Një nga parimet e para që duhet të mbajmë në mendje, është që puna e Zotit shkon përpara nëpërmjet detyrave. Udhëheqësit marrin dhe japin detyra. Kjo është një pjesë e rëndësishme e parimit të nevojshëm të delegimit. Asnjë nuk e vlerëson më shumë se unë një vullnetar të gatshëm, por puna në tërësi nuk mund të bëhet ashtu siç e do Zoti, thjesht nga ata që bëjnë

punë dhe që mund të jenë të pranishëm në mbledhjet. Unë shpesh kam vrarë mendjen se ç'pamje do të kishte toka, nëse Zoti në Krijim do ta kishte lënë punën të bëhej vetëm nga vullnetarë.

Nëse e shohim përmbushjen e detyrave si ndërtim të mbretërisë së Perëndisë e si një mundësi e dhënë dhe po ashtu si një privilegj dhe një nder, atëherë detyrat dhe sfidat duhet t'i jepen me siguri çdo anëtarit të kuorumi. Një përfshirje e tillë duhet të përfshijë, me urtësinë dhe kujdesin e duhur, ata që ndoshta kanë më shumë nevojë për to – vëllezërit joaktivë dhe pjesërisht aktivë. Detyrat gjithnjë duhet të jepen me dashurinë, konsideratën dhe mirësinë më të madhe. Ata të cilëve u kërkohet t'u përgjigjen, duhet të trajtohen me respekt dhe vlerësim.

Autoritetet e Përgjithshme marrin detyra rregullisht nga Presidencia e Parë dhe nga Presidenti i Këshillit të Të Dymbëdhjetëve. Qoftë kur detyra të tilla vijnë me shkrim, siç ndodh në më të shumtën, apo jepen personalisht, ato gjithnjë shoqërohen me “nëse do t'ju pëlqente” apo “nëse ju përshtatet” apo “A do të kishit mirësinë t'i kushtonit vëmendje kësaj apo asaj”. Kurrë nuk hartohen këto detyra në formë urdhri apo kërkese.

### **Ndiqui shembullin e Shpëtimtarit**

Qysh kur shkova për herë të parë në Egjipt në Luftën II Botërore, kam qenë i interesuar për rrënojat antike. Ka një kuriozitet të vëresh përse disa kolona qëndrojnë ende dhe të tjera janë rrëzuar. Shumë shpesh ato që ende qëndrojnë, qëndrojnë sepse ato kanë një peshë përsipër. Atje ka, besoj, një parim të ngjashëm me udhëheqjen. Ata që qëndrojnë besnikë ndaj priftërisë së tyre janë shpesh ata që mbajnë një peshë përgjegjësie. Ata që përfshihen janë ata që ka më shumë gjasa që të angazhohen. Kështu, një udhëheqës i suksesshëm kuorumi do të dojë që të gjithë anëtarët e kuorumi të kenë një mundësi të shërbejnë me ndonjë lloj thirrjeje të përshtatshme për rrethanat.

Mësimi i shkurtër më përfshirës mbi udhëheqjen është dhënë nga vetë Shpëtimtari: “Dhe u tha atyre: ‘Ndiqmeni’ (Mateu 4:19). Një udhëheqës

nuk mund t'u kërkojë të tjerëve atë që nuk është i gatshëm ta bëjë vetë. Kursi ynë më i sigurt është të ndjekim shembullin e Shpëtimtarit dhe siguria jonë është të dëgjojmë dhe të ndjekim drejtimin e profetit të tij, Presidentit të Kishës.

### **Udhëheqësi i mirë “shpreson shumë, frymëzon thellësisht”**

Disa vite përpara isha në udhëtim në Misionin e Rosarios, Argjentinë, sipër në pjesën veriore të Argjentinës. Duke udhëtuar përgjatë rrugës, kaluam një kope të madhe bagëtish të trasha në lëvizje. Kopeja po lëvizte qetësisht dhe pa vështirësi. Kopeja ishte e shtruar. Nuk kishte qenë. Në ballë, duke udhëhequr kopenë, ishin tre gauços mbi kuaj, secili rreth 14 deri 18 metra nga njëri-tjetri. Këta tre kalorës ishin të përkulur mbi shalën e kalit, tërësisht të lirshëm, të sigurt se kopeja do t'i ndiqte. Mbrapa kopesë ishte një kalorës i vetëm që kujdesej për fundin. Ai, gjithashtu, ishte përkulur në shalën e tij sikur të ishte në gjumë. E gjithë kopeja lëvizte në paqe, e qetë dhe ishte e nënshtruar. Nga kjo përvojë dukej qartë për mua se udhëheqja është në rreth tre të katërtat e saj ‘trego rrugën’ dhe në rreth një të katërtën ‘ndiq nga prapa’.

Vetë udhëheqësi, kur drejton, nuk i duhet të jetë bombastik dhe i zhurmshëm. Ata që janë thirrur të udhëheqin në shërbesën e Mjeshtrit, nuk thirren që të jenë shefa apo diktatorë. Ata janë thirrur të jenë barinj të mirë. Ata duhet të jenë gjithnjë në trajnim të të tjerëve për të zenë vendin e tyre dhe që të bëhen udhëheqës më të mëdhenj sesa mësuesit e tyre. Një udhëheqës i mirë shpreson shumë, frymëzon thellë dhe ua ndez entuziazmin atyre që thirret t'i udhëheqë.

Tani, një udhëheqës duhet të sjellë realizim të gjërave dhe ndikim të jetëve. Diçka duhet të lëvizë dhe të ndryshojë. Ai duhet të shohë që ata që udhëhiqen prej tij, të mos gabojnë. Por kjo duhet të bëhet në mënyrën e Zotit. Ai duhet të jetë një instrument në duart e të Gjithëfuqishmit për ndryshimin e jetëve. Ai duhet të dijë ku është tani, ku po shkon dhe si do të arrijë atje.

### **Dëgjimi**

Një udhëheqës duhet të jetë një dëgjues i mirë. Ai duhet të jetë i gatshëm që të marrë këshillë. Ai duhet të tregojë një interesim dhe dashuri të vërtetë për ata që janë nën kujdesin e tij. Asnjë udhëheqës priftërie nuk mund të jetë kurrë i efektshëm, veçse kur ai mban fort në mendje çelësat e jashtëzakonshëm të udhëheqjes që gjenden në seksionin 121 të Doktrinës dhe Besëlidhjeve:

“Asnjë fuqi apo ndikim nuk mund ose nuk duhet të mbahet me anë të priftërisë, veçse nëpërmjet bindjes, nëpërmjet durimit, nëpërmjet mirësjelljes e zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pashtirur;

Nëpërmjet mirësisë dhe diturisë së pastër, të cilat do ta zgjerojnë shumë shpirtin, pa hipokrizi dhe pa mashtrim—

Duke qortuar në kohën e duhur me mprehtësi, kur u nxite nga Fryma e Shenjtë; dhe atëherë duke treguar më pas rritje të dashurisë ndaj atij që e ke qortuar, që ai të mos të të vlerësojë si armikun e tij” (DeB 121:41–43).

Në përvojën time, Fryma e Shenjtë lëviz për të qortuar me mprehtësi vetëm shumë rrallë. Çdo qortim duhet të bëhet butësisht, në përpjekje për të bindur personin që qortohet se kjo bëhet në vetë interesin e tij...

### **Ndihma hyjnore**

Me besim në Zot dhe me përulesë, një udhëheqës priftërie mund të presë me besim ndihmë hyjnore për problemet e tij. Mund të kërkohej përpjekje dhe mendim, por shpërbëlimi është i sigurt. Përgjigjja mund të vijë siç i erdhi Enosit: “Zëri i Zotit erdhi në mendjen time”, tha ai (Enosi 1:10). Ose mund të jetë ndjesi në kraharor sipas seksionit 9 të Doktrinës dhe Besëlidhjeve.

Pasi të marrë një siguri të tillë hyjnore me dhe nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, udhëheqësi i përuhur mundet pastaj të ndjekë një drejtim të palëkundur me bindje absolute në mendje dhe në zemër se ajo që po bëhet është në drejtimin e duhur dhe është ajo që Zoti vetë do të bënte për çështjen...



Shumë nga ne që janë thirrur të udhëheqin në Kishë, ndihemi sikur jemi të papërshtatshëm për shkak të mungesës së përvojës, të mungesës së aftësisë apo të mësimit dhe arsimit të pamjaftueshëm. Një nga përshkrimet e shumta për Moisiun është i mëposhtmi: “Sepse Moisiu ishte një njeri shumë zemërbutë, më tepër se kushdo mbi faqen e dheut” (Numrat 12:3).

Vite më parë, mbaj mend Presidentin Xhon Kelli, i cili kryesonte atëherë Kunjin e Fort-Uorthit, Teksas, që thirri Vëllanë Feliks Velaskez që të ishte president i degës spanjolle. Ky njeri i mirë punonte, siç mbaj mend, si inspektor makinash në hekurudhë. Kur presidenti Kelli e thirri atë në këtë shërbim, ai u përgjigj: “President, unë nuk mund të jem president i degës spanjolle. Unë nuk di të lexoj.” Presidenti Kelli i premtoi pastaj se, nëse do të pranonte thirrjen dhe do të punonte me zell për ta lartësuar atë, ai do të merrte mbështetje dhe do të bekohej. Me ndihmën e Zotit, ky njeri i përulur, nëpërmjet përpjekjeve të tij të zellshme, u bë i aftë të lexonte. Ai shërbeu mirë si president dege dhe, për shumë vite më pas, edhe tani, po shërben në këshillin e lartë të atij kunji. Zoti i bekon shërbëtorët e tij në shumë mënyra...

### **Këshillimi; “gjenia e udhëheqjes”**

Po vij tani tek gjenia e udhëheqjes, nëpërmjet priftërisë, në qeverisjen e Kishës. Unë dua të citoj Presidentin Stiven L. Riçards, që ka thënë:

“Siç e kuptoj unë, gjenia e drejtimit të Kishës sonë është drejtimit nëpërmjet këshillave... Vështirë të kalojë një ditë që të mos shoh urtësinë, urtësinë e Perëndisë, në krijimin e këshillave: për të drejtuar Mbretërinë e tij. Në shpirtin me të cilin punojmë, njerëzit mund të bashkohen me pikëpamje në dukje të papajtueshme e tradita shumë të ndryshme dhe, nën veprimin e atij shpirti, duke u këshilluar së bashku, ata mund të arrijnë në një marrëveshje.” (Në Conference Report, tetor 1953, f. 86; korsivët shtuar.)

Këshillimi së bashku si udhëheqës është çelësi për funksionimin e suksesshëm të një presidenciaje apo të një këshilli të peshkopit. Por çfarë

ndodh nëse uniteti në vendimmarrje është i vështirë apo mungon? Presidenti Jozef F. Smith na dha këtë këshillë:

“Kur peshkopët dhe këshilltarët e tyre nuk bien dakord ose kur presidentët dhe këshilltarët e tyre kanë çfarëdo ndryshimi në opinionet e tyre ose në politikën e tyre, është detyrë e tyre të mblidhen së bashku, të shkojnë së bashku para Zotit dhe ta përulin veten para tij derisa të marrin zbulues nga Zoti dhe ta shohin njëllonj të vërtetën, që ata të mund të shkojnë në unitet para popullit të tyre” (*Gospel Doctrine*, [botimi i 5-të (1939)], f. 156).

### **Ji shembull i drejtësisë vetjake**

Ata që do të udhëhiqnin këtë Kishë duhet të jepnin shembullin e drejtësisë vetjake. Ata duhet të kërkonin për drejtimit të përhershëm nga Fryma e Shenjtë. Ata duhej të kishin jetën dhe shtëpinë e tyre në rregull. Ata duhej të ishin të ndershëm dhe të gatshëm të paguanin faturat e tyre. Ata duhet të ishin shembull në të gjithë sjelljen e tyre. Ata duhej të ishin burra të nderit dhe të integritetit moral. Kur kërkojmë për drejtimit të përhershëm nga Fryma e Shenjtë, Zoti do të përgjigjet.

Kur shërbeja si Mbikëqyrës Zone në Amerikën e Jugut, një përvojë shumë e paharrueshme ndodhi në Montevideo, Uruguaj. Unë doja të këmbëja disa para, sepse jetoja në Brazil në atë kohë, prandaj, Vëllai Karlos Prat më shoqëroi në një zyrë këmbimi të hollash në qendrën e Montevideos. Ai më prezantoi tek një nga nëpunësit dhe nëpunësi tha se mund të këmbënim 1.000 dollarë. Unë nuk kisha 1.000 dollarë para në dorë dhe kisha vetëm një çek të tërhequr në një bankë në Solt-Lejk-Siti. Zyra e këmbimit të parave nuk më kishte shërbyer kurrë më parë. Në fakt, ata nuk më kishin parë asnjëherë më parë dhe nuk mund të prisnin të më shihnin më ndonjëherë. Ata nuk kishin asnjë mënyrë që të verifikonin nëse kisha depozitë me 1.000 dollarë në bankën ku kisha tërhequr çekun. Por ata e pranuan çekun tim pa ngurrim – të mbështetur vetëm në faktin që isha mormon dhe që ata kishin pasur të bënin

më parë me mormonë të tjerë. Sinqerisht, unë isha edhe mirënjohës, edhe i kënaqur nga mirëbesimi i tyre...

### “Forco vëllezërit e tu”

Kur Shpëtimtari po i bënte Pjetrit pak trajnim për udhëheqjen, ai tha: “Kur të jesh kthyer, forco vëllezërit e tu” (Lluka 22:32).

Është interesante që ai përdori fjalën forco. Është shumë e vështirë të forcosh pa qënë një komunikues i mirë. Shpesh problemet ndërlikohen, jo sepse plani është i gabuar, por sepse komunikimi është i pamjaftueshëm...

Udhëheqësit e priftërisë kanë mundësinë e rralle të drejtojnë intervista të priftërisë. Veçanërisht, nëpërmjet kontakteve vetjake dhe intervistave udhëheqësi mund të përmbushë sa më poshtë:

1. Të frymëzojë dhe të motivojë.
2. Të delegojë dhe të japë në mirëbesim.
3. Të kërkojëpërgjegjësi dhe të ndjekë ecurinë.
4. Të japë mësim nëpërmjet shembullit dhe parimit.
5. Të jetë zemërgjerë në vlerësim.

Ndonëherë udhëheqësit i mbajnë frerët tepër fort, shpesh duke kufizuar talentet dhe dhuntitë e atyre që janë thirrur të punojnë në krah të tyre.

Udhëheqja nuk prodhon gjithnjë një simfoni të harmonishme besimi, aftësish dhe talentesh të grupit, që jep maksimumin e efektshmërisë dhe të fuqisë. Ndonjëherë ajo është një solo zëllartë. Presidenti Li na mësoi një kuptim më të plotë të shkrimit të shenjtë: “Si rrjedhim, tani çdo njeri duhet ta mësojë detyrën e tij dhe të veprojë në thirrjen që është caktuar, gjithë zell” (DeB 107:99). Përveçse të na vënë të gjithëve që të mësojmë detyrat tona, udhëheqësit duhet të lejojnë shoqëruesit e tyre të jenë plotësisht të efektshëm brenda detyrës dhe thirrjeve të tyre dhe ndihmësit duhet të jenë të veshur plotësisht me autoritetin e përshtatshëm...


Unë lutem që, duke punuar me zell nën drejtimin e Frymës së Shenjtë, ata që kanë dhe do të kenë thirrje për të udhëhequr, të shohin detyrën tonë më qartë dhe të kenë një vizion më të largët për të vendosur objektiva dhe për të përvijuar një kurs më të drejtë.

Dëshmia ime është që kjo Kishë rritet dhe ka sukses sepse ne jemi nën ndikimin drejtues të priftërisë së shenjtë të Perëndisë. Unë besoj se udhëheqësit tanë mund të krijojnë fuqinë e madhe shpirtërore që nevojitet për të drejtuar punën e Perëndisë nëpërmjet zbulësës vetjake, të cilën u është dhënë e drejta ta kenë me drejtësi. Këshilla e Zotit drejtuar Jozueut është e paçmueshme: “A nuk të urdhërova unë? Ji i fortë dhe trim; mos ki frikë dhe mos u thyej, sepse Zoti, Perëndia yt, është me ty kudo që të shkosh.” (Jozueut 1:9.)

Që të mund të jetë kështu, unë lutem për ulësisht në emrin e Jezu Krishtit, amen.

### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Përse është e rëndësishme që udhëheqësit t’u caktojnë detyra atyre që kryesojnë?
- Çfarë parimesh rregullojnë dhënien e detyrave?
- Çfarë parimi udhëheqjeje qëndron prapa këshillës së Shpëtimtarit: “Ndiqmëni”?
- Si munden udhëheqësit të dinë se po udhëheqin në rrugën që Zoti do?
- Përveçse për t’u bërë të denjë për të patur Shpirtin, çfarë mund të bëjnë udhëheqësit për të plotësuar përgjegjësitë e tyre ndaj atyre që udhëheqin?
- Çfarë është “gjenia e udhëheqjes”?
- Çfarë mund të ndodhë nëse udhëheqësit përpiqen t’i “mbajnë frerët tepër fort”?



## DHËNIA E NJË SHEMBULLI TË MIRË

*“Ju jeni drita e botës; një qytet i ngritur në majë të malit nuk mund të fshihet.*

*Po ashtu nuk ndizet një qiri për ta vënë nën babunë, por për ta vënë mbi shandan, dhe t’u bëjë dritë të gjithë atyre që janë në shtëpi.*

*Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej” (Mateu 5:14–16).*

### PARIM I UDHËHEQJES

Udhëheqësit duhet të japin një shembull të të qenit dishepull për njerëzit të cilëve u shërbejnë.

### KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Kur udhëheqësit punojnë për të zhvilluar tipare të Jezu Krishtit, ata japin një shembull për ata të cilëve u shërbejnë.

### KONCEPTI 1. KUR UDHËHEQËSIT PUNOJNË PËR TË ZHVILLUAR TIPARE TË JEZU KRISHTIT, ATA JAPIN NJË SHEMBULL PËR ATA TË CILËVE U SHËRBEJNË.

#### KOMENT

Kur Zoti i ringjallur vizitoi Kontinentet Amerikane, Ai u shpjegoi dishepujeve të Tij se, të lejonin që drita e tyre të ndriçonte, do të thoshte të imitonin Atë (shih 3 Nefi 18:24).

Duke folur për udhëheqjen në Kishë, Plaku Xhejms E. Faust, kur ishte anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, vërejtë: “Ata që do të udhëhiqnin këtë Kishë, duhet të jepnin shembullin e drejtësisë vetjake. Ata duhet të kërkonin për drejtim të përhershëm nga Fryma e Shenjtë. Ata duhej të kishin jetën dhe shtëpinë e tyre në rregull. Ata duhej të ishin të ndershëm dhe të gatshëm të paguanin faturat e tyre. Ata duhet të jenë shembullorë në të gjithë sjelljen e tyre” (në Conference Report, tetor 1980, f. 53; ose *Ensign*, nëntor 1980, f. 36).

Plaku Din L. Larsen, që ishte atëherë anëtar i Presidencisë së Të Shtatëdhjetëve, shpjegoi: “Ata që marrin ungjillin, pritët të manifestojnë rezultatet e tij në jetën e tyre, jo vetëm për përfitimin dhe bekimin e tyre, por edhe për qëllimin e sjelljes së të tjerëve tek e vërteta. ...

... Në mënyra të rëndësishme jeta e tyre do të manifestojë rezultatet e ungjillit dhe do t’i veçojë ata si fener për të gjithë ata që po kërkojnë dritë dhe të vërtetë” (në Conference Report, tetor 1985, f. 85; ose *Ensign*, nëntor 1985, f. 68).

Presidenti Gordon B. Hinkli shkroi: “Nga vetë natyra e saj, udhëheqja e vërtetë ka në vetvete barrën e të qenit shembull. ... Nëse vlerat nuk vendosen dhe mbahen nga ata që udhëheqin, sjellja në radhët e të udhëhequrve poshtë rrezikohet dhe dëmtohet seriozisht. Në të vërtetë, në çfarëdo organizate ku ndodh kjo – qoftë familje, korporatë, shoqëri apo komb – vlerat që neglizhohen, me kohë do të zhduken” (*Standing for Something: Ten Neglected Virtues That Will Heal Our Hearts and Homes* [2000], f. 170).

Udhëheqësit janë më të aftë të ndihmojnë njerëzit, kur përpiqen të bëjnë shembull jetën dhe mësimet e Shpëtimtarit. Zoti “vazhdoi nga hiri në hir” derisa Ai u bë i përsosur (DeB 93:13). Tiparet e Tij përfshijnë njohuri, fuqi, drejtësi, gjykim, mirësi, mëshirë, durim, të vërtetë, përulesi, butësi, nënshtrim, hir, mirësjellje, urtësi, vetëmohim, bindje, angazhim për të respektuar lirinë tonë të zgjedhjes, dhembshuri, guxim, ndershmëri dhe hare. (*Shënim: Secili nga këto tipare mund të bëhet tema e një mësimi.*)

Udhëheqësit që zhvillojnë këto tipare, do të dinë se si të komunikojnë qartëme ata që udhëheqin, si t'i duan ata pa u përpjekur t'i kontrollojnë, si të gëzohen në mirësinë dhe arritjet e tyre dhe si t'u rezistojnë tundimeve të Satanit. Kur ne nuk ndjekim shembullin e Jezu Krishtit, ne rrezikojmë të shkurajojmë njerëzit për të ardhur te Krishti. Sikurse i shpjegoi Alma birit të tij të pabindur: “Vër re, O biri im, çfarë paudhësie të madhe solle mbi Zoramitet; pasi kur ata panë sjelljen tënde, nuk besuan në fjalët e mia” (Alma 39:11).

### IDE MËSIMORE

U kërkoni studentëve të analizojnë kuptimin e thënies së Shpëtimtarit: “Unë jam drita e botës” (Gjoni 8:12) dhe diskutojeni atë si klasë (shih gjithashtu Gjoni 9:5; 3 Nefi 9:18; 11:11; Ethëri 4:12; DeB 11:28; 12:9; 45:7; 88:5–13).

Përse duhet që udhëheqësit e Kishës dhe të familjes të jetojnë vetë parimet e ungjillit dhe jo thjesht të nxisin të tjerët ta bëjnë këtë?

Diskutoni si klasë veçoritë e karakterit që shfaqi Shpëtimtari dhe i rendisni ato në dërrasë. Pyesni se si zhvillimi i këtyre veçorive në jetën tonë do të na ndihmojë për të qenë udhëheqës më të mirë. Diskutoni çfarë mësojnë Mateu në 16:24 dhe Alma 39:11 mbi rëndësinë e shembullit.

U dëshmoni studentëve që, kur ata ndjekin shembullin e Shpëtimtarit, ata pasqyrojnë dritën e Tij që ta ndjekin të tjerët. U kujtoni studentëve që, ashtu si Ai, ne duhet të rritemi “nga hiri në hir” (shih DeB 93:13; shih gjithashtu 2 Nefi 28:30).

### BURIME PËR MËSUESIN



**Presidenti Gordon B. Hinkli**

*President i Kishës*

*“A Prophet’s Counsel and Prayer for Youth”, Ensign, janar 2001, f. 2–11; ose New Era, janar 2001, f. 4–15*

Unë mendoj se kurrë më parë nuk ka pasur një takim si ky në këtë Kishë. Ka qark shumë nga ju këtu sonte. Sa mirë që dukeni.

Disa nga ju kanë ardhur me dyshime. Disa kanë ardhur me pritshmëri të mëdha. Unë dua që

ta dini se unë kam rënë në gjunjë duke i kërkuar Zotit të më bekojë me forcë e me aftësi dhe me të folur, për të arritur tek zemrat tuaja.

Përtej kësaj salle janë me qindra mijë të tjerë që marrin pjesë me ne. Unë i uroj secilit prej jush mirëseardhjen. Unë jam i gëzuar për këtë mundësi të jashtëzakonshme që t’ju flas dhe e di se sa rëndësi ka.

Unë jam tani i moshuar në vite – mbi 90. Unë kam jetuar një kohë të gjatë dhe kam jetuar me dashuri të madhe për të rinjtë dhe të rejtat e kësaj Kishë. Çfarë grupi me të vërtetë i mrekullueshëm jeni ju. Ju flisni gjuhë të ndryshme. Ju jeni të gjithë pjesë e një familjeje të madhe. Por ju jeni gjithashtu individë, secili me problemet e veta, secili duke kërkuar përgjigje për gjërat që ju ngatërrojnë dhe ju shqetësojnë. Sa ju duam dhe sa lutemi vazhdimisht që fuqia gjeniale t’ju ndihmojë. Jeta juaj është e mbushur me vendime të vështira dhe me ëndrra e shpresa, dhe dëshirë për të gjetur atë që do t’ju sjellë paqe dhe lumturi.

Një herë e një kohë, shumë kohë përpara, unë isha në moshën tuaj. Unë nuk shqetësohesha lidhur me droga apo pornografi, sepse atëherë nuk kishte nga ato. Unë shqetësohesha për shkollën dhe ku do të na çonte ajo. Ishte periudha e depressionit të tmerrshëm ekonomik. Unë shqetësohesha se si të siguroja jetesën. Shërbeva në një mision pasi mbarova universitetin. Unë shkova në Angli. Ne udhëtua me tren për në Çikago, kaluam me autobus nëpër qytet dhe shkuam në Nju-Jork, ku morëm një anije me avull për në Ishujt Britanikë. Duke udhëtuar në Çikago me autobuz, një grua i tha shoferit: “Çfarë është ajo godina përpara?” Ai tha: “Zonjë, ajo është Ndërtesa e Bordit të Tregtisë të Çikagos. Çdo javë ndonjë që ka humbur pasurinë, hidhet nga një prej atyre dritareve. Ai nuk ka tjetër gjë pse të jetojë.”

Të tilla ishin kohërat. Ato ishin të pandershme dhe të shëmtuara. Askush që nuk e ka jetuar atë kohë, nuk do ta kuptojë kurrë plotësisht. Unë shpresoj me gjithë zemër që kurrë të mos kemi përsëri diçka të ngjashme me të.

Tani, ju jeni këtu në prag të jetës suaj të pjekur. Ju gjithashtu shqetësoheni për shkollën. Ju shqetësoheni për martesën. Ju shqetësoheni për shumë gjëra. Unë ju bëj një premtim që Perëndia

nuk do t'ju braktisë, nëse do të ecni në rrugët e Tij nën drejtimin e urdhërimeve të Tij.

Kjo është epoka e mundësive të mëdha. Ju jeni kaq me fat që jetoni. Kurrë në historinë e njerëzimit jeta nuk ka qenë e mbushur me kaq shumë mundësi dhe sfida. Kur linda unë, moshë mesatare e pritshme e jetës së burrit ose të gruas në Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera perëndimore ishte 50 vjeç. Tani ajo është më shumë se 75 vjeç. A mund ta përfytyroni këtë? Mesatarisht, ju mund të prisni të jetoni të paktën 25 vite më gjatë se dikush që jetoi në 1910-ën.

Kjo është epoka e një shpërthimi të dijeve. Për shembull, kur unë kam qenë në moshën tuaj, nuk kishte antibiotikë. Të gjitha këto medikamente të mrekullueshme u zbuluan dhe u përmirësuan në kohë më të reja. Disa nga plagët e mëdha të rruzullit janë kapëcyer. Lija dikur rrëmbente popullata të tëra. Ajo është zhdukur tërësisht. Kjo është një mrekulli. Poliomieli ishte dikur një frikë e tmerrshme për çdo nënë. Unë mbaj mend që shkova të vizitoja një burrë me poliomieli në një spital të kontesë. Ai ishte në një mushkëri të madhe prej hekuri që lëvizte mushkëritë e tij duke pompuar lart e poshtë. Nuk kishte shpresë për të; ai nuk mund të merrte frymë vetë. Ai vdiq, duke lënë gruan dhe fëmijët. Kjo sëmundje e tmerrshme tani është zhdukur. Kjo gjithashtu është një mrekulli. Dhe kështu është edhe për gjëra të tjera.

Sigurisht që ju përballeni me sfida. Çdo brez që ka ecur ndonjëherë mbi tokë, është përballur me sfida. Ne mund ta kalojmë gjithë mbrëmjen duke folur për to. Por, nga të gjitha sfidat që janë përballur në të kaluarën, ato që ne kemi sot, besoj unë, trajtohen më me lehtësi. E them këtë sepse ato janë të administrueshme. Ato përfshijnë gjërësisht vendime vetjake për sjelljen, por ato vendime mund të merren dhe të ndiqen. Dhe kur ndodh kjo, sfida është lënë prapa.

Unë supozoj se shumica prej jush janë në shkollë. Jam i kënaqur që ju e keni atë mundësi dhe atë dëshirë. Unë shpresoj se ju po studioni me zell dhe se ambicia juaj e madhe është të merrni notat më të larta në lëndët e ndryshme. Unë shpresoj se mësuesit tuaj do të jenë bujarë ndaj jush dhe se studimet tuaja do të sigurojnë notat më të larta dhe një arsimim të shkëlqyer.

Nuk do të mund të uroja gjë më të mirë për ju nëse punën tuaj të shkollës.

Sonte unë do t'ua lë mësuesve tuaj t'ju japin notat 10-ta, që shpresoj se ju i meritoni. Unë dua të flas për disa nota "Jini". Ju merrni notat 10-ta; unë do t'ju jap notat "Jini".

1. *Jini mirënjohës.*
2. *Jini të zgjuar.*
3. *Jini të pastër.*
4. *Jini të vërtetë.*
5. *Jini të përvuilur.*
6. *Jini të lutjes. ...*

*Jini mirënjohës.* Ka dy fjalë të vogla në gjuhën angleze, që ndoshta shprehin më shumë se të gjitha të tjerat. Ato janë "ju faleminderit". Fjalë të krahasueshme gjenden në çdo gjuhë tjetër, të tilla si *gracias, merci, danke, obrigado, domo.*

Zakoni i të thënit faleminderit është shenjë e një burri apo gruaje të edukuar. Me kë është i pakënaqur Zoti? Ai përmend ata "që nuk e pohojnë dorën e tij në gjithçka" (DeB 59:21). Që do të thotë ata që ecin pa shprehje mirënjohjeje. Ecni me mirënjohje në zemrat tuaja, miqtë e mi të dashur. Jini falënderues për bekimet e mrekullueshme që janë tuajat. Jini mirënjohës për mundësitë e pamasa që keni. Jini falënderues ndaj prindërve tuaj, që kujdesen aq shumë për ju dhe që kanë punuar aq fort për t'ju plotësuar nevojat. Bëjuani të ditur se jeni mirënjohës. I thoni faleminderit nënës dhe babait tuaj. U thoni faleminderit miqve tuaj. U thoni faleminderit mësuesve tuaj. I shprehni vlerësim kujtdo që ju bën një nder apo ju ndihmon në çfarëdo mënyre.

Falënderoni Zotin për mirësinë e Tij ndaj jush. Falënderoni të Gjithëfuqishmin për Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin, që ka bërë për ju atë që askush tjetër në botë nuk mund ta bënte. Falënderojeni Atë për shembullin e Tij të madh, për mësimet e Tij të mrekullueshme, për dorën e Tij që zgjatet për të lartësuar dhe ndihmuar. Mendoni mbi kuptimin e Shlyerjes së Tij. Lexoni rreth Tij dhe lexoni fjalët e Tij në Dhiatën e Re dhe tek 3 Nefi në Librin e Mormonit. I lexoni ato qetësisht për vete dhe pastaj mendoni mbi to. Dërdheni zemrën tuaj tek Ati juaj në Qiell me mirënjohje për dhuratën e Birit të Tij të Dashur.

Falënderojeni Zotin për Kishën e Tij të mrekullueshme të rivendosur në këtë epokë të madhe të historisë. Falënderojeni Atë për të gjitha sa ajo ju ofron. Falënderojeni Atë për miqtë dhe të dashurit, për prindërit dhe vëllezërit e motrat, për familjen. Lejoni një shpirt falënderues të drejtojë dhe të bekojë ditët dhe netët tuaja. Punoni për këtë. Ju do ta shihni që do të japë rezultate të mrekullueshme.

“Jini” numër dy – *jini të zgjuar*.

Ju po i drejtoheni epokës më konkurruese që bota ka njohur ndonjëherë. Ngado rreth jush ka konkurrencë. Ju keni nevojë për të gjithë arsimimin që mund të merrni. Sakrifikoni një makinë, sakrifikoni çfarëdo gjëje tjetër që nevojitet të sakrifikohet, për t’u bërë të pranueshëm për punën e botës. Ajo botë do t’ju paguajë ju në masë të madhe atë që ajo mendon se ju e vleni dhe vlera juaj do të rritet kur ju merrni arsim dhe kompetencë në fushën që keni zgjedhur.

Ju i përkisni një kishe që të mëson rëndësinë e arsimimit. Ju keni një mandat nga Zoti për të arsimuar mendjen tuaj dhe zemrën tuaj, dhe duart tuaja. Zoti ka thënë: “I mësoni me zell ... për gjërat si në qiell, edhe në tokë dhe nën tokë; gjërat që kanë qenë, gjërat që janë, gjërat që duhet të ndodhin së shpejti, gjërat që janë në vendin tuaj, gjërat që janë jashtë; luftërat dhe ngatërresat e kombeve dhe gjykimet që janë mbi tokën; dhe një dije gjithashtu për vendet dhe mbretëritë— Me qëllim që ju të mund të përgatiteni në gjithçka” (DeB 88:78–80).

Mbani parasysh, këto nuk janë fjalët e mia. Këto janë fjalët e Zotit, i cili ju do. Ai do që ju t’i trajtoni mendjet dhe duart tuaja për t’u bërë një ndikim për mirë ndërsa përparoni në jetën tuaj. Dhe kur ju e bëni këtë dhe kur ju punoni ndershmërisht e shkëlqyeshëm, ju do t’i sillni nder Kishës, sepse ju do të konsideroheni si burrë apo grua me integritet moral e me aftësi dhe me profesionalizëm të ndërgjegjshëm. Jini të zgjuar. Mos jini të marrë. Ju nuk mund t’u bëni hile apo t’i mashtroni të tjerët pa i bërë hile apo mashtruar veten.

Shumë vite përpara unë punoja për një hekurudhë në zyrat qendrore në Denver. Isha ngarkuar me atë që quhet trafiku skaj më skaj. Kjo

që në ato ditë kur thuajse çdo njeri udhëtonte me trenat e pasagjerëve. Një mëngjes pata një thirrje telefonike nga pala homologe në Njuark të Nju-Xhersit. Ai tha: “Treni me numër aq e kaq ka arritur, por ai nuk ka vagon bagazhesh. Diku, 300 pasagjerë kanë humbur bagazhet dhe janë tërbuar.”

Shkova menjëherë të punoj për të gjetur çfarë mund të kishte ndodhur. Pashë se ishte bërë siç duhej ngarkimi dhe lidhja me trenin në Okland të Kalifornisë. Ai kishte lëvizur për në hekurudhën tonë në Solt-Lejk-Siti, ishte çuar në Denver, poshtë në Pueblo, vendosur në një linjë tjetër dhe lëvizur për në Sent- Ljuis. Atje duhej të manovrohej nga një hekurudhë tjetër që do ta çonte për në Njuark të Nju-Xhersit. Por në Sent- Ljuis ndonjë ndërrues shinash i pamend kish lëvizur një pjesë të vogël çeliku vetëm 7 cm, një pozicion çelësi, pastaj tërhoqi levën për të shkëputur vagonin. Ne zbuluam se vagoni i bagazheve që i përkiste Njuarkut të Nju-Xhersit, ishte në fakt në Nju-Orleans të Luizianës – 2223 km larg destinacionit të tij. Vetëm 7 cm lëvizje çelësi në stacionin e Sent- Ljuisit, nga një punonjës i pakujdesshëm, e kishte nisur atë në shinat e gabuara dhe largësia nga destinacioni i tij i vërtetë u rrit në masë tronditëse. Kështu ndodh edhe me jetën tonë. Në vend të ndjekjes së një kursi të qëndrueshëm, tërhiqemi nga disa ide të gabuara në tjetër drejtim. Lëvizja nga destinacioni ynë fillestar mund të jetë ndonjëherë aq e vogël, por, nëse vazhdohet, ajo lëvizje shumë e vogël bëhet një e çarë e madhe dhe ne e gjejmë veten larg nga ku donim të shkonim.

A keni parë ndonjëherë një nga ato portat 5-metërshe të fermave? Kur hapet, ajo shtrihet shumë gjerë. Skaji i saj tek menteshat lëviz gjithnjë aq pak, ndërsa jashtë në perimetër lëvizja është e madhe. Janë gjërat e vogla ku merr kthesë jeta, që bëjnë ndryshimin e madh në jetën tonë, të dashur miq të mi të rinj.

Jini të zgjuar. Zoti do që ju të arsimoni mendjen dhe duart tuaja, cilado qoftë fusha që keni zgjedhur. Qoftë ajo në riparimin e frigoriferëve apo puna e një kirurgu të zotë, ju duhet të trajtoni veten. Kërkoni për shkollimin më të mirë të mundshëm. Bëhuni një punonjës i ndershëm në botën që shtrihet përpara jush. Unë e

përsëris, ju do t'i sillni nder Kishës dhe ju do të bekoheni bujarisht në saje të atij trajnimi.

Nuk mund të ketë dyshim, të asnjë lloji, se arsimimi shpërblen. Mos e mbyllni në qark të shkurtër jetën tuaj. Po ta bëni këtë, ju do të paguani për të në një mënyrë vazhdimisht të përsëritur.

“Jini” e tretë – *jini të pastër*. Ne jetojmë në një botë që është e mbushur me fëlliqësi dhe ndyrësi, një botë që kutërbon ligësi. Kjo është gjithandej rreth nesh. Kjo është në ekranin e televizionit. Kjo është në filma. Kjo është në letërsinë masive. Kjo është në internet. Ju nuk mund t'ia lejoni vetes që ta shihni atë, miq të mi të dashur. Ju nuk mund të lejoni që ai helm i ndyrë t'ju prekë. Qëndroni larg saj. Shmangeni. Ju nuk mund të merrni me qira video dhe t'i shikonin ato kur paraqesin gjëra degjeneruese. Ju të rinj që mbani priftërinë e Perëndisë nuk mund ta përziëni këtë ndyrësi me prifërinë e shenjtë.

Shmangini bisedat e liga. Mos e përdorni emrin e Zotit kot. Nga rrufetë e Sinait gishti i Zotit shkroi në pllakat e gurit: “Nuk do ta përdorësh emrin e Zotit, të Perëndisë tënd, kot” (Eksodi 20:7).

Nuk është shenjë burrërie të përdorësh pa kujdes emrin e të Gjithëfuqishmit apo të Birit të Tij të Dashur në një mënyrë të kotë dhe të shpejnguar, siç priren shumë njerëz.

I zgjidhni me kujdes miqtë tuaj. Janë ata që do t'ju udhëheqin në një drejtim apo një tjetër. Çdo njeri do miq. Çdo njeri ka nevojë për miq. Askush nuk dëshiron të jetë pa ta.. Por mos e humbisni kurrë nga shikimi faktin që janë miqtë tuaj ata që do t'ju udhëheqin nëpër rrugët që do të ndiqni.

Ndërsa duhet të jeni miqësorë me të gjithë njerëzit, zgjidhni me kujdes të madh ata të cilët dëshironi t'i keni pranë jush. Ata do të jenë mburojat tuaja në situata ku mund të lëkundeni midis zgjedhjeve dhe ju, në kthim, mund t'i shpëtoni ata.

Jini të pastër. Mos humbisni kohën me dëfrime shkatërruese. Kohët e fundit u mbajt një shfaqje në Luginën e Solt-Lejikut nga një trupë në udhëtim. Më thanë se ishte e fëlliqur, se ishte

epsharake, se ishte e keqe në çdo drejtim. Të rinjtë e këtij komuniteti kishin paguar 25 deri 35 dollarë për ta parë. Çfarë morën për paratë e tyre? Vetëm një zë joshës që i nxiste të lëviznin në drejtim të gjërave të neveritshme të jetës. Unë ju lutem, miq të mi, të qëndroni larg gjërave të tilla. Kjo nuk do t'ju ndihmojë. Ajo vetëm mund t'ju lëndojë.

Unë u fola kohët e fundit nënave dhe baballarëve tuaj. Midis gjërash të tjera, unë fola me ta për tatuazhet.

Çfarë krijimi është më i mrekullueshëm sesa trupi njerëzor? Çfarë gjë e mrekullueshme është ai, si punë kurorëzuese e të Gjithëfuqishmit.

Pali, në letrën drejtuar korintasve, tha: “A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju?”

Në qoftë se dikush e prish tempullin e Perëndisë, Perëndia do ta prishë atë, sepse tempulli i Perëndisë, i cili jeni ju, është i shenjtë” (1 Korintasve 3:16–17).

A menduat ndonjëherë se trupi juaj është i shenjtë? Ju jeni një fëmijë i Perëndisë. Trupi juaj është krijesë e Tij. A do ta shfiguroni atë krijesë me portrete njerëzish, kafshësh dhe fjalësh të vizatuara në lëkurën tuaj?

Unë ju premtoj se koha do të vijë, nëse keni tatuazhe, që juve do t'ju vijë keq për veprimet tuaja. Ato nuk mund të fshihen. Ato janë të përhershme. Vetëm me një proces të shtrenjtë dhe të dhimbshëm mund të hiqen ato. Nëse keni bërë tatuazhe, atëherë ndoshta në pjesën tjetër të jetës ju do t'i mbani me vete. Unë besoj se koha do të vijë kur ato do të jenë një shqetësim për ju. Shmangeni. Ne, si Vëllezërit tuaj që ju duam, ju lutemi që të mos tregoheni aq pa respekt ndaj trupit që Zoti ju ka dhënë.

Më lejoni të përmend vathët dhe unazat që vendosen në pjesë të tjera të trupit. Këto nuk janë burrërore. Ato nuk janë tërheqëse. Ju të rinj dukeni më mirë pa to dhe unë besoj se ju do të ndiheni më mirë pa to. Sa për të rejtat, ju nuk keni nevojë të varni unaza lart e poshtë veshëve tuaj. Një palë vathë modestë mjafton.

Unë i përmend këto gjëra sepse ato përsëri shqetësojnë trupat tuaj.



Sa e bukur vërtet është një e re e rregulluar mirë që është e pastër në trup dhe në mendje. Ajo është bijë e Perëndisë me të cilën Ati i Përjetshëm mund të krenohet. Sa i hijshëm është një i ri që është i rregulluar mirë. Ai është një bir i Perëndisë, i konsideruar i denjë të mbajë priftërinë e shenjtë të Perëndisë. Ai nuk ka nevojë për tatuazhe apo vathë mbi apo në trupin e tij. Presidencia e Parë dhe Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve janë të gjithë të bashkuar në këshillën kundër këtyre gjërave.

Dhe kur flas për gjëra të tilla, unë dua t'i vë theks përsëri çështjes së pornografisë. Ajo është bërë një industri prej 10 miliard dollarësh në Shtetet e Bashkuara, ku disa njerëz pasurohen në dëm të mijëra e mijëra vetëve që janë viktima të tyre. Qëndroni larg saj. Është emocionuese, por do t'ju shkatërrojë. Ajo do të shtrembërojë ndjenjat tuaja. Ajo do të ndërtojë brenda jush një oreks që ju do të bëni gjithçka që ta kënaqni. Dhe mos u përpiqni të krijoni shoqëri nëpërmjet internetit dhe dhomave virtuale të bisedave. Ato mund t'ju çojnë poshtë në vetë humnerën e dëshpërimit dhe të hidhërimit.

Unë duhet të them gjithashtu një fjalë lidhur me drogat e paligjshme. Ju e dini se çfarë ndiej për to. Unë nuk marr parasysh se cili lloj mund të jetë. Ato do t'ju shkatërrojnë, nëse i përdorni. Ju do të bëheni skllëvër të tyre. Pasi vihesh nën forcën e tyre, ti do të bësh çdo gjë që të sigurosh para për të blerë përsëri.

U çudita kur mësova, duke parë një program televiziv, se prindërit i njihnin me drogat fëmijët e tyre në 20 përqind të rasteve. Unë nuk mund ta kuptoj atë që e konsideroj si budallallëk të këtyre prindërve. Çfarë të ardhme tjetër veç skllavërisë për fëmijët e tyre mund të shohin tek ato? Drogat e paligjshme do të shkatërrojnë tërësisht ata që bëhen të varur prej tyre.

Këshilla ime, lutja ime për ju të rinj dhe të reja të mrekullueshme, është të qëndroni absolutisht larg tyre. Ju nuk keni nevojë të bëni prova me to. Shihni rreth jush dhe do të vëreni efektet që kanë pasur tek të tjerët. Nuk ka nevojë për asnjë shenjtor të ditëve të mëvonshme, djalë apo vajzë, të ri apo të re, as madje t'i provojë ato. Qëndroni të pastër nga këto varësi që e tjetërsojnë mendjen dhe formojnë zakone.

Dhe tani vetëm një fjalë për problemin më të zakonshëm dhe më të vështirë nga të gjithë për ju të rinj dhe të reja për ta trajtuar. Është marrëdhënia që ju keni me njëri-tjetrin. Ju po merreni me më të fuqishmin prej instikteve njerëzore. Vetëm vullneti për të jetuar ndoshta është më i madh se ai.

Zoti na ka bërë tërheqës për njëri-tjetrin për një qëllim të madh. Por pikërisht kjo tërheqje bëhet një fuçi baruti, po të mos mbahet nën kontroll. Ajo është e bukur kur trajtohet në mënyrën e duhur. Ajo është vdekjeprurëse nëse të del nga dora.

Është kjo arsyeja për të cilën Kisha këshillon kundër takimeve të parakohshme. Ky rregull nuk është bërë për t'ju dëmtuar juve në ndonjë mënyrë. Ai është bërë për t'ju ndihmuar dhe ai do ta bëjë këtë, nëse ju do ta respektoni.

Takimet e vazhdueshme në një moshë të hershme çojnë kaq shpesh në tragjedi. Studimet kanë treguar se sa më gjatë një djalë dhe një vajzë takohen së bashku, aq më shumë gjasa ka që ata të futen në hall.

Është më mirë, miq të mi, të takoni shumë shokë apo shoqe derisa të jeni gati për martesë. Kaloni një kohë të mrekullueshme, por qëndroni larg familjaritetit. I përmbani duart. Mund të duket jo e lehtë, por është e mundshme.

Ju të rinj që planifikoni të shkoni në misione duhet të dini se mëkati seksual mund t'ju mbajë larg asaj mundësie. Ju mund të mendoni se mund ta fshihni. Përvoja e gjatë ka treguar se nuk do të mundni. Për të shërbyer me një mision të efektshëm ju duhet të keni Shpirtin e Zotit dhe e vërteta e fshehur nuk mund të përzihet me atë Shpirt. Herët a vonë ju do të ndiheni të detyruar të rrëfeni mëkatet tuaja të mëparshme. Mirë e tha Sër Galahadi: "Forca ime është sa forca e dhjetëve, sepse zemra ime është e kulluar" (Alfred, Lord Tennyson, *Sir Galahad* [1842], st. 1).

Të dashur miq të mi të rinj, në çështje të lidhjes gjinore ju e dini se çfarë është e drejtë. Ju e dini kur jeni duke ecur në terren të rrezikshëm, kur është aq e lehtë të pengohesh dhe të rrëshkasësh në gropën e shkëljes. Unë lutem që të jeni të kujdesshëm, të qëndroni të sigurt larg

nga shkrepri i mëkatit, nga i cili është kaq e lehtë të biesh. Qëndroni të pastër nga e keqja e zezë dhe zhgënjyese e shkeljes seksuale. Ecni në dritën e diellit të asaj paqeje e cila vjen nga bindja ndaj urdhërimeve të Zotit.

Tani, nëse ka ndonjë që e ka kaluar vijën, që mund të ketë kryer shkelje tashmë, a ka ndonjë shpresë për të? Patjetër që ka. Atje ku ka pendesë të vërtetë, atje do të ketë falje. Ky proces fillon me lutje. Zoti ka thënë: “Ai që është penduar për mëkatet e tij, po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato” (DeB 58:42). Ndajeni barrën tuaj me prindërit tuaj nëse mundeni. Dhe patjetër rrëfejani atë peshkopit tuaj, i cili qëndron gati që t’ju ndihmojë.

Nota ime tjetër “Jini” – *jini të vërtetë*.

Tha Shekspiri: “Mbaji besën vetes; edhe kështu, siç vjen pas natës dita, s’i del dot i pabesë asnjëri” (*Hamleti*, akti I, skena III, f. 249 vëllimi I, botim i 1981, Tiranë). Ju keni një trashëgimi të mrekullueshme. Keni një sfond madhështor prej paraardhësish fisnikë. Shumë nga ju janë pasardhës të pionierëve, që vdiqën me qindra dhe mijëra në dëshmi të së vërtetës së kësaj pune. Nëse ata do të hidhnin vështrimin mbi ju, ata do t’ju luteshin: “Jini të vërtetë. Jini besnikë. Jini ‘të vërtetë në besimin që prindërit tanë kanë ushqyer, të vërtetë në besimin tek e vërteta për të cilën dëshmorët dhanë jetën’.” Ata do të thoshin: “Besim i etërve tanë, besim i shenjtë, ne do të jemi të vërtetë ndaj teje deri në vdekje” (*Himne*, numrat. 254 dhe 84).

Dhe ata nga ju që mund të mos jenë pasardhës me origjinë nga pionierët, ju i përkisni një kishe që është forcuar nëpërmjet besnikërisë dhe dashurisë së palëkundur të anëtarëve të saj ndër breza. Sa gjë e mrekullueshme është t’i përkasësh një shoqërie, qëllimet e së cilës janë fisnike, realizimet e së cilës janë madhështore, puna e së cilës është lartësuese, madje heroike. Jini besnikë ndaj Kishës në të gjitha rrethanat. Unë ju bëj një premtim që autoritetet e kësaj Kishe nuk do t’ju udhëheqin kurrë në udhë të shtrembër. Ata do t’ju udhëheqin në rrugë lumturie.

Juve që jeni anëtarë të kësaj Kishe, duhet të keni besnikëri ndaj saj. Kjo është kisha juaj. Ju keni një përgjegjësi aq të madhe në fushën tuaj të veprimtarisë, sa e kam edhe unë në fushën

time të veprimtarisë. Ajo ju përket juve pikërisht ashtu siç më përket edhe mua. Ju keni përqaftuar ungjillin e saj. Ju keni marrë mbi vete një besëlidhje në ujërat e pagëzimit. Këtë ju e keni përtërirë sa herë që keni marrë sakramentin. Këto besëlidhje do të shtohen kur të martoheni në tempull. Ju nuk mund t’i trajtoni lehtë-lehtë. Ato janë diçka tepër e madhe. Kjo është vetë puna e Perëndisë e planifikuar që të sjellë pavdekësinë dhe jetën e përjetshme të bijve dhe bijave të Tij.

Ecni në besim përpara Tij me kokën lart, krenarë për anëtarësinë tuaj në këtë kauzë dhe mbretëri të madhe, që Ai e ka rivendosur në tokë në këtë periudhë, periudhën e fundit ungjillore të plotësisë së kohëve. Pse? Që t’ju sjellë lumturi.

Jini të vërtetë ndaj vetë bindjeve tuaja. Ju e dini çfarë është e drejtë dhe ju e dini çfarë është e gabuar. Ju e dini kur jeni duke bërë atë që duhet. Ju e dini se kur po i jepni forcë një kauze të drejtë. Jini besnikë. Jini besimtarë. Jini të vërtetë, të dashur shokë të mi në këtë mbretëri të madhe.

“Jini” e pestë – *jini të përulur*.

Nuk ka vend për arrogancë në jetën tonë. Nuk ka vend për mendjemadhësi. Nuk ka vend për kult të vetvetes. Ne kemi një punë të madhe për të bërë. Ne kemi gjëra për të përmbushur. Ne kemi nevojë për drejtim në ndjekje të edukimit tonë. Ne kemi nevojë për ndihmë në zgjedhjen e një shoku apo shoqeje të përjetshme.

Zoti ka thënë: “Ji i përulur; dhe Zoti, Perëndia yt, do të të udhëheqë përdore dhe do t’u japë përgjigje lutjeve të tua” (DeB 112:10).

Çfarë premtimi i mrekullueshëm që është dhënë në këtë deklaram. Nëse ne jemi pa mendjemadhësi e krenari dhe arrogancë, nëse ne jemi të përulur dhe të bindur, atëherë Zoti do të na drejtojë për dore dhe do t’u përgjigjet lutjeve tona. Çfarë gjëje më të madhe mund të kërkojmë? Nuk ka gjë që të krahasohet me këtë.

Shpëtimtari, në të madhin Predikim në Mal, deklaroi: “Lum ata që janë zemërbutë, sepse ata do ta trashëgojnë tokën” (Mateu 5:5).

Unë besoj se zemërbutët dhe të përulurit janë ata të cilëve mund t’u mësohet. Ata janë të gatshëm që të mësojnë. Ata janë të gatshëm të dëgjojnë pëshpëritjet e zërit të qetë e të ulët për

drejtim në jetën e tyre. Ata vendosin urtësinë e Zotit mbi urtësinë e tyre.

Dhe kjo çon në notën time të fundit “Jini” – *jini të lutjes*.

Ju nuk mund t’ia dilni vetëm. Unë shoh në këtë kongregacion të madh dhe e di se ju jeni të rinj që luteni, që uleni në gjunjë dhe flisni me Zotin. Ju e dini se Ai është burimi i gjithë urtësisë.

Ju keni nevojë për ndihmën e Tij dhe ju e dini se keni nevojë për ndihmën e Tij. Ju nuk mund t’ia dilni vetëm. Ju do të arrini ta kuptoni këtë dhe ta njihni atë gjithnjë e më shumë me kalimin e viteve. Jetoni në mënyrë të tillë që me ndërgjegje të mirë të mund të flisni me Zotin. Përkuluni në gjunjë dhe falënderojeni Atë për mirësinë e Tij ndaj jush dhe i shprehni Atij dëshirat e drejta të zemrës suaj. Mrekullia e gjithë kësaj është se Ai dëgjon. Ai përgjigjet. Ai përgjigjet – jo gjithnjë si mund të dëshironim që Ai të përgjigjej, por nuk ka dyshim në mendjen time se Ai përgjigjet.

Ju keni një përgjegjësi të tillë kaq të madhe, ju të rinj dhe të reja. Ju jeni produkt i të gjithë brezave që kanë kaluar përpara jush. Gjithçka që keni në trup dhe në mendje, kanë kaluar tek ju nëpërmjet prindërve tuaj. Një ditë ju do të bëheni prindër dhe do të përcillni në brezat pasardhëse cilësitë e trupit dhe të mendjes që keni marrë nga e kaluara. Mos e këputni zinxhirin e brezave të familjes suaj. Mbajeni atë të shkëlqyer dhe të fortë. Varet kaq shumë nga ju. Ju jeni aq shumë të çmueshëm. Ju keni një domethënie aq të madhe për këtë Kishë. Nuk mund të ishte njësoj pa ju. Qëndroni lart, krenarë për trashëgiminë tuaj si bij dhe bija të Perëndisë. Shihni tek Ai për kuptim dhe drejtim. Ecni në përputhje me këshillat dhe urdhërimet e Tij.

Ju mund të keni një kohë të mirë. Sigurisht që mundeni! Ne duam që ju të keni hare. Ne duam që ju ta gëzoni jetën. Ne nuk duam që ju të jeni puritanë. Ne duam që ju të jeni të fortë dhe të hareshëm, të këndonit dhe të kërceni, të qeshni dhe të jeni të lumtur.

Por duke bërë kështu, të jeni të përlulur e plot lutje dhe buzëqeshjet e qiellit do të bien mbi ju.

Nuk do të mund të uroja për ju asgjë më të mirë sesa që jeta juaj të jetë e frutshme, që shërbimi juaj të jetë i përkushtuar dhe i dhënë vullnetarisht, që ju të kontribuoni në dijen dhe mirëqenien e botës ku jetoni dhe që ju ta bëni këtë me përlulësi dhe plot besim përpara Perëndisë tuaj. Ai ju do juve. Ne ju duam juve. Ne duam që ju të jeni të lumtur dhe të suksesshëm, të jepni kontribute të rëndësishme në botën ku do të jetoni dhe në çuarjen përpara të kësaj pune të madhe dhe të madhërishtme të Zotit.

Mirë, vëllezër dhe motra të mia, këto janë notat e mia “Jini” – jini mirënjohës, jini të zgjuar, jini të pastër, jini të vërtetë, jini të përlulur, jini të lutjes.

Tani, në mbyllje, unë shpreh një fjalë lutjeje lidhur me ju.

O Perëndi, Ati ynë Qiellor, si shërbëtor i Yti unë përkulem përpara Teje në lutje në emër të këtyre të rinjve të përhapur në të gjithë tokën, që janë grumbulluar sonte kudo nëpër mbledhje. Të lutem buzëqesh në përkrahje të tyre. Të lutem dëgjoji ata kur ngrenë zërin e tyre në lutje tek Ty. Të lutem udhëhiqi butësisht për dore në drejtimin që duhet të ndjekin.

Të lutem ndihmoji të ecin në rrugët e së vërtetës e të drejtësisë dhe mbaji larg të ligave të botës. Bekoju që të jenë herë të lumtur e herë seriozë, që ata të mund të gëzojnë jetën dhe të pijnë nga plotësia e saj. Bekoju ata që të mund të ecin të pranueshëm përpara Teje si bij dhe bija të dashura të Tutë. Secili është fëmija Yt me aftësi të bëjë gjëra të mëdha dhe fisnike. Mbaji në rrugë të lartë që çon në arritje. Shpëtoji nga gabimet që mund t’i shkatërrojnë. Nëse kanë gabuar, fali shkeljet e tyre dhe udhëhiqi përsëri në rrugët e paqes dhe të përparimit. Për këto bekime unë lutem me mirënjohje për ata dhe lutem për bekimet e Tua për ta, me dashuri dhe dhembshuri, në emrin e Atij që mban barrët e mëkateve tona, madje Zotit Jezu Krisht, amen.

#### **NDIHMË STUDIMI**

- Cilat janë “gjashtë notat ‘Jini’ të Presidentit Hinkli dhe përse ato janë të rëndësishme?

- Cilat parime të udhëheqjes mund të mësojmë nga fjala e Presidentit Hinkli? (Shih posaçërisht lutjen e tij për rininë.) Përse janë të rëndësishme këto parime?
- Përse është mirënjohja e rëndësishme për shërbëtorët e Zotit? Çfarë mund të bëjë një udhëheqës për të frymëzuar mirënjohje ndaj Zotit?
- Presidenti Hinkli iu referua një porte dhe menteshës. Çfarë mund të përfaqësojë mentesha në udhëheqje? Çfarë mund të përfaqësojë porta? Si mund të na ndihmojë ky ilustrim neve si udhëheqës?
- Si mund të mbahemi të përqendruar në arsimimin e mendjes dhe përmirësimin e aftësive tona?
- Çfarë këshille jep Presidenti Hinkli lidhur me miqtë? Përse është e rëndësishme kjo këshillë?
- Cilat janë disa nga këshillat që të bësh dhe të mos bësh, nga pjesa “Jini të pastër” e bisedës së Presidentit Hinkli?
- Përse është përvullësia e rëndësishme për udhëheqje në mbretëri?
- Çfarë roli duhet të luajë lutja në udhëheqje? Pse?

# MËSIMI I DETYRAVE TONA SI UDHËHEQËS

“Si rrjedhim, tani çdo njeri duhet ta mësojë detyrën e tij dhe të veprojë në thirrjen që është caktuar, gjithë zell” (DeB 107:99).

## PARIM I UDHËHEQJES

Udhëheqësit në Kishë dhe në familje duhet të kuptojnë detyrat e tyre me qëllim që t’u ndihmojnë atyre të cilëve u shërbejnë që të marrin bekimet e ugjillit.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Udhëheqësit janë më të efektshëm kur mësojnë detyrat që lidhen me postin e tyre.

### KONCEPTI 1. UDHËHEQËSIT JANË MË TË EFEKTSHËM KUR MËSOJNË DETYRAT QË LIDHEN ME POSTIN E TYRE.

#### KOMENT

Në Doktrina e Besëlidhje 107:99–100, Zoti i këshillon të gjithë të mësojnë detyrën e tyre. Këto vargje u drejtohen atyre që shërbejnë në detyra të priftërisë, por shpirti i kësaj këshille zbatohet tek të gjithë udhëheqësit. Plaku Riçard L. Evans, që ishte anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, na mësoi: “Familjeve tona, Kishës, komunitetit, kombit, mbretërisë së Perëndisë u shërbehet më mirë nga njerëzit më të mirëpërgatitur. Përgatitja dhe njohuritë, me besnikërinë, janë pafundësisht më të mira sesa thjesht vetëm besnikëria. Dhe ata që heqin dorë për shkaqe të vogla, ata që ndërpresin mësimin, ata që nuk vazhdojnë të përpiqen të rrisin kompetencën e tyre, unë besoj se po dështojnë të bëjnë detyrën e tyre të plotë” (në Conference Report, tetor 1966, f. 55).

Çdo rol udhëheqës ka detyra unike. Ne mund t’i mësojmë këto detyra nga manualët, udhëheqësit tanë, nga të tjerë që kanë shërbyer në detyrën e dhënë, nga mbledhje trajnuese, vrojtimi vetjak, kërkimi i Shpirtit, studimi i shkrimeve të shenjta dhe duke u lutur.

Thirrjet në poste udhëheqëse u japin njerëzve mundësinë të mësojnë dhe të ushtrjnë një mori aftësish, si “vlerësimi i alternativave, programimi,

çaktimi i detyrave dhe motivimi i të tjerëve. Sidoqoftë, të gjithë udhëheqësit e Kishës nxiten të përqendrohen kryesisht te njerëzit, të kujdesen për delet në tufën e Zotit, të njohin dhe të duan anëtarët, të dëgjojnë, të duan dhe të ndihmojnë për nevojat vetjake. [Presidenti Dejvid O. Mek-Kei tha:] ‘Është detyra e udhëheqësit ... t’u mësojë anëtarëve të duan – jo udhëheqësin apo mësuesin, por të vërtetën e ugjillit’ [në Conference Report, tetor 1968, f. 143–144]. Për ta bërë këtë, udhëheqësit shpesh këshillohen të kërkojnë dhuratat shpirtërore të mprehtësisë dhe urtësisë (krahaso Lluca 12:12; DeB 84:85)” (në Daniel H. Ludlow, red., *Encyclopedia of Mormonism*, 5 volume [1992], 2:818).

Udhëheqësit duhet t’i mësojnë detyrat e tyre dhe ato që presin të tjerët prej tyre. Për shembull, një president klase mund të jetë përgjegjës për t’iu uruar mirëseardhjen studentëve në klasë, për t’u takuar me mësuesin dhe me të ngarkuar të tjerë të klasës për të planifikuar veprimtari, për trajnimin e të ngarkuarve të tjerë të klasës, për festimin e ditëlindjeve të anëtarëve të klasës, për ndihmën anëtarëve që kanë sfida apo nuk marrin pjesë e kështu me radhë.

Si udhëheqës të familjes, prindërit janë përgjegjës për mirëqenien e vetes dhe të fëmijëve të tyre. Detyrat e tyre përfshijnë porositë që renditen te “Familja: Një Proklamatë Drejtuar Botës” (*Ensign*, nëntor 1995, f. 102).

Udhëheqësit e shoqatave të ndihmës dhe të priftërisë janë përgjegjës për t'u ndihmuar atyre që u shërbejnë për marrjen e bekimeve të ungjillit. Detyrat e tyre mund të përfshijnë drejtimin e mbledhjeve, mbikëqyrjen e mësimin të shtëpisë apo të vizitave mësimore, raportimin udhëheqësve të tjerë, këshillimin, intervistimin, përgatitjen e buxheteve, thirrjen e njerëzve për të shërbyer, drejtimin e projekteve të shërbimit dhe, në përgjithësi, ndihmën që organizatat e tyre të funksionojnë mirë. Përgjegjësia parësore e udhëheqësve të priftërisë dhe të shoqatave të ndihmës është të mbështesin dhe të nxisin prindërit në detyrën e tyre që t'u mësojnë ungjillin njerëzve të shtëpisë.

Udhëheqësit e Kishës dhe të familjes zakonisht kanë nevojë të zhvillojnë aftësi të tilla, si:

- Vlerësimi i alternativave
- Marrja e vendimeve
- Programimi i veprimtarive
- Planifikimi i kohës
- Dhënia e përgjegjësisë
- Motivimi
- Përqendrimi më shumë tek njerëzit sesa tek detyrat
- Komunikimi me ata të cilëve u shërbejnë dhe me udhëheqësit e tjerë
- Ngritja morale
- Dëgjimi me dhembshuri
- Njohja e njerëzve dhe dashuria për ta
- Ndihma njerëzve për nevojat e tyre vetjake
- Mësimi i atyre për të dashur të vërtetat e ungjillit
- Përdorimi i dhuratave shpirtërore si mprehtësia dhe urtësia
- Puna brenda kufijve të doktrinae dhe të rregullave

#### IDE MËSIMORE

Pyetni dy ose tre studentë se me çfarë lloj pune e mbajnë familjen prindërit e tyre. Ose, nëse studentët janë kryefamiljarë, mund t'i pyetni se çfarë lloj pune bëjnë. Diskutoni çfarë aftësish, njohurish apo qëndrimesh kërkojnë këto punë.

Theksoni se çdo anëtar duhet të përgatitet të bëhet një udhëheqës në Kishë apo në familje. Çdo rol udhëheqës ka detyrat e veta unike.

Pyetni se përse është e rëndësishme që udhëheqësit t'i mësojnë detyrat e tyre. A nuk mjafton që udhëheqësit thjesht të jenë njerëz të mirë dhe të përpiqen të ndihmojnë të tjerët?

Përmendni së bashku me studentët disa nga detyrat në poste të ndryshme udhëheqëse në Kishë dhe familje. Diskutoni se si i mësojnë në këto detyra. I nxitni studentët të përpiqen t'i mësojnë të gjitha detyrat kurdoherë që caktohen në një post udhëheqës.

Bëni një listë të detyrave të presidentes së Shoqatës së Ndihmës. Bëni një listë tjetër të detyrave të një presidenti të kuorumit të pleqve. Theksoni që ne mund të bëjmë lista të ngjashme për çdo post udhëheqës në Kishë dhe familje. Theksoni sa e rëndësishme është që udhëheqësit të mësojnë detyrat e tyre, që të mund të jenë shërbyes të dobishëm.

Rishikoni disa nga mënyrat me të cilat mësojnë detyrat tona si udhëheqës.

Pyetni se çfarë mund të na pengojë të mësojmë detyrat tona si udhëheqës dhe diskutoni se si mund t'i kapërcejmë këto pengesa.

U kujtoni studentëve bekimet e mëdha që u shkojnë atyre që ndihmojnë të tjerët të vijnë te Jezu Krishti (shih DeB 18:15–16).

#### BURIME PËR MËSUESIN



**Plaku Dallin H. Ouks**

*Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve*

*“Parental Leadership in the Family”, Ensign, qershor 1985, f. 7–11*

Unë e vlerësoj këtë mundësi që t'u flas prindërve të Kishës mbi udhëheqjen prindërore në familje. Unë ia drejtoj vërejtjet e mia çdo prindi, të ri dhe të vjetër. Unë u flas atyre të cilët duhet t'i ushtrojnë të vetëm rolet e tyre prindërore dhe u flas atyre që janë barabar në zgjedhë së bashku në një martesë të lumtur.

Ne nuk mund ta teprojmë me rëndësinë e prindërimit dhe të familjes. Baza e qeverisjes së Perëndisë është familja e përjetshme. Teologjia jonë fillon me prindërit qiellorë dhe aspirata jonë më e lartë është ta arrijmë ne vetë atë status. Ungjilli i Jezu Krishtit është plani i Atit tonë Qiellor, në dobi të fëmijëve të tij shpirtërorë. Planin e ungjillit është bërë i mundur nga sakrifica e Vëllait tonë Më të Madh. Si prindër tokësorë ne marrim pjesë në planin e ungjillit duke dhënë trupa tokësorë për fëmijët shpirtërorë të prindërve qiellorë. Ne pohojmë solemnisht se plotësia e shpëtimit të përjetshëm është një çështje e gjithë familjes. Ne mund të themi vërtet se plani i ungjillit filloi në këshillin e një familjeje të përjetshme, është zbatuar nëpërmjet familjeve tona tokësore dhe e ka destinacionin e vet tek familjet tona të përjetshme. Nuk është çudi pse Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme njihet si kishë e përqendruar tek familja.

Si prindër në Sion, ne jemi përgjegjës t'ua mësojmë pasardhësve tanë ungjillin e Jezu Krishtit, përfshirë nevojën e mbajtjes së urdhërimeve të Perëndisë dhe të marrjes së ordinancave shpëtuese të ungjillit.

Ne të gjithë dëshirojmë të përmirësojmë rolin tonë si prindër. Nuk ka detyrë më të zakonshme dhe, megjithatë, asnjë nuk është më e rëndësishme. Presidenti Jozef F. Smith na dha këtë këshillë:

“Ne nuk duhet të shkurajohemi kurrë në ato detyra të përditshme që Perëndia u ka paracaktuar shumicës së zakonshme të njerëzve. Çdo punë e përditshme duhet të ndërmerret me një shpirt të gëzuar dhe me mendimin e bindjen se lumturia dhe mirëqenia jonë e përjetshme varen nga bërja mirë e asaj që duhet të bëjmë, asaj që Zoti e ka caktuar detyrë që ne ta bëjmë.”

Presidenti Smith e zbatoi atë parim tek prindërimi, si më poshtë:

“Në fund të fundit, të bësh mirë ato gjëra që Perëndia i shuguroi që të jenë fati i përbashkët i gjithë njerëzimit, është madhështia më e vërtetë. Të jesh një baba i suksesshëm apo një nënë e suksesshme, është më madhështore sesa të jesh një gjeneral i suksesshëm apo një burrë shteti i suksesshëm.”

Suksesi në një punë – qoftë edhe të rëndësishme – është vetëm i përkohshëm, përfundoi Presidenti Smith, ndërsa suksesi si prind është “madhështi universale dhe e përjetshme”. (*Gospel Doctrine*, botim i 5-të Salt Lake City: Deseret Book Co., 1939, f. 285.)

Megjithë rëndësinë e detyrës sonë, këto janë kohë të vështira për prindërit. Streset dhe problemet e jetës moderne paraqesin probleme për prindërit. Ato karakterizohen në përkufizimin e trishtuar të familjes si “një grup njerëzish që kanë çelësa për të njëjtën shtëpi”.

Termet e përhapura “çlirim i gruas” dhe “çlirim i burrit” nënkuptojnë probleme të tjera. Ky lloj “çlirimi” shpesh kërkon të çlirojë burrat dhe gratë nga përgjegjësitë familjare. Burrat apo gratë që braktisin apo neglizhojnë familjet e tyre, mund të çlirohen nga përgjegjësitë, por ata burgosen nga mëkati. Çfarëdo që të ndodhë brenda një periudhe të shkurtër, askush nuk mund të arrijë ndonjëherë çlirim apo liri të vërtetë duke iu larguar përgjegjësive të përjetshme. Liria e përjetshme kërkon përmbushje të vetëdijshme të përgjegjësive familjare.

Kur studiojmë predikimet që kanë dhënë udhëheqësit tanë në shekullin e parë të Kishës së rivendosur, vëmë re se sa rrallë kanë folur ata për përgjegjësitë familjare. Në të kundërtën, kjo është një temë e shpeshtë udhëzimi në kohët e fundit. Përse ndodh kjo?

Në djalërinë time në fermë, çdo mbrëmje ishte mbrëmje familjare dhe nuk kishte televizion që të na shkëpuste nga veprimtaritë familjare. Përveç orëve të shkurtra në shkollë, çfarëdo që të ndodhte gjatë ditës, ndodhte nën drejtimin e familjes. Normalisht ne e linim fermën vetëm dy herë në javë – të shtunën për pazar dhe të dielën për në kishë. Ky ishte modeli i jetës për shumicën e anëtarëve gjatë shekullit të parë të Kishës së rivendosur. Në ato kushte kishte pak nevojë për një mbrëmje familjare të programuar rregullisht. Dhe kishte pak nevojë të theksoje përparësinë e familjes apo rëndësinë e përgjegjësive familjare.

Sot shumë pak prej jush përjetojnë veprimtari të qëndrueshme të përqendruar tek familja si ato të kohëve të mëparshme. Jeta urbane dhe transporti modern e kanë bërë të lehtë për rininë tonë t'i përdorë shtëpitë e veta si konvikte

ku flenë dhe marrin një vakt të rastit, por ku ka pak drejtim të veprimtarive të tyre. Veprimtaritë defryese të organizuara dhe transporti me shpejtësi të mëdha i tërheqin të rinjtë larg mbikëqyrjes prindërore.

Mënyra me të cilën shumë anëtarë të Kishës e nxjerrin jetesën, i ndërlikon gjithashtu rolet e tyre prindërore. Në kohët e shkuara familja ishte një njësi prodhimi ekonomik, e organizuar dhe e disiplinuar. Të katër gjyshërit e mi merrreshin me bujqësi, duke e drejtuar mundin e fëmijëve të tyre tek tokat apo fermat e familjes. E gjithë familja punonte bashkë për prodhimin e ushqimit të saj, për mirëmbajtjen e shtëpisë së saj dhe për krijimin e të ardhurave në para për atë që duhej blerë.

Sot, relativisht pak familje punojnë së bashku në prodhimin e të ardhurës. Në këto kohëra, shumica e familjeve janë njësi të konsumit ekonomik, që nuk kërkon një shkallë të lartë organizimi dhe bashkëpunimi. Në këto rrethana, kërkohet një përpjekje e posaçme që prindërit të punojnë me fëmijët e tyre në përpjekje të përbashkëta, por është e rëndësishme të vepohet kështu.

Një nga ndikimet e mëdha që bashkonte familjet në kohët e para, ishte përjetimi i të përpjekurit së bashku në arritjen e një qëllimi të përbashkët – si kultivimi i tokave të shkreta apo krijimi i një biznesi. Ky parim është aq i rëndësishëm sa që një komentator sugjeroi: “Nëse familja nuk ka një krizë të përbashkët, huani një ujë që të ulërijë tek dera”. (Time, dhjetor 15, 1967, f. 31.) Shumica e prindërve kanë mjaft kriza, pa krijuar ndonjë tjetër. Por ata mund të kenë nevojë t’i dallojnë ato dhe të organizojnë familjet e tyre në përpjekje të bashkuara për t’i zgjidhur ato.

Familjet bashkohen kur ato bëjnë së bashku gjëra kuptimplote. Fëmijët duhet të punojnë së bashku nën udhëheqjen e prindërve. Punësimi i përbashkët, madje edhe me kohë të pjesshme, është i vlefshëm. I tillë është një kopsht në familje. Projekte të zakonshme në ndihmë të të tjerëve janë gjithashtu të dëshirueshme. Familja mund të krijojë një fond të përhershëm për misione. Ata mund të kërkojnë dhe të shkruajnë histori familjare dhe t’ua tregojnë të tjerëve. Ata mund të organizojnë ribashkime familjare. Ata

mund të edukojnë anëtarë të familjes me aftësitë bazë të jetës, përfshirë administrimin e financave, mirëmbajtjen e pronës dhe zgjerimin e arsimit të tyre të përgjithshëm. Mësimi i gjuhëve të huaja është një përgatitje e dobishme për shërbim misionar dhe jetë bashkëkohore. Mësuesit e këtyre lëndëve mund të jenë prindërit apo gjyshërit ose pjesëtarë të tjerë të rrethit familjar.

Disa mund të thonë: “Por ne nuk kemi kohë për këtë”. Sa për kohën për të bërë atë që vërtet ia vlen, unë sugjeroj që shumë prindër do të shohin se ata mund të kyçen në punë me familjen, nëse çkyçin nga puna televizorin. Pajisja televizive rri ndezur mesatarisht për 7 orë në ditë në shtëpitë në Shtetet e Bashkuara. (*USA Today*, 17 maj 1984.) Më tej për çështjen, një studim i 1984-s për ndjekjen e televizionit në një zonë kryesisht të banuar ngashenjtorë të ditëve të mëvonshme, tregoi se 70 përqind e atyre që u studiuan – shumica të rritur – shikonin televizionin tre apo më shumë orë në ditë. Thuajse gjysma e atij grupi shihte televizion për pesë orë apo më tepër.

Presidenti Dejvid O. Mek-Kei na mësoi:

“Shtëpia është vendi i parë dhe më efikas ku fëmijët marrin mësimet e jetës: të vërtetën, ndërin, virtytin, vetëkontrollin; vlerën e arsimit, punën e ndershme si dhe qëllimin dhe privilegjin e jetës. Asgjë nuk mund ta zëvendësojë shtëpinë në rritjen dhe mësimin e fëmijëve dhe asnjë sukses tjetër nuk mund të kompensojë dështimin në shtëpi.” (*Family Home Evening Manual 1968–1969*, f. iii.)

Prindërit janë mësuesit kryesorë. Ata e realizojnë mësimdhënien e tyre më të efektshme nëpërmjet shembullit. Rrethi familjar është vendi ideal për të shfaqur dhe mësuar mirësinë, faljen, besimin në Perëndi dhe çdo virtut tjetër të praktikuar të ungjillit të Jezu Krishtit.

Babai kryeson dhe ka përgjegjësinë themelore në qeverisjen e shtëpisë, por prindërimi natyrisht është një përgjegjësi e përbashkët. Të dy prindërit zënë një rol udhëheqës në mësimin e fëmijëve të tyre dhe të dy duhet të këshillohen së bashku e të mbështesin njëri-tjetrin. Në këtë përpjekje prindërit duhet të kujtojnë metaforën e mrekullueshëm të qiririt dhe pasqyrës nga Presidenti Kimball: “Ka



dy mënyra për të përhapur dritë: të jesh qiri ose të jesh pasqyra që e reflekton atë. Ne prindërit mund të jemi në të dy rolet.” (Në Conference Report, Stockholm Sweden Area Conference 1974, f. 49.) Në detyrën e shenjtë të mësimi të fëmijëve të Perëndisë, prindërit duhet të bashkohen dhe të ndërthurin përpjekjet për të larguar forcat e errësirës nga jeta e fëmijëve të tyre.

Grupi familjar është gjithashtu organizata më e mirë për të reaguar kundër egoizmit dhe vetë-kënaqësisë, atyre temave të ngulitura që duket se janë këngët e sirenavë të kohëve moderne. Në kontrast me individualizmin egoist që na rrethon, ne duhet të kërkojmë ta modelojmë jetën tonë familjare sipas vetësakrificimit të Shpëtimtarit tonë. Ai na mësoi të japim veten në shërbim të një tjetri. Në predikimin tij të madh të mbylljes, Mbreti Benjamin i tha popullit të tij të mësonte fëmijët e vet që “të ecin në udhët e së vërtetës dhe të maturisë... [dhe] të duan njëri-tjetrin dhe t'i shërbejnë njëri-tjetrit”. (Mosia 4:15.)

Nuk ka marrëdhënie njerëzore më të përshtatshme për mësim të tilla, sesa familja ku prindërit vërtet i duan dhe japin jetën e vet në shërbim të fëmijëve të tyre. Prindërit duhet t'u mësojnë parimet e ungjillit të rivendosur, përfshirë veçanërisht sakrificën shlyese të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Prindërit duhet gjithashtu t'u mësojnë sakrificat e një shkalle më të vogël që ata po bëjnë për vetë familjet e tyre. Nëse bëhet me një shpirt të drejtë – nëpërmjet shembullit si edhe këshillës – kjo mësimdhënie duhet t'i ndihmojë fëmijët të jenë më të dashur dhe më nderues ndaj prindërve të tyre. Ajo duhet gjithashtu të ndihmojë përgatitjen e fëmijëve për të qënë prindër edhe ata.

Prindërit japin mësim dhe familjet mësojnë duke i bërë gjërat së bashku.

Familjet duhet të luten së bashku, të gjunjëzohen në mbrëmje dhe në mëngjes për të dhënë falënderime për bekimet dhe lutje për shqetësimet e përbashkëta.

Familjet duhet të adhurojnë së bashku, duke marrë pjesë në shërbesat e kishës dhe në takimet shpirtërore familjare.

Familjet duhet të studiojnë dhe të mësojnë së bashku. Kjo duhet të përfshijë leximin dhe diskutimin në grup të shkrimeve të shenjta dhe

diskutimin në grup të temave të tjera të vlefshme, si ajo e njohurisë praktike të nevojshme për të ecur në një botë moderne.

Familjet duhet të punojnë së bashku, siç u sugjerua më sipër. Familjet duhet gjithashtu të luajnë së bashku, në mënyrë që përvoja të lumtura argëtuese të shoqërohen me veprimtari të familjes.

Familjet duhet të këshillohen së bashku, të trajtojnë të gjitha çështjet që shqetësojnë familjen dhe pjesëtarët e saj.

Familjet duhet të ulen së bashku për të ngrënë. Koha e ngrënies është një kohë e natyrshe që familja të mblidhet dhe të komunikojë. Është turp që një mundësi e tillë të humbasë në grindje familjare apo të copëtohet nga pjesëtarët e familjes që marrin ushqim dhe shpërndahen në të katër qoshet, sikur kuzhina familjare të ishte një sportel fastfudi.

Familjet duhet të bashkohen për regjistrimin e traditave familjare dhe të përvojave të shenjta. Ato duhet gjithashtu të mblidhen për të treguar të dhëna të tilla për të forcuar familjen dhe secilin pjesëtar të saj. Siç na rikujtoi Presidenti Kimball: “Histori frymëzimi nga jeta jonë dhe e asaj të paraardhësve tanë ... janë mjete të fuqishme mësimi”, një burim frymëzimi për ne dhe pasardhësit tanë. (*Ensign*, janar 1982, f. 4.)

Është një fakt për t'u shënuar që mbrëmja familjare është kohë ideale për të plotësuar thujtë çdo lloj afrimi familjar. Ajo është vendi ideal ku familja të lutet së bashku, të mësojë së bashku, të këshillohet së bashku, të luajë së bashku dhe madje të punojë së bashku. Shumica prej nesh e di këtë, por unë do të doja të dija sa nga ne janë duke e përdorur realisht mbrëmjen familjare në të gjithë mundësitë e saj. ...

Rëndësia e përgjegjësisë tona si prindër zbulohet në këtë deklaratë profetike nga Presidenti Spenser W. Kimball:

“Do të vijë koha kur vetëm ata që besojnë thellë dhe aktivisht tek familja, do të jenë në gjendje t'i ruajnë familjet e tyre në mes të ligësisë që grumbullohet rreth nesh.” (*Ensign*, nëntor 1980, f. 4.)

Në detyrën absolutisht të rëndësishme të ruajtjes së familjeve na duhet gjithë ndihma që

mund të marrim. Në këtë përpjekje ne kemi të drejtën të marrim dhe do të marrim bekimet e qiellit. Ne jemi shërbëtorët e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, dhe është porosia e tij që ne ndjekim kur përpiqemi të plotësojmë përgjegjësitë tona të shenjta si prindër në Sion. Qofshim të zellshëm dhe të bekuar në atë përpjekje.

#### **NDIHMË STUDIMI**

- Cilat janë disa nga përgjegjësitë kryesore të prindërve si udhëheqës të familjes?
- Cilat shkaqe jep Plaku Ouks për vërejtjen e tij se udhëheqësit e hershëm të Kishës folën

më rallë se të tanishmit mbi përgjegjësitë familjare?

- Çfarë mund të bëjnë familjet, thotë Plaku Ouks, që të jenë të bashkuara?
- Sipas Plakut Ouks, cila është për prindërit mënyra më e efektshme e mësimdhënies?
- Cilat janë disa nga gjërat që familjet mund t'i bëjnë së bashku?
- Çfarë mund të bëjnë udhëheqësit për të forcuar prindërit dhe shtëpinë si vend për mësimin e ungjillit dhe si laborator për të jetuar mësimet e Shpëtimtarit?

# SHËRBIMI PËR ATA QË UDHËHEQIM

*“Por Jezusi u tha atyre: ‘Mbretërit e kombeve i sundojnë ato, dhe ata që ushtrojnë pushtet mbi to quhen bamirës.*

*Por me ju mos qoftë kështu; madje më i madhi ndër ju le të jetë si më i vogli dhe ai që drejton si ai që shërben.*

*Në fakt kush është më i madh: ai që është në tryezë apo ai që shërben? Vallë, a s’është ai që rri në tryezë? E pra, unë jam midis jush pors ai që shërben” (Lluka 22:25–27).*

## PARIM I UDHËHEQJES

Udhëheqësit e familjes dhe të Kishës i shërbejnë Zotit duke u shërbyer atyre që udhëheqin.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Shpëtimtari ishte udhëheqësi i përsosur dhe shërbëtori i përsosur.
2. Ne duhet të mësojmë të jemi udhëheqës-shërbyes.
3. Ne mund të jemi udhëheqës-shërbyes më të mirë kur kuptojmë nevojat e njerëzve që u shërbejmë.

## KONCEPTI 1. SHPËTIMTARI ISHTE UDHËHEQËSI I PËRSOSUR DHE SHËRBËTORI I PËRSOSUR.

### KOMENT

Gjatë shërbesës tokësore të Jezu Krishtit, nëna e Jakobit dhe e Gjonit kërkoi njëherë që bijtë e saj të merrnin një favor të veçantë. Jezusi shpjegoi: “Ju e dini se të parët e kombeve i sundojnë ato dhe të mëdhenjtë përdorin pushtet mbi ato,

por midis jush kështu nuk do të ndodhë; madje secili prej jush që do të dojë të bëhet i madh, qoftë shërbëtori juaj;

dhe kushdo prej jush që do të dojë të jetë i pari, qoftë skllavi juaj.

Sepse edhe Biri i njeriut nuk erdhi që t’i shërbejnë, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si çmim për shpengimin e shumë vetëve” (Mateu 20:25–28).

Pas festës së Tij të fundit të Pashkës, Jezusi u lau këmbët Apostujve të Tij dhe pastaj i pyeti: “A e kuptoni këtë që ju kam bërë?”

Ju më quani Mësues dhe Zot, dhe mirë thoni, sepse jam.

Në qoftë se unë, Zoti dhe Mësuesi, ju kam larë këmbët, edhe ju duhet t’i lani këmbët njëri-tjetrit.

Unë, në fakt, ju kam dhënë shëmbullin që ashtu siç kam bërë unë, bëni edhe ju.

Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Shërbëtori nuk është më i madh se padroni i tij, as i dërguari më i madh se ai që e ka dërguar” (Gjoni 13:12–16).

Siç vërejtë Plaku Nil A. Maksuell, anëtar i Kuoromit të Dymbëdhjetëve: “Udhëheqësi-shërbyes është mishëruar përsosmërisht nga Jezusi” (*Even As I Am* [1982], f. 62). Jezusi shpenzoi shërbesën e tij tokësore duke i shëruar, bekuar, mësuar dhe duke u shërbyer të gjithëve, pavarësisht nga pozita. Ai u shërbeu njerëzve në kushtet e nevojave të tyre më të thella. Shpëtimtari, në fjalimin e Tij për bukën e jetës, vërejtë se shumë njerëz e ndoqën Atë për shkak të mrekullive që Ai bëri. Të tjerë e ndoqën sepse ai u dha bukë dhe peshk. Shpëtimtari e dinte se ata kishin nevojë më shumë sesa për mrekulli dhe bukë për të ushqyer shpirtrat e tyre. Ai i ftoi ata të “[hanin] mishin e Birit të njeriut dhe ... të ... [pinin] gjakun e tij”, duke u premtuar se “kush ha këtë bukë

do të jetojë përjetë” (Gjoni 6:53, 58). Pjetri, duke folur për Të Dymbëdhjetët, dëshmoi se Jezusi vërtet tha “fjalë jete të përjetshme” (v. 68).

Presidenti Xhejms E. Faust, Këshilltar në Presidencinë e Parë, na mësoi: “Nevojat bazë të njerëzimit ... – vetërespekti, paqja e mendjes dhe kënaqësia vetjake – mund të kënaqen plotësisht nëpërmjet bindjes besnike ndaj urdhërimeve të Perëndisë. Kjo është e vërtetë për çdo njeri në çdo vend apo kulturë” (në Conference Report, prill 1995, f. 81; ose *Ensign*, maj 1995, f. 62).

## IDE MËSIMORE

Lexoni me klasën tuaj Mateu 20:25–28; Gjoni 13:12–16 dhe pyesni: Si ndryshon udhëheqja në mbretërinë e Perëndisë nga udhëheqja në botë? Diskutoni përgjigjet e tyre (shih komentin).

U thoni studentëve të kërkojnë në shkrimet e shenjta për shembuj të shërbimit që dha Jezusi apo një nga ndjekësit e Tij. U thoni gjithashtu të kërkojnë për shkrime të shenjta që shpjegojnë rëndësinë e shërbimit. I ftoni të tregojnë shkrimet e shenjta që gjejnë.

Shpjegoni se Jezusi “mishëroi përsosmërisht” idenë e udhëheqjes shërbyese. Diskutoni se në ç’mënyrë Shlyerja e Zotit është vepra më e madhe e shërbimit e kryer ndonjëherë.

## KONCEPT 2. NE DUHET TË MËSOJMË TË JEMI UDHËHEQËS-SHËRBYES.

### KOMENT

Pas Jezu Krishtit, disa nga shembujt më të mirë të udhëheqësve-shërbyes janë profetët dhe misionarët e lashtë dhe modernë. Mbreti Benjamin i mësoi popullit të tij rëndësinë e shërbimit: “Kur jeni në shërbimin e bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë tuaj”. (Mosia 2:17). Amoni që në gjendje t’i mësonte Mbretit Lamon dhe popullit të tij sepse ai, së pari, u bë shërbëtori i tij (shih Alma 17–19). Plaku Nil A. Maksuell tha për Profetin Jozef Smith: “A ishte Jozefi një udhëheqës-shërbyes? Dukshëm! Një vajzë dhe vëllai i saj po përpiqeshin në baltë të thellë rrugës së tyre për në shkollë. Profeti Jozef ‘ndaloi dhe na e pastroi baltën nga këpucët tona të vogla ngarkuar rëndë me baltë, nxori shaminë e dorës nga xhepi dhe na fshiu fytyrën e përlotur. Ai na tha fjalë të

mira dhe inkurajuese dhe na nisi të gëzuar rrugës për në shkollë” (Juvenile Instructor, 15 janar 1892, f. 67).

“Lidhur me shpëtimin bashkë me Jozefin nga një turmë keqbërësish, një i ri tregoi: ‘Sëmundja dhe frika ma kishin rrëmbyer forcën. Jozefit i duhej të vendoste nëse duhej të më linte të më kapte turma apo të rrezikohej vetë duke dhënë ndihmë. Duke zgjedhur të dytën, ai më ngriti mbi shpatullat e tij të gjera dhe më mbarti me ndalesa të rastit nëpër moçal dhe errësirë. Disa orë më vonë ne dolëm tek e vetmja rrugë dhe shpejt arritëm në vend të sigurt. Forca herkuliane e Jozefit e lejoi të më [shpëtonte] jetën’ (*New Era*, dhjetor 1973, f. 19)” (në Conference Report, tetor 1983, f. 78; ose *Ensign*, nëntor 1983, f. 56).

Plaku L. Tom Perri i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve tha për Presidentin Hauard W. Hanter: “Historia e jetës së tij është e mbushur me tregime vendosmërie, realizimi, besimi dhe dashurie të vërtetë të krishterë. Ai është një frymëzim për të gjithë ne. Ai është profeti ynë. Ne ulemi te këmbët e tij gati të ushqehemi me bollëk nga urtësia e këtij udhëheqësi-shërbyes të vërtetë dhe besnik” (në Conference Report, tetor 1994, f. 23; ose *Ensign*, nëntor 1994, f. 19).

Plaku Nil A. Maksuell shkroi: “Udhëheqësi-shërbyes është mishëruar përsosmërisht nga Jezusi dhe, nëse duhet të bëhemi si Ai, kështu duhet të ndodhë me ne.

Vërtet, vetë dobia e jetës sonë varet nga gatishmëria jonë që t’u shërbejmë të tjerëve” (*Even As I Am*, f. 62).

Në të kundërtën, siç vërejti Plaku Rasëll M. Nelson i Të Dymbëdhjetëve, “përpjekja për t’u bërë më shumë zot sesa shërbyes ... mund të shkatërrojë shpirtin e punëtorit dhe të punës” (në Conference Report, prill 1996, f. 19; ose *Ensign*, maj 1996, f. 15). Presidenti Gordon B. Hinkli shkroi: “Disa nga punët tona më të mira vijnë nëpërmjet shërbimit për të tjerët” (*Standing for Something: Ten Neglected Virtues That Will Heal Our Hearts and Homes* [2000], f. 161).

Plaku Van J. Fedhërstoun renditi veçori dhe praktika të dobishme të udhëheqësve-shërbyes. Referojuni listës së tij në seksionin burime për mësuesin të mësimi 1 (f. 5).

## IDE MËSIMORE

Jepini çdo student një kopje të listës së Plakut Fedhërstoun për veçoritë e udhëheqësve-shërbyes (f. 5). Diskutoni me studentët veçori vetjake dhe se në ç'mënyrë zhvillimi i tyre mund të na ndihmojë të bëhemi udhëheqës më të mirë të familjes dhe të Kishës.

Ndajini studentët në grupe të vogla. I thoni secilit grup të lexojë Mosia 2. Shpjegoni se ky kapitull përmban fillimin e predikimit të fundit të Mbretit Benjamin për popullin e tij. U thoni studentëve të vërejnë mënyrat se si e mishëroi Mbreti Benjamin udhëheqësin-shërbyes dhe çfarë i mësoi popullit mbi shërbimin ndaj njëri-tjetrit. Kur të mbarojnë, diskutoni çfarë mësuan mbi udhëheqësin-shërbyes nga jeta dhe mësimdhënia e Mbretit Benjamin.

### **KONCEPT 3. NE MUND TË JEMI UDHËHEQËS-SHËRBYES MË TË MIRË KUR KUPTOJMË NEVOJAT E NJERËZVE QË U SHËRBEJMË.**

#### **KOMENT**

Udhëheqësit janë më të efektshëm kur ata kuptojnë nevojat e atyre që u shërbejnë. Disa nevoja janë të përbashkëta për të gjithë. Nëse uria gërren stomakun, mendja priret të përqendrohet tek nevoja për ushqim. Po kështu, nëse individët janë të sëmurë apo nuk kanë veshje, strehë apo të ardhura, ata mund ta gjejnë të vështirë të përqendrohen në çështje të tjera.

Përveç nevojave fizike, njerëzit kanë nevoja mendore, emocionale dhe shpirtërore. Individët në përgjithësi ia kalojnë më mirë nëse kanë miq të mirë, mbështetje familjare, njohje, ndjesinë se i përkasin një grupi apo kauze që ia vlen, dhe nëse ndihen të vlefshëm.

Disa nevoja ndryshojnë sipas moshës. Për shembull, të rinjtë në përgjithësi ndiejnë presionin e shokëve dhe kanë nevojë më të mprehtë sesa të moshuarit që të jenë shoqërisht të pranueshëm. Nevoja të tjera i prekin të gjithë, pavarësisht nga mosha apo rrethanat. Për shembull, të gjithë kemi nevojë të dimë që Perëndia kujdeset se ç'ndodh në jetën tonë.

Ka shumë mënyra për të rritur kuptimin tonë mbi nevojat e atyre që u shërbejmë. Për

shembull, kur lexojmë tregimet e shkrimeve të shenjta për Jezusin dhe udhëheqësit e Tij që i shërbenin popullit, ne mund të bëjmë pyetje si këto: “Si i zbuloi ky udhëheqës nevojat e njerëzve? Si ia treguan njerëzit nevojat e tyre udhëheqësit? Çfarë bëri udhëheqësi për të ditur rreth tyre që e ndihmoi atë të zbulojë nevojat e tyre? Cilat janë nevojat fizike që duhet të trajtojnë ndonjëherë udhëheqësit, para se të mund të ndihmojnë njerëzit të plotësojnë nevojat e tyre shpirtërore?”

Ne mund të marrim njohuri vetë mbi nevojat e njerëzve në përgjithësi, nëpërmjet leximit, vrojtimit, pjesëmarrjes në klasa mbi udhëheqjen dhe nëpërmjet lutjes. Ne gjithashtu mund të mendojmë për nevojat tona dhe si i plotësojmë ato.

Presidenti Gordon B. Hinkli shpjegoi: “Ndërsa shohim me dashuri dhe mirënjohje tek Perëndia dhe ndërsa u shërbejmë të tjerëve pa ndonjë shpërblim të dukshëm për vete, do të vijë një ndjesi më e madhe shërbimi ndaj qenieve të tjera njerëzore si ne, më pak mendim për vetveten dhe më shumë afrim ndaj të tjerëve. Ky parim i dashurisë është esenca bazë e mirësisë” (*Standing for Something*, f. 9).

## IDE MËSIMORE

Diskutoni materialin e komentit. Ju mund të drejtoni pyetje si këto:

- Çfarë nevojash duhet të shqyrtojmë kur punojmë të bëhemi udhëheqës-shërbyes më të mirë?
- Çfarë nevojash të përveçme kanë të rinjtë që duhet të shqyrtohen nga udhëheqësit e tyre?
- Çfarë librash i keni parë si të dobishëm për kuptimin e nevojave të të tjerëve?

Diskutoni përvojat që ju kanë ndihmuar të keni më mirë parasysh nevojat e individëve. Bëni një diskutim klase mbi veprimtaritë misionare të Amonit (shih Alma 17–19). U thoni studentëve të kërkojnë se çfarë bëri Amoni për të kuptuar dhe plotësuar nevojat e Mbretit Lamoni.

Ju mund ta mbyllni duke lexuar deklaratën e Presidentit Hinkli nga komenti.

**BURIME PËR MËSUESIN****Plaku Van J. Fedhërstoun***Nga Të Shtatëdhjetët**Pjesë të nxjerra nga More Purity Give Me [1991], f. 11–14*

Parimi i udhëheqësit-shërbyes rrjedh nga vetë burimi i të gjithë drejtësisë, Perëndia Atë Qiellor, dhe na vjen nëpërmjet Zotit Jezu Krisht, Biri i Vetëmlindur. Të dy kanë qenë për ne shembuj kulmorë të udhëheqjes nëpërmjet shërbimit. ...

A nuk është lutja e Mësuesit në përputhje me udhëheqjen shërbyese? Ai tha: “Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’ju jap çlodhje. Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përulur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtat tuaj. Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë!” (Mateu 11:28–30.)

Tek Marku ne lexojmë se dishepujt kishin diskutuar midis tyre lidhur me atë se kush duhej të ishte më i madhi: “Atëherë ai u ul, i thirri të dymbëdhjetët dhe u tha atyre: ‘Nëse dikush don të jetë i pari, le të bëhet i fundit i të gjithëve dhe shërbëtori i të gjithëve’”. (Marku 9:35.) ...

Udhëheqësit-shërbyes u shërbejnë njerëzve, të cilët të gjithë janë individë të krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, Atit tonë të Gjithëfuqishëm. Administratorët, menaxherët dhe udhëheqësit e përqendruar tek vetja janë kryesisht të interesuar për rregullat, rregulloret, politikat dhe programet. Për njerëz të tillë, burrat dhe gratë janë të rëndësishëm për sa kohë që ata janë “të dobishëm” për arritjen e qëllimeve.

Sa menaxherë, administratorë dhe udhëheqës do të kishin vërejtur njerëz në dukje të parëndësishëm duke bërë gjëra të mrekullueshme. “Dhe Jezusi u ul përballë arkës së thesarit dhe vërente se njerëzit hidhnin aty denar; shumë të pasur hidhnin shumë.” (Marku 12:41.) Jezusi e kishte parasysh dhënien e tyre. Ishte një akt i denjë dhe shumë të mira do të bëheshin. Ai nuk nënvlehtësonte atë që kushdo qoftë kishte dhënë. Shumë

udhëheqës sot do të përlogaritnin vetëm atë shumë të hollash që mund të përdoret për të prodhuar fitim të mëtejshëm në shuma të bollshme. Pak vëmendje do t’i kushtohej një të veje, padyshim të gjendur në siklet, me pak rëndësi, veshur jo mirë, ndoshta e drithëruar dhe kokëulur, që afrohej tek thesari. Ajo hodhi dy monedha të vogla, dy nga monedhat më të vogla të hebrenjve. Dy monedhat e vogla nuk ishin të mjaftueshme as për të blerë një çyrek bukë. Ajo ndoshta nuk guxoi as të ngrinte sytë nga frika se mos ndonjëri kishte parë dhuratën e saj tepër të vogël dhe mund ta përqueshte. Mund ta përfytyroj që ajo nxitoi të largohej për të shmangur turpin apo sikletin.

Jezusi i thirri dishepujt e tij dhe u tha: “Ju them në të vërtetë se kjo e ve e varfër ka hedhur në thesar më shumë se të gjithë të tjerët. Sepse të gjithë hodhën aty nga teprica e tyre, kurse ajo, me skamjen e vet, hodhi gjithë sa kishte për të jetuar.” (Marku 12:43–44.)

Unë pyes veten nëse, në njëfarë mënyre, ai që është Mësues i qiellit dhe i tokës, ishte në gjendje të përcillte në zemrën e së vesë mirënjohjen e tij të ëmbël e të përzemërt për dhuratën e saj.

**Plaku M. Rasëll Ballard***Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve**Fragmente nga “The Greater Priesthood: Giving a Lifetime of Service in the Kingdom”, Ensign, shtator 1992, f. 71, 73*

Të gjithë ata që mbajnë priftërinë e Perëndisë, janë të lidhur së bashku në një marrëdhënie të përbashkët shërbimi. Gjon Pagëzori i ringjallur e shprehu këtë koncept në atë rast të shenjtë kur ai rivendosi Priftërinë Aarone tek njerëzit në tokë. Ky lajmëtar engjellor nga Perëndia, i njëjti që kishte pasur privilegjin të pagëzonte Shpëtimtarin, iu drejtua Profetit Jozef Smith dhe shokut të tij në atë vepër, Oliver Kaudrit, si “bashkëshërbëtorët e mi”. (DeB 13:1.) Çfarë modeli i mrekullueshëm për shërbim të përulur në mbretërinë e Perëndisë!

Çdo burrë apo djalë që mban priftërinë, pavarësisht nga priftëria e tij apo detyra në të cilën

është shuguruar, është një bashkëshërbëtor në punën e Zotit Jezu Krisht.

Edhe pse unë mbaj detyrën e shuguruar të Apostullit në Priftërinë Melkizedeke, shokët e mi në atë detyrë dhe unë jemi bashkëshërbëtorë në punën e Zotit me dhjakët apo pleqtë e porsashuguruar në Kishë.

Ndërsa Apostulli Pal deklaroi të vërtetën se “Perëndia i vuri ... së pari apostuj [në Kishë]” (1 Korintasve 12:28), ai gjithashtu deklaroi të vërtetën se çdo anëtar i trupit është i nevojshëm. Asnjë, në cilëndo detyrë të priftërisë, nuk mund të thotë për ata që janë në detyra të tjera: “Unë nuk kam nevojë për ty”, sepse ne të gjithë jemi bashkëshërbëtorë në shërbim të Zotit. (Shih vargjet 14–28.) Objektivi ynë i përbashkët dhe më i rëndësishëm është të bëjmë punën e Tij. Çdo mbajtës priftërie, duke vepruar brenda detyrave të thirrjes së tij, është i nevojshëm për të përmbushur punën e Zotit.

E përsëris, një detyrë priftërie jepet jo për status, por për shërbim. Ju dhe unë jemi bashkëshërbëtorë në Kishën e Jezu Krishtit. ...

Presidenti Dejvid O. Mek-Kei deklaroi: “Priftëri do të thotë shërbim. Kjo është e vërtetë madje në burimin e saj hyjnor, siç mund ta kuptojmë nga deklarata frymëzuese: ‘Kjo është puna ime dhe lavdia ime – të bëjë të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut’. Me burim nga Hyjnia është shërbimi që çon në shëlbimin e fëmijëve të Perëndisë.” (*Pathways to Happiness*, Salt Lake City: Bookcraft, 1957, f. 231.) ...

... Unë ju ftoj të mendoheni thellë mbi fjalët e mëposhtme të Presidentit Marion G. Romni:

“Shërbimi nuk është diçka që ne e durojmë mbi këtë tokë që të mund të fitojmë të drejtën të

jetojmë në mbretërinë çelestiale. Shërbimi është vetë materiali me të cilin ndërtohet një jetë e ekzaltuar në mbretërinë çelestiale.

Duke ditur se shërbimi është gjëja që i jep përmbushje Atit tonë në Qiell, dhe duke ditur që ne duam të jemi atje ku Ai është dhe ashtu si Ai është, përse duhet të urdhërohemi që t'i shërbejmë njëri-tjetrit? ... Shërbimi është gjithçka që lidhet me Perëndishmërinë.” (*Ensign*, nëntor 1982, f. 93.)

Vëllezër, është një bekim i dashur të mbash priftërinë e Perëndisë dhe të kesh mundësinë e shërbimit pa kufi ndaj bashkënjerezve tanë. Unë e di se Zoti Jezu Krisht jeton dhe unë lutem që Perëndia të mund t'ju bekojë juve, të rinj dhe të vjetër, me një vlerësim të thellë për priftërinë që mbani dhe me një dëshirë të shtuar për t'i shërbyer bashkënjerezve tuaj dhe Atit tuaj Qiellor, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

#### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Kur u shërbejmë të tjerëve, si mund të përcaktojmë dhe të shprehim mirënjohjen për atë që ata e bëjnë mirë? (shih diskutimin e Plakut Fedhërstoun për monedhën e vogël të së vesë).
- Çfarë efektesh pozitive mund të ketë një kompliment i sinqertë te një person tjetër?
- Si jeni ndier kur përpjekjet tuaja të merituar kaluan pa u vënë re? Çfarë do t'ju pëlqente që të ndodhte?
- Cili mendoni se është drejtpeshimi i duhur midis njerëzve dhe programeve?
- Zgjidhni dhe diskutoni disa thënie nga komentet e Plakut Ballard, që janë domethënëse për ju.

# MËSIMI PËR TË UDHËHEQUR ME DASHURI HYJNORE

*“Por, dashuria hyjnore është dashuria e pastër e Krishtit dhe nuk ka mbarim; dhe kushdo që gjendet i zotëruar prej saj në ditën e fundit, do të jetë mirë me të.*

*Prandaj, vëllezër të mi të dashur, lutuni Atit me gjithë fuqinë e zemrës suaj, që të mbusheni me këtë dashuri që ai ua jep të gjithë atyre që janë pasues të vërtetë të Birit të tij Jezu Krisht” (Moroni 7:47, 48).*

## PARIME TË UDHËHEQJES

Udhëheqja si ajo e Krishtit motivohet nga dashuria hyjnore.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Dashuria hyjnore është motivi më i lartë për shërbim si udhëheqës.
2. Ne mund të rritemi në aftësinë tonë për të udhëhequr me dashuri hyjnore.

### **KONCEPT 1. DASHURIA HYJNORE ËSHTË MOTIVI MË I LARTË PËR SHËRBIM SI UDHËHEQËS.**

#### KOMENT

Dashuria hyjnore është “lloji më i lartë, më fisnik, më i fortë, jo thjesht dhembshuri; dashuria e pastër e Krishtit. Ajo nuk përdoret kurrë [në shkrimet e shenjta] për të treguar lëmoshë apo veprime apo dashamirësi” (Bible Dictionary “dashuria hyjnore”, f. 632).

Apostulli Pal na mësoi se dashuria hyjnore është më e madhe se çfarëdo akt i dukshëm shërbimi apo çfarëdo dhurate tjetër shpirtërore: “Po të flisja gjuhët e njerëzve dhe të engjëjve, dhe të mos kisha dashuri, do të bëhesha si një bronx që kumbon ose si cimballi që tingëllon.

Edhe sikur të kisha dhuntinë e profecisë, edhe të dija të gjitha misteret dhe mbarë shkencën dhe të kisha gjithë besimin sa të luaja nga vendi malet, por të mos kisha dashuri, nuk jam asgjë.

Edhe sikur të ndaja gjithë pasuritë e mia për të ushqyer të varfërit dhe ta jepja trupin tim që të digjej, e të mos kisha dashuri, nuk do të më vlente asgjë! ...

Dashuria nuk ligshtohet kurrë; por profecitë shfuqizohen, gjuhët pushojnë dhe njohuria do të shfuqizohet,

sepse ne njohim pjesërisht dhe profetizojmë pjesërisht.

Por, kur të vijë përsosmëria, atëherë ajo që është e pjesshme do të shfuqizohet ...

Tani, pra, këto tri gjëra mbeten: besimi, shpresa dhe dashuria; por më e madhja nga këto është dashuria (1 Korintasve 13:1–3, 8–10, 13).

Plaku Dallin H. Oaks, anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, na mësoi: “Ne jo vetëm duhet të bëjmë çka është e drejtë. Ne duhet të veprojmë për arsye të drejta. Termi modern është *motiv i mirë*. Shkrimet e shenjta shpesh e shënojnë këtë qëndrim mendor të drejtë me fjalët *qëllim i plotë i zemrës ose synim i vërtetë*...”

... Nëse nuk veprojmë për arsye të drejta, aktet tona nuk do të llogariten për drejtësi...

Nuk ka bekime në aktet gjoja të mira që kryhen për arsye të gabuara” (*Pure in Heart* [1988], f. 15, 33; shih gjithashtu Moroni 7:6–11).

Në një rast tjetër, Plaku Oaks parashtroi gjashtë arsye që njerëzit kanë për të shërbyer:



1. “Për hir të pasurive apo nderimit.”
2. “Për të fituar shoqëri të mirë.”
3. “Nga frika e ndëshkimit.”
4. “Nga ndjenja e detyrës apo nga besnikëria.”
5. “Nga shpresa e një shpërblimi të përjetshëm.”
6. “Nga dashuria për Perëndinë dhe dashuria për bashkënjëzërit.”

Këtë arsye të fundit, dashurinë hyjnore, Plaku Ouks e quan “arsyen më të lartë nga të gjitha... Është ajo që shkrimet e shenjta e quajnë ‘dhun-titë më të mira’ (1 Korintasve 12:31)” (në Conference Report, tetor 1984, f. 14–16; ose *Ensign*, nëntor 1984, f. 13–14).

Udhëheqësit në Kishë dhe në familje kanë nevojë për drejtim, vizion dhe forcë, që vetëm Shpirti i Zotit mund ta japë dhe ky Shpirt pengohet kur motivet tona për të shërbyer nuk janë të pastra. Udhëheqësit duhet të shërbejnë nga dashuria hyjnore më shumë sesa nga motive më pak të denja.

#### IDE MËSIMDHËNIEJE

I pyesni studentët nëse më të rëndësishme janë motivet, aktet apo rezultatet dhe diskutoni përgjigjet e tyre. Shpjegoni që njerëzit priren ta vlerësojnë mirësinë e veprimeve të tyre me anë të rezultatit (për shembull: Sa para fituat? Sa njerëz pagëzuar?). Por Zoti sheh në zemër, apo tek motivi për veprimet tona (shih DeB 137:9). Plaku Nil A. Maksuell nga Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve shpjegoi: “Çdo gjë varet – fillimisht dhe përfundimisht – nga dëshirat tona. Këto u japin formë modeleve tona të mendimit. Dëshirat tona u paraprijnë kështu veprimeve tona dhe gjenden pikërisht në thellësi të shpirt-trave tanë” (në Conference Report, shtator–tetor 1995, f. 28; ose *Ensign*, nëntor 1995, f. 23).

Përkufizoni termin *dashuri hyjnore* dhe shpjegoni që ajo është motivi më i lartë për shërbim si udhëheqës (shih komentin). Diskutoni pyetjet që vijnë si klasë ose në grupe të vogla:

- Cilat janë disa nga arsyet pse mund të shërbejmë si udhëheqës Kisha apo familjeje? A janë të gjitha njësoj të vlefshme?

- Çfarë duhet të bëj nëse motivet e mia për shërbim si udhëheqës janë më pak se prej dashurisë hyjnore?
- Si mund të mësoj t’i dua njerëzit të cilëve u shërbej?

#### KONCEPTI 2. NE MUND TË RRITEMI NË AFTËSINË TONË PËR TË UDHËHEQUR ME DASHURI HYJNORE.

#### KOMENT

Plaku Dallin H. Ouks shkroi: “Kërkesa që aktet tona të mira duhet të shoqërohen nga motive të mira është delikate dhe e vështirë në praktikë...”

Që të bëhemi të pastër në zemër – të arrijmë ekzaltimin – ne duhet të modifikojmë qëndrimet dhe përparësitë tona drejt një gjendjeje shpirtshmërie, duhet të kontrollojmë mendimet tona, duhet të reformojmë motivet tona dhe duhet të përsosim dëshirat tona. Si mund të bëhet kjo?

Hapi i parë në modifikimin e qëndrimeve dhe të përparësive tona është të përballemi me papërsosmëritë tona dhe nevojën për ndryshim...

Ne fillojmë duke pyetur veten. Duke larguar sjelljet e pasinqerta dhe paraqitjet false që kemi, duke shqyrtuar ndershëmrisht dhe thellësisht brenda vetes tonë, ne duhet të kërkojmë të përcaktojmë qëndrimet dhe përparësitë tona të vërteta...

Ne e kërkojmë shpirtshmërinë nëpërmjet besimit, pendimit dhe pagëzimit; nëpërmjet faljes së njëri-tjetrit; nëpërmjet agjërit dhe lutjes; nëpërmjet dëshirave të drejta dhe mendimeve e veprimeve të pastra. Ne e kërkojmë shpirtshmërinë nëpërmjet shërbimit ndaj bashkënjëzëve tanë; nëpërmjet adhurimit; nëpërmjet ushqimit me bollëk me fjalën e Perëndisë, në shkrimet e shenjta dhe në mësimet e profetëve të gjallë. Ne e arrijmë shpirtshmërinë duke bërë dhe mbajtur besëlidhje me Zotin, nëpërmjet përpjekjeve të vetëdijshme për t’i mbajtur të gjitha urdhërimet e Perëndisë. Shpirtshmëria nuk arrihet papritmas. Ajo është

rrjedhim i një vargu zgjedhjesh të drejta. Ajo është fryti i një jete të drejtë...

Për të arritur shpirtshmërinë, për të përmirësuar motivet dhe përsosur dëshirat tona, ne duhet të mësojmë të kontrollojmë mendimet tona. Profeti Alma e mësoi birin e tij besnik Helamanin: ‘Le të jenë të gjitha mendimet e tua të drejtuara te Zoti; po, le të jetë dashuria e zemrës sate e vendosur përgjithnjë te Zoti’ (Alma 37:36)...

Motivi i mirë më i lartë për çfarëdo akti është dashuria hyjnore – dashuria e pastër e Krishtit. Ne e fitojmë atë motiv në dy mënyra: (1) duke u lutur për dashuri dhe (2) duke kryer shërbim.

Ne mund të ndikojmë tek motivet tona nëpërmjet lutjes...

Me qëllim që të mësojmë të shërbejmë për dashurinë e pastër të Krishtit, ne duhet të praktikojmë shërbimin ndaj Perëndisë dhe bashkënjehëzve tanë” (*Pure in Heart*, f. 18, 140–141, 144–145, 148).

## IDE MËSIMDHËNIEJE

Diskutoni me studentët se si mund të zhvillojmë pastërti të zemrës dhe dashurinë hyjnore me qëllim që të jemi udhëheqës më të mirë. Rendisni konkluzionet tuaja në dërrasë. (Këto mund të përfshijnë ndryshimin e qëndrimeve, kontrollimin e mendimeve tona dhe pranimin e papërsosmërive tona. Shih komentin.)

Merrni në konsideratë t’i ftoni studentët për të organizuar një projekt shërbimi për dikë në shkollë ose në lagje, duke mbajtur parasysh rëndësinë e dashurisë hyjnore në një përpjekje të tillë.

## BURIME PËR MËSUESIN



**Vëllai Stefën D. Nadold**

*Ish i Kuorumit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve*

*Fragmente nga Principles of Priesthood Leadership (1999), f. 102–106, 109–119*

Kisha është duke u rritur me shpejtësi në një mjedis shumë kompleks dhe duhet të ketë

udhëheqje priftërie rezultative. Udhëheqja është ndryshe nga menaxhimi. Sfida më e madhe për udhëheqësit e sotëm të priftërisë është të bëjnë disa gjëra të drejta. Unë besoj se ka tre gjëra të drejta që, nëse bëhen plot lutje dhe me zell, do t’i bëjnë udhëheqësit e priftërisë të fuqishëm dhe rezultativë në çuarjen përpara të punës së Zotit. Ato janë:

### I. Mësimdhënia e Planit të Shëlbimit

Kjo është numër një për tre arsye. Së pari, në një këndvështrim shpirtëror, ne mësojmë nga Alma 13 se është përgjegjësi e shuguruar e çdo mbajtësi të Priftërisë Melkizedeke të jetë një mësues i planit të shëlbimit. Së dyti, ne e dimë nga bota laike se udhëheqësit janë ata që mishërojnë vlerat e grupit. Së treti, si çështje praktike, të flasësh mbi doktrinën dhe parimet bën më shumë për të ndryshuar sjellje sesa të flasësh rreth sjelljes [shih Boyd K. Packer, në Conference Report, tetor 1986, f. 20; ose *Ensign*, nëntor 1986, f. 17].

### II. Kryerja e shërbesës

Kryerja e shërbesës, shërbimi dhe bekimi i jetëve është një aspekt thelbësor i ungjillit dhe i udhëheqjes së priftërisë. Ngaqë dashuria hyjnore është thelbi i sjelljes kristiane, kuptimi dhe zbatimi i ndershëm i saj duhet të jenë të pranishëm tek ata që udhëheqin. Kur anëtarët kuptojnë se udhëheqësi i do dhe kujdeset vërtet për ta, ata janë më të gatshëm të udhëhiqen.

### III. Pasja e Vizionit dhe e Përqendrimit

Vetëm duke zhvilluar, shprehur dhe treguar një tablo të qartë e të arritshme të së ardhmes mundet udhëheqësi i priftërisë të fillojë të çojë punën me rezultat përpara. Ajo pamje e asaj që mund të arrihet nga kuorumi, lagjja apo kunji duhet të jetë në përputhje me misionin e Kishës dhe me drejtimin nga autoriteti kryesues...

Këto janë tre veprimtaritë thelbësore që përcaktojnë një udhëheqje, ndajnë udhëheqësit nga menaxherët dhe e bëjnë atë të jetë rezultative... Tre idetë dhe pyetjet me numra romakë që udhëheqësit duhet t’ia shtrojnë vetes janë paraqitur në Figurën 15...

Figura 15

### UDHËHEQËS PRIFTËRIE REZULTATIVË

#### I. Mësimdhënia e Planit të Shëlbimit

- A shpenzoj kohë për të studiuar dhe kuptuar parimet e planit të shëlbimit në mënyrë që të mund t'i jap mësim me qartësi?
- A ua mësoj planin anëtarëve të familjes sime, anëtarëve të kuoromit, lagjes apo kunjit tim dhe miqve e fqinjëve të mi?
- A ua mësoj planin pjesëmarrësve në mbledhjen e sakramentit, në mbledhjet e udhëheqjes, në konferencat e lagjes dhe të kunjit, në intervistat dhe rastet e këshillimeve?

#### II. Kryerja e shërbesës

- A është kryerja e shërbesës vetjake në natyrën e saj, apo vetëm përgjigje ndaj detyrave të caktuara nga institucionet?
- Nëse e gjej të vështirë që të kujdesem vërtet për të tjerët, çfarë mund të bëj që të ndryshoj?
- A po përpiqem të ndjek shembullin e Shpëtimtarit?

#### III. Pasma e Vizionit dhe e Përqendrimit

- A e kuptoj misionin e Kishës?
- Cili grup mund të më ndihmojë të kap një ide praktike se çfarë mund të bëhet?
- Cilat janë dy apo tre gjëra ku mund të përqendrohem?
- Si mund të matet përparimi në rezultatet që synoj?

... Udhëheqja në çdo plan, përfshi priftërinë, është më rezultative nëse i kushtohet vëmendje diçkaje që do ta etiketoj si “proces”. Shqyrtim kërkohet për të parë se si bëhen punët dhe si shkojnë ndërveprimet midis udhëheqësit të priftërisë dhe anëtarëve të kunjit, lagjes apo kuoromit.

Si shembull, shqyrtoni një grua që ka mbetur kohët e fundit e ve, e cila shkoi te peshkopi dhe i shprehu dëshpërimin që nuk do të mund të lutej më kurrë në një mbledhje sakramenti. Kur e pyeti peshkopi, përse duhej të mendonte se nuk do t'i kërkohet më kurrë të lutej në mbledhjen e sakramentit, ajo shpjegoi: “Peshkop, kam vënë re se ju gjithnjë zgjidhni një bashkëshort dhe një bashkëshorte që bëjnë lutjet në mbledhjet e sakramentit dhe, përderisa bashkëshorti më ka vdekur tashmë, më duket se nuk do ta kem më kurrë atë mundësi.”

Pasi u mendua për pak çaste, peshkopi kuptoi se problemi vinte nga një proces i keqdrejtuar – kur

ndërtohej programi i mbledhjes së sakramentit nga një anëtar i këshillit të peshkopit, praktika ishte t'i bëhej një thirrje telefonike një anëtari familjeje dhe i kërkoheshin dy lutje! Një thirrje telefonike për dy lutje ishte e mjaftueshme, por në këtë rast jo rezultative për bekimin e jetës së anëtarëve të lagjes.

Procesi ishte përjashtues jo përfshirës. Ai ishte i mjaftueshëm por jo rezultativ. Unë besoj se udhëheqësit rezultativë mësojnë të menaxhojnë proceset apo mënyrat se si i kryen punët një organizatë. Në trajtimin e një procesi, një udhëheqës rezultativ u drejtohet nevojave që shfaqin individët kur janë pjesë e një organizate. A ia keni shtruar vetes ndonjëherë pyetjet e më poshtme? Përse dua të përfshihem në një organizatë të veçantë; përse i kushtoj kohën dhe përpjekjet e mia kësaj organizate në vend të shumë të tjerave? Cilët janë faktorët e angazhimit, pasionit, emocionit apo entuziazmit që më bëjnë të dua të shoqërohem dhe të jap më të mirën? Shqyrtoni, ndër të tjera, këto gjashtë nevoja apo faktorë.

- Të jesh i përfshirë në diçka me synim
- Të njohësh kujdesin e udhëheqësve dhe të të tjerëve
- Të marrësh pjesë në përparim dhe sukses
- Të jesh pjesë e një grupi
- Të dish çfarë po ndodh
- Të kesh hare

Sigurisht, unë besoj se njerëzit bashkohen me Kishën sepse ajo është e vërtetë. Por a janë të angazhuar, entuziastë, të emocionuar dhe të ruajtur [në aktivitet]? ...

... Udhëheqja në mjedisin dhe organizatat e sotme të ndërlikuara shpesh realizohet më mirë nga udhëheqës në grup sesa nga individualistë të shkëlqyer. Ka me tepëri faktorë të ndryshueshëm, me tepëri prurje, me tepëri mundësi dhe me tepëri ndryshime të shpejta për cilindo individ që vepron i vetëm për të proceduar dhe menaxhuar...

... Ky parim është i vërtetë në thujtë të gjitha përpjekjet tona dhe është i vërtetë në Kishë. Udhëheqja rezultative e Kishës kërkon qasje në grup dhe vëmendje ndaj proceseve në grup...

[Një] sfidë ... për udhëheqësit e priftërisë në Kishë sot është të njohin ndryshimin midis efektshmërisë dhe dobishmërisë. Sigurisht është më e efektshme për një këshill peshkopi apo presidenci kunji të shqyrtojë një çështje dhe të marrë vendim pa kërkuar pjesëmarrje apo pa bërë shumë analizë. Ka një kategori vendimesh ku mirëbesimi apo shqetësime të tjera të tilla diktojnë që vendimet të merren vetëm nga udhëheqësi i priftërisë apo e shumta në konsultim me dy këshilltarët e tij. Në të tilla raste edhe efektshmëria edhe dobishmëria arrihen zakonisht më mirë nga veprimi individual krahasuar me veprimin e grupit. Edhe në këto situata, udhëheqës të urtë kanë mësuar se mbledhja e të gjithë informacionit të mundshëm, mendimi me kujdes i alternativave dhe kryerja e analizës së gjerë janë parakushte për marrje frymëzimi nga Zoti.

Ka, sidoqoftë, shumë situata ku një udhëheqës priftërie mund të jetë me më shumë dobi kur e përfytyron veten si udhëheqës grupi...

... Është e nevojshme të përfshihen anëtarë të organizatës në diskutim, analizë dhe alternativa zgjidhjesh për çfarëdo ndryshimi që duhet bërë. Nëse udhëheqësi i priftërisë dëshiron të shohë të ndodhë diçka, ai duhet ta mendojë veten si udhëheqës grupi. Udhëheqja e duhur në grup në lagje është këshilli i lagjes. Në kunj është këshilli i kunjit...

... Udhëheqësi rezultativ i priftërisë është një udhëheqës në grup. Secili në grup është anëtar i Kishës dhe kujdeset për suksesin e saj. Secilit duhet t'i jepet mundësi e barabartë për pjesëmarrje si dhe mundësi për të mbajtur mbi shpatulla përgjegjësi për rezultatet. Lutemi shënoni! Udhëheqja në grup *nuk* është vendim-marrje me anë votash apo rrëmujë në grup pa asnjë përgjegjës.

Vendimet përfundimtare duhet të merren nga udhëheqës priftërie të shuguruar e të veçuar. Por vendimet më të mira do të merren nga ata udhëheqës që e kanë lejuar procesin të sigurojë pjesëmarrje dhe të nxitë frymëzim.

## KOMUNIKIMI PËRFSHIRËS

Është e natyrshme për dikë në organizatë të dëshirojë të dijë se çfarë po ndodh. Ato ndjenja

mund të injorohen nga udhëheqës apo mund të përdoren për të forcuar angazhimin dhe entuziazmin. Problemi është se komunikimi me anëtarë grupi kërkon kohë dhe përpjekje. Një udhëheqësi të zënë kjo mund të mos t'i duket një përdorim i efektshëm i burimeve. Dhe ka gjithnjë një pyetje të ligjshme mbi atë se çfarë mund dhe duhet të komunikohet dhe çfarë është më mirë të trajtohet në një mënyrë më mirëbesuese. Çdo organizatë ndeshet me këto çështje dhe Kisha nuk është përjashtim.

Udhëheqësit e priftërisë në të gjitha nivelet konsultohen gjerësisht dhe siç duhet mbi rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit kur merren me informacion delikat që ka të bëjë me jetën dhe sjelljen e anëtarëve. Ky konfidencialitet është thelbësor për procesin e pendimit dhe duhet të ekzistojë tek udhëheqësit që të ruajnë mirëbesimin e anëtarëve të Kishës. Ky parim ka rëndësi të skajshme. Duke thënë këtë, unë besoj gjithashtu se ka mundësira për komunikim përfshirës të ligjshëm, që do të jetë i përshtatshëm, i mirëpritur dhe që do të forcojë procesin e udhëheqjes. Sfidat për udhëheqësit e priftërisë është përcaktimi i atyre çështjeve që duhet të komunikohen haptas dhe pastaj të vijojnë me përpjekjen për ta realizuar atë komunikim...

... Përpjekja e bërë për të krijuar procese përfshirëse do të shpërblehet shumëfish me rritje të angazhimit e të entuziazmit dhe do t'i sigurojë udhëheqësit forcën të shtuar për të përmbushur misionin e Kishës.

## *Esprit de corps (shpirti i grupit)*

*Esprit de corps* është përkufizuar në *American Heritage Dictionary (Fjalori i Trashëgimisë Amerikane)* si shpirt i përkushtimit dhe entuziazmit midis anëtarëve të një grupi për njëri-tjetritin, për grupin e tyre dhe qëllimet e tij. Një grup që ka shpirtin i përmbush qëllimet e veta, ka lidhje të forta me anëtarët e tij dhe është kënaqësi të jesh pjesë e tij. Udhëheqës të urtë mund t'i nxitin këto ndjenja në mënyrat e duhura dhe të vërejnë përmirësim të shënuar në funksionimin e grupit. Shumë grupe sportive demonstrojnë *esprit de corps*. Ai ekziston në shumë organizata të suksesshme biznesi, ushtarake dhe patriotike dhe njihet në përgjithësi si

një faktor kyç në suksesin e tyre. Por, a është ky parim i përshtatshëm për përdorim në Kishë? Për shembull, a duam ne si udhëheqës të Kishës të nxitim një qëndrim të përkushtuar skajshëm dhe tepër entuziast për veprimtarinë e Kishës tonë dhe të presim një përkushtim që përjashton çfarëdo veprimtarie apo shoqërimi tjetër? A është e përshtatshme në Kishë të mendojmë në terma të të paturit hare? (Unë njoh një udhëheqës Kishe që thotë se, nëse nuk po zbaviteni, ju nuk po veproni drejt. Unë besoj se ai hap një çështje të rëndësishme.) ...

Përgjigjja nuk është e njëjta për çdo grup dhe për çdo udhëheqës. Disa udhëheqës përdorin personalitetin dhe interesin e tyre të natyrshëm për të nxitur afëri, entuziazëm dhe shpirt. Të tjerë ndihen në siklet dhe të shqetësuar në tentativa të tilla. Ndërsa *esprit de corps* mund të jetë një element i rëndësishëm për suksesin e një udhëheqësi, nuk është e domosdoshme që udhëheqësi të jetë përgjegjës personalisht për fillimin dhe nxitjen e tij. Të tjerë mund ta sjellin atë element në grup. Një udhëheqës i urtë do të inkurajojë shpirtin dhe forcën të vijnë nga një këshilltar entuziast dhe i ri, kryetari i Komitetit të Aktiviteteve apo presidencia e Të Rejave. Sigurisht, *esprit de corps* dhe ndjesia e haresë mund të shpërdorohen... Por, kur ngrohtësia, humori dhe hareja kontrollohen dhe futen siç duhet në kuadrin e nderimit për Shpëtimtarin dhe punën e Tij, mund të jenë skajshëm të dobishme në procesin e udhëheqjes...

... Nëse një udhëheqës priftërie i drejton vazhdimisht vetes pyetje të tilla si: A ndihen anëtarët e kunjit, lagjes apo kuorumit pjesë e asaj çka po ndodh? A janë “në grup”? A ndihen të informuar dhe të përfshirë? A po gëzohen për vete, për shërbimin e tyre dhe përvojën e tyre në Kishë?—nëse ai i drejton vetes pyetje të tilla, ai është në përgjithësi i vetëdijshëm për procesin...

Si përfundim, jam i bindur se udhëheqësi i priftërisë mund të jetë i dobishëm duke bërë

*disa* gjëra të drejta. Një themel bazë i pacënueshëm duhet të jetë drejtësia vetjake dhe dëshira për të kërkuar Shpirtin dhe për t’u mësuar prej Tij. Duke patur këtë themel, gjërat e drejta janë: 1) jepni mësim planin e shëlbimit, 2) kryeni shërbesa siç do të bënte Shpëtimtari, 3) kini vizion dhe përqendrojeni atë vizion në një numër të vogël objektivash. Nëse përveç këtyre udhëheqësi i kushton vëmendje proceseve të nevojshme për përfshirjen e anëtarëve dhe angazhimin e tyre, ai do të jetë një udhëheqës rezultativ i mrekullueshëm. Udhëheqësi do të jetë i lumtur dhe i suksesshëm, jeta e anëtarëve do të bekohet dhe puna e Zotit do të përparojë me drejtim dhe me forcë...

Unë besoj se në proces Perëndia do të na bekojë me urtësi, përvojë, rritje shpirtërore dhe sukses në thirrjet tona. Kjo sigurisht është shpresa dhe lutja ime për çdo udhëheqës priftërie.

#### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Sipas Vëllait Nadold, cilat janë tre aktivitetet që i veçojnë udhëheqësit nga menaxherët?
- Çfarë kupton Vëllai Nadold me “proces”?
- Cilat janë epërsitë e përfshirjes në procesin e vendim-marrjes të atyre që udhëheqim?
- Kur mund të jetë më mirë për një udhëheqës që të veprojë i vetëm?
- Cilat janë disa karakteristika të një grupi që ka *esprit de corps*?
- Cilat konsiderata janë të rëndësishme për udhëheqësit kur ata përfytyrojnë *esprit de corps* në grupet e tyre?
- Cilin themel rekomandon Vëllai Nadold për t’u bërë udhëheqës i mirë?

# UDHËHEQJA SHPESH KËRKON SAKRIFICË

*“Dhe ai që nuk e merr kryqin e vet dhe nuk vjen pas meje, nuk është i denjë për mua.*

*Kush do të gjejë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do të humbasë jetën e vet për hirin tim, do ta gjejë përsëri” (Mateu 10:38–39).*

## PARIME TË UDHËHEQJES

Udhëheqësit e Kishës dhe të familjes duhet të jenë të gatshëm të bëjnë sakrifica për t’u ndihmuar atyre që u shërbejnë.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Jezu Krishti mishëroi sakrificën në shërbimin e Tij për të tjerët.
2. Udhëheqësit duhet të jenë të gatshëm të bëjnë sakrifica për ata të cilëve u shërbejnë.

### KONCEPT 1. JEZU KRISHTI MISHËROI SAKRIFICËN NË SHËRBIMIN E TIJ PËR TË TJERËT.

#### KOMENT

Jezu Krishti vendosi një shembull të përsosur të sakrificës për të tjerët. Asnjë dhuratë nuk që më e madhe sesa dhurata e Tij e Shlyerjes. Presidenti Spenser W. Kimball tha për Shpëtimtarin: “Ai ishte gjithnjë dhënësi, rrallë marrësi. Kurrë nuk dha ai këpucë, çorape apo makinë; kurrë nuk dha ai parfum, këmishë apo një mantel gëzofi. Dhuratat e Tij ishin të një natyre të tillë që marrësi zor se mund t’i këmbente apo t’i paguante. Dhuratat e Tij ishin të rralla: sy për të verbrin, veshë për shurdhin dhe këmbë për sakatin; pastërti për të papastrin, plotësi për të pasigurtin dhe frymë për të pajetin. Dhuratat e Tij ishin mundësi për të dërrmuarin, liri për të shtypurin, dritë në errësirë, falje për të penduarin, shpresë për të dëshpëruarin. Miqtë e Tij i dhanë strehë, ushqim dhe dashuri. Ai u dha atyre veten, dashurinë e tij, shërbimin e tij, jetën e tij. Burrat e urtë i sollën ar dhe temjan. Ai u dha atyre dhe të gjithë shokëve të tyre të vdekshëm ringjallje, shpëtim dhe jetë të përjetshme... Të japësh nga vetja është një dhuratë hyjnore” (*The Teachings of Spencer W. Kimball*, red. Edward L. Kimball [1982], f. 246–247).

#### IDE MËSIMDHËNIEJE

Vini një student të lexojë me zë Mateu 10:37–39 dhe diskutoni idenë se të jesh dishepull i Krishtit kërkon sakrificë. Shpjegoni që Jezu Krishti vendosi shembullin kur Ai sakrifiko për ne. Ftoni studentët të përmendin disa nga sakrificat që Ai bëri.

### KONCEPT 2. UDHËHEQËSIT DUHET TË JENË TË GATSHËM TË BËJNË SAKRIFICA PËR ATA TË CILËVE U SHËRBEJNË.

#### KOMENT

Zoti i ftoi udhëheqësit e hershëm të Kishës ta humbisnin veten në shërbim të Tij. Afër fillimit të shërbesës së Tij tokësore, “ndërsa po kalonte gjatë bregut të detit të Galileës, ai pa Simonin dhe Andrean, vëllanë e tij, të cilët po hidhnin rrjetën në det sepse ishin peshkatarë.

Dhe Jezusi u tha atyre: ‘Ndiqmëni dhe unë do t’ju bëj peshkatarë njerëzish’.

Dhe ata i lanë menjëherë rrjetat dhe e ndoqën” (Marku 16–18).

Levi (Mateu) gjithashtu e la jetesën e tij për të ndjekur Mësuesin (shih Lluka 5:27–28). Pjetri dhe Apostuj të tjerë gjithashtu lanë çdo gjë (shih Lluka 18:28). Edhe Pjetri edhe Pali shprehën

gatishmëri ta linin jetesën e tyre për hir të Tij (shih Gjoni 13:37, Veprat e Apostujve 21:13). Shpëtimtari priste që të gjithë dishepujt e Tij të zhvillonin vetmohimin për të tjerët (shih Lluca 3:11; 9:23).

Zoti u kërkon të gjithë shenjtorëve të Tij të heqin dorë nga bota dhe të kërkojnë të bëhen më të shenjtë. Alma u tha njerëzve të Zarahemlas: “Dhe tani unë ju them juve, të gjithë ju që dëshironi të ndiqni zërin e bariut të mirë, dilni nga të këqijat dhe veçohuni dhe mos prekni gjërat e tyre të papastra” (Alma 5:57; shih 2 Korintasve 6:17). Zoti i kërkon secilit prej nesh t’i paraqesë Atij një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar (shih për shembull 3 Nefi 9:20).

Udhëheqësit e Kishës dhe të familjes duhet të jenë të gatshëm të sakrifikojnë për t’u ndihmuar atyre që u shërbejnë. Në kohëra të ndryshme ata mund të thirren të japin kohën, talentet dhe mjetet e tyre për të bekuar jetën e të tjerëve. Plaku M. Rasëll Ballard nga Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve shpjegoi: “Sakrifica është shfaqje e një dashurie të pastër. Shkalla e dashurisë tonë për Zotin, për ungjillin dhe për bashkënjerezit tanë mund të matet me atë çka ne jemi të gatshëm të sakrifikojmë për ta” (në Conference Report, prill 1992, f. 108; ose *Ensign*, maj 1992, f. 76).

Kur udhëheqësit sakrifikojnë për njerëzit të cilëve u shërbejnë, ata duhet të mbajnë parasysh këshillën e Mbretit Benjamin: “Pasi nuk është e nevojshme që një njeri duhet të vrapojë më shpejt sesa ai ka fuqi. Dhe përsëri, është e domosdoshme që ai duhet të jetë i zellshëm, që kështu të mund të fitojë çmimin; prandaj të gjitha gjërat duhet të bëhen në rregull” (Mosia 4:27; shih gjithashtu DeB 10:4). Plaku Nil A. Maksiuell, që ishte atëherë anëtar i Presidencisë së Të Shtatëdhjetëve, vërejt: “Kur ne vrapojmë më shpejt sesa jemi të aftë, ne bëhemi edhe jo të efektshëm edhe të lodhur” (*Deposition of a Disciple* [1976], f. 58).

#### IDE MËSIMDHËNIEJE

I ftoni studentët të tregojnë raste kur njerëz (të tillë si prindër dhe peshkopë) kanë sakrifikuar për t’u ndihmuar atyre apo dikujt tjetër. I pyesni çfarë sakrificash tipike bëjnë misionarët për të ndihmuar njerëzit të pranojnë ungjillin.

Renditni në dërrasë gjëra që udhëheqës të familjes dhe të Kishës mund të jenë thirrur të sakrifikojnë për të ndihmuar ata të cilëve u shërbejnë. Përfshini vlera që udhëheqësit duhet të jenë të gatshëm të ndajnë, të tilla si koha dhe talente. Përfshini gjithashtu dobësi që ata duhet të jenë të gatshëm t’i mënjanojnë, të tilla si kënaqësitë tokësore (shih komentin).

Diskutoni mënyrat se si sakrificat e udhëheqësve sjellin dobi për ata të cilëve u shërbejnë. Diskutoni se si Zoti bekon udhëheqësit që bëjnë këto sakrificat.

U thoni studentëve të lexojnë Mosia 4:27 dhe shpjegoni se si ky varg zbatohet tek udhëheqësit e Kishës dhe të familjes. Ndani ide nga komenti dhe shpjegoni që udhëheqësit duhet ta “rregullojnë ritmin e vet” në shërbim të tyre.

#### BURIME PËR MËSUESIN



**Plaku Gordon B. Hinkli**

*Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve*

The Loneliness of Leadership, *Brigham Young University Speeches of the Year* (4 nëntor 1969), f. 3–6

... Ka një vetmi në të gjitha aspektet e udhëheqjes...

Gjithnjë kështu ka qenë. Çmimi i udhëheqjes është vetmia. Çmimi i bindjes ndaj ndërgjegjes është vetmia. Çmimi i bindjes ndaj parimit është vetmia. Unë mendoj se kjo është e pashmangshme. Shpëtimtari i botës ishte një njeri që eci në vetmi. Unë nuk di ndonjë deklaratë më të nënvizuar me pathos për vetminë sesa kjo:

“...*Dhelprat i kanë strofkat, dhe zogjtë e qiellit i kanë çerdhet, por Biri i njeriut nuk ka as ku të mbështetë kokën.*” (*Mateu 8:20.*)

Nuk ka shembull më të vetmuar në histori sesa Shpëtimtari në kryq, vetëm, Shëlbuesi i njerëzimit, Shpëtimtari i botës, duke bërë të ndodhë shlyerja, Biri i Perëndisë duke vuajtur për mëkatet e njerëzimit. Duke menduar për këtë unë reflektoj mbi një deklaratë të bërë nga Çaning Pollok (Channing Pollock, shkrimtar 1880–1946).

*Juda me thridhjetë asprat e tij të argjendta ishte një dështim. Krishti në kryq ishte figura më e madhe e kohës dhe e përjetësisë.*

### Jozef Smithi

Jozef Smithi po ashtu ishte një shembull vetmie. Unë kam një dashuri të madhe për djalin që doli nga pyjet, i cili pas asaj përvoje nuk mund të ishte kurrë i njëjti përsëri, të cilin e shanë dhe e përndoqën, dhe e panë me përbuzje. A mund ta ndieni vuajtjen në këto fjalë të djaloshit Profet?

*...Sepse unë kisha parë një vegim; unë e dija atë dhe e dija se Perëndia e dinte atë dhe nuk mund ta mohojta, as nuk guxojta ta bëja atë; të paktën e dija se duke e bërë këtë, do ta fyeja Perëndinë dhe do të isha nën dënim. [JS—H 1:25.]*

Ka pak portrete më dëshpëruese, jo në historinë tonë sidoqoftë, sesa Profeti që Stefen Merkam e çonte me barkë nga ana tjetër e lumit Misisipi, duke ditur që armiqtë kërkonin vdekjen e tij dhe pastaj erdhën disa nga të tijtë, që e akuzuan për arrati. Dëgjoni përgjigjen e tij:

*Nëse jeta ime nuk ka vlerë për miqtë e mi, ajo nuk ka as për mua. ([History of the Church,] 6:549, qershor 1844.)*

### Historia e Kishës

Kjo ka qenë historia e kësaj Kise, miq të mi të rinj, dhe unë shpresoj se ne kurrë nuk do ta harrojmë atë. Ajo erdhi si rezultat i pozicionit të udhëheqjes, e cila na u shugurua nga Perëndia i qiellit që solli rivendosjen e ungjillit të Jezu Krishtit. Dhe kur deklarata u bë lidhur me të vetmen Kishë të vërtetë dhe të gjallë mbi faqen e dheut, ne u vumë menjëherë në një pozitë vetmie, në vetminë e udhëheqjes nga e cila nuk mund të zbrapsemi apo të largohemi dhe të cilën duhet ta përballojmë me guxim dhe kurajë, dhe aftësi. Historia jonë është e një të dëbuar, të shoshituri dhe të zhveshuri, apo të persekutuari dhe gjuajturi...

Unë kthehem prapa tek këto fjalë të Palit:

*Ne jemi të shtrënguar në çdo mënyrë, por nuk jemi të ngushtuar deri në fund; jemi ndër-dyshas por jo të dëshpëruar;*

*jemi të përndjekur por jo të braktisur; të rrëzuar, por jo të shkatëruar” (2 Korintasve 4:8–9).*

### Vetmi misionari

Unë fola natën e shkuar me babanë e një misionari. Ai tha: “Sapo isha duke folur me djalin tim në një vend tjetër. Ai është i vvarë; ai është i dërrmuar. Ai është i vetmuar; ai është i trembur. Ç’mund të bëj që ta ndihmoj?”

Unë i thashë: “Sa kohë ka atje?”

Ai tha: “Tre muaj”.

Unë i thashë: “Ma merr mendja se ky është përjetimi i çdo misionari që ka qenë atje tre muaj. Vështirë të ketë një të ri apo të re që është thirrur të shkojë në botë në një pozitë me përgjegjësi të madhe për të përfaqësuar Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, që nuk ndien shpesh, jam i sigurt, në muajt e parë të misionit të tij apo saj, vetminë e tmerrshme të asaj përgjegjësie. Por ai gjithashtu do të njohë, duke punuar në shërbim të Zotit, shoqërinë e ëmbël dhe të mrekullueshme të Frymës së Shenjtë e cila zbut dhe largon prej tij atë ndjenjë vetmie.”

### I kthyeri i vetmuar

Ndodh po ashtu me një të kthyer. Po mendoja këtë mëngjes për një mik timin, të cilin e njoha kur isha në mision në Londër tridhjetë e gjashtë vite më parë. Kujtoj ardhjen e tij në apartamentin tonë nëpër shiun e natës. Ai trokiti në derë dhe unë e ftova brenda.

Ai tha: “Dua të flas me dikë. Jam krejtësisht vetëm. Unë jam i shkatërruar.”

I thashë: “Çfarë problemi ke?”

Ai tha: “Kur u bashkova me Kishën më pak se një vit përpara, babai më tha të dilja nga shtëpia dhe të mos kthehesha kurrë më dhe unë nuk u ktheva kurrë më”.

Ai vazhdoi: “Pak muaj më vonë klubi i kriektit, ku isha anëtar, më fshiu nga lista e tij, më largoi nga anëtarësia, nga djemtë me të cilët isha rritur dhe me të cilët kisha qenë aq i afërt dhe miqësor”.

Pastaj ai tha: “Muajin e fundit pronari më pushoi nga puna sepse isha anëtar i kësaj Kise dhe nuk kam qenë në gjendje të gjej punë tjetër dhe më është dashur të jetoj me ndihmat e qeverisë.



Dhe natën e shkuar vajza me të cilën takohe-  
shim gjatë një viti e gjysmë, më tha se nuk do të  
martohej kurrë me mua sepse jam mormon.”

Unë i thashë: “Nëse kjo të ka kushtuar ty aq  
shumë, përse nuk e lë Kishën dhe të kthehesh në  
shtëpinë e babait tënd dhe te klubi yt i kriketit,  
dhe te puna që kishte aq shumë rëndësi për ty,  
dhe te vajza që mendon se e dashuron?”

Ai nuk tha asgjë për një kohë, që u duk e  
gjatë. Pastaj, duke vënë kokën në duart e tij,  
qau e qau me dënesë. Më në fund ai ngriti shiki-  
min përmes lotëve dhe tha: “Unë nuk mund ta  
bëj atë. Unë e di se kjo është e vërtetë dhe, edhe  
sikur të më kushtonte jetën, unë kurrë nuk do  
të mund të hiqja dorë”. Ai ngriti kapelen e  
qullur dhe u largua drejt derës, dhe doli nëpër  
shi, i vetëm dhe duke u dridhur, dhe i trembur,  
por i vendosur. Duke e vërejtur, mendova për  
vetminë e ndërgjegjes, vetminë e dëshmisë, vet-  
minë e besimit dhe forcën e qetësinë e Shpirtit  
të Perëndisë.

### **Vetmia e dëshmisë**

Unë do të doja të përfundoja duke ju thënë  
juve këtu sot, juve të rinjve dhe të rejave që jeni  
në këtë kongregacion të madh, ky është fati tuaj.  
Oh, ju jeni të gjithë bashkë tani këtu. Ju jeni të  
gjithë të një lloji, ju jeni të gjithë të një mendjeje.  
Por ju po trajtohemi të shkoni jashtë në botë, ku  
ju *nuk* do të keni përreth dhjetë mijë, njëzet mijë,  
njëzet e pesë mijë të tjerë si ju. Ju do të ndieni  
vetminë e besimit tuaj.

Nuk është aq e lehtë, për shembull, të jesh i  
virtutshëm, kur kudo rreth jush janë ata që tallen  
me virtytin.

Nuk është e lehtë të jesh i ndershëm, kur  
kudo rreth jush janë ata që interesohen vetëm  
të bëjnë “para të shpejta”.

Nuk është gjithnjë e lehtë të jesh i përmbaj-  
tur, kur kudo rreth jush janë ata që tallen me  
vetëpërmbajtjen.

Nuk është e lehtë të jesh punëtor, kur  
kudo rreth jush janë ata që nuk besojnë në  
vlerën e punës.

Nuk është e lehtë të kesh integritet moral, kur  
kudo rreth jush janë ata që do ta braktisnin pari-  
min për rehatinë.

### **Paqja e Shpirtit**

Do të doja t’ju thoshja sot këtu, vëllezër dhe  
motra të mija, se ka vetmi – por një njeri i llojit  
tuaj duhet të jetojë me ndërgjegjen e tij. Një  
njeri duhet të jetojë me parimet e tij. Një njeri  
duhet të jetojë me bindjet e tij. Një njeri duhet  
të jetojë me dëshminë e tij. Po të mos e bëjë  
këtë, ai është i mjeruar – tmerrësisht i mjeruar.  
Dhe megjithëse mund të ketë gjemba, megjithë-  
thëse mund të ketë zhgënjim, megjithëse mund  
të ketë shqetësim dhe vuajtje, dhimbje e thyerje  
zemre dhe vetmi të dëshpëruar, do të ketë paqe  
dhe qetësi, dhe forcë.

### **Një premtim dhe një bekim**

Unë i pëlqej këto fjalë të mëdha të Zotit dhënë  
atyre që do të shkonin jashtë për të dhënë mësim  
këtë ungjill.

*Unë do të shkoj përpara fytyrës suaj. Unë  
do të jem në të djathtën e në të majtën tuaj  
dhe Shpirti im do të jetë në zemrat tuaja e  
engjëjt e mi përreth jush, për t’ju ngritur lart.  
(DeB 84:88.)*

Unë mendoj se ai është një premtim për seci-  
lin prej nesh. Unë e besoj; unë e di këtë. Unë ju  
dëshmoj sot për të vërtetën e tij.

Perëndia ju bekoftë, të dashur miq të mi të  
rinj e të dashur, ju të trashëgimisë fisnike, ju të  
besëlidhjes, ju që jeni shpresa më e madhe e këtij  
brezi – të rinj dhe të reja të zotë dhe të ndër-  
gjegjshëm, të udhëheqjes dhe të potencialit të  
mrekullueshëm.

Perëndia ju bekoftë për të ecur pa frikë edhe  
pse udhëtoni në vetmi dhe të njihni në zemrën  
tuaj atë paqe që vjen nga përputhja e jetës së nje-  
riut me parimin, atë “[paqe të] Perëndisë, që ia  
tejkalon çdo zgjuarësi”, unë lutem me përlulësi,  
duke ju lënë vërtetimin dhe dëshminë time për  
karakterin hyjnor të kësaj pune të shenjtë. Dhe si  
shërbëtor i Zotit, unë lutem për ju që të keni çdo  
gëzim ndërsa ecni përpara në jetën tuaj në një  
përvojë të pasur dhe mrekullisht të dobishme, në  
emrin e Jezu Krishtit. Amen.

### **NDIHMË PËR STUDIMIN**

- Çfarë mendoni se do të thotë fraza: “Ka një  
vetmi të madhe në udhëheqje?”

- Si mund ta përballojmë vetminë e udhëheqjes?
- Çfarë mund ta kompensojë vetminë e udhëheqjes?
- Çfarë mund të mësojmë nga Shpëtimtari mbi vetminë e udhëheqjes?
- Presidenti Spenser W. Kimball, duke komentuar Mateu 10:39, shënoi se “duke e lënë veten, ne e gjejmë veten”, dhe shtoi: “Vërtet, është më e lehtë të ‘gjesh’ veten sepse ka aq shumë më tepër për t’u gjetur tek ne!” (“Small Acts of Service” *Ensign*, dhjetor 1974, f. 2). Si zbatohet ky parim tek dhënia e një udhëheqjeje si e Krishtit?

# QASJA GËZUESHËM NË UDHËHEQJE

“Si rrjedhim, ... shumë të dashur, le të bëjmë me gëzim të gjitha gjërat që janë në fuqinë tonë” (DeB 123:17).

## PARIME TË UDHËHEQJES

Në duhet të qasemi në udhëheqje gëzueshëm.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Udhëheqësit e Kishës dhe të familjes duhet të udhëheqin me “humor të mirë, optimizëm dhe kurajë”.

### KONCEPT 1. UDHËHEQËSIT E KISHËS DHE TË FAMILJES DUHET TË UDHËHEQIN ME “HUMOR TË MIRË, OPTIMIZËM DHE KURAJË”.

#### KOMENT

Merrni zemër do të thotë “kini një natyrë apo sjellje të lumtur apo të guximshme”. Kjo frazë shfaqet disa herë në shkrimet e shenjta. Për shembull, në prag të lindjes së Tij, Zoti i tha Nefit të merakosur: “Ngrije kokën dhe mos e humb kurajën, pasi vër re, koha është afër dhe në këtë natë shenja do të jepet dhe nesër unë do të vij në këtë botë, për t’i treguar botës se unë do të përmbush çdo gjë që kam bërë të thuhet nga goja e profetëve të mi të shenjtë” (3 Nefi 1:13; korsivet shtuar).

Jezusi përdori fjalët merr zemër\_ për të inkurajuar një paralitik dhe pastaj shtoi: “mëkatet e tua të janë falur” (Mateu 9:2). Më vonë Zoti i tha këto fjalë për të qetësuar dishepujt e tij që u trembën kur panë Jezusin të ecte në ujë dhe shtoi: “Jam unë, mos kini frikë” (Mateu 14:27).

Plaku Harold B. Li, që ishte atëherë anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve tha: “Mësuesi e mbylli predikimin e tij të fundit të regjistruar përpara kryqëzimit të tij me fjalët: ‘Jua kam thënë këto gjëra, që ta keni paqen në mua; në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën.’ (Gjoni 16:33.)” (në Conference Report, prill 1966, f. 68).

Në vitin 1831 Zoti i siguroi përsëri shenjtorët: “Merrni zemër, fëmijë të vegjël; pasi unë jam në mes tuaj dhe nuk ju kam braktisur;

Dhe ngaqë jeni përlur përpara meje, bekimet e mbretërisë janë tuajat” (DeB 61:36–37; shih DeB 68:6; 78:18; 112:4).

Plaku Marvin J. Eshton, që ishte anëtar i Të Dymbëdhjetëve, tha: “Neve na duhet të udhëheqim me humor të mirë, optimizëm dhe kurajë nëse duhet të vazhdojmë të shkojmë përpara dhe lart” (në Conference Report, tetor 1974, f. 56; ose *Ensign*, nëntor 1974, f. 41). Presidenti Gordon B. Hinkli shkroi: “Unë sugjeroj që, ndërsa ecim në jetë, ne ‘të nënvizojmë pozitivën’. Unë po kërkoj që të shohim pak më thellë për të mirën, që ne të ulim zërat e fyerjes dhe të sarkazmës, që ne të vlerësojmë më bujarisht dhe të miratojmë virtytin dhe përpjekjen” (*Standing for Something: Ten Neglected Virtues That Will Heal Our Hearts and Homes* [2000], f. 101).

#### IDE MËSIMDHËNIEJE

U kërkoni disa studentëve të përshkruajnë qëndrimin e një udhëheqësi Kise apo familjeje, i cili ka pasur ndikim të mirë në jetën e tyre. Theksoni se udhëheqësit rezultativë janë thaujse gjithnjë pozitive apo të hareshëm kur janë me njerëz të tjerë. I pyesni studentët se si udhëheqësit që ndikuan tek ata e shfaqën qasjen e tyre pozitive dhe të hareshme.

Lexoni Doktrina e Besëlidhje 61:36 dhe i ndihmoni studentët të kuptojnë që Zoti do që të gjithë ne të “[marrim] zemër”.

U thoni studentëve të lexojnë 2 Nefi 4:17–35. Diskutoni pyetje të tilla si:

- Çfarë arsyes kishte Nefi për të mos qenë i hareshëm?
- Çfarë arsyes kishte ai për të qenë i hareshëm?
- Cilin grup arsyes e shihni si më bindës? Pse?
- Si mendoni se ndikoi qëndrimi i Nefit, siç përshkruhet në këto vargje, në udhëheqjen e tij?
- Si mund ta ndjekim shembullin e Nefit në vetë udhëheqjen tonë?

Shkruani fjalët *Hareshëm* dhe *Frikshëm* në dërrasë. Diskutoni arsyet që mund të kenë udhëheqësit sot për të mos qenë të hareshëm (të tilla si frika, stresi, probleme shëndetësore, dështime, luftra, fatkeqësi natyrore, probleme në shkollë apo në punë, mungesë aktiviteti e njerëzve të dashur apo të miqve). Diskutoni arsyet që mund të kenë udhëheqësit sot për të qenë të hareshëm (të tilla si mirësia e të tjerëve, bukuria, “lajmi i mirë” i sakrificës shlyese të Jezu Krishtit, arritjet e të tjerëve, potenciali ynë si fëmijë të Atit Qiellor). Theksoni fjalët në dërrasë dhe thoni: “Ju mund të zgjidhni se çfarë lloj udhëheqësi dëshironi të jeni”.

Ndajeni klasën tuaj në grupe të vogla. I kërkoni secilit grup të përcaktojë dy apo tre gjëra pse udhëheqësit duhet të jenë më të hareshëm në udhëheqjen e tyre. I thoni secilit grup t’i shprehë sugjerimet e veta klasës. Këto mund të përfshijnë:

- “Pushoni së fjeturi më gjatë se ç’është e nevojshme; shkoni në shtrat herët, që të mos jini të lodhur; ngrihuni herët, që trupat tuaja dhe mendjet tuaja të mund të fuqizohen” (DeB 88:124).
- Ushtroni siç duhet dhe ushqehuni me një dietë të baraspeshuar.
- Shijoni muzikë lartësuese.
- Studioni shkrimet e shenjta dhe libra të tjerë të mirë.
- Mësoni të falni njerëzit që ju kanë fyer dhe harroni fyerjen.

- Zbatoni Rregullin e Artë.
- Jini më mirënjohës. Numëroni bekimet tuaja dhe falënderoni Atin Qiellor për to.
- Trajtoni njerëzit me mirësi dhe mirësjellje.
- Jini aktivë në lagjen tuaj.
- Zhvilloni një ndjesi të shëndetshme dhe të përshtatshme humori.

I nxitni studentët të kenë “humor të mirë” kur udhëheqin.

## BURIME PËR MËSUESIN



### *Plaku Jozef B. Uirthlin*

*Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve*

*“Lessons Learned in the Journey of Life”, Ensign, dhjetor 2000, f. 6–13*

Nuk është e vështirë për mua të kujtoj kur isha në kolegji. Unë pëlqeja shumë gjëra nga jeta e kolegjit: Më pëlqente mësimi. Më pëlqente shoqëria. Dhe më pëlqente futbolli.

Unë kisha ëndërruar gjithnjë të luaja futboll me përfaqësuesen e universitetit dhe gjatë viteve si student i vitit të parë, të dytë dhe në vitet e rinisë unë vishja një uniformë të kuqe, që ishte ngjyra e shkollës, dhe luaja në mbrojtje.

Në atë kohë bota dridhej në prag të kaosit. Forca politike opozitare luftonin kundra njëra-tjetrës. Tensioni rritej me shpejtësi. Kombet irritohehin kundër njëri-tjetrit. Ngjante sikur gjithë bota rënkonte përpara një shpërthimi, një vullkan që duhej të shpërthente, që në fund të fundit do të shpërthente. Përpara se të mbaronte, çdo komb, çdo popull ndjeu pasojat e atyre ditëve të errëta.

Unë kujtoj ditën kur babai erdhi tek unë. Ishte shi pasi kishte mbaruar sezoni futbollistik i 1936-ës.

“Jozef”, tha, “a dëshiron të shkosh në një mision?”

I thashë se doja.

“Atëherë ti duhet të shkosh tani”, tha ai. “Nëse do të presësh më gjatë, ti nuk do të shkosh kurrë.”

Unë nuk doja ta besoja. Unë doja të ndiqja ëndrrën time për të vazhduar të luaja futboll dhe të diplomohesha në universitet. Nëse do ta pranoja thirrjen për mision, do të më duhej të hiqja dorë nga gjithçka. Në ato kohë një thirrje misioni ishte 30 mujore dhe e dija se po ta pranoja, kishte gjasa të forta që nuk do të luaja më kurrë futboll – ndoshta nuk do të isha madje në gjendje të diplomohesha.

Por e dija gjithashtu se ajo që kishte thënë babai ishte e vërtetë. Peshkopi im ishte Marion G. Romni (1897–1988), i cili më vonë u bë anëtar i Presidencisë së Parë të Kishës. Ai kishte folur me mua më përpara për shërbimin në një mision dhe unë shkova për t'i thënë se tani ishte koha.

Disa muaj më vonë u nisa me anijen SS *Manhattan* në një udhëtim të gjatë që do të më çonte në zemër të krizës botërore. Thirrja ime për mision ishte në Misionin Gjermano-Austriak.

Fusha ime e parë e punës ishte Salcburgu në Austri. Misioni ishte me përbërje të pakësuar dhe jo shumë pas arritjes time, shoku im u transferua në një distrikt tjetër në mision. Shpejt e pashe veten vetëm në Salcburg, një misionar i ri në një vend të huaj, të panjohur.

Diçka tjetër po ndodhte që nuk e kam përmendur: një ushtri e madhe e Rajhut të Tretë të Hitlerit po grumbullohej pikërisht matanë kufirit, jo më shumë se 37 km nga Salcburgu. Kudo që shkoje do të ndieje në ajër tensionin që rritej. Askush nuk e dinte nëse nesër do të ishte dita kur tanket pancër do të vërshonin këtej kufirit.

Unë i mbaj mend mirë ato ditë. Nuk mendoj se ka pasur ndonjë kohë në jetën time kur jam ndier më i shkujtuar, më i humbur. Misioni ishte i vështirë; askush nuk dukej se kishte kohë për mua apo për mesazhin që solla. Unë pyesja veten nëse do të kishte ndonjëherë mjaft anëtarë në atë qytet për të krijuar një lagje.

Për gjashtë javë isha i vetëm. Gjashtë javë prita për një shok. Gjashtë javë pyesja veten se çfarë mund të isha duke bërë, po të kisha qëndruar në Solt-Lejk-Siti dhe të vazhdoja studimet.

Edhe pse ditët dhe netët dukeshin atëherë sikur nuk do të mbaronin, ato më në fund kaluan.

Një shok i vjetër arriti dhe ne bëmë më të mirën tonë në ato kushte për t'i shërbyer Zotit.

Atë vit, ndërsa Dita e Krishtlindjes afrohej, shoku im dhe unë vendosëm të shkonim në Oberndorf, një fshat i vogël strehuar në Alpet e mrekullueshme të Bavarisë. Ju mund ta dini se bukuria dhe madhështia e këtij fshati të vogël është ajo që frymëzoi Jozef Morin në 1818 të shkruante himnin e mrekullueshëm “Nat’ e Qet” (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 53).

Në prag të Krishtlindjes ne shkuam në fshat dhe qëndruam qetësisht për pak kohë në një kishë të vogël modeste, duke dëgjuar muzikën e mrekullueshme me organo. Një natë gjallëruese e kthjellët dimri na mbështolli ndërsa nisëm rrugën e kthimit. Ecnim nën një qiell plot yje dhe nëpër qetësinë e butë të një bore të re. Ndoshta ishte një natë si ajo që frymëzoi një ndihmësprit të shkruante vargjet e një prej këngëve më të dashura të të gjithë krishtërimit, më se njëqind vite përpara.

Duke ecur, bisedonim me shokun për shpresat dhe ëndrrat tona. Bisedonim për qëllimet tona dhe për çka donim të ndodhte në jetën tonë. Sa më shumë bisedonim, aq më seriozë bëheshim për arritjen e gjërave për të cilat flisnim. Ndërsa ecnim nën dritën e një hëne të plotë, ne të dy morëm vendime serioze.

Unë u zotova atë natë që nuk do ta shpërdo-roja kohën. Unë do të ripërtërija përpjekjet për t'i shërbyer Zotit. Unë e ndava mendjen që do të lartësoja çdo thirrje që do të merrja në mbretërinë e Zotit.

Ajo ishte gjithashtu mbrëmja kur unë e ndava mendjen mbi atë me të cilën do të martohesha. Nuk e dija emrin e saj, por unë kisha në mendje tipin e personit të saj – një njeri që jetonte ungjillin dhe që ishte e fortë shpirtërisht. Unë madje ia përshkrova shokut tim – se ajo do të ishte 1,65 metra, se do të kishte sy të kaltër dhe do të ishte bjonde. Motra Uirthlin i përshtatet të gjithë përshkrimit që i bëra atëherë pa e njohur. E kështu, ajo natë që e rëndësishme për mua.

Dy vite e gjysmë kaluan dhe, para se ta kuptoja, unë u ndodha përsëri në shtëpi. Mbaj mend se dëgjova dikë të përmendte një emër:

Elisa Roxhers, një e re që ishte e ngarkuar për një vallëzim nën kujdesin e universitetit në Hotel Juta. Kishte diçka të veçantë lidhur me atë emër. Vendosa se duhej ta takoja.

Mbaj mend herën e parë kur e pashë. Si nder për një mikun tim, pata shkuar në shtëpinë e saj për t'i sjellë atij motrën e saj. Elisa hapi derën dhe unë e vështrova ngultas. Ja tek ishte, e bukur, një metër e gjashtëdhjetë e pesë, sy kaltër, bjonde.

Ajo duhet të ketë pasur gjithashtu një ndjesi, sepse më tha: “Unë e di kush ishit”.

Ajo kuptoi shpejt se kishte bërë një gabim gramatikor. Për të vlerësuar plotësisht këtë, duhet të mbani parasysh se ajo ishte një e diplomuar universiteti për gramatikë angleze.

Edhe pas gjithë këtyre viteve, ajo e ka kujtuar sikletin e atij momenti. Sigurisht, ritregimi i kësaj historie nuk i bën më mirë gjërat, por besoj se ajo do të më falë.

Gjashtë dekada kanë kaluar qysh nga ai prag Krishtlindjeje në Oberndorf kur unë mora ato vendime. Shumë gjëra kanë ngjarë në vitet që kanë kaluar. Parandjenjat e mia për të luajtur futboll ishin të drejta; unë nuk luajta kurrë më. Por unë u diplomova në universitet. Edhe pse ndodhi kështu, nuk kam ndier kurrë keqardhje që shërbeva në mision dhe që e angazhova veten në shërbim të Zotit. Duke vepruar kështu, jeta ime ka qenë e mbushur me ngjarje emocionuese, përvoja shpirtërore dhe gëzim që e tejkalon imagjinatën.

Shumë nga ju mund të keni një kohë në jetë, kur ndoshta do të ndiheni pak të shkurajuar apo të vetmuar. Ndoshta ju ndiheni pak të humbur, ndoshta madje pak të trembur. Secili është ndier kështu në ndonjë rast apo një tjetër. Secili ka pyetur veten nëse jeta e tij apo e saj do të jetë më në fund e lumtur.

Më shumë se dy mijë vite përpara, Aristoteli tha se çdo njeri që jeton ka të njëjtin objektiv themelor: të jetë i lumtur (shih *Nicomachean Ethics*, libri 1, kapitujt 4, 7). Pas 80 vitesh jetë, unë kam filluar të kuptoj disa ide nga ajo se çfarë e bën njeriun të lumtur dhe të suksesshëm. Do të doja t'ju tregoja pesë gjëra që, nëse do t'i merrni seriozisht dhe t'i zbatoni në vetë

jetën tuaj, do t'ju sjellin lumturi, sukses, përmbushje dhe arritje të një trashëgimie në mbretërinë çelestiale.

### **Kini besim në Atin Qiellor**

Së pari, kini besim në Atin tuaj Qiellor. Ai ju njuh kush jeni. Ai ju dëgjon kur luteni. Ai ju do juve. Ai ju ka në vëmendje. Ai do më të mirën për ju.

Pas shërbimit për një kohë në Salcburg, unë u transferova në Zyrih të Zvicrës. Gjatë kohës që isha atje, Vëllai Julius Bileter, anëtar i Kishës, m'u afrua. Ai ishte një gjenealogjist profesionist dhe më tregoi se kishte parë shumë mbiemra Uirthlin në punën e tij. Ai më ofroi të kërkonte prejardhjen e familjes sime. I shkrova shtëpisë dhe babai mendoi se ishte një mundësi e mrekullueshme, kështu që ne i thamë atij të fillonte.

Një vit më vonë ai më dorëzoi një libër. Ai ishte 35,56 cm i gjatë, 45,72 cm i gjerë dhe peshonte 6,187 kg. Ai ishte mbushur me rreth 6.000 emra të paraardhësve të mi. Ishte një volum i paçmueshëm që e ruajta si thesar. Pikërisht përpara lirimt nga misioni, unë e paketova librin e çmuar në një bagazh lluksi bashkë me disa sende të tjera që kisha dhe e nisa për në shtëpi. U luta që të arrinte i sigurt dhe që historia e çmuar e familjes të mos humbiste.

Unë arrita në shtëpi përpara bagazhit. Kaluan javë. Ende bagazhi nuk po vinte. Nisa të shqetsohem se mos libri i pazëvendësueshëm kishte humbur. Gjashtë muaj pasi kisha mbërritur në Solt-Lejk-Siti, mora një thirrje nga depua Junion Pesifik. Kishte arritur një bagazh për mua. U vërsula poshtë për ta marrë, por kur e pashë, më ngriu zemra. Çelësi i bagazhit ishte thyer.

Hapa kapakun dhe kur pashë brenda, u dëshpërova më shumë. Çdo gjë ishte bërë qull nga ujët e detit. Ç'ishte më keq, dallova se dikush kishte rrëmuar dhe vjedhur në sendet e mia. Disa prej tyre nuk ishin.

Hoqa me kujdes shtresat e rrobave, duke kërkuar librin tim të çmuar. Kur e arrita, zemra më gufoi nga gëzimi. Jo vetëm që ishte atje, por fletët ishin krejt të thata! E di se libri ishte ruajtur nga ndërhyrje hyjnore.

Shpëtimtari pyeti: “A nuk shiten vallë dy harabela për një aspër? Dhe, megjithatë asnjë prej tyre nuk bie për tokë pa dashjen e Atit tuaj.

Sa për ju, madje edhe të gjitha fijet e flokëve të kokës suaj janë të numëruara.

Mos kini frikë, pra; ju vleni më tepër se shumë harabela” (Mateu 10:29–31).

Në mënyrë të ngjashme, nëse shpëtimi i një libri nga uji i detit mund të jetë i denjë për vëmendje qiellore, sa më e madhe do të jetë vëmendja e Atit Qiellor për jetën dhe nevojat tuaja?

Në një rast Presidenti Tomas S. Monson më bëri këtë deklaratë: “Ka një ndikim drejtues për të gjitha gjërat. Shpesh kur ndodhin gjërat, nuk është rastësi. Një ditë, kur ne shohim pas tek rastësitë në dukje të jetës sonë, ne kuptojmë se ndoshta ato nuk ishin aspak aq të rastit.”

Zoti i di sprovat tuaja. Ai i di fitoret tuaja. Dhe nëse ti do të “[kesh] besim tek Zoti me gjithë zemër dhe [nuk do të mbështetesh] në gjykimin tënd; pranoje në të gjitha rrugët e tua, dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua” (Fjalët e Urta 3:5–6).

### **Vendosni objektiva të drejta**

Së dyti, vendosni objektiva të drejta. Shumë gjëra do të kërkojnë vëmendjen tuaj kur ndiqni rrugën tuaj në jetë. Do të ketë hutime pafund. Njerëzit dhe gjërat do t’ju thërrasin, do të këndojnë këngët e sirenavë për pasuri, kënaqësi dhe pushtet.

*Suksesi* është një fjalë joshëse. Mijëra libra janë shkruar për këtë temë. Ato premtojnë para, liri, kohë të lirë dhe lluks. Mijëra njerëz kanë dhënë mijëra mënyra që do të çonin në ngritjen e pasurisë. Për shembull, një proces me tre etapa për t’u bërë i pasur i atribuohet J. Pol Getit: “Çohu herët. Puno fort. Zbulo naftë.”

Të tjera formula ndoshta më praktike mbrojnë variantin e një teme të vetme: Ju duhet të përqendroni të gjitha mendimet, ndjenjat dhe veprimet tuaj mbi objektivat tuaja. Ju duhet ta doni objektivin tuaj me gjithë pasionin e zemrës suaj. Ju duhet të përqendroni çdo mendim mbi objektivin tuaj. Ju duhet të përqendroni të gjithë energjinë tuaj në arritjen e objektivit tuaj.

Sigurisht, kur zbatohen për qëllime të drejta, këto metoda mund të jenë me vlerë të madhe. Problemi është se në shumë raste kërkimi për pasuri, kënaqësi dhe pushtet çon në një vend që mund të duket në pamje të parë si i dëshirueshëm, por sa më afër shkoni, aq më mirë shihni se çfarë është. Çmimi për sukses tokësor tepër shpesh arrin çmimim e bekimeve të përjetësisë. Ata që bëjnë atë pazar një ditë do të ndihen si Esau, që pasi kuptoi se çfarë kishte humbur, “dha një ulërimë të fortë dhe shumë të hidhur” (Zanafilla 27:34).

Një kurth tjetër në të cilin biem shpesh kur rendim pas suksesit është se i besojmë forcës së krahut tonë dhe forcës së mendjes tonë dhe harrojmë Zotin, që na ka bekuar dhe begatuar.

Moisiu u tha fëmijëve të Izraelit se një ditë, “pasi të kesh ngrënë deri sa të ngopesh dhe të kesh ndërtuar ... shtëpi të bukura,

pasi të kesh parë të shtohet bagëtia jote e trashë dhe e imët, të shtohet argjendi dhe ari yt, dhe të rriten tërë të mirat e tua, ...

Të thuash në zemrën tënde: ‘Forca ime dhe fuqi e dorës sime m’i kanë siguruar këto pasuri’...

Por në qoftë se ti harron Zotin, Perëndinë tënd, për të shkuar pas perëndive të tjera dhe për t’u shërbyer dhe për të rënë përmbys para tyre, unë sot shpall solemnisht para jush se do të vdisin me siguri (Ligji i Përtërirë 8:12, 13, 17, 19).

A mendoni se ju mund t’i përdorni paratë që keni fituar në këtë jetë si monedhë për në tjetrën? Vendosni Atin tuaj Qiellor të parin në jetën tuaj. Premtoni ta ndiqni Atë dhe t’u bindeni urdhërimeve të Tij, dhe të përpiqeni çdo ditë të bëheni më shumë si Krishti. Përqendroni përpjekjet tuaja në arritjen e pasurive qiellore. Të bësh ndryshe do të çojë përfundimisht në zhgënjim dhe dëshpërim.

Më vjen ndër mend shëmbëlltyra e Shpëtimtarit për burrin që punonte fort për të vënë pasuri. Ai kishte aq të mira sa që nuk kishte vend të mjaftueshëm për t’i mbajtur. Kështu, ai ndërtoi koçekë të mëdhenj për t’i depozituar. Ideja e tij ishte që sapo të kishte një vend të sigurt për të gjitha burimet e tij,

ai mund të tërhiqej pastaj dhe të bënte një jetë boshe – me të ngrëna, të pira dhe gazmend.

Por sapo përfundoi ndërtimet e tij, “Perëndia i tha: ‘O i pamend, po atë natë shpirtin tënd do të ta kërkojnë dhe ato që përgatite të kujt do të jenë?’ ” (Luka 12:20).

Një pyetje kthjelluese që Shpëtimtari u drejtoi njerëzve të ditëve të Tij jehon ndër shekuj deri sot: “Ç’përfitim ka nëse fiton gjithë botën dhe pastaj e humb shpirtin e vet?” (Mateu 16:26).

A është patjetër një gjë e keqe paraja? Profeti Jakob në Librin e Mormonit i dha përgjigje kësaj pyetjeje. Ai i mësoi njerëzit e tij: “Mendoni për vëllezërit tuaj si për veten tuaj dhe jini të dashur me të gjithë dhe bujarë me pasurinë tuaj, që ata të mund të jenë të pasur sikurse ju.

Por, para se të kërkonti pasuri, kërkonti mbretërinë e Perëndisë.

Dhe, pasi ju të keni marrë një shpresë në Krisht, ju do të merrni pasuri, në qoftë se ju i kërkonti ato; dhe ju do t’i kërkonti ato me qëllim që të bëni mirë—të vishni të zhveshurit dhe të ushqeni të uriturit dhe të çlironi robërit, dhe tu jepni ndihmë të sëmurëve dhe të mjerëve” (Jakobi [LiM] 2:17–9).

Moisiu u tha njerëzve në kohën e tij: “Në rast se ke ndonjë vëlla nevojtar midis jush, midis ndonjë prej qyteteve ... , nuk do të fortësosh zemrën dhe nuk do të mbyllësh dorën para vëllait tënd nevojtar” (Ligji i Përtërirë 15:7).

### **Punoni për të përmbushur qëllimet tuaja**

Së treti, sapo të keni përcaktuar qëllimet tuaja të drejta, punoni me të gjithë fuqinë për t’i përmbushur ato. Me fjalët e Plakut Dejvid O. Mek-Kei (1873–1970), kur ai ishte në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve: “Le të ... kuptojmë se *privilegji për të punuar* është një dhuratë, ajo *fuqi* për të punuar është një bekim, që *dashuria* për të punuar është sukses” (në Conference Report, tetor 1909, f. 94; theksimi në origjinal).

Puna është kurim për shpirtin. Ungjilli i Jezu Krishtit është ungjilli i punës. Unë besoj se shumë nga koha pa punë që përjetojmë vjen nga keqkuptimi i Shlyerjes së Zotit. Ne nuk mundet që thjesht të vijmë vërdallë dhe të mos bëjmë gjë, dhe të presim të jemi të suksesshëm në

gjërat shpirtërore dhe tokësore. Ne kemi nevojë të bëjmë të gjitha ato që varen nga ne për të përmbushur qëllimet tona dhe Zoti do të bëjë pjesën tjetër.

Kujtoni fjalët e Presidentit Gordon B. Hinkli: “Puna më e madhe e botës nuk është bërë nga njerëz gjënjallë. Ajo është bërë nga njerëz të zakonshëm, me baraspeshim në jetën e tyre, që kanë mësuar të punojnë në një mënyrë të jashtëzakonshme” (“Our Fading Civility”, BYU commencement address, 25 prill 1996, f. 15).

Më lejoni t’ju tregoj për një person të mrekullueshëm që mori përgjegjësi për jetën e tij dhe bëri diçka vetë, megjithë fillimet modeste. Emri i tij është Dr. Ben Kersën. Dr. Kersën u lind dhe u rrit në lagjet e varfra të Detroitit. Ai u rrit në një shtëpi që nuk kishte baba. Mamaja e tij mori përgjegjësinë mbi vete për rritjen e një familjeje dhe ajo e përcolli këtë ndjenjë përgjegjësie tek i biri.

Dr. Kersën tha se mamaja e tij shpesh do t’u thoshte fëmijëve të saj: “A keni tru?” Po të përgjigjeshin po, ajo do të vazhdonte me: “Atëherë ju duhej ta kishit menduar si do ta zgjidhnit atë situatë. Nuk ka rëndësi se çfarë bënë Xhoni apo Meri apo kushdo tjetër. Ju keni një tru, kështu mendoni zgjidhjen tuaj të problemeve.”

Dr. Kersën tregoi:

“Unë fillova të kuptoj se i kisha gjërat në dorë, që mund të shkoja kudo që dëshiroja të shkoja dhe që mund të bëja çfarëdo që do të doja. I vetmi person që me të vërtetë përcaktoi apo kufizoi suksesin tim isha unë. Me ta kuptuar këtë, e gjithë mendësia prej viktime u zhduk. Kuptova se nuk duhej të vija vërdallë dhe të prisja për dikë që të bënte çdo gjë për mua” (“Seeing the Big Picture: An Interview with Ben Carson, M.D.”, *Saturday Evening Post*, korrik/gusht 1999, f. 50–51).

Dr. Kersën nuk erdhi vërdallë dhe të priste që dikush tjetër të bënte diçka për të. Ai e mori në dorë jetën e vet. Ai studioi fort në shkollë dhe mësoi shumë – aq shumë sa vazhdoi dhe u bë mjek. Ai përfundimisht u ngrit dhe u bë drejtor i neurokirurgjisë pediatrike në Qendrën e Fëmijëve Xhons Hopkins në Baltimorë, një spital



me famë botërore. Në vitin 1987 Dr. Kersën kreu operacionin e parë të suksesshëm për të ndarë vëllezërit siamezë që ishin ngjitur në pjesën e pasme të kokës.

Sokrati tha: “Perënditë na i shesin të gjitha gjërat e mira me çmimin e punës tonë” (Xenophon, *Recollections of Socrates*, libri 2, kapitulli 1, seksioni 20).

Presidenti Gordon B. Hinkli i bëri jehonë asaj ndjesie: “Nuk ka zëvendësues nën qiell për punën prodhuese. Ai është procesi nëpërmjet të cilit ëndrrat bëhen realitet. Ai është procesi me të cilin vegimet boshe bëhen arritje dinamike.

Është puna që përcakton ndryshimin në jetë. Është tendosja e mendjeve tona dhe përdorimi i zotësive të duarve tona që na ngre nga mediokriteti” (në “Pres. Hinckley Shares 10 Beliefs with Chamber”, *Church News*, 31 janar 1998, f. 3).

### **Lartësoni thirrjet tuaja**

Së katërti, lartësoni thirrjet tuaja dhe jini anëtarë besnikë të Kishës. Kur shkojmë në kishë, ne rrethohemi nga të tjerë që ndajnë të njëjtin angazhim t’u binden urdhërimeve dhe të ndjekin Shpëtimtarin.

Disa e marrin gabimisht Kishën si një vend ku njerëz të përsosur mblidhen për të thënë gjëra të përsosura, të kenë mendime të përsosura dhe ndjenja të përsosura. Më lejoni ta largoj me shpejtësi një mendim të tillë? Kisha është vendi ku njerëz jo të përsosur mblidhen për të ndihmuar dhe forcuar njëri-tjetrin duke u përpjekur të kthehemi tek Ati ynë Qiellor. Secili prej nesh do të udhëtojë në rrugë të ndryshme në jetën tokësore. Secili prej nesh do të përparojë me ritme të ndryshme. Tundimet që e bëjnë të ndihet keq vëllanë tuaj mund të mos ju shqetësojnë juve aspak.

Kurrë mos i shih me përbuzje ata që janë më pak të përsosur se ty. Kurrë mos u shqetëso sepse dikush nuk mund të flasë aq mirë sa ju, nuk mund të udhëheqë aq mirë sa ju, nuk mund të qepë apo prashisë apo shkëlqejë aq mirë sa ju.

Kisha është një shoqëri përmirësimi të ndërsjelltë me qëllim të ndihmojë çdo bir dhe

bijë të Perëndisë të kthehet në praninë e Tij. Një mënyrë për të matur vlerën tuaj në mbretërinë e Perëndisë është të pyesni veten: “Sa mirë po vepron për të ndihmuar të tjerët të arrijnë mundësitë e tyre? A i mbështes të tjerët në Kishë, apo i rrëzoi ata?” Nëse po i rrëzoni të tjerët, ju po rrëzoni mbretërinë e Perëndisë. Nëse po ngrini të tjerët, ju po ngrini mbretërinë.

Një provë tjetër e vlerës tuaj në mbretëri është të pyesni veten nëse jeni aktivisht të angazhuar në lartësimin e thirrjes tuaj në Kishë. Kur ju lartësoni thirrjen tuaj, ju nuk i kryeni formalisht veprimet; ju sfidoni veten për të shërbyer në vendin ku jeni thirrur me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën tuaj.

Nëse nuk keni thirrje në Kishë, a do të shkoni tek peshkopi dhe t’i thoni se jeni i dëshiruar për të shërbyer, i gatshëm t’i vini shpatullat punës?

Duke shërbyer besnikërisht, Zoti do të jetë me ju dhe ju do të ndieni Shpirtin e Tij dhe do të ndieni ndikimin e Tij drejtues.

Vite përpara në një konferencë të përgjithshme, Presidenti Bojd K. Paker i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve tregoi historinë e Jozef Miletit, një anëtar pak i njohur i Kishës.

Ai jetonte në kohët e hershme të Kishës dhe kaloi përmes fushave me anëtarë të tjerë besnikë për të ‘zbutur’ shkretëtirën dhe për të gjetur një shtëpi të re. Në ato vite të para, ushqimi shpesh ishte i mangët. Dimrave ishte veçanërisht e vështirë dhe shpesh ditët zgjatnin më shumë sesa ushqimi i rezervuar.

Jozef Miletit shkroi në ditarin e tij: “Një nga fëmijët e mi hyri brenda dhe tha se familjes së Vëllait Njuton Holl u ishte mbaruar buka dhe nuk kishin asgjë atë ditë.

Unë ndava miellin në një thes për ta dërguar tek Vëllai Holl. Pikërisht atëherë ai erdhi.

“I them: ‘Vëlla Holl, ju ka mbaruar mielli?’

‘Vëlla Milet, ne nuk kemi fare.’

‘Mirë, Vëlla Holl, ka ca tek ai thesi. Unë e ndava dhe do ta dërgoja tek juve. Fëmijët tuaj u thanë të mijve se ju kishte mbaruar.’

Vëllai Holl filloi të qajë. Ai tha se kishte kërkuar tek të tjerë, por nuk i kishin dhënë. Ai shkoi tek cedrat dhe iu lut Zotit dhe Zoti i tha të shkonte tek Jozef Mileti.

‘Mirë Vëlla Holl, ti nuk ke nevojë ta kthesh këtë. Nëse Zoti të dërgoi për këtë, ju nuk ma keni borxh.’ ...

Ju nuk mund ta imagjinoni sa mirë u ndjeva ngaqë mësova se Zoti e dinte që kishte një njeri të tillë si Jozef Mileti” (Diary of Joseph Millett, shkrim me dorën e vet, Historical Department Archives, The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints; cituar në Boyd K. Packer, “A Tribute to the Rank and File of the Church”, *Ensign*, maj 1980, f. 63).1980, 63).

Kjo është një ndjenjë e mrekullueshme – të dish se Zoti të beson dhe të do aq sa të ketë dëshirë të të përdorë për të bekuar jetën e të tjerëve. Vëllezër dhe motra, Ati juaj Qiellor dëshiron t’ju përdorë për të njëjtin qëllim. Duke lartësuar thirrjet tuaja dhe duke u përpjekur të bëni mirë, unë ju premtoj se Zoti do të derdhë mbi kokat tuaja bekime kënaqësie dhe gëzimi aq të mëdha sa që ju nuk do të keni vend të mjaftueshëm ku t’i shtini.

### **Gëzojuni udhëtimit**

Së pesti, gëzojuni udhëtimit. Njerëzit e Perëndisë janë njerëz të gëzuar. Ne e kuptojmë se ka kohë për vetëpërmbytje, nderim dhe përkushtim; ne gjithashtu kuptojmë se ne kemi parimet e gëzueshme të jetës së përjetshme.

Ne kemi aq shumë arsye për të buzëqeshur, për të qenë të lumtur, po, madje për të qeshur.

Aq shumë nga ne janë gjithnjë në pritje të jenë të lumtur. “Sikur vetëm të mund të merrja diplomë, sikur vetëm të mund të merrja një makinë, sikur vetëm të mund të martohesha...” Për mjaft njerëz, lumturia është vetëm në horizont, e paarrtshme kurrë. Sa herë që ngjitemi në një kodër, lumturia ndriçon pikërisht matanë tjetrës.

Është e tmerrshme që gjithnjë të jesh në pritje për të nesërmen, gjithnjë i varur tek e nesërmja, gjithnjë duke justifikuar të sotmet

sepse ne jemi të sigurt se vetëm në të ardhmen do të kemi gjërat që do të na përmbushin dëshirat.

Mos prisni për të nesërmen. Mos prisni për punën e saktë, shtëpinë e saktë, pagën e saktë, masën e saktë të veshjes. Jini të lumtur sot. Jini të lumtur tani.

Abraham Linkoln tha: “Shumë njerëz janë thujtë aq të lumtur sa e vendosin të jenë” (në John Cook, përmb., *The Book of Positive Quotations* [1997], f. 7).

Vendoseni të jeni të lumtur – madje kur nuk keni para, madje kur nuk keni një fytyrë pa të meta, madje kur nuk keni Çmimin Nobel. Disa nga njerëzit më të lumtur që njoh nuk kanë asnjë nga këto gjëra që bota këmbëngul se janë të nevojshme për kënaqësi dhe gëzim. Pse janë të lumtur ata? Unë mendoj ngaqë ata nuk mbajnë vesh shumë mirë. Ose ata mbajnë vesh tepër mirë – gjërat që zemrat e tyre u thonë. Ata gjejnë kënaqësi në bukurinë e tokës. Ata gjejnë kënaqësi tek lumenjtë dhe kanionet, dhe kënga e trishtilit. Ata gjejnë kënaqësi në dashurinë e familjeve të tyre, në hapat e penguar të motakëve, në buzëqeshjen e urtë dhe delikate të të moshuarve.

Ata gjejnë kënaqësi në punën e shëndetshme. Ata gjejnë kënaqësi në shkrimet e shenjta. Ata gjejnë kënaqësi në praninë e Frymës së Shenjtë.

Një gjë e di me siguri: koha që kemi këtu kalon tepër shpejt. Mos humbisni më kohë duke ndenjur si lojtar në stol duke parë jetën t’ju kalojë.

A mund t’ju jap një tjetër këshillë? Jini të gatshëm të qeshni me veten. Kur Plaku Methju Kauli (1897–1953) u thirr për herë të parë në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve, Presidenti J. Ruben Klark (1871–1961) e ftoi në zyrën e tij dhe e këshilloi lidhur me detyrën e tij të re. Presidenti Klark ishte një nga udhëheqësit dhe mendimtarët e mëdhenj të Kishës. Ai la një post si ambasador i Shteteve të Bashkuara në Meksiko për të pranuar një detyrë në Presidencinë e Parë të Kishës. Ai ishte një burrë i mësuar prej kohësh të përballonte peshën e përgjegjësive të mëdha.

Kur takimi midis Plakut Kauli dhe Presidentit Klark po i afrohej fundit, Presidenti Klark tha: “Tani, djali im, çunak [Presidenti Klark i thërriste të gjithë anëtarët e Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve ‘çunak’] – Tani, çunak, mos harro rregullin gjashtë.” Plaku Kauli pyeti: “Cili është rregulli gjashtë?” Presidenti Klark tha: “Mos e merr tepër seriozisht veten.” Plaku Kauli pyeti: “Cilat janë pesë të tjerat?” Presidenti Klark tha: “Nuk ka të tjera” (*Matthew Cowley Speaks* [1954], f. 132–133).

Disa njerëz e marrin veten aq seriozisht sa që mendojnë se nuk mund të ndihen të plotësuar deri sa ta gjejnë veten. Disa braktisin familjen, punën dhe arsimin në këtë kërkim për të zbuluar cilët janë.

Xhorxh Bernard Shou tha: “Jeta nuk është të gjesh veten. Jeta është ta krijosh veten.” Mos u shqetësoni për kërkimin e asaj se cilët jeni; përqendroni energjitë tuaja në krijimin e personit që doni të jeni! Ju do të zbuloni se duke ndjekur atë udhëtim, jo vetëm që do të gjeni veten, por shanset janë që të befasoheni të kënaqur dhe krenarë për personin që do të gjeni përgjatë udhëtimit.

Mos e shtyni asnjë minutë më tej. Çdo moment është i çmuar. Vendosni tani që do të bëni diçka të mrekullueshme me jetën tuaj!

Jo shumë kohë përpara pata rastin të kthehem me Motrën Uirthlin tek vendi ku fillova misionin tim. Detyra ime ishte të organizoja Kunjin e Salcburgut në Austri. Në një mënyrë ajo ishte për mua si të ktheheshe në shtëpi. Kujtoja ditët kur ecja nëpër ato rrugë të shtruara me gurë dhe pyesja veten nëse do të kishte ndonjëherë aq anëtarë sa të formohej një lagje e vogël. Dhe unë isha këtu, vite më vonë, duke organizuar një kunj. Zemra më gufoi nga gëzimi duke parë atë kongregacion anëtarësh besnikë dhe duke kujtuar kohën që kisha kaluar atje.

Duke hedhur vështrimin pas tek ajo kohë tani, pyes veten nëse ato kohëra prove dhe vetmie ishin të dobishme për forcimin e karakterit tim dhe rritjen e dëshirës time për të arritur sukses. Ato kohë që dukeshin dështim mund të kenë qenë disa nga më të dobishmet e jetës time,

sepse ato më përgatitën për gjëra më të mëdha që do të vinin.

Ndërsa isha atje, unë udhëtova me bashkëshorten për në Oberndorf. Ne ecëm në të njëjtën rrugë që shoku im dhe unë patëm ecur aq vite përpara. Dhe atje, përpara maleve madhështore dhe bukurisë së kulluar të atij fshati të vogël bavarez, unë i tregova asaj edhe një herë për natën e qetë kur i përshkrova shokut tim gruan me të cilën do të martohesha.

Vendimet që mora atë natë të shenjtë në Oberndorf në Austri, kanë qenë një forcë drejtuese gjatë gjithë jetës sime. Edhe pse unë ende kam shumë për të mësuar dhe plotësuar, unë kam bërë më të mirën për të pasur besim në Perëndi; unë kam bërë më të mirën për t’u përqendruar në gjërat që janë të rëndësishme në jetë; unë kam bërë më të mirën që të punoj fort në detyra të drejta; unë kam bërë më të mirën për të lartësuar thirrjet që kam marrë në Kishë dhe unë kam bërë më të mirën për ta gëzuar udhëtimin.

Bëfshi po ashtu ndërsa krijoni nga jeta juaj diçka të denjë për trashëgiminë tuaj hyjnore.

Unë dëshmoj se qëllimi i misionit tim në Europën e largët është i njëjti tani siç ishte atëherë: të dëshmoj se ne kemi një Atë Qiellor të dashur dhe gjithashtu Birin e Tij Shumë të Dashur, Jezu Krishtin, i cili na dha Shlyerjen e madhe. Unë dëshmoj se Jozef Smithi ishte një profet i Perëndisë që mori plotësinë e ungjillit të përjetshëm dhe që krijoi Kishën e Zotit në tokë në këto ditë të mëvonshme. Unë jap dëshmi se Gordon B. Hinkli është sot profeti, shikuesi dhe zbuluesi ynë.

Duke ndjekur dëshira të drejta, Zoti do të jetë me ju dhe do të drejtojë rrugët tuaja. Ai do që ju të jeni të lumtur dhe të suksesshëm. Ai do që ju të vini tek Ai. Uroj të gjeni paqe dhe gëzim në udhëtimin tuaj gjatë gjithë jetës.

## NDIHMË PËR STUDIMIN

- A bini dakord me pikëpamjen e Aristotelit se qëllimi i jetës është të jesh i lumtur? Shpjegoni përgjigjen tuaj.

- Sipas Plakut Uirthlin, cilat janë “pesë gjëra që, nëse do t’i merrni seriozisht dhe t’i zbatoni në vetë jetën tuaj, do t’ju sjellin lumturi, sukses, përmbushje dhe ... një trashëgimi në mbretërinë çelestiale”?
- Bëni një listë vetjake të gjërave që ju sjellin gëzim dhe lumturi. Shpjegoni se si këto gjëra mund t’ju ndihmojnë të ruani një qëndrim pozitiv dhe gazmor si udhëheqës.
- Gjeni një shkrim të shenjtë që ju sjell hare.

# TË VËMË TË PARAT GJËRAT PARËSORE

*“Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë, ku i brejnë tenja dhe ndryshku, dhe ku vjedhësit shpërthejnë dhe vjedhin,*

*përkundrazi mblidhni për vete thesare në qiell, ku as tenja as ndryshku nuk prishin dhe ku vjedhësit nuk shpërthejnë dhe nuk vjedhin.*

*Sepse ku është thesari juaj do të jetë edhe zemra juaj...*

*Por para së gjithash kërkoni mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto gjëra do t’ju shtohen” (Mateu 6:19–21, 33).*

## PARIME TË UDHËHEQJES

Udhëheqësit duhet ta planifikojnë kohën e tyre duke pasur në mendje përjetësinë.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Udhëheqësit duhet t’ia japin përparësinë më të lartë jetës së përjetshme sesa gjërave të kësaj bote.
2. Drejtpeshimi është një tipar i rëndësishëm i udhëheqësve të Kishës dhe të familjes.
3. Udhëheqësit duhet të mësojnë të caktojnë përparësitë për kohën e tyre.

### KONCEPT 1. UDHËHEQËSIT DUHET T’IA JAPIN PËRPARËSINË MË TË LARTË JETËS SË PËRJETSHME SESA GJËRAVE TË KËSAJ BOTE.

#### KOMENT

Gjatë Predikimit të Tij në Mal, Jezusi na mësoi: “Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë, ku i brejnë tenja dhe ndryshku, dhe ku vjedhësit shpërthejnë dhe vjedhin, ...

Sepse ku është thesari juaj do të jetë edhe zemra juaj” (Mateu 6:19, 21).

Plaku Delbert L. Staplei, që ishte anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, shpjegoi: “Përtëritja dhe shenjtërimi i trupave tanë nga fuqia e Frymës së Shenjtë arrihet duke jetuar ungjillin. Thesaret e punëve të mira që na paraprijnë po ndërtojnë shtëpitë tona të përjetshme. Shtrirja e mendimit në përjetësitë nën ndikimin e shpirtit të mobilizon mendimin dhe të jep një pamje të qartë të planit të Perëndisë, i cili do të ndihmojë të përcaktosh një rrugë të vërtetë të kthimit në praninë e Tij. Mbajeni përjetësinë gjithnjë parasysh këtu në vdekshmëri e i

mbështesni veprimet dhe gjykimet, dhe vendimet tuaja në ligjet e përjetshme të Perëndisë. Ne duhet të edukojmë veten jo vetëm për kohën por gjithashtu për përjetësinë” (në Conference Report, shtator–tetor 1967, f. 75).

Plaku M. Rasëll Ballard, që ishte atëherë anëtar i Të Shtatëdhjetëve, këshilloi: “Kujtohuni, përjetësia është tani, nuk është një e ardhme e mjegullt dhe e largët. Ne përgatitemi çdo ditë, pikërisht tani, për jetë të përjetshme. Nëse nuk po përgatitemi për jetë të përjetshme, ne po përgatitemi për diçka tjetër, ndoshta diçka shumë më të vogël” (në Conference Report, shtator–tetor 1978, f. 100; ose *Ensign*, nëntor 1978, f. 66).

Presidenti Harold B. Li, i cili ishte atëherë Këshilltar në Presidencinë e Parë, këshilloi: “Shumë njerëz nuk vendosin përparësi që t’i drejtojnë në ndarjen e kohës së tyre dhe shumë njerëz harrojnë se përparësia e parë duhet jetë ruajtja e vetë forcës së tyre shpirtërore dhe fizike. Pastaj vjen familja e tyre, pastaj Kisha dhe pastaj profesionet e tyre – dhe të gjitha kërkojnë kohë”

(*The Teachings of Harold B. Lee*, red. Clyde J. Williams [1996], f. 615).

Plaku Ballard, pasi u bë anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, shtoi këtë këshillë: “Së pari, mendoni për jetën tuaj dhe vendosni përparësitë tuaja. Gjëni rregullisht pak kohë të qetë për të menduar thellë mbi atë se ku po shkoni dhe çfarë do të keni nevojë të bëni për të arritur atje. Jezusi, shembulli ynë, shpesh ‘tërhiqej në vende të vetmuara dhe lutej’ (Lluka 5:16). Ne kemi nevojë të bëjmë të njëjtën gjë herë pas here për t’u rigjallëruar shpirtërisht, siç bëri Shpëtimtari. I shkruani detyrat që do të donit t’i përmbushni çdo ditë. Mbani në mend në radhë të parë besëlidhjet e shenjta që keni bërë me Zotin kur shkruani programet tuaja ditore” (në Conference Report, prill 1987, f. 15; ose *Ensign*, maj 1987, f. 14).

#### IDE MËSIMORE

Lexoni me studentët Mateu 6:19–21; Lluka 12:13–21. Diskutoni çfarë na mësojnë këto shkrime të shenjta mbi rëndësinë relative të gjërave tokësore dhe të përjetshme (shih gjithashtu komentin).

I vini studentët të rendisin veprimtaritë dhe shqetësimet që u kërkojnë secila kohën e vet. Lista e tyre mund të përfshijë studimin e shkrimeve të shenjta, dhënie shërbimi, punë, bërje gjërash me miq, kalim kohe me familjen, ushtrime fizike, punë shkolle dhe argëtim. I vini studentët të klasifikojnë çdo veprimtari në listë nga më e rëndësishmja deri te më pak e rëndësishmja dhe diskutoni kriteret e tyre të klasifikimit.

Sigurohuni që studentët ta kuptojnë se ndonjëherë mund të kemi nevojë të shtyjme madje dhe përparësi të mëdha për t’iu përgjigjur një urgjence, për të përmbushur një detyrë që ia vlen, apo që t’u shërbejmë të tjerëve. Po kështu, përparësi që mund të duken më pak të rëndësishme nga një këndvështrim përjetësie, të tilla si puna e shkollës, mund të jenë shumë të rëndësishme në përgatitjen tonë për shërbim të ardhshëm në mbretëri. Ndër të gjitha përparësitë tona duhet ta mbajmë jetën tonë të përqendruar tek Jezu Krishti dhe tek ungjilli.

## KONCEPT 2. DREJTPESHIMI ËSHTË NJË TIPAR I RËNDËSISHËM I UDHËHEQËSVE TË KISHËS DHE TË FAMILJES.

#### KOMENT

Presidenti Ezra Taft Benson shkroi: “Për përgatitjen e Jezusit për misionin e Tij, shkrimi i shenjtë thotë se Ai ‘rritej në dituri, në shtat dhe në hir përpara Perëndisë dhe njerëzve’ (Lluka 2:52). Kjo përfshin katër fusha kryesore për qëllime: shpirtërore, mendore, fizike dhe shoqërore. ‘Prandaj, çfarë lloj njerëzish duhet të jeni?’ pyeti Mësuesi dhe Ai u përgjigj: ‘Në të vërtetë, unë ju them juve, madje siç jam unë’ (3 Nefi 27:27). Tani, ka një qëllim për gjithë jetën – të ecësh në hapat e Tij, ta përsosësh veten në çdo veti ashtu siç bëri Ai” (*The Teachings of Ezra Taft Benson* [1988], f. 383–384).

Plaku Spenser W. Kimball, që ishte atëherë anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, dëshmoi: “Shpëtimtari kishte një personalitet të dashur, ai ishte i mirë, ai ishte i këndshëm, ai ishte mirëkuptues, ai nuk iu shmang kurrë qëllimeve, ai kishte drejtpeshim të përsosur. Asnjë sjellje e çuditshme nuk mund të gjendet në jetën e tij” (*The Teachings of Spencer W. Kimball*, red. Edward L. Kimball [1982], f. 13).

Plaku Nil A. Maksiuell, anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, na mësoi: “Duke pasur parasysh stinët e parregullta të jetës, Zoti dëshiron drejtpeshim tek dishepujt e Tij si edhe te Kisha kolektive. Ne nuk mund të jemi si anije që ka vetëm vela dhe është pa spirancë. Për më tepër, duke u rritur, ‘rrënja dhe maja’ duhet të jenë ‘njësoj në fuqi’, duke dhënë një aftësi për të duruar edhe të nxehtin edhe stuhinë (Jakobi [LiM] 5:66)” (*If Thou Endure It Well* [1996], f. 122).

#### IDE MËSIMORE

I thoni një studentit të lexojë Lluka 2:52 me zë të lartë. Renditni në dërrasë fjalët në këtë varg që përshkruajnë mënyrat se si Jezu Krishti u rrit (*në dituri, shtat dhe hir përpara Perëndisë dhe njerëzve*). Pas këtyre fjalëve shkruani *mendor, fizik, shpirtëror dhe shoqëror* (shih komentin). U thoni studentëve të diskutojnë sfidat e ruajtjes së drejtpeshimit në këto fusha.

Merrni parasysh diskutimin e idesë që ndonjëherë ne materialisht bëjmë një jetë “jo të drejtpeshuar” për shkak të rrethanave. Për shembull, studentët e universitetit mund të kalojnë një periudhë kohe jashtëzakonisht të madhe për studim. Ndërsa kjo mund të nevojitet për një kohë, studentët nuk duhet të neglizhojnë tërësisht zhvillimin në fusha të tjera të jetës dhe të personalitetit të tyre. Një program peshkopi mund të duket ndonjëherë “jo i drejtpeshuar” në kuptimin që detyrat e lagjes së tij mund ta pengojnë të kalonte kohën që do të dëshironte me familjen e tij. Sidoqoftë, ai duhet të bëjë gjithçka mundet për të kaluar kohën e nevojshme me ata dhe pastaj të mbështetet tek Zoti për ta ndihmuar t’u përgjigjet nevojave të tyre.

### **KONCEPT 3. UDHËHEQËSIT DUHET TË MËSOJNË TË ÇAKTOJNË PËRPARËSITË PËR KOHËN E TYRE.**

#### **KOMENT**

Udhëheqësit e Kishës na nxisin të vendosim përparësi që janë në harmoni me parimet e ungjillit. Plaku Riçard G. Skot i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve na mësoi: “Vendoseni Shpëtimtarin, mësimet e Tij dhe Kishën e Tij në qendër të jetës suaj. Sigurohuni që të gjitha vendimet të përputhen me këtë standard” (në Conference Report, prill 1991, f. 43, ose *Ensign*, maj 1991, f. 34). Më vonë Plaku Skot këshilloi: “Bëjeni Atin tuaj të Përjetshëm dhe Birin e Tij të Shumë të Dashur përparësinë më të rëndësishme në jetën tuaj – më të rëndësishme sesa vetë jetën, më të rëndësishme sesa një shok apo shoqe shumë të dashur apo fëmijët apo cilindo qoftë mbi tokë. Bëjeni vullnetin e Tyre dëshirën tuaj qendrore. Pastaj gjithçka keni nevojë për lumturi do t’ju vijë” (në Conference Report, prill 1993, f. 43; ose *Ensign*, maj 1993, f. 34).

Në një rast tjetër Plaku Skot paralajmëroi: “Pjesë e provës [tonë në vdekshmëri] është të kemi për të bërë kaq shumë gjëra interesante në dukje, sa që mund të harrojmë qëllimet kryesore pse jemi këtu. Satani punon shumë fort që gjërat thelbësore të mos ndodhin ...

... Në çaste të qeta kur mendoni për këtë, ju dalloni se çfarë është me rëndësi vendimtare në jetë dhe çfarë nuk është. Jini të urtë dhe mos

lejoni që gjëra të mira t’u zënë vendin atyre që janë thelbësore...

... Studioni gjërat që bëni në kohën tuaj private, atë kohë që ju jeni të lirë ta kontrolloni. A mendoni se ajo është përqendruar në ato gjëra që janë të përparësisë më të lartë dhe të rëndësisë më të madhe? Apo pa vetëdije dhe vazhdimisht e mbushni atë me gjëra pa rëndësi dhe veprimtari pa vlerë afatgjatë e që nuk ju ndihmojnë të përmbushni qëllimin për të cilin erdhët në tokë? Mendoni për aspektin e përjetshëm të jetës, jo thjesht çfarë do të ndodhë sot apo nesër. *Mos hiqni dorë nga ajo që doni më shumë në jetë për diçka që mendoni se e doni tani.*

Gjërat thelbësore duhet të përmbushen gjatë periudhës tuaj të provës mbi tokë. Ato duhet të kenë përparësi numër një. Ato nuk duhet të sakrifikohen për gjëra më të vogla, edhe pse ato janë përmbushje të mira dhe të denja” (në Conference Report, prill 1997, f. 78–79; ose *Ensign*, maj 1997, f. 53–54).

Shumë nga ne ndiejmë ndonjëherë se nuk kemi mjaft kohë për të gjitha ato që duhet të bëjmë apo që do të donim të bënim. Thirrjet në Kishë, detyrimet familjare, puna, hobet e kështu me radhë, të gjitha kërkojnë vëmendjen tonë. Plaku Nil A. Maksiuell, atëherë anëtar i Presidencisë së Të Shtatëdhjetëve, na këshilloi të përdorim lirinë e zgjedhjes “në mënyrë të tillë që të bëjmë gjërat që kanë më shumë rëndësi, kështu që këto të mos jenë në mëshirën e gjërave më pak të rëndësishme” (*Deposition of a Disciple* [1976], f. 58). Udhëheqësit e Kishës dhe të familjes nevojitet ta përqendrojnë jetën tek thesarët qiellorë që të mund të ndihmojnë të tjerët të bëjnë po ashtu.

#### **IDE MËSIMORE**

Ne vendosim përparësitë e kohës tonë për të njëjtën arsye pse bëjmë atë të parave tona: për t’u siguruar që të kemi mjaft për shpenzime për ato që na nevojiten dhe i duam më shumë.

Shpjegojini që hapi i parë në menaxhimin e kohës tonë është të sqarojmë se ç’sasi kemi për përdorim. Pyetini Pyetini studentët sa orë ka në një javë (168). Pyetini studentët çfarë aktivitete *kanë* për të bërë gjatë çdo jave (punë, shkollë, gjumë, ngrënie etj.) dhe u thoni t’i rendisin ato

në një copë letër. I vini vini të shkruajnë pranë çdo zëri sa orë kalojnë në atë aktivitet në çdo javë dhe zbriteni nga shuma e përgjithshme. Për shembull, nëse ata kalojnë 40 orë në javë për punë, atyre u mbeten 128 orë. Nëse shpenzojnë 8 orë në ditë për gjumë, atëherë u mbeten edhe 72 orë në javë. Nëse shpenzojnë 3 orë në kishë çdo të diel, atyre u mbeten edhe 69 orë.

Kur studentët arrijnë tek një shumë e përgjithshme, pyetini se çfarë aktivitete *pëlqejnë* të bëjnë në kohën e lirë dhe i vini t'i shkruajnë në letër. I vinitë shkruajnë përbri secilit zë sa kohë mendojnë se duhet t'i kushtojnë në javë dhe zbriteni atë nga shuma e përgjithshme. (Nëse disa nga veprimtaritë që duan të bëjnë ishin përfshirë gjithashtu në listat e tyre të gjërave që ata duhet të bëjnë, mos i zbritni ato orë për herë të dytë.)

Theksoni se veprimtaritë që vlerësojmë më shumë jo domosdoshmërisht zënë shumicën e kohës. Për shembull, ne mund të shpenzojmë vetëm pak minuta në një ditë të dhënë për lutje, por lutja mund të jetë gjëja më e rëndësishme e asaj dite.

Tani jepini çdo student një fletë kalendari javor të përgjithshme. U thoni studentëve të shohin në listën e veprimtarive që *kanë* për të bërë dhe t'i shënojnë ato në kalendar. Pastaj i vini të shkruajnë veprimtaritë që do të *donin* të bënin në hapësirën kohore që mbetet.

Theksoni rëndësinë e dhënies së përparësisë më të lartë veprimtarive që vlerësojnë më shumë. Sugjeroni që ata të vendosin çdo javë përparësi kohe për qëllimet e Kishës në shpalljen e ungjillit, shëlbimin e të vdekurve dhe përsosjen e shenjtorëve.

Tregojuni studentëve që si udhëheqës, ne kemi nevojë të organizojmë kohën në mënyrë që të mund të jetojmë sipas parimeve të ungjillit dhe të ndihmojmë të tjerët të veprojnë në të njëjtën mënyrë.

Shpjegojuni se një kalendar mund t'u ndihmojë të kujtojnë takimet dhe angazhime të tjera dhe të drejtpeshojnë të gjitha veprimtaritë që vlerësojnë. Theksoni se një kalendar është vetëm një mënyrë për të vendosur përparësitë në kohë dhe i nxisni të gjejnë një mënyrë që u përshtatet.

## BURIME PËR MËSUESIN



### Plaku M. Rasëll Ballard

*Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve*

*“Keeping Life’s Demands in Balance”, në Conference Report, prill 1987, f. 14–18; ose Ensign, maj 1987, f. 13–16.*

### Rishqyrtoni përparësitë e jetës

Të dashur vëllezër dhe motra, që nga konferenca e përgjithshme e fundit, unë kam ndier në vetë jetën time fuqinë e bekimeve të priftërisë dhe fuqinë e besimit e të lutjeve të anëtarëve të Kishës. Për shumë vite, u kam dhënë bekime të tjerëve. Unë kam agjëruar dhe jam lutur për mirëqenien e tyre dhe kam ushtruar besimin tim për shërimin e tyre. Së fundi, gjatë një sëmundjeje të rëndë, unë isha marrës besimi, lutjesh dhe bekimesh të tilla. Ju falënderoj, vëllezër dhe motra, për lutjet që keni ofruar në emrin tim.

Një nga kolegët e mi më tha se diçka e mirë do të vinte nga kjo sëmundje. Ai sugjeroi se është mirë për këdo, me raste, që të ballafaqohet me vështirësi, veçanërisht kur ajo sjell shqyrtim të vetvetes që na mundëson të vlerësojmë hapur dhe ndershmërisht jetën tonë. Kjo është ajo që bëra.

Natën para operacionit, mjekët biseduan mbi mundësinë e kancerit. Kur mbeta vetëm, mendja m'u mbush me mendime për familjen dhe shërbesën time. Gjeta ngushëllim në ordinancat e ungjillit që më lidhin me familjen nëse jemi besnikë. Kuptova se kisha nevojë të ndreqja disa nga përparësitë për të përmbushur gjërat që ishin më të rëndësishme për mua.

Ndonjëherë na duhet një krizë vetjake që të ngulitim në mendje atë çka vërtet e vlerësojmë dhe e kemi të shtrenjtë. Shkrimet e shenjta janë mbushur me shembuj nga njerëz që përballen me kriza para se të mësojnë se si t'i shërbejnë më mirë Perëndisë dhe të tjerëve. Ndoshta ju gjithashtu, po të kërkonte në zemrën tuaj dhe me kurajë të vlerësoni përparësitë në jetën tuaj, mund të zbuloni, ashtu si unë, se keni nevojë për një drejtpeshim më të mirë të përparësive tuaja.



Të gjithë duhet të vijmë në një vetëshqyrtim të ndershëm, të hapur, një vetëndërgjegjësim për atë se cili dhe çfarë duam të jemi.

### **Rishikimi i besëlidhjeve na ndihmon të drejtpeshojmë kërkesat e jetës**

Siç e dinë shumica prej jush, përballimi i sfidave komplekse dhe të ndryshme të jetës së përditshme, që nuk është detyrë e lehtë, mund të na prishë drejtpeshimin dhe paqen që kërkojmë. Mjaft njerëz të mirë që kujdesen shumë po përpiqen goxha fort për të ruajtur drejtpeshimin, por ata ndihen ndonjëherë të hutuar dhe të mundur.

Një nënë me katër fëmijë të vegjël tha: “Nuk ka fare drejtpeshim në jetën time. Unë jam tërësisht e konsumuar në përpjekje për të rritur fëmijët e mi. Zor se kam kohë të mendoj për ndonjë gjë tjetër!”

Një baba në moshë të re, që ndiente presionin si siguries i jetës së familjes, tha: “Puna e re më kërkon gjithë kohën që kam. E kuptoj se po i lë pas dore detyrat familjare dhe të kishës, por nëse mund ta shtyj për vetëm edhe një vit, do të bëj mjaft para dhe atëherë gjërat do të rregullohen.”

Një student i shkollës së mesme tha: “Ne dëgjojmë kaq shumë pikëpamje të kundërta se është e vështirë që gjithnjë ta dish çfarë është e drejtë dhe çfarë e gabuar.”

Sa shpesh e kemi dëgjuar këtë? “Asnjë nuk e di më mirë se unë sa i rëndësishëm është ushtrimi, por unë thjesht nuk kam kohë gjatë ditës për t’u ushtruar.”

Një prind i vetëm tha: “Më duket thujse e pamundur të përmbush gjithçka duhet që të menaxhoj shtëpinë dhe të drejtoj familjen time. Në fakt, ndonjëherë mendoj se bota pret më tepër shumë prej meje. Pavarësisht sa fort punoj, unë kurrë nuk do mund t’i bëj gjërat aq mirë sa presin t’i bëj.”

Një nënë tjetër me katër fëmijë vërejti: “Lufta ime është midis respektit për veten, besimit në vetvete dhe ndjenjave të vlerës së vetes kundër atyre të fajësisë, dëshpërimit dhe shkurajimit për mosbërjen e gjithçkaje që më është thënë se duhet të bëj për arritjen e mbretërisë çelestiale.”

Vëllezër dhe motra, ne të gjithë përballemi me këto lloj përpjekjesh herë pas here. Ato janë përvoja të zakonshme njerëzore. Shumë njerëz kanë

kërkesa të rënda mbi vete që rrjedhin nga përgjegjësitë prindërore, familjare, të punës, të kishës dhe qytetare. Mbajtja e gjithçkaje në drejtpeshim mund të jetë një problem i vërtetë.

Një rishikim i rregullt i besëlidhjeve që kemi bërë me Zotin do të na ndihmojë për përparësitë dhe drejtpeshimin në jetën tonë. Ky rishikim do të na ndihmojë të shohim ku kemi nevojë të pendohemi dhe ta ndryshojmë jetën për t’u siguruar që jemi të denjë për premtimet që shoqërojnë besëlidhjet tona dhe ordinancat e shenjta. Puna për shpëtimin tonë kërkon planifikim të mirë dhe një përpjekje të menduar dhe të guximshme.

Unë kam disa sugjerime që shpresoj se do të jenë të vlefshme për ata prej jush që shqetësohen për drejtpeshimin e kërkesave të jetës. Këto sugjerime janë shumë themelore; nocionet në to lehtësisht mund të mos vihen re po të mos jeni të kujdesshëm. Ju do të keni nevojë për angazhim të fortë dhe disiplinë vetjake që t’i bëni pjesë të jetës suaj.

### **Përdorni këndvështrim përjetësie për të vendosur përparësi**

Së pari, mendoni për jetën tuaj dhe vendosni përparësitë tuaja. Gjenero rregullisht pak kohë të qetë për të menduar thellë mbi atë se ku po shkoni dhe çfarë do të keni nevojë të bëni për të arritur atje. Jezusi, shembulli ynë, shpesh “tërhijtej në vende të vetmuara dhe lutej” (Lluka 5:16). Ne kemi nevojë të bëjmë të njëjtën gjë herë pas here për t’u rigjallëruar shpirtërisht, siç bëri Shpëtimtari. I shkruani detyrat që do të donit t’i përmbushni çdo ditë. Mbani mend në radhë të parë besëlidhjet e shenjta që keni bërë me Zotin kur shkruani programet tuaja ditore.

### **Vendosni objektiva të arsyeshme afatshkurtra**

Së dyti, vendosni objektiva afatshkurtra që mund t’i arrini. Vendosni objektiva që janë të drejtpeshuara mirë – jo tepër, as shumë pak dhe as tepër të vështira, as tepër të lehta. Shkruani qëllimet tuaja realiste dhe punoni për to sipas rëndësisë së tyre. Lutuni për drejtim hyjnor në vendosjen e qëllimeve tuaja.

Sillni ndër mend që Alma tha se do të donte të ishte një engjëll që të mund “të njofto[nte] me borinë e Perëndisë, ... [të tundte] tokën dhe të

thërris[te] pendim në çdo popull!” (Alma 29:1). Ai tha pastaj: “Por vini re, unë jam një njeri dhe mëkatoj në dëshirën time; pasi duhet të isha i kënaqur me gjërat që më ka dhënë Zoti...

... Përse duhet të dëshiroj më shumë sesa të kryej punën për të cilën unë jam thirrur?” (Alma 29:3, 6).

### **Bëhuni përgjegjës dhe të sigurt financiarisht**

Së treti, secili përballet me sfida financiare në jetë. Duke hartuar buxhet me mençuri, kontrolloni nevojat tuaja reale dhe i vlerësoni me kujdes kundrejt dëshirave tuaja të shumta në jetë. Tepër shumë individë dhe familje kanë hyrë në borxhe tepër të mëdha. Jini të kujdesshëm nga ofertat tërheqëse për të marrë para hua. Është shumë më lehtë të marrësh borxh sesa ta kthesh. Nuk ka rrugë të shkurtra për sigurinë financiare. Nuk ka skema pasurimi të shpejtë që funksionojnë. Ndoshta askush nuk ka nevojë më shumë për parimin e drejtpeshimit në jetën e vet, sesa ata që ndihen të prirur të blejnë shumë gjëra materiale.

Mos ua besoni paratë tuaja të tjerëve pa një vlerësim të plotë të çdo investimi të propozuar. Njerëzit tanë kanë humbur me shumë tepri para duke ua besuar pasuritë të tjerëve. Sipas gjyqimit tim, kurrë nuk do të ketë drejtpeshim në jetën tonë, nëse financat tona nuk janë nën kontroll të sigurt.

Profeti Jakob u tha njerëzve të tij: “Prandaj, mos shpenzoni para për atë që nuk ka vlerë, as punën tuaj për atë që nuk mund të japë kënaqësi. Më dëgjoni me zell dhe mbani mend fjalët që ju kam thënë; dhe ejani tek i Shenjti i Izraelit dhe merrni sa të mundni nga ajo që nuk mbaron, as që nuk mund të korruptohet dhe e lini shpirtin tuaj të kënaqet në bollëk” (2 Nefi 9:51).

Vëllezër dhe motra, kujtohuni kurdoherë të paguani një të dhjetën e plotë.

### **Ndërtoni marrëdhënie të ngushta me familjen dhe miqtë**

Së katërti, qëndroni afër bashkëshortes, fëmijëve, të afërmeve dhe miqve tuaj. Ata do t’ju ndihmojnë të mbani drejtpeshim në jetë. Në një studim të kohëve të fundit nga Kisha, disa të rriturve në Shtetet e Bashkuara iu kërkua të gjenin

një kohë kur kishin qenë shumë të lumtur dhe ta përshkruanin përjetimin. Atyre iu kërkua gjithashtu të përshkruanin një kohë kur ishin shumë të brengosur. Për shumicën e njerëzve një gjë që i kishte bërë shumë të lumtur apo shumë të dëshpëruar ishin marrëdhëniet me të tjerët. Shumë më pak të rëndësishme ishin shëndeti vetjak, puna, paratë dhe gjëra të tjera materiale. Ndërtoni marrëdhënie me familjen dhe miqtë tuaj nëpërmjet një komunikimi të hapur dhe të ndershëm.

Një martesë e mirë dhe marrëdhëniet e mira familjare mund të ruhen nëpërmjet një komunikimi të butë, të dashur dhe plot vëmendje. Kujtohuni se shpesh një shikim, një shkelje syri, një lëvizje koke apo një prekje do të shprehë më shumë sesa fjalët. Një ndjesi humori dhe dëgjim me vëmendje janë gjithashtu pjesë jetike të komunikimit të mirë.

### **Studioni shkrimet e shenjta**

Së pesti, studioni shkrimet e shenjta. Ato ofrojnë një nga burimet më të mira që kemi për të mbajtur kontakt me Shpirtin e Zotit. Një nga mënyrat se si kam fituar dijen e sigurt se Jezusi është Krishti është nëpërmjet studimit të shkrimeve të shenjta. Presidenti Ezra Taft Benson u ka bërë thirrje anëtarëve të Kishës ta bëjnë studimin e Librit të Mormonit një zakon të përditshëm dhe aktivitet të të gjithë jetës. Këshilla e Apostullit Pal për Timoteun është një këshillë e mirë për secilin prej nesh. Ai shkroi: “Që nga fëmijëria i njej Shkrimet e shenjta, të cilat mund të të bëjnë të ditur për shpëtimin me anë të besimit që është në Krishtin Jezus.

I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi” (2 Timoteut 3:15–16).

### **Pushimi, ushtrimi dhe çlodhja**

Së gjashti, shumë njerëz, përfshi mua, kanë vështirësi në gjetjen e kohës për pushim, ushtrim dhe çlodhje të mjaftueshme. Ne duhet të programojmë kohën në kalendarin tonë ditor për këto veprimtari, që të gëzojmë një jetë të shëndetshme dhe të drejtpeshuar. Një paraqitje e mirë fizike rrit dinjitetin dhe respektin tonë për veten.

### **“I mësoni njëri-tjetrit ungjillin”**

Së shtati, profetët na kanë mësuar në mënyrë të përsëritur se në familje duhet t'i mësojmë njëri-tjetrit ungjillin, është më mirë në një mbrëmje familjare në shtëpi. Kjo praktikë familjare, nëse nuk jemi shumë të kujdesshëm, mundet ngadalë të na largohet. Ne duhet të mos e humbasim këtë mundësi të veçantë që “t’ia [mësojmë] njëri-tjetrit doktrinën e mbretërisë” (DeB 88:77), e cila do t’i drejtojë familjet në jetë të përzetshme.

Satani është kurdoherë në punë për të shkatërruar dëshmitë tona, por ai kurrë nuk do të ketë forcën të na tundojë apo të na shqetësojë tej forcave tona për të rezistuar, kur studiojmë ungjillin dhe jetojmë urdhërimet e tij.

### **Lutuni shpesh**

Sugjerimi im i fundit është të luteni shpesh si individë dhe si familje. Prindërit kanë nevojë të ushtrojnë disiplinën e kërkuar për të udhëhequr dhe motivuar fëmijët e tyre që të mblidhen së bashku për lutje të rregullta familjare. Rinia jonë mund të dallojë vendimet e drejta që duhet të marrë çdo ditë duke u lutur vazhdimisht dhe sinqerisht.

Profeti Alma bëri përmbledhjen e rëndësisë së lutjes në këto fjalë: “Por që ju të përuleni para Zotit dhe të thërrisni në emrin e tij të shenjtë dhe të jeni vigilentë, dhe të luteni vazhdimisht, që ju të mos tundoheni mbi atë që mund të duroni dhe kështu të udhëhiqeni nga Shpirti i Shenjtë, të bëheni të përulur, të bindur, të nënshtruar, të durueshëm, plot dashuri dhe keqardhje” (Alma 13:28). Kur jam në gjendje të mirë shpirtërore, unë e shoh se mund të drejtpeshoj shumë më lehtësisht çdo gjë në jetën time.

### **Bëni të gjitha gjërat në urtësi dhe rregull**

Unë e kuptoj, vëllezër dhe motra, se këtyre mund t’u shtohen sugjerime të tjera. Sidoqoftë, besoj se kur përqendrohemi në disa objektiva themelore, për ne ka më shumë gjasa të jemi në gjendje të menaxhojmë kërkesat e shumta me të cilat ballafaqohemi në jetë. Kujtohuni, janë me tepri në jetë gjërat çfarëdo që mund të na prishin drejtpeshimin. Njëkohësisht, shumë pak gjëra

me rëndësi mund të bëjnë të njëjtën gjë. Mbreti Benjamin këshilloi: “të gjitha këto gjëra të jenë bërë në urtësi dhe rregull” (Mosia 4:27).

Shpesh mungesa e një drejtimi dhe objekti vash të qarta mund të na humbasë kohën dhe energjinë dhe të ndihmojë në prishjen e drejtpeshimit në jetën tonë. Një jetë që humbet drejtpeshimin i ngjan shumë një gome makine pa balancim. Ajo do ta bëjë manovrimin e makinës të ashpër dhe të pasigurt. Gomat me balancim të përsosur mund të japin një udhëtim të butë dhe të rehatshëm. Kështu është me jetën. Udhëtimi nëpër vdekshmëri mund të jetë më i qetë për ne kur përpiqemi të qëndrojmë në drejtpeshim. Qëllimi ynë kryesor duhet të jetë të kërkojmë “[pavdekësi dhe jetë të] përzetshme” (Moisiu 1:39). Duke pasur këtë si qëllimin tonë, përse të mos i largojmë nga jeta jonë gjërat që i thërrasin dhe i konsumojnë mendimet, ndjenjat dhe energjitë tona pa na ndihmuar në arritjen e atij qëllimi?

### **Më mirë të ndihmoni sesa të pengoni**

Vetëm një fjalë për udhëheqësit e Kishës: Jini shumë të kujdesshëm që ajo që kërkon nga anëtarët t’i ndihmojë të arrijnë jetë të përzetshme. Që anëtarët e Kishës të jenë në gjendje të drejtpeshojnë jetën e vet, udhëheqësit e Kishës duhet të sigurohen që nuk do t’u kërkojnë aq shumë anëtarëve, sa të mos u lënë kohë të përmbushin qëllimet e tyre vetjake dhe familjare.

### **Bëni më të mirën çdo ditë**

Jo shumë kohë përpara, një nga fëmijët e mi më tha: “Babi, ndonjëherë pyes veten a do t’ia dal ndonjëherë mbanë.” Përgjigjja që i dhashë asaj ishte po ajo që do t’ju jepja juve, po të keni pasur ndjesi të ngjashme. Vetëm bëni më të mirën që mundeni çdo ditë. Bëni gjërat bazë dhe, përpara se ta keni kuptuar, jeta juaj do të jetë plot kuptim shpirtëror që do t’ju konfirmojë se Ati juaj Qiellor ju do. Kur një njeri e di këtë, atëherë jeta do të jetë plot qëllim dhe kuptim, duke e bërë më të lehtë mbajtjen e drejtpeshimit.

Jetoheni çdo ditë me gëzim në zemër, vëllezër dhe motra. Unë përlësisht dëshmoj se jeta mund të jetë e mrekullueshme, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Çfarë mund të bëjmë për të nxitur veten dhe ata që udhëheqim që të vlerësojmë përparësitë tona dhe të kërkojmë drejtpeshim në jetën tonë?
  - Çfarë roli mund të luajë vështirësia për të na motivuar të vlerësojmë jetën tonë?
  - Cilat mendoni se duhet të jenë pesë apo gjashtë përparësitë më të mëdha në jetën tuaj? A duhet të ndryshojnë këto përparësi sipas moshës dhe përvojës? Përse po apo përse jo? Cilat përparësi janë të adaptueshme?
  - Bëni një listë qëllimesh laike, pastaj shpirtërore. Kombinoni listat sipas përparësive. Çfarë mësimesh mund të nxjerrim nga ky ushtrim?
- Cili është rreziku kur ndiqen qëllimet shpirtërore, ndërsa injorohen ato fizike?
  - Diskutoni këshillën e Mbretit Benjamin: “të gjitha... gjëra[t] të jenë bërë në urtësi dhe rregull” (Mosia 4:27).
  - Si mundemi ne, si udhëheqës të Kishës, të sigurojmë që të gjitha programet dhe veprimtaritë të ndihmojnë forcimin e familjeve dhe mbështetjen e prindërve në detyrën e tyre, për t’u mësuar ungjillin njerëzve të shtëpisë, në vend që t’i largojmë nga ajo detyrë?

# NDERIMI I PRIFTËRISË DHE I GRARISË

*“Por ju jeni fis i zgjedhur, priftëri mbretërore, një komb i shenjtë, një popull i fituar, që të shpallni mrekullitë e atij që ju thirri nga terri në dritën e tij të mrekullueshme” (1 Pjetri 2:9).*

## PARIME TË UDHËHEQJES

Udhëheqësit e Kishës dhe të familjes duhet të punojnë në përputhje me parimet e priftërisë.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Mbretëria e Perëndisë qeveriset nga priftëria.
2. Ne duhet të nderojmë priftërinë dhe ne duhet të nderojmë grarinë.
3. Udhëheqësit duhet të respektojnë ata që janë thirrur të kryesojnë në mbretërinë e Zotit.

## KONCEPT 1. MBRETËRIA E PERËNDISË QEVERISET NGA PRIFTËRIA.

### KOMENT

Presidenti Dejvid O. Mek-Kei na mësoi: “Mbrotjtja më e madhe që kemi për unitetin dhe forcën në Kishë gjendet tek priftëria, nëpërmjet nderimit dhe respektimit të saj. Oh, vëllezërit e mi – presidentë të kunjeve, peshkopë të lagjeve dhe të gjithë që mbani priftërinë – Perëndia ju bekon në udhëheqjen tuaj, në përgjegjësinë tuaj për të drejtuar, bekuar dhe ngushëlluar njerëzit, që jeni caktuar t’i kryesoni dhe t’i vizitoni. I drejtoni që të shkojnë tek Zoti dhe të kërkojnë frymëzim për të jetuar në mënyrë të tillë që të mund të ngrihen mbi të ultën e të poshtren dhe të jetojnë në mbretërinë shpirtërore” (në Conference Report, tetor 1967, f. 6).

Plaku M. Rasëll Ballard, anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, shpjegoi: “Mbajtja e priftërisë është më shumë se thjesht një bekim i madh. Ajo mbart me vete gjithashtu përgjegjësi të rëndësishme të tilla si vëzhgimi i Kishës; nderimi i të gjitha grave, veçanërisht i bashkëshorteve tona, nënave tona, bijave tona, motrave tona; vizitat në shtëpitë e çdo anëtari, duke i nxitur të gjithë ‘të luten me zë e në fshehtësi dhe të ndjekin të gjitha detyrat familjare’ [DeB 20:47] dhe ‘të [qëndrojnë] si dëshmitarë të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha

gjërat dhe në të gjitha vendet’ [Mosia 18:9]” (në Conference Report, tetor 1997, f. 50–51; ose *Ensign*, nëntor 1997, f. 37).

Plaku Rasëll M. Nelson i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve dëshmoi: “Gjithë njerëzimit ne i shpallim këto të vërteta të përhershme: ‘Priftëria Melkizedeke mban të drejtën e kryesimit dhe ka fuqi e autoritet mbi gjithë detyrat në kishë, në të gjitha epokat e botës’ (DeB 107:8). Kjo priftëri mban ‘çelësat e të gjitha bekimeve shpirtërore të kishës’ (DeB 107:18). E nderofshim plotësisht atë priftëri” (në Conference Report, prill 1993, f. 53; ose *Ensign*, maj 1993, f. 41).

### IDE MËSIMORE

Ftoni dy ose tre studentë që punojnë për organizata (për shembull dyqane apo kompani) të përshkruajnë se si janë organizuar. Si e fitojnë njerëzit autoritetin në organizatë për të bërë punët e tyre?

Pyetini se si është organizuar Kisha dhe nga e mori autoritetin e saj.

Konsideroni të merrni një vullnetar për të vizituar një skicë organizimi të lagjes, degës apo kunjit. I thoni vullnetarit të shpjegojë skemën. Ose mund të ftoni një misionar të kthyer që të përshkruajë se si është organizuar një mision dhe epërsitë e atij organizimi për të bërë punën e Zotit.

Pyetni:

- Si i vëzhgojnë udhëheqësit e priftërisë të niveleve të ndryshme anëtarët?
- Sa e suksesshme do të ishte Kisha, nëse autoriteti i priftërisë papritmas do të hiqej? Përse?

Shpjegoni se herë pas here Zoti frymëzon udhëheqësit e Kishës që të bëjnë ndryshime organizative për t'iu përgjigjur nevojave të Kishës në zgjerim.

## **KONCEPTI 2. NE DUHET TË NDEROJMË PRIFTËRINË DHE NE DUHET TË NDEROJMË GRARINË.**

### **KOMENT**

Plaku Rasëll M. Nelson shpjegoi: “Kjo është Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ai që qëndron në krye të Kishës së Tij të rivendosur e urdhëroi kështu priftërinë e Tij: ‘që çdo njeri të mund të flasë në emër të Perëndisë, Zotit, madje Shpëtimtarit të botës’ (DeB 1:20). E mrekullueshme! Ai zgjodhi të na nderojë me priftërinë e Tij. Kështu ne e nderojmë Atë duke nderuar priftërinë e Tij – edhe fuqinë e saj edhe ata që e mbajnë atë. Duke vepruar kështu, burra, gra dhe fëmijë kudo në botë do të bekohen. Sjellja me vlerësim ndaj priftërisë ushqen respektin, respektin nxit nderimin dhe nderimi fton zbuluesën” (në Conference Report, prill 1993, f. 49; ose *Ensign*, maj 1993, f. 38).

Presidenti N. Eldon Taner, që ishte Këshilltar në Presidencinë e Parë, tha: “Asnjë burrë, i ri apo i moshuar, që mban priftërinë e Perëndisë nuk mund ta nderojë atë priftëri pa nderuar dhe respektuar grarinë. Çdo i ri duhet të jetë i përgatitur të mbrojë virtytin e një gruaje me jetën e tij, nëse është e nevojshme, të mos gabojë kurrë duke u epshuar pas një gruaje apo duke bërë çfarëdo që do ta degradonte atë apo do ta bënte që të humbiste virtytin e saj. Çdo e re ka një të drejtë legjitime të ndihet e sigurt kur takohet me një të ri që mban priftërinë, duke ditur se ai do ta respektojë dhe do ta mbrojë me çdo mënyrë” (në Conference Report, prill 1973, f. 124; ose *Ensign*, korrik 1973, f. 95).

Presidenti Spenser W. Kimball dha kujtesën e mëposhtme: “Sonte planifikoj të flas përpara

vëllezërve të priftërisë, të mbledhur nga qindra vende rreth botës dhe t’u kujtoj atyre se ‘ne të gjithë jemi bekuar me gra të veçanta në jetën tonë, të cilat kanë pasur një ndikim të thellë dhe të qëndrueshëm mbi ne. Ndhimesa e tyre ka qenë dhe është e rëndësishme për ne [vëllezër] dhe është diçka që do të jetë për ne me një vlerë të përhershme.’ (Shih *Ensign*, nëntor 1979, f. 48.) Unë dëshiroj ta theksoj atë mendim këtë mëngjes. Unë nuk gjej fjalë ta përshkruaj këtu vendin e lartë të nderit dhe respektit që bashkëshortet, nënat, motrat dhe bijat tona zënë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme” (në Conference Report, tetor 1979, f. 6–7; ose *Ensign*, nëntor 1979, f. 5).

### **IDE MËSIMORE**

Pyetini motrat se çfarë duhet të bëjnë burrat për të nderuar priftërinë e tyre dhe diskutoni përgjigjet e tyre. Pyetini vëllezërit se si mbajtësit e priftërisë mund ta nderojnë grarinë.

Çfarë bekimesh u shkojnë grave në sajë të autoritetit të priftërisë? (Përgjigjet duhet të përfshijnë ordianca të ungjillit.)

U thoni studentëve të lexojnë DeB 121:34–46 dhe rendisni parimet e udhëheqjes që zbatohen për të gjithë udhëheqësit e Kishës dhe të familjes.

## **KONCEPT 3. UDHËHEQËSIT DUHET TË RESPEKTOJNË ATA QË JANË THIRRUR TË KRYESOJNË NË MBRETËRINË E ZOTIT.**

### **KOMENT**

Presidenti Dejvid O. Mek-Kei këshilloi: “Njihni ata që ju kryesojnë dhe, kur është e nevojshme, kërkoni këshillën e tyre. Vetë Shpëtimtari e njëhte këtë autoritet në tokë. Ju do të kujtoni përvojën që Pali pati pikërisht kur iu afrua Damaskut me autoritet ligjor për të ndaluar të gjithë ata që besonin në Jezu Krisht. Një dritë shkëlqeu befaz rreth tij dhe ai dëgjoi një zë që tha: ‘Saul, Saul, përse më përndjek?’

Dhe Sauli tha: “‘Zot, ç’don ti të bëj unë?’ Dhe Zoti: ‘Çohu dhe hyr në qytet, dhe do të të thuhet ç’duhet të bësh.’” (Veprat e Apostujve 9:4, 6.)

Ai mund t’i kishte thënë Saulit me pak fjalë se çfarë duhej të bënte, por kishte një degë të

Kishës në Damask, e kryesuar nga një burrë i përulur me emrin Ananias, dhe Jezusi e njihje atë autoritet...

Këtu është një mësim për të gjithë ne në këtë Kishë. Le ta njohim, ne gjithashtu, autoritetin vendor. Peshkopi mund të jetë një burrë i përulur. Disa nga ju mund të mendojnë se jeni superiore ndaj tij, dhe mund të jeni, por atij i është dhënë autoriteti drejtpërdrejt nga Ati ynë në qiell. Njiheni atë. Kërkoni këshillën e tij dhe këshillën e presidentit të kunjit tuaj. Nëse ata nuk mund të përgjigjen për vështirësitë apo problemet tuaja, ata do t'u shkruajnë Autoriteteve të Përgjithshme dhe do të marrin këshillën e nevojshme. Njohja e autoritetit është një parim i rëndësishëm” (në Conference Report, tetor 1967, f. 6–7).

### IDE MËSIMORE

Pyetni nëse dikush ka marrë pjesë në një konferencë të përgjithshme. Nëse dikush ka marrë pjesë, pyeteni çfarë bën kongregacioni kur hyn Presidenti i Kishës. (Ata ngrihen dhe qëndrojnë të qetë derisa ai ulet.) Përse reagon në këtë mënyrë kongregacioni?

Diskutoni pyetjet e mëposhtme:

- Përse do të ishte e papërshtatshme të kërkohet këshillë nga një udhëheqës priftërie i një miku në një lagje apo kunj tjetër, dhe jo nga vetë juaji?
- Çfarë mësimesh mund të nxjerrim nga përvoja e Palit në Vepra të Apostujve 9:6? (shih komentin).
- Presidenti i kunjit njofton që një peshkop i ri do të mbështetet në lagjen tuaj të dielën tjetër. Ju njihni disa anëtarë të lagjes tuaj, që besoni se do të ishin peshkopë të shkëlqyer. Për çudinë tuaj, presidenti i kunjit thërret një burrë që nuk e kishit menduar si udhëheqës të fortë. Çfarë duhet të bëni? Përse është e rëndësishme që gjithnjë t'i mbështesim ata që Zoti i thërret?
- Një mik i juaj ka një pyetje doktrinale dhe planifikon t'i shkruajë një Autoriteti të Përgjithshëm, sepse mendon se do të jetë burimi më i mirë për një përgjigje. Ku është gabimi në atë plan?

- Pse është e vërtetë thënia: “Një udhëheqës i madh është gjithashtu një pasues i madh?”

### BURIME PËR MËSUESIN



#### Plaku Rasëll M. Nelson

Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve

“Honoring the Priesthood”, në Conference Report, prill 1993, f. 49–53; ose Ensign, maj 1993, f. 38–41.

### Nderimi i priftërisë

Vëllezër, relativisht është shkruar pak mbi temën time<sup>1</sup>. Dhe përsëri pritet që ne të gjithë të dimë rreth saj. Unë flas për nderimin e priftërisë.

Kjo është Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ai që qëndron në krye të Kishës së Tij të rivendosur e urdhëroi kështu priftërinë e Tij: “që çdo njeri të mund të flasë në emër të Perëndisë, Zotit, madje Shpëtimtarit të botës” (DeB 1:20). E mrekullueshme! Ai zgjodhi të na nderojë me priftërinë e Tij. Kështu ne e nderojmë Atë duke nderuar priftërinë e Tij – edhe fuqinë e saj edhe ata që e mbajnë atë. Duke vepruar kështu, burra, gra dhe fëmijë kudo në botë do të bekohen. Sjellja me vlerësim ndaj priftërisë ushqen respektin, respekti nxit nderimin dhe nderimi fton zbuluesen<sup>2</sup>.

Presidenti Ezra Taft Benson na ka kërkuar posaçërisht neve të ndjekim një procedurë të përshtatshme priftërie – parime, theksoi ai, “që shumë nga ne i kanë mësuar nga vrojtimi duke dëgjuar vëllezërit më të mëdhenj”. Ai tha: “Procedura është një praktikë e krijuar prej kohësh që përcakton një respektim të plotë të... një rendi veprimesh të sakta”<sup>3</sup>. Unë do të citoj nga Presidenti Benson dhe udhëheqës të tjerë sepse, siç do ta shihni, shumë nga mesazhi im lidhet me ato procedura.

### Lloje organizimi

Ka ndryshime në praktikë dhe organizim midis Kishës së Zotit dhe institucioneve të krijuara nga njeriu. Burrat dhe gratë mund të formojnë shoqata për vete e midis tyre dhe të qeverisen me marrëveshje që janë reciprokisht

të pranueshme. . Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, sidoqoftë, nuk është as demokraci as republikë. E Tija është një mbretëri – mbretëria e Perëndisë në tokë. E Tija është një kishë hierarkike, me autoritetin më të lartë në krye. Zoti drejton shërbëtorët e Tij të vajosur. Ata i dëshmojnë të gjithë botës se Perëndia ka folur përsëri. Qiejt janë hapur. Një lidhje e gjallë është formuar midis qiellit dhe tokës në kohën tonë.

Ai autoritet suprem mbështetet nga një themel i fortë që ndjek një model organizativ të krijuar në kohën antike. Jezu Krishti është gur kryesor i qoshes, me Apostujt dhe profetët, dhe të gjitha dhuntitë, fuqitë dhe bekimet që karakterizonin Kishën në kohën e lashtë (shih 1 Korintasve 12:28).

### Udhëheqësit dhe titujt

Institucionet laike dhe shpirtërore kanë modele të ndryshme udhëheqjeje. Organizatat e krijuara nga njeriu qeverisen nga zyrtarë me tituj që tregojnë rangun apo aftësinë. Një oficeri ushtrie, gjyqtari, senatori, doktori apo profesori i adresohemi siç duhet me titull. Ne nderojmë siç duhet individët që kanë arritur pozita të tilla.

Në të kundërt, mbretëria e Perëndisë qeveriset nga autoriteti i priftërisë. Ai nuk jepet për nderim, por si instrument shërbimi. Titujt e priftërisë nuk janë krijuar nga njeriu; as janë për zbulim, as shprehin mjeshtëri në një punë të caktuar. Ato tregojnë emërim për shërbim në punën e Zotit. Ne jemi thirrur, mbështetur dhe shuguruar – jo nga vetja, por “me anë të profesisë dhe me anë të vënies së duarve prej atyre që janë në autoritet, për të predikuar Ungjillin dhe për të administruar ordiancat e tij” (Nenet e Besimit 1:5; shih gjithashtu Hebrenjve 5:4).

Titujt që lidhen me priftërinë e shenjtë meritojnë kujdesin dhe respektin tonë më të madh. Çdo anëtar i Presidencisë së Parë i adresohemi dhe e përmendim si “President” (shih DeB 107:22). Titulli *President* përdoret gjithashtu kur i referohemi presidencisë së një kunji apo misoni dhe presidentit të një kuorumi apo lagjeje. Titulli *Apostull* është i shenjtë. Ai është dhënë nga Perëndia dhe i përket vetëm atyre që janë thirrur dhe shuguruar si “dëshmitarët e veçantë të emrit

të Krishtit në gjithë botën” (DeB 107:23). Një Apostull flet në emër të Atij, dëshmitar i posaçëm i të cilit është. Ky titull i shenjtë nuk përdoret në forma apo adresime të zakonshme. Titulli i parapëlqyer për një anëtar të Të Dymbëdhjetëve është *Plak ose Vëlla*.

Titulli *peshkop* shpreh gjithashtu presidenci; peshkopi është president i Priftërisë Aarone në lagjen e tij dhe prifti i lartë kryesues në organizatën e lagjes. Me nderim ne i referohemi atij me fjalën “peshkopi”.

*Plak* është një titull i shenjtë që e marrin të gjithë ata që mbajnë Priftërinë Melkizedeke.

### Këshillë e përgjithshme

Më lejoni të ofroj një këshillë të një natyre të përgjithshme, në fillim me komente mbi Autoritetet e Përgjithshme. Ne i njohm ata si instrumente në dorën e Zotit, por përsëri e shohim se ata janë qenie njerëzore të zakonshme. Ata kanë nevojë për qethje flokësh, shërbime lavanderie dhe që t'i kujtojnë herë pas here njësoj si kushdo tjetër. Presidenti Benson një herë na tregoi një ngjarje për ta ilustruar këtë. Ai tha:

“Orson F. Uitni ... ishte njeri i jashtëzakonshëm për t'u përqendruar. Një ditë kur po udhëtonte me tren, ishte aq i preokupuar sa që nuk vuri re se treni e kaloi stacionin ku duhej të zbriste. Kështu, iu desh të kthehej me makinë atje ku duhej të ndodhej. Ndërkohë presidenti i kunjit priti e priti... Më në fund, kur mendoi se thujse me siguri diçka i kishte ndodhur Vëllait Uitni dhe ai nuk do të mund të vinte, ata e filluan mbledhjen. Kur Plaku Uitni u afrua, ai u përshëndet nga himni i hapjes, që ishte ‘Ju njerëz të thjeshtë që endeni’.”<sup>4</sup>

Ne e nderojmë një njeri të tillë për shkak të thirrjes së tij të jashtëzakonshme. Veprimet e tij zyrtare janë të vlefshme në tokë dhe në qiell. Unë kujtoj mirë kur për herë të parë takova një nga Autoritetet e Përgjithshme. Ishte një ndjesi e papërshkrueshme. Edhe pse nuk isha veçse një djalë, menjëherë – thujse instinktivisht – u ngrita në këmbë. Edhe tani unë ndihem njësoj kur një nga Vëllezërit hyn në dhomë. Një Autoritet i Përgjithshëm është një orakull i Perëndisë.



Shpesh ne flasim për *çelësat* e autoritetit të priftërisë. Pesëmbëdhjetë burra që jetojnë – Presidencia e Parë dhe Të Dymbëdhjetët – janë shuguruar si Apostuj dhe kanë të gjitha çelësat e autoritetit të priftërisë të dhënë atyre. Presidenti Gordon B. Hinkli së fundi shpjegoi:

“Vetëm Presidenti i Kishës ka të drejtën t’i ushtrojë [ato çelësa] në plotësinë e tyre. Ai mund ta delegojë ushtrimin e disa prej tyre tek një apo më shumë nga Vëllezërit e tij...

Një e drejtë e tillë i është dhënë nga Presidenti Benson Këshilltarëve të tij dhe Të Dymbëdhjetëve sipas përgjegjësisë të ndryshme deleguar atyre.”<sup>5</sup>

Sipas emërimit nga Presidencia e Parë dhe nga Të Dymbëdhjetët, Autoritetet e Përgjithshme u japin çelësat e duhur presidentëve të kunjeve dhe të misionëve, të cilët nga ana e tyre u japin çelësat e nevojshëm peshkopëve dhe presidentëve të kuorumëve dhe të degëve.

“shtëpia ime është një shtëpi rregull, thotë Zoti Perëndi, dhe jo një shtëpi rrëmuje” (DeB 132:8).

Ky rregull përcakton gjithashtu kufijtë e zbulësës. Profeti Jozef Smith na mësoi se “është në mospërputhje me logjikën e Perëndisë që cilido anëtar i Kishës, apo kushdo, të marrë udhëzim për ata që kanë autoritet, më të lartë se ata vetë”<sup>6</sup>. Po ky parim përjashtoi paraprakisht marrjen e zbulësës për këdo që është jashtë rrethit të përcaktuar të tij të përgjegjësisë.

Nderimi i priftërisë do të thotë gjithashtu të nderosh thirrjen tënde vetjake për të shërbyer. Disa porosi ‘bëj dhe mos bëj’ mund të jenë të dobishme:

- Mëso të këshillohesh. Kërko drejtim nga udhëheqësit e tu dhe pranoje atë me dëshirë.
- Mos fol keq për udhëheqësit e Kishës.
- Mos lakmo thirrje apo post.
- Mos bëj vlerësime se kujt duhej t’i ishte dhënë apo kujt nuk duhej t’i ishte dhënë një thirrje.
- Mos kundërshtoj mundësinë për të shërbyer.
- Mos jep dorëheqje nga thirrja. Informo udhëheqësit për ndryshimin e rrethanave të jetës tënde, duke ditur që udhëheqësit do të

peshojnë faktorët kur të shqyrtojnë plot lutje kohën e përshtatshme për lirim tuaj.

Ai që e ofron dhe ai që e merr një thirrje janë të dy nën detyrim përgjegjshmërie. Po citoj nga Plaku Xhejms E. Talmixh:

“Ata që i dhanë thirrjen... janë me po aq siguri përgjegjës për veprimet e tyre sa është edhe i thirruri për të tijën; dhe nga secili do të kërkohet llogari personale dhe e rreptë për kujdestarinë e vet, një raport i plotë për shërbimin apo shmangien, për përdorimin apo shpërdorimin e administrimit të besimit që u është dhënë.”<sup>7</sup>

Disa aspekte të priftërisë nuk lidhen me pozitën apo titullin. Autoriteti për të administruar një bekim priftërie, për shembull, varet vetëm nga shugurimi dhe denjësia. Zoti nuk do t’i ndalte bekimet për asnjë prej fëmijëve të Tij nga mungesa e një mbajtësi priftërie me thirrje të veçantë. Çdo Plak në Kishë mban të njëjtën priftëri si edhe Presidenti i Kishës.

Vëllezër, ju lutem mbani mend: shkalla më e lartë e lavdisë është e disponueshme për ju vetëm nëpërmjet atij urdhri të priftërisë që lidhet me besëlidhjen e re dhe të përjetshme të martesës (shih DeB 131:1–4). Prandaj,

### **Këshillë e veçantë**

Tani për një këshillë më të veçantë. **Bashkëshortë dhe baballarë:** me partneren tuaj të dashur, përcaktoni qëndrime në shtëpi. Krijoni një model lutjeje. Lutuni rregullisht dhe me zë për udhëheqësit tuaj të priftërisë dhe të organizatave ndihmëse, si për vendorët edhe për të përgjithshmit. Mënyrat tuaja të mirësjelljes në shtëpi dhe të nderimit në godinën kishtare do të kopjohen nga anëtarët e familjes suaj. I ndihmoni të dashurit tuaj të ndjekin procedurat e duhura kur kërkojnë drejtim. U mësoni se këshilla duhet të merret nga prindër dhe udhëheqës të besuar në nivel vendor, jo nga Autoritetet e Përgjithshme. Në dy dekadat e fundit, Presidencia e Parë ka dërguar në thelb të njëjtën letër gjashtë herë për të ripohuar atë politikë.

Baballarë, ju e kuptoni parimin e mbështetjes tek vetja në *vdekshmëri* dhe përpikuni të siguronit furnizime për një vit të depozituara në

shtëpi. Lutem gjithashtu të merrni parasysh nevojën për ushqim e mbështetje tek vetja në plan *shpirtëror* – jo vetëm për një vit, por për gjithë jetën – gjithashtu ‘të depozituar’ në shtëpi. Një baba i denjë duhet të ketë mundësinë e parë që të administrojë bekimet për anëtarët e familjes së tij. Me kalimin e kohës, bijtë e tij mund të tërheqin pastaj nga ai rezervuar shpirtëror, të denjë të administrojnë për vetë familjet e tyre dhe prindërit e tyre.

Tani të rinjve të cilët mbajnë Priftërinë Aarone (apo përgatitoren): nëse e nderoni atë dhe përgatiteni e jeni të denjë për thirrje për një mision, unë premtoj se ju do “të flisni në emër të Perëndisë Zotit” dhe do t’u sillni dritën e Tij shpirttrave kërkues. Për ata ju do të jeni si engjëll shërbyes, i kujtuar me dashuri për gjithmonë. (Shih DeB 13.)

Edhe pse në vazhdim do të flas për presidentët dhe peshkopët tanë shumë të dashur, parimet zbatohen tek të gjithë. Kur një që ju kryeson juve, vjen në një mbledhje ku ju po kryesoni, lutemi këshillohuni me të menjëherë për udhëzim. Sqaroni çfarë dëshiron ai. Sigurohuni të jepni kohën e duhur për një mesazh prej tij. Një ilustrim prekës u tregua një herë nga Plaku Xhejms E. Faust:

“Disa kohë përpara mësova për shqetësimin që ndienin anëtarët e një kunji në këtë luginë kur presidenca e kunjit të tyre u riorganizua. Zyrtari kryesues ishte një nga Apostujt më të nderuar dhe të pashoq në gjithë historinë e Kishës. [Plaku] LeGrand Riçards ishte atëherë në të nëntëdhjetat, por ishte i mprehtë dhe vigjilues. Gjatë konferencës, vendasi që ishin thirrur për të folur zunë shumicën e kohës. Si rrjedhim, Plakut Riçards i mbetën vetëm dhjetë apo pesëmbëdhjetë minuta për të folur. Çfarë bëri ai? Tejkaloj kohën? Jo. Ai dha një dëshmi të shkurtër dhe e mbylli mbledhjen në kohë.

Anëtarët e kunjit nuk donin domosdoshmërisht të tejkalohej koha... Ata u turbulluan, gjithsesi, sepse anëtarësia vendase, që do të kishte raste të tjera t’i dëgjonte udhëheqësit e saj vendorë, nuk do të kishte rast kurrë përsëri, dhe në fakt ashtu ndodhi, që të dëgjonte këtë Apostull të nderuar. Shkurt, folësit nuk e respektuan zyrtarin kryesues.”<sup>8</sup>

Kur ka folur një Autoritet i Përgjithshëm, askush nuk flet pas tij. Pasi mbledhja mbyllet, presidentët dhe peshkopët, qëndrojnë në krah të udhëheqësit të tyre të drejtpërdrejtë deri sa t’u jepet leje. Ai mund të ndiejë nevojën për mësimdhënie apo udhëzim shtesë. Dhe ju gjithashtu mund të parandaloni problemet. Për shembull, nëse një anëtar i drejton një pyetje udhëheqësit tuaj, që nuk duhet t’i drejtohet atij, ju jeni aty për t’u përgjigjur.

Tani për komente mbi këshillin e lartë të **kunjit**. Ai nuk ka president. Ai nuk ka autonomi dhe mblidhet, madje edhe kur është i ndarë në komitete, vetëm nga presidenca e kunjit. Edhe pse këshilltarë të lartë mund të jenë ulur sipas radhës së thirrjes së tyre në këshill, asnjë anëtar nuk ka parësi mbi të tjerët.

Në të kundërt, parësia nderohet midis Apostujve të shuguruar – madje dhe kur hyjnë apo dalin nga një dhomë. Presidenti Benson na tregoi këtë ngjarje:

“Disa [vite] përpara Plaku Heit i shfaqti një mirësjellje të veçantë Presidentit Romni kur ndodheshin në dhomën e sipërme në tempull. Presidenti Romni po mbetej prapa për diçka dhe [Plaku Heit] nuk donte të dilte nga dera përpara tij. Kur Presidenti Romni bëri shenjë [për të] që të shkonte përpara, Plaku Heit u përgjigj, ‘Jo, President shkoni ju përpara’.

Presidenti Romni u përgjigj me humorin e tij: ‘Si është puna, Dejvid? Ke frikë se mos vjedh ndonjë gjë?’ ”<sup>9</sup>

Një respekt i tillë nga një Apostull i ri për një të vjetër është shënuar në Dhiatën e Re. Kur Simon Pjetri dhe Gjoni Shumë i Dashuri vrapuan të hetonin lajmin se trupi i Zotit të tyre të kryqëzuar ishte nxjerrë nga varri, Gjoni, duke qenë më i ri dhe më i shpejtë, arriti i pari, por prapë nuk hyri brenda. Ai i la radhën Apostullit më të vjetër, që u fut i pari tek varri. (Shih Gjoni 20:2–6.) Vjetërsia në detyrën e Apostullit ka qenë prej shumë kohësh një mënyrë me të cilin Zoti zgjedh priftin e Tij të lartë kryesues.

### **Qortimi dhe pendimi**

Vëllezër, këto çështje janë të rëndësishme. Më se një shekull e gjysmë përpara, Zoti bëri një

qortim të mprehtë për popullin e Tij. Këto janë fjalët e Tij:

“Vërtet, dënimi ardhë mbi ju, që jeni caktuar të udhëhiqni Kishën time, ... dhe gjithashtu mbi Kishën; dhe do të ketë nevojë për pendim dhe reformim midis jush, në të gjitha gjërat, në shembullin tuaj përpara Kishës dhe përpara botës, në të gjitha sjelljet, shprehitë e zakonet dhe përshëndetjet midis njëri-tjetrit; duke i dhënë çdo njeriu respektin sipas detyrës, thirrjes dhe priftërisë në të cilën Unë, Zoti, ju kam caktuar dhe shuguruar.”<sup>10</sup>

Nëse ndonjë midis nesh bën gabimin e trajtimit si të parëndësishme të këtyre gjërave që janë të shenjta, ne mund të pendohemi dhe të vendosim të nderojmë priftërinë dhe ata të cilëve Zoti u ka besuar çelësat e saj.

Vëllezër, gjithë njerëzimit ne i shpallim këto të vërteta të përjetshme: “Priftëria Melkizedeke mban të drejtën e kryesimit dhe ka fuqi e autoritet mbi gjithë detyrat në kishë, në të gjitha epokat e botës” (DeB 107:8). Ky pushtet mban “çelësat e të gjitha bekimeve shpirtërore të kishës” (DeB 107:18). E nderofshim plotësisht atë priftëri, unë lutem në emrin e Jezu Krishtit, amen.

### Shënime

1. Lexuesi mund të ketë dëshirë të këshillohet me James E. Talmage, “The Honor and Dignity of Priesthood”, në James R. Clark, përmb., *Messages of the First Presidency of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints*, vëllimi 6. (Salt Lake City: Bookcraft, 1965–1975), 4:305–309.
2. Presidenti Xhorxh Q. Kenën (George Q. Cannon) ka thënë: “[Nderimi i Presidentit të Kishës] do të na bëjë që t’i afrohem me shumë Atit dhe të jetojmë në mënyrë të tillë që të marrim vetë zbulesa prej tij, që njohja e Shpirtit do të jetë në zemrat tona, që zëri i Bariut të vërtetë do të njihet nga veshët tanë, që kur ta dëgjojmë ne do ta njohim atë... Ky është privilegj i shenjtorëve të ditëve të mëvonshme dhe burri dhe gruaja në këtë Kishë, që nuk jeton në mënyrë që ta gëzojë këtë privilegj, nuk do të arrijë të

jetë ai që duhet të jetë” (në *Journal of Discourses*, 19:110).

3. “The Unique Commission of a General Authority” (fjalë e mbajtur në një mbledhje trajnimit për Autoritetet e Përgjithshme, 2 tetor 1985), f. 5.
4. “Commission”, f. 1.
5. Në Conference Report, tetor 1992, f. 77; ose *Ensign*, nëntor 1992, f. 54.
6. *Teachings of the Prophet Joseph Smith*, përzgjedh. Joseph Fielding Smith (Salt Lake City: Deseret Book Co., 1938), f. 21.
7. *Messages of the First Presidency*, 4:306.
8. James E. Faust, “A Seventy Is a General Authority” (fjalë e mbajtur në një sesion të posaçëm trajnimit për Të Shtatëdhjetët, 29 shtator 1987), f. 4.
9. “Commission”, f. 9.
10. *History of the Church*, 2:177.

### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Nëse po kryesoni një mbledhje dhe një autoritet, që kryeson mbi ju, vjen papritur në mbledhje, çfarë duhet të bëni?
- Analizoni deklaratën e mëposhtme: “Udhëheqësit vendorë të Kishës janë thirrur në pozita edhe për atë çka mund të ndihmojnë edhe për atë çka mund të mësojnë nëpërmjet shërbimit të tyre.”
- Çfarë kuptohet me *çelësa të priftërisë*. Kush përcakton se kush i mban dhe çfarë çelësash mban?
- Çfarë arsye mund të shihni për çdo zë në listën e ‘*bëj dhe mos bëj*’ të Plakut Nelson?
- Cila nga deklaratat e mëposhtme mendoni se është e vërtetë? (Shpjegoni përgjigjet tuaja.)
  - Udhëheqësit e priftërisë janë thirrur të udhëheqin njerëzit.
  - Udhëheqësit e priftërisë janë thirrur t’u shërbejnë njerëzve.
  - Udhëheqësit e priftërisë janë njerëz normalë si edhe ju dhe unë.

- Diskutoni rolin udhëheqës të grave në Kishë.
- Çfarë cilësish kanë nënat e mira që mundën të ndikojnë tek fëmijët me mënyra pozitive?  
Çfarë roli udhëheqës luan gratia në mbretërinë e Zotit?
- Diskutoni Alma 56:47–48 lidhur me ndikimin e nënave tek fëmijët e tyre.
- Përmendni emrat e motrave që kanë pasur ndikim pozitiv në jetën tuaj (për shembull udhëheqëset e Fillores, mësueset e Shkollës të së Dieles, apo mësueset e vizitave) dhe përshkruani përjetimet tuaja me to.

# NDIHMJA QË TË TJERËT TË PËRFSHIHEN ME ZELL

*“Sepse vini re, nuk është e përshtatshme që unë duhet të urdhëroj për gjithçka; sepse ai që detyrohet në gjithçka, po ai është një shërbëtor i ngathët dhe jo i mençur; si rrjedhim ai nuk merr shpërblim.*

*Në të vërtetë unë them, njerëzit duhet të përfshihen me zell në një kauzë të mirë dhe të bëjnë shumë gjëra me vullnetin e tyre të lirë e të shkaktajnë shumë drejtësi;*

*Sepse është në ta fuqia, me anë të së cilës ata janë veprues për veten” (DeB 58:26–28).*

## PARIMI I UDHËHEQJES

Udhëheqësve mund t’u duhet t’i ndihmojnë ata, të cilëve u shërbejnë, që të “përfshihen me zell në një kauzë të mirë”.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Mësuesit mund të kenë nevojë t’i nxisin ata, të cilëve u shërbejnë, të bëhen më shumë si Krishti dhe të ndihmojnë të ndërtohet mbretëria e Perëndisë.

### **KONCEPT 1. UDHËHEQËSIT MUND TË KENË NEVOJË TË INKURAJONJË ATA, TË CILËVE U SHËRBEJNË, TË BËHEN MË SHUMË SI KRISHTI DHE TË NDIHMOJNË TË NDËRTOHET MBRETËRIA E PERËNDISË.**

#### KOMENT

Roli i udhëheqësve të Kishës dhe të familjes është të ndihmojnë njerëzit të bëhen më shumë si Jezu Krishti dhe të ndërtojnë mbretërinë e Perëndisë. Në mënyrë ideale secili do të “përfshihe[j] me zell” në këto aktivitete, duke bërë “shumë gjëra me vullnetin e [vet] të lirë” (DeB 58:27). Në praktikë udhëheqësit shpesh duhet të sigurojnë një farë motivimi.

Të motivosh do të thotë të nxitësh, të frymëzosh, të aktivizosh, të ndikosh, të shtysh apo të gjallërosh dikë për vepra të mira. Shih listën e Plakut Dallin H. Ouks për motivet që kanë njerëzit për të shërbyer (f. 41–42). Udhëheqësit e Kishës dhe të familjes mund t’u drejtohen disa prej këtyre motiveve, kur i ndihmojnë njerëzit të përfshihen me zell në zbatimin e parimeve të ungjillit.

Plaku Xhin R. Kuk, anëtar i Të Shtatëdhjetëve, shkroi: “Dashuria është një motiv i shenjtë; ajo motivon Zotin dhe kështu duhet të na motivojë gjithashtu edhe neve. Veçanërisht është kështu kur është fjala për familjet tona” (*Raising Up a Family to the Lord* [1993], f. 176).

Udhëheqësit shpesh mund t’i motivojnë ata, të cilët i udhëheqin, thjesht duke u mësuar të vërtetat e ungjillit. Shumë nga ne janë të motivuar të bëjnë mirë nga besimi ynë në Atin Qiellor dhe në planin e Tij të shpëtimit. Plaku Marion G. Romni, që ishte atëherë anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, na mësoi: “Besimi i një shenjtorit të ditëve të mëvonshme se ardhja e dytë e Krishtit është e afërt, duhet ta motivojë të ndjekë me zell më të madh planet e zbuluara të Zotit për ndalimin e luftës dhe eliminimin e varfërisë dhe të ndotjes. Ai duhet të shtojë dëshirën e tij për arsimim, veçanërisht për njohuri për Perëndinë dhe jetën e përjetshme” (në “*Gospel Forum*”, *Ensign*, janar 1971, f. 16).

Po kështu, udhëheqësit mund të motivojnë duke i nxitur ata që udhëheqin që të studiojnë

shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve modernë. Plaku Parli P. Prat, që ishte anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, shkroi:

“Në moshën shtatëvjeçare nëna më dha mësim për të lexuar në shkrimet e shenjta; unë lexova për Jozefin në Egjipt, – ëndrrat e tij, skllavërinë e tij, tundimin dhe ekzaltimin e tij; mirësinë dhe dashurinë e tij për babanë dhe vëllezërit. E gjithë kjo më frymëzoi me dashuri dhe me ndjenjat më fisnike që mund të jenë futur ndonjëherë në zemrën e njeriut.

Lexova për Davidin dhe Goliathin; për Saulin dhe Samuelin, për Samsonin dhe filistejtë – të gjitha këto më frymëzuan me urrejtje për aktet e keqbërësve dhe me dashuri për njerëzit e mirë dhe aktet e tyre.

Pas kësaj lexova për Jezusin dhe Apostujt e tij, dhe ou, sa i desha ata! Sa doja të bija tek këmbët e Jezusit; ta adhuroja apo të ofroja jetën time për të tijën.

Në moshën rreth dymbëdhjetë vjeç lexova për ringjalljen e parë, siç është përshkruar nga Gjoni, Apostulli, në kapitullin 20 të Zbulesës së tij; se si ata, martirët e Jezusit, dhe ata që mbajtën urdhërimet e Tij do të jetonin dhe mbretëronin me Krishtin një mijë vjet, ndërsa pjesa tjetër e të vdekurve nuk do të jetonin përsëri, derisa të kalonin një mijë vjet. Oh, çfarë përshtypje bëri kjo në mendjen time; unë u tërhoqa për të pushuar pas një mbrëmjeje kaluar kështu; por nuk mund të flija. Unë ndieja një dëshirë të madhe dhe ankth të papërshkrueshëm për t'i siguruar vetes një pjesë nga një ringjallje aq e lavdishme” (*Autobiography of Parley P. Pratt* [1985], f. 2).

I formuar mbi përjetime të tilla me Biblën, Plaku Prat u rrit për t'u bërë një nga udhëheqësit më të mëdhenj të Kishës në këtë periudhë ungujillore.

Profeti Jozef Smith i paralajmëroi udhëheqësit për “sundim të padrejtë” apo përdorim të padrejtë të autoritetit (DeB 121:39). “Kur përpiqemi t'i mbulojmë mëkatet tona ose të kënaqim krenarinë tonë, ambicien tonë të kotë ose të ushtrojmë kontroll apo sundim, apo detyrim mbi shpirtrat e fëmijëve të njerëzve, në çfarëdo shkallë padrejtësie, vini re, qiejt tërhiqen;

Shpirti i Zotit hidhërohet; dhe kur ai tërhiqet, Amen priftërisë ose autoritetit të atij njeriu...

Asnjë fuqi apo ndikim nuk mund ose nuk duhet të mbahet me anë të priftërisë, veçse nëpërmjet bindjes, nëpërmjet durimit, nëpërmjet mirësjelljes e zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pashtirur;

Nëpërmjet mirësisë dhe diturisë së pastër, të cilat do ta zgjerojnë shumë shpirtin, pa hipokrizi dhe pa mashtrim” (vv. 37, 41–42).

Udhëheqësit mund të përdorin shpërblime nga jashtë për të motivuar por këtë duhet ta bëjnë me kujdes. Një shpërblim nga jashtë është diçka që nuk lidhet drejtpërdrejt me atë çka shpërblehet, për shembull dhënia e parave një personi për leximin e shkrimeve të shenjta. Shpërblime të tilla mund të sjellin rezultate, por nëse përdoren pa urtësi, ato mund të jenë të dëmshme për pjekurinë shpirtërore të një personi. Lavdërimi i tepruar mund të paraqitet si i pasinqertë apo manipulues. Shpërblimet nga jashtë mundet gjithashtu të ulin motivimin e brendshëm të një personi.

Udhëheqësit mund të motivojnë duke treguar ngjarje dhe mësim nga Jezu Krishti. Presidenti Harold B. Li, që ishte atëherë Këshilltar në Presidencinë e Parë, renditi mënyrat e mëposhtme se si Jezusi u bë shembull i parimeve të mësimdhënies së mirë dhe ato zbatohen për udhëheqjen gjithashtu:

“1. Mësuesi kishte një dashuri të vërtetë për Perëndinë dhe fëmijët e Perëndisë.

2. Ai pati një besim të zjarrtë në misionin e tij për t'i shërbyer dhe për ta shpëtuar njerëzimin.

3. Ai pati një kuptim të qartë dhe të dhimbsur për qeniet njerëzore dhe nevojat e tyre jetike.

4. Ai ishte një nxënës i përhershëm, serioz. Ai e njihnte ‘ligjin dhe profetët’. Ai e dinte historinë dhe gjendjen shoqërore të kohës së tij.

5. Ai mund ta dallonte të vërtetën dhe nuk bënte lëshime për mbrojtjen e saj.

6. E folura e Tij e thjeshtë i mundësoi të arrihte dhe të mbante dëgjues nga çdo grup dhe gjendje shoqërore.

7. Aftësia e tij krijuese i bëri mësimet me vlerë për të gjitha kohërat.

8. Ai i udhëhoqi njerëzit tek uria dhe etja për drejtësi.

9. Ai frymëzoi mirësi aktive – një dëshirë për të zbatuar ungjillin në një shërbim lartësues.

10. Ai demonstroi besimin e tij duke e jetuar në mënyrë të përhershme dhe me kurajë” (“And Ye Shall Teach”, *Ensign*, shtator 1971, f. 5).

### IDE MËSIMORE

Shpjegoni që udhëheqësit shpesh kanë nevojë të ndihmojnë njerëzit të zhvillohen në ungjill dhe të mësojnë të shërbejnë në mënyrë rezultative në thirrjet e tyre. Diskutoni disa nga motivet që mund të kemi për të shërbyer, edhe si udhëheqës edhe si pasues, dhe i rendisni ato në dërrasë. I ftoni studentët t’i rendisin ato nga më pak i rëndësishmi deri tek më i rëndësishmi dhe diskutoni arsyet e tyre.

Diskutoni Doktrina e Besëlidhje 121:34–46. Përcaktoni motivet dhe sjelljet në këto vargje që përbëjnë një dominim të padrejtë, si dhe ato që karakterizojnë një udhëheqje të drejtë. Theksoni rëndësinë e qenies në frekuencë me Frymën e Shenjtë.

Diskutoni disa anë të dobëta të përdorimit të shpërblimeve të jashtme në motivimin e njerëzve për të jetuar sipas parimeve të ungjillit.

Rendisni mënyrat se si Jezu Krishti tregoi udhëheqje të përsosur. I ftoni studentët të zbatojnë karakteristikat pozitive të diskutuara në këto mësimë në rolet e tyre udhëheqëse.

### IDE MËSIMORE

Lexoni apo tregoni ngjarjen e Plakut Hju B. Braun me kaçubet e farave nga seksioni i mëposhtëm Burime për Mësuesin. U thoni studentëve të analizojnë motivet në jetën e Plakut Braun përpara dhe pas kësaj përvoje.

### BURIME PËR MËSUESIN



**Plaku Hju B. Braun**

*Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve*

“*The Currant Bush*”, New Era, janar 1973, f. 14–15; *shih gjithashtu* New Era, prill 2001, f. 12–14

Ju ndonjëherë pyesni veten nëse Zoti e di vërtet çfarë duhet të bëjë me ju. Ju ndonjëherë pyesni veten nëse e dini më mirë se ai se çfarë duhet të bëni e të bëheni. Unë pyes veten nëse mund t’ju tregoj një ngjarje që e kam treguar disi shpesh në Kishë. Është një ngjarje më e vjetër se ju. Është një pjesë nga vetë jeta ime dhe e kam treguar atë në shumë kunjë dhe misione. Ajo ka të bëjë me një incident në jetën time kur Perëndia më tregoi se *ai di më mirë se kushdo*.

Jetoja në Kanada. Kisha blerë një fermë. Ajo kishte nevojë për rregullime. Një mëngjes dola dhe sharrova një kaçube ribesesh. Ajo ishte ngjitur mbi 1,8 metra lartësi. Ajo po bëhej e gjitha dru. Nuk kishte as lule dhe as ribese. Unë isha rritur në një fermë frutash në Solt-Lejk përpara se të shkoja në Kanada dhe e dija se çfarë duhej bërë me atë kaçube ribesesh. Kështu, mora gërshërët krasitëse dhe shkova tek bima, dhe e preva, dhe e krasita, dhe e shkurtova përsëri, deri sa nuk kishte mbetur tjetër përveç një mase cunjesh. Sapo zbardhte dhe mendova se pashë në majë të secilit nga këto cungje të vegjël diçka që ngjante si lot dhe mendova se kaçubja e ribeseve po qante. Isha një lloj naivi (dhe unë ende nuk e kam kapërcyer krejt këtë) dhe e vështrova, dhe buzëqesha, dhe thashë: “Përse po qan?” A e dini, mendova se dëgjova kaçuben e ribeseve të fliste. Dhe mendova se e dëgjova të thoshte: “Si arrite të ma bësh këtë? Unë po bëja një rritje të mrekuillueshme. Unë isha thuajse po aq e madhe sa pema e hijes dhe pema e frutave që janë brenda gardhit dhe tani ti më shkurtove. Çdo bimë në kopsht do të më përçmojë, sepse nuk bëra atë që duhet të kisha bërë. Si arrite të ma bësh këtë? Unë mendova se ti ishe kopshtari këtu.” Kjo ishte ajo që mendova se dëgjova të thoshte kaçubja e ribes dhe e mendova aq shumë sa që u përgjigja. Thashë: “Shiko, kaçube e vogël e ribeseve, unë jam kopshtari këtu dhe unë e di se si duhet të jesh ti. Unë nuk doja që ti të jesh pemë frutore apo pemë për hije. Unë dua të jesh një kaçube ribesesh dhe një ditë, kaçube e vogël e ribeseve, kur të jesh ngarkuar me fruta, ti do të thuash: ‘Faleminderit Z. Kopshtar, që më do aq sa të më shkurtosh, që kujdesesh aq për mua sa të më plagosësh. Faleminderit, Z. Kopshtar.’ ”

Kaloi kohë. Kaluan vite dhe unë u gjenda në Angli. Komandoja një repart kavalerie në

Ushtrinë Kanadeze. Kisha bërë një përparim disi të shpejtë në karrierë dhe kisha gradën e oficerit madhor në Ushtrinë Britanike Kanadeze. Dhe isha krenar për pozitën time. Dhe kishte një mundësi për mua që të bëhesha gjeneral. I kisha marrë të gjitha provimet. Unë kisha përparësinë. Kishte vetëm një burrë midis meje dhe asaj që për dhjetë vite kisha shpresuar ta merrja, detyrën e gjeneralit në Ushtrinë Britanike. Unë krekosesha nga krenaria. Dhe ky burrë i vetëm ra në betejë dhe unë mora një telegram nga Londra. Atje shkruhej: “Paraqituni në zyrën time nesër në mëngjes në orën 10:00”, nënshkruar nga Gjeneral Turner komandues i të gjitha forcave kanadeze. Thirra shërbyesin, shërbëtorin tim personal. I thashë të më lustronte kopsat, të më fshinte kapelen dhe këpucët dhe të më bënte të dukesh si gjeneral, sepse ashtu do të bëhesha. Ai bëri sa mundi me ato që duhej të merrej dhe unë shkova në Londër. Hyra me saktësi në zyrën e gjeneralit dhe e përshëndeta gjallërisht, dhe ai më ktheu të njëjtën lloj përshëndetjeje që zakonisht jep një oficer epror – një lloj “Hapu nga rruga, zvarranik!” Ai tha: “Uluni, Braun.” Pastaj tha: “Më vjen keq që nuk mund ta bëj emërimin. Ju e keni fituar të drejtën. Ju i keni kaluar të gjitha provimet. Ju e keni përparësinë. Ju keni qenë oficer i mirë, por unë nuk mund t’ju emëroj. Ju duhet të ktheheni në Kanada dhe të bëheni oficer trajnimi dhe oficer transporti. Dikush tjetër do të bëhet gjeneral.” Ajo për të cilën kisha shpresuar dhe isha lutur për dhjetë vite papritmas më rrëshqiti nga duart.

Pastaj ai shkoi në dhomën tjetër për t’u përgjigjur në telefon dhe unë përfitova nga privilegji i ushtarit për të parë mbi tavolinën e tij. Pashë fletën me të dhënat e mija vetjake. Pikërisht në fund të saj me germa shtypi të mëdha e të theksuara ishte shkruar: “KY PERSON ËSHTË MORMON”. Ne nuk ishim shumë të pëlqyeshëm në ato kohë. Kur e pashë atë, e kuptova përse nuk isha emëruar. Unë tashmë kisha gradën më të lartë nga çdo mormon në Ushtrinë Britanike. Ai u kthye dhe tha: “Kjo është e gjitha, Braun”. Unë e përshëndeta përsëri, por jo aq gjallërisht. E përshëndeta për të bërë detyrën dhe dola jashtë. Mora trenin dhe u nisa për në qytetin tim, 220 km larg, me zemër të thyer, me helm në shpirt. Dhe çdo kërcitje e rrotave në shina dukej

sikur thoshte: “Ti je dështak. Ty do të të quajnë frikacak kur të shkosh në shtëpi. Ti ngrite gjithë ata djem mormonë për t’iu bashkuar ushtrisë dhe pastaj dredhove për në shtëpi.” E dija se çdo të merrja dhe kur shkova tek çadra ime, isha aq i hidhëruar sa që i hodha kapelen dhe rripin e mesit mbi krevatin portativ. Shtrëngova grushtet dhe i tunda drejt qiellit. Thashë: “Si mund të ma bësh këtë, Perëndi? Unë kam bërë çdo gjë që të përgatitem për këtë. Nuk ka gjë që mund ta kisha bërë – që duhet ta kisha bërë – dhe që nuk e kam bërë. Si mund të ma bësh këtë?” Isha në vlerin e hidhësisë.

Dhe pastaj dëgjova një zë dhe dallova tonin e këtij zëri. Ishte vetë zëri im dhe zëri tha: “Unë jam kopshtari këtu. Unë e di se çfarë duhet të bësh ti.” Hidhësia m’u largua nga shpirti dhe rashë në gjunjë pranë krevatit portativ për të kërkuar falje për mosmirënjohjen dhe zemërimin tim. Ndërsa isha në gjunjë dëgjova një këngë që këndohej në tendën përbri. Një numër djemsh mormonë takoheshin rregullisht çdo të martë në mbrëmje. Unë zakonisht takohesha me ta. Ne uleshim në dysheme dhe bënim një Shoqërim Përmirësimi të Ndërsjellët. Ndërsa isha atje në gjunjë, duke u lutur për falje, dëgjova zërat e tyre që këndonin:

“Ndoshta s’do t’jet’ në mal’n e lart  
Ose n’detin me stuhi,  
ndoshta s’do t’jet’ n’ betej’n e zjarrt’  
që Zoti mua do më th’rras’.  
Por në se me një zë t’vogël më thërret  
në rrugë që un’ s’i di,  
përgjigjem “Zot, jetën time ke ti,  
do t’shkoj ku ti do që të shkoj.”  
(*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 46.)

Unë u çova nga gjunjëzimi një njeri i përlulur. Dhe tani, thuajse pesëdhjetë vjet më vonë, unë shoh nga ai dhe them: “Ju faleminderit, Z. Kopshtar, që më shkurtove, që më do aq sa të më plagosësh.” Unë shoh tani se ishte urtësi që të mos bëhesha gjeneral atëherë, sepse po të isha bërë, do të kisha qenë oficeri madhor për të gjithë Kanadanë perëndimore, me një pagë të madhe për gjithë jetën, një vend për të jetuar dhe një pension kur të mos vlej më për punë, por do t’i kisha rritur gjashtë vajzat dhe dy djemtë e mi në kazerma ushtrie. Ata pa dyshim



do të ishin martuar jashtë Kishës dhe mendoj se nuk do të kisha arritur kushedi çfarë. Unë nuk kam arritur ndonjë gjë të madhe edhe kështu, por kam bërë më mirë sesa po të më kishte lejuar Zoti të shkoja në rrugën që doja unë.

Unë doja t'ua tregoja këtë histori që përsëritet shpesh, pasi ka shumë nga ju, që jeta do t'i vërë përpara disa përvoja shumë të vështira: zhgënjim, zemërthyerje, zi, disfatë. Ju do të provoheni dhe shqyrtoheni për të treguar se të çfarë cilësie jeni. Unë thjesht dua që ta dini, që po të mos merrni atë që mendoni se duhet ta merrni, kujtohuni që: “Perëndia është kopshtari këtu. Ai e di se çfarë do që ju të jeni.” Nënshtrijani veten vullnetit të tij. Jini të denjë për bekimet e tij dhe ju do të merrni bekimet e tij.

#### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Cilat ishin rrethanat që motivuan Plakun Braun të ndryshonte përparësitë e tij?
- Çfarë parimesh mund të mësojmë nga biseda e Plakut Braun për vetë jetën tonë?
- Cilat qëndrime na ndihmojnë që ta lejojmë Zotin t'i japë formë jetës tonë?
- Si mundet “një qëndrim mirënjohjeje” të na ndihmojë të jemi udhëheqës të mirë?



**Motra Margaret D. Nadold**

*Presidente e Përgjithshme e Të Rejave*

*“The Joy of Womanhood”, në Conference Report, tetor 2000, f. 14–17; ose Ensign, nëntor 2000, f. 14–16*

#### Gratë besnike kanë një mision të lavdishëm

Është një bekim i mrekullueshëm të jesh bijë e Perëndisë sot. Ne ndiejmë plotësinë e ungjillit të Jezu Krishtit. Ne jemi bekuar të kemi priftërinë e rivendosur në tokë. Ne udhëhiqemi nga një profet i Perëndisë që mban të gjithë çelësat e priftërisë. Unë e dua dhe e nderoj Presidentin Gordon B. Hinkli dhe të gjithë vëllezërit tanë që mbajnë denjësisht priftërinë.

Unë frymëzohem nga jeta e grave të mira dhe besnike. Që nga fillimi i kohës Zoti u ka dhënë atyre një besim të rëndësishëm. Ai na ka dërguar

në tokë për një kohë të tillë si kjo për të kryer një mision të madh dhe të lavdishëm. Doktrina dhe Besëlidhje na mëson se madje përpara se të lindeshim, ne ishim midis atyre që “morën mësimet e para në botën e shpirtave dhe u përgatitën për të ardhur në kohën e duhur të Zotit për të punuar në vreshtin e tij për shpëtimin e shpirtave të njerëzve” (DeB 138:56). Çfarë kuptimi të mrekullueshëm që na jep për synimin tonë në tokë.

Atje ku shumë është dhënë, shumë kërkohet. Ati ynë Qiellor u kërkoi bijave të Tij të ecin në virtut, të jetojnë në drejtësi në mënyrë që ne të mund të përmbushim misionin e jetës tonë dhe qëllimet e Tij. Ai do që ne të jemi të suksesshëm dhe Ai do të na ndihmojë kur e kërkojmë ndihmën e Tij.

#### Grave u janë dhënë cilësi të veçanta

Që gratë u lindën në këtë tokë si femra, kjo ishte përcaktuar shumë përpara lindjes në vdekshmëri, kur bëheshin dallimet hyjnore të mashkullit dhe femrës. Unë e dua qartësinë e mësimëve të Presidencisë së Parë dhe të Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve në proklamatin mbi familjen, ku ata deklarojnë: “Gjinia është një karakteristikë thelbësore e identitetit dhe qëllimit individual të jetës para lindjes, të jetës së vdekshme dhe asaj të përjetshme.”<sup>1</sup> Nga kjo deklaratë mësojmë se çdo vajzë që femërore dhe femër në shpirt shumë kohë përpara lindjes së saj në vdekshmëri.

Perëndia i dërgoi gratë në tokë me disa cilësi në masë më të madhe. Duke u folur të rejave, Presidenti Faust vërejti se feminiteti “është zbulimi hyjnor i njerëzimit. Ai gjen shprehje në aftësinë tuaj ... për të dashuruar, në shpirtshmërinë, delikatesën, shkëlqimin, ndjeshmërinë, kreativitetin, magjepsjen, butësinë, dinjitetin dhe forcën tuaj të qetë. Ai shfaqet ndryshe në secilën vajzë apo grua, por secila ... e ka atë. Feminiteti është pjesë e bukurisë suaj të brendshme.”<sup>2</sup>

#### Kujdesi për paraqitjen e jashtme

Paraqitja jonë e jashtme është pasqyrim i asaj çka jemi në brendësi. Jeta jonë pasqyron atë që ne kërkojmë. Dhe nëse me gjithë zemrën tonë vërtet kërkojmë të njohim Shpëtimtarin dhe të jemi më shumë si Ai, ne do të jemi, sepse Ai është Vëllai ynë hyjnor, i përjetshëm. Por Ai

është më shumë se kaq. Ai është Shpëtimtari ynë i çmuar, Shëlbuesi ynë i dashur. Ne pyesim me Almën e lashtë: “A keni marrë shëmbëlltyrën e tij në pamjen tuaj?” (Alma 5:14).

Ju mund t’i dalloni nga pamja e jashtme gratë mirënjohëse që janë bija të Perëndisë. Këto gra e kuptojnë kujdestarinë e vet për trupin dhe e trajtojnë atë me dinjitet. Ato kujdesen për trupin e tyre ashtu si për një tempull të shenjtë, sepse e kuptojnë mësimin e Palit: “A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju?” (1 Korintasve 3:16).

Gratë që duan Perëndinë nuk do ta shpërdorin a shformonin kurrë me mbishkrime një tempull. As do t’i linin hapur dyert e asaj ndërtese të shenjtë dhe të përkushtuar, duke ftuar botën ta vështronte. Madje sa më shumë i shenjtë është trupi, për këtë ai nuk u bë nga njeriu. Ai u bë nga Perëndia. Ne jemi kujdestarët, mbajtësit e pastërtisë dhe dëlirësisë me të cilat ai erdhi nga qielli. “Në qoftë se dikush e prish tempullin e Perëndisë, Perëndia do ta prishë atë, sepse tempulli i Perëndisë, i cili jeni ju, është i shenjtë” (1 Korintasve 3:17).

Bijat mirënjohëse të Perëndisë e mbrojnë me kujdes trupin e tyre, sepse ato e dinë se ai është burimi i jetës dhe ato e nderojnë jetën. Ato nuk e zbulojnë trupin e tyre për të siguruar favore nga bota. Ato ecin me thjeshtësi për të qenë të favorizuara nga Ati i tyre Qiellor, sepse e dinë që Ai i do ato shumë.

### **Shërbejuni të tjerëve**

Ju mund t’i dalloni nga qëndrimi gratë mirënjohëse që janë bija të Perëndisë. Ato e dinë se porosia e engjëjve u është dhënë grave dhe ato dëshirojnë t’i përgjigjen porosisë së Perëndisë për t’i dashur fëmijet e Tij dhe për t’u shërbyer, për t’u mësuar doktrinat e shpëtimit, për t’i ftuar në pendim, për t’i shpëtuar në rrethana të rrezikshme, për t’i drejtuar në kryerjen e punës së Tij, për të dhënë mesazhin e Tij.<sup>3</sup> Ato e kuptojnë se ato mund t’i bekojnë fëmijët e Atit në shtëpitë e lagjet e tyre dhe përtej. Gratë që janë mirënjohëse që janë bija të Perëndisë i sjellin lavdi emrit të Tij.

### **Lartësoni dhuntitë**

Ju mund t’i dalloni nga aftësitë gratë mirënjohëse që janë bija të Perëndisë. Ato plotësojnë potencialin e tyre hyjnor dhe lartësojnë dhuntitë e tyre dhënë prej Perëndisë. Ato janë gra të afta, të forta që bekojnë familje, u shërbejnë të tjerëve dhe kuptojnë që “lavdia e Perëndisë është inteligjencë” (DeB 93:36). Ato janë gra që përqafojnë vlerat e përjetshme me qëllim që të jenë gjithçka që Ati ynë do që ato të jenë. Profeti Jakob foli për disa nga ato virtyte kur tha për ndjenjat e tyre se ato “janë jashtëzakonisht të buta dhe të dëlira dhe të brishta para Perëndisë, gjë e cila është e këndshme ndaj Perëndisë” (Jakobi [LiM] 2:7).

### **Nderoni amësinë**

Ju mund t’i dalloni nga nderimi për amësinë gratë mirënjohëse që janë bija të Perëndisë, madje edhe kur ky bekim u është privuar për një kohë. Në ato rrethana, ndikimi i drejtë i tyre mund të jetë një bekim në jetën e fëmijëve që ato i duan. Mësimet e tyre shembullore mund t’i bëjnë jehonë zërit të një shtëpie besnike dhe të përforcojnë të vërtetën në zemrat e fëmijëve që kanë nevojë për një dëshmi tjetër.

Bijat mirënjohëse të Perëndisë e duan Atë dhe u mësojnë fëmijëve të tyre ta duan Atë pa rezerva dhe pa mëri. Ato janë si nënat e ushtrisë rinore të Helamanit, që patën një besim të tillë të madh dhe “nënat u kishin mësuar se, në qoftë se nuk do të dyshonin, Perëndia do t’i shpëtonte” (Alma 56:47).

Kur vëreni nëna të mira dhe të buta në veprim, ju shihni gra me forcë të madhe. Familjet e tyre mund të ndiejnë shpirtin e dashurisë dhe të respektit, dhe të sigurisë, kur ata janë pranë tyre, ndërsa ato kërkojnë shoqërimin nga Fryma e Shenjtë dhe drejtimin nga Shpirti i Tij. Ato bekohen nga urtësia dhe gjykimi i mirë i tyre. Bashkëshortët dhe fëmijët, jetën e të cilëve ato bekojnë, do të ndihmojnë në qëndrueshmërinë e shoqërive kudo mbi këtë botë. Bijat mirënjohëse për Perëndinë mësojnë të vërteta nga nënat dhe gjyshet, dhe hallat e tezet e tyre. Ato u mësojnë bijave të tyre artin e gëzueshëm të krijimit të një shtëpie. Ato kërkojnë një edukim të shkëlqyer për fëmijët e tyre dhe kanë etje për njohuri për vete. Ato u ndihmojnë fëmijëve të tyre të zhvillojnë

aftësi që mund t'i përdorin për t'u shërbyer të tjerëve. Ato e dinë se rruga që kanë zgjedhur nuk është rruga e lehtë, por e dinë se ajo i meriton absolutisht përpjekjet e tyre më të mira.

Ato kuptojnë çfarë donte të thoshte Plaku Nil A. Maksuell kur tha: “Kur historia e vërtetë e njerëzimit të jetë shpalosur tërësisht, a do të karakterizohet ajo nga jehonat e zjarrit të armëve apo nga tingulli formues i ninullave? Nga armëpushimet e mëdha të ushtarakëve apo nga pajtimi prej grave në shtëpitë dhe lagjet? A do të provohet se ajo që ndodhi në djepet dhe në kuzhinat, është më e pushtetshme se ajo që ndodhi nëpër kongrese?”<sup>4</sup>

Bijat e Perëndisë e dinë se është natyra ushqyese e grave ajo që mund të sjellë bekime të përhershme dhe se ato jetojnë për ta kultivuar këtë dhunti hyjnore. Sigurisht kur një grua ndëron amësinë, fëmijët e saj do të rriten dhe do ta quajnë atë fatlume (shih Fjalët e Urta 31:28).

### Jo si gratë e botës

Gratë e Perëndisë nuk mund të jenë kurrë si gratë e botës. Bota ka boll gra që janë të ashpra; ne kemi nevojë për gra që janë buta. Ka boll gra që janë të vrazhda; ne kemi nevojë për gra që janë të dashura. Ka boll gra që janë të pasjellshme; ne kemi nevojë për gra që janë edukuara. Ne kemi boll gra me famë dhe pasuri; ne kemi nevojë për më shumë gra të besimit. Ne kemi boll lakmi; ne kemi nevojë për më shumë mirësi. Ne kemi boll kotësi; ne kemi nevojë për më shumë virtyt. Ne kemi boll masivitet; ne kemi nevojë për më shumë pastërti.

Oh, sa lutemi që çdo e re të rritet duke mishëruar të gjitha gjërat e mrekullueshme që i përkasin. Ne lutemi që nëna dhe babai i saj t'i tregojnë asaj rrugën e drejtë. Nderofshin bijat e Perëndisë priftërinë dhe mbështetshin mbajtësit e denjë të priftërisë. Kuptofshin ato vetë aftësinë e tyre të madhe për forcë në virtytet e përjetshme, që disa do t'i përqeshnin në një botë moderne, të çliruar për gratë.

### Kuptoni dhe ushqeni potencialin

Shumë nëna dhe baballarë e kuptojnë potencialin e madh për mirë që bijat e tyre kanë trashëguar nga shtëpia e tyre qiellore. Ne duhet ta ushqejmë butësinë e tyre, natyrën e tyre edukuese, shpirtshmërinë dhe ndjeshmërinë e tyre

të brendshme dhe mendjet e tyre të ndritura. Gëzojuni faktit që vajzat janë të ndryshme nga djemtë. Jini mirënjohëse për pozitën që ato kanë në planin e madh të Perëndisë. Dhe gjithnjë kujtoni atë që tha Presidenti Hinkli: “Vetëm pasi toka u formua, pasi dita ishte ndarë nga nata, pasi ujërat ishin ndarë nga toka, pasi jeta bimore dhe shtazore ishin krijuar dhe pasi njeriu ishte vendosur në tokë, u krijua gruaja; dhe vetëm atëherë puna u shpall e plotë dhe e mirë”<sup>5</sup>.

Baballarë, bashkëshortë, të rinj, urojmë të rrokni një pamje nga gjithë ajo që gratë janë dhe mund të jenë. Lutemi jini të denjë për priftërinë hyjnore të Perëndisë, të cilën e mbani, dhe nderojeni atë priftëri, sepse ajo na bekon të gjithëve.

Motra, pavarësisht nga mosha juaj, ju lutem kuptoni gjithë çka jeni dhe duhet të jeni, gjithë çka ishit përgatitur për të qenë në oborret mbretërore lart nga Perëndia Vetë. I përdorshim me mirënjohje dhuntitë e paçmueshme që na janë dhënë për lartësimin e njerëzimit në një mendim më të lartë dhe në aspirata më fisnike, lutem në emrin e Jezu Krishtit, amen.

### Shënime

1. *Ensign*, nëntor 1995, f. 102.
2. “Womanhood: The Highest Place of Honor”, *Ensign*, maj 2000, f. 96.
3. Shih Bruce R. McConkie, *Mormon Doctrine*, botimi i dytë (1966), f. 35.
4. Në Conference Report, prill 1978, f. 14; ose *Ensign*, maj 1978, f. 10–11.
5. “Our Responsibility to Our Young Women”, *Ensign*, shtator 1988, f. 11.

### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Rendisni shprehje frymëzuese dhe pozitive që Motra Nadold përdor në bisedën e saj (për shembull “bekim i mrekullueshëm”, “frymëzuar nga”, “vegim i mrekullueshëm”). Çfarë mësimi mund të nxjerrim ne si udhëheqës nga këto shprehje që mund t'i përdorim në komunikimin me të tjerët?
- Krahasoni forcën e deklaratave pozitive dhe negative për të motivuar të tjerët.
- Sipas Motrës Nadold, cilat janë disa aspekte të pamjes së jashtme të një personi të

- drejtë? Përse janë ato të rëndësishme për një udhëheqës?
- Përse janë këto aspekte më të rëndësishme se bukuria fizike?
  - Si mund t'i ndihmojmë të tjerët të bëhen më të vetëdijshëm për potencialin e tyre hyjnor?

# PUNA E UDHËHEQJES

“Mësoju të mos lodhen kurrë me punët e mira, por të jenë të bindur dhe të përvuajtur në zemër; pasi të tillë do t’u gjejnë pushim shpirttrave të tyre” (Alma 37:34).

## PARIM I UDHËHEQJES

Udhëheqësit e familjes dhe të Kishës duhet të punojnë me zell për të ndihmuar sjelljen e shpirttrave tek Zoti dhe vendosjen e mbretërisë së Tij.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Udhëheqësit duhet të punojnë me zell për sjelljen e shpirttrave tek Zoti.

### KONCEPT 1. UDHËHEQËSIT DUHET TË PUNOJNË ME ZELL PËR SJELLJEN E SHPIRTRAVE TEK ZOTI.

#### KOMENT

Plaku Brus R. Mek-Konki, që ishte atëherë anëtar i Të Shtatëdhjetëve, shkroi: “Puna është parimi më i madh bazë që i bën të mundshme të gjitha gjërat edhe në kohë edhe në përjetësi” (*Mormon Doctrine*, botim i dytë [1966], f. 847). Presidenti Gordon B. Hinkli na mësoi: “Asgjë me vlerë reale nuk vjen pa punë. Asgjë nuk ndodh në këtë botë po të mos ketë punë. ... Duhet të ketë punë” (*Standing for Something: Ten Neglected Virtues That Will Heal Our Hearts and Homes* [2000], f. 80).

Ati Qiellor punon për të shpëtuar dhe ekzaltuar fëmijët e Tij (shih Moisiu 1:39). Shlyerja e Jezu Krishtit e bën të mundur këtë, duke kryer kështu veprën e Atit (shih Gjoni 4:34; 5:17; 9:4). Ai na jep mundësinë të ndihmojmë njëri-tjetrin që të kthehemi tek Ati. “Dikush e ka thënë mirë: ‘Ashtu siç është cilësi e zjarrit të djegë, e borës të ftohë, kështu është e Perëndisë të punojë.’ Dhe ne jemi fëmijët e tij” (George Reynolds dhe Janne M. Sjodahl, *Commentary on the Book of Mormon*, red. Philip C. Reynolds, 7 vëllime [1955–1961], 1:275).

Puna e udhëheqësve jo vetëm ndihmon të tjerët në udhëtimin e tyre por është me dobi edhe për udhëheqësin. “Puna me përkushtim ndihmon të zhvillosh tiparet e perëndishmërisë:

vetëdisiplinimin, këmbënguljen, përgjegjshmërinë dhe ndershmërinë” (në Daniel H. Ludlow, red., *Encyclopedia of Mormonism*, 5 vëllime [1992], 4:1586).

Mundësia për punë filloi për njerëzimin kur Zoti e vendosi Adamin “në kopshtin e Edenit, me qëllim që ta punonte dhe ta ruante” (Zanafilla 2:15). Nevoja për punë vazhdoi kur Perëndia e nxori Adamin jashtë kopshtit (shih Zanafilla 3:17–19).

Nëse duam të bëhemi udhëheqës të dobishëm, ne duhet të jemi të gatshëm të punojmë fort. Presidenti Spencer W. Kimball shpjegoi: “Ne duhet të bëjmë më shumë sesa t’i kërkojmë Zotit për shkëlqim. Djersa duhet t’i paraprijë frymëzimit; duket të ketë përpjekje përpara se të ketë shkëlqim. Ne duhet të bëjmë më shumë sesa të lutemi për këto rezultate... , edhe pse sigurisht duhet të lutemi. Ne duhet të mendojmë. Ne duhet të përpiqemi” (*The Teachings of Spencer W. Kimball* [1982], f. 402).

Udhëheqësit duhet të kenë parasysh gjithashtu këshillën e Mbretit Benjamin: “Dhe shikoni, që të gjitha këto gjëra të jenë bërë në urtësi dhe rregull; pasi nuk është e nevojshme që një njeri duhet të vrapojë më shpejt sesa ai ka fuqi” (Mosia 4:27).

Mbani parasysh vështrimet e mëposhtme nga Plaku Nil A. Maksiuell. Kur ishte Ndihmës tek Të Dymbëdhjetët, Plaku Maksiuell na mësoi:

“Puna e jashtëzakonshme e Perëndisë është bërë më shpesh nga njerëz të zakonshëm në

mjedisin e rëndomtë në dukje të një shtëpie dhe familjeje” (*That My Family Should Partake* [1974], f. 122).

“Ka diçka të shenjtë lidhur me punën; edhe në kohë bollëku, ajo është një nevojë. Edhe pse nuk është gjithçka në jetë, puna gjithsesi mund të na mbajë të vetëdijshëm për bekimet që kemi” (*Look Back at Sodom: A Timely Account from Imaginary Sodom Scrolls* [1975], f. 10).

Më vonë, si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, Plaku Maksuell shkroi:

“Perëndia ua jep kazmat dhe lopatat ‘të zgjedhurve’, sepse ata janë me vullnet për punë dhe për t’u bërë me kallo në duar. Ata mund të mos jenë më të mirët apo më të zotët, por ata janë më të gjendshmit” (*Deposition of a Disciple* [1976], f. 54).

Pasi u bë anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, Plaku Maksuell na mësoi:

“Nëse mendojmë thellë thjesht çfarë është ajo që do të ngrihet me ne në ringjallje, duket qartë se zgjuarsia jonë do të ngrihet me ne, që nuk tregon thjesht nivelin e zgjuarsisë, por gjithashtu aftësinë tonë për të njohur dhe zbatuar të vërtetën. Talentet, cilësitë dhe aftësitë tona do të ngrihen me ne; sigurisht edhe aftësia jonë për të mësuar, niveli ynë i vetëdisiplinimit dhe aftësia jonë për të punuar. Saktësisht forma jonë e punës këtu mund të mos ketë atje diçka të njëjtë, por aftësia për të punuar nuk do të jetë kurrë jashtëpërdorimit” (*We Will Prove Them Herewith* [1982], f. 12).

“Edhe pse me të drejtë flasim për ‘besim dhe vepra’, besimi vetë...është punë e vazhdueshme! Ai është një punë që duhet bërë dhe një proces që ndiqet më mirë duke qenë jo vetëm ‘i përfshirë me zell’, por gjithashtu i përfshirë me ‘frikë dhe me të dridhura’. Ndryshe ne mund të humbasim përqendrimin në Krisht” (*Lord, Increase Our Faith* [1994], f. 111–112).

“Për ne, qëllimi është qartësisht që ta bëjmë veprën e Perëndisë tonën – jo anasjelltas” (*If Thou Endure It Well* [1996], f. 101).

#### IDE MËSIMORE

Këndoni apo lexoni një himn që lidhet me punën (për shembull: “Punës Le t’i Vihemi, f. 10

252). Diskutoni rolin e punës në udhëheqje, në familje dhe në Kishë.

I vini studentët të lexojnë Alma 26 duke kërkuar të gjejnë punën që Amoni dhe shokët e tij misionarë kryen përpara se të kishin sukses. I ndihmoni studentët të kuptojnë se në punën udhëheqëse, si dhe në atë misionare, rezultatet arrihen me punë.

Ndajeni klasën tuaj në grupe të vogla dhe jepini secilit grup një apo më shumë thënie të Plakut Nil A. Maksuell nga komentit. Ftojini grupet të diskutojnë thëniet dhe pastaj i thoni një anëtarit nga secili grup t’i tregojë klasës vërejtjet e grupit. Komentoni dhe diskutoni sipas situatës.

Theksoni se puna që bëjmë në familjet dhe në thirrjet tona është puna më e rëndësishme që do të bëjmë në këtë jetë. Ngaqë ajo është puna e Zotit, ne duhet të mbështetemi në Shpirtin e Tij për të arritur sukses.

Këndoni apo lexoni një himn tjetër mbi rëndësinë e punës.

#### BURIME PËR MËSUESIN



**Plaku Mark E. Petersen**

*Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve*

“*The Image of a Church Leader*”, *Ensign*, gusht 1980, f. 5–8

“Çfarë lloj njerëzish duhet të jeni?” i pyeti Shpëtimtari Dymbëdhjetë Nefitët e Tij kur ata do të merrnin përsipër shërbesën.

Dhe cila ishte përgjigjja për atë pyetje? (3 Nefi 27:27).

Madje siç është ai! Mendoni për këtë! Jezu Krishti është modeli ynë.

Dhe kur priste ai që ata vëllezër ta përvetësonin modelin e tij të jetës? Nuk ishte për ndonjë të nesërme apo për ndonjë vit të ardhshëm. Ishte menjëherë. Si shërbetarë të tij, ata patën përgjegjësinë atëherë dhe atje të pasqyronin imazhin e tij për gjithë njerëzimin.

Ai është çelësi për mënyrën se si të gjithë ne duhet ta kryejmë punën e tij.

Por le të pyesim, cila është puna e tij? Ai thotë se puna e tij dhe madje lavdia e tij është të bëjë të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut. Por çfarë është jeta e përjetshme? Ajo është të bëhesh si Perëndia. Sepse ne jemi fëmijët e tij, ne kemi potencialin që vërtet të bëhemi të përsosur, siç është ai.

Kjo mundësi është e hapur për të gjithë njerëzimin, në çdo vend dhe klimë. Por ajo duhet të vijë nëpërmjet besimit në Krisht. Dhe si e arrijnë njerëzit atë besim? Pali bëri po atë pyetje me këto fjalë: “Si do ta thërrasin, ... atë, të cilit nuk i besuan? Dhe si do të besojnë tek ai për të cilin nuk kanë dëgjuar? Dhe si do të dëgjojnë, kur s’ka kush predikon?”

Dhe si do të predikojnë pa qenë dërguar?” (Romakëve 10:14–15).

Ne jemi predikuesit e tij. Ne jemi dërguar zyrtarisht. Atëherë si e kryejmë shërbesën tonë?

### **Kthehuni në besim**

Nikodemi erdhi tek Jezusi natën. A mund ta harrojmë ndonjëherë çfarë i tha Zoti atij? “Nëse një nuk ka rilindur, nuk mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë” (Gjoni 3:3).

Ne e lidhim këtë mësim me lindjen tonë nga uji dhe nga Shpirti në pagëzim. Tepër shpesh ne mbetemi me një shpjegim të pagëzimit vetëm me ujë dhe mendojmë pak për pagëzimin me Shpirt.

Ne marrim konfirmim me vendosjen e duarve mbi ne dhe na jepet dhurata e Frymës së Shenjtë. Por ne duhet të kujtojmë që në atë ordinancë ne marrim gjithashtu risinë e jetës. Po të jemi të sinqertë, ne në kuptimin e plotë të fjalës jemi lindur përsëri. Në një kuptim shumë real ne bëhemi njerëz të ndryshëm dhe më të mirë. Ne marrim një zemër të re. Ne largojmë njeriun e mëkatit, siç e përshkruan Pali, dhe marrim mbi vete emrin dhe shëmbëlltyrën e Krishtit (shih Kolosianëve 3:9–10).

Ne kemi nevojë për atë rilindje në mënyrë që të tjerët të besojnë nëpërmjet nesh se vërtet Jezusi ishte dërguar nga qielli nga Ati i tij, që ai është Shpëtimtari dhe se ne jemi shërbëtorët e tij, të autorizuar t’i udhëheqim në udhën e së vërtetës. Ai është fillimi i shpëtimit të tyre dhe një zgjerim i tonit.

Ne duhet të ruajmë vazhdimisht ndikimin e ringjalljes së tij në vetë jetën tonë. Ne kërkojmë rilindje për të tjerë nëpërmjet shërbesës tonë, por nuk mund të japim diçka që nuk e kemi vetë ne. Nëse shtëpia jonë nuk është ndërtuar siç duhet, ne zor se mund të jemi arkitektë dhe ndërtues rezultativë në jetën e të tjerëve.

Kështu çfarë lloj njerëzish duhet të jemi? Madje siç është ai.

Zoti na mësoi shumë gjëra të rëndësishme që ai pret nga dishepujt e tij. Një nga mësimet e tij më të mprehta ishte që ne duhet të jemi dëshmitarë të gjallë që ai është Krishti, duke bindur kështu njerëzit e tjerë se Ati i tij në Qiell vërtet e dërgoi atë në botë për t’u bërë Shpëtimtari ynë.

Dhe ndërsa lutej për dishepujt e tij, ai gjithashtu lutej “edhe për ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre. ...

*që bota të besojë se ti më ke dërguar”* (Gjoni 17:20–21 [korsivet shtuar]).

Ky është një nga përkufizimet më të përpikta të thirrjeve tona hyjnore që e kemi të regjistruar. Çfarë qëllimi! Çfarë përgjegjësie! Ato fjalë duhet të jenë ylli ynë drejtues. Por a i kuptojmë plotësisht ato?

Ato janë zemra dhe thelbi i fesë tonë. Askush nuk mund të shpëtohet pa këtë besim themelor. Si zyrtarë të Kishës, gjithçka themi dhe bëjmë duhet të pasqyrojë këtë të vërtetë të madhe. Ai është Biri i Perëndisë. Ai është hyjnor. Ai ishte dërguar në botë me urdhër nga qielli. Ne jemi përfaqësuesit e tij, dëshmitarët e tij dhe ai mbështetet tek ne që të punojmë në mënyrë të tillë që bota të besojë se Perëndia vërtet e dërgoi atë dhe atëherë mbase që shumë të mund të jetojnë ungjillin e tij dhe të shpëtohen.

### **Jini shembull**

Siç i tha Pali Timoteut, ne duhet të jemi shembuj besimtarësh, “në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe në dëlirësi” (1 Timoteut 4:12).

Sa vëmendje i kushtojmë seksionit të katërt të Doktrina e Besëlidhjeve?

“Dhe besimi, shpresa, dashuria hyjnore dhe dashuria, me syrin drejtuar vetëm te lavdia e Perëndisë, e cilësojnë [një person] për veprën.

Kujtoni besimin, virtytin, diturinë, maturinë, durimin, mirësinë vëllazërore, perëndishmërinë, dashurinë hyjnore, përlulësinë, zellin. ...

Fusha është e bardhë gati për t'u korrur; dhe shihni, ai që e shtyn draprin e tij *me fuqi*, njësoj vendos në ruajtje, që ai të mos mbarojë, por t'i sjellë shpëtim shpirtit të tij" (DeB 4:5–6, 4 [korsivet shtuar]).

Shtëpitë tona janë gurë themeli në mbretërinë e Perëndisë. Gjersa ne jemi shërbëtorët e tij, çfarë lloj jete shtëpiake kemi? A është e bollshme dashuria atje? A japim ne një shembull si të Krishtit për familjet tona që ata gjithashtu, nëpërmjet nesh, të mund të besojnë tek ai?

A jemi të pastër dhe të dëlirë në prirjet tona të brendshme? A e lejojmë mëkatën apo ndyrësinë, qoftë edhe fshehtas, që të ngrejë pengesa kundër Shpirtit të Perëndisë, duke mbajtur shenjtërinë jashtë jetës sonë? Apo jemi gati ta mbajmë lart virtytin, aq lart sa ta vlerësojmë edhe më shumë se jetën tonë?

A jemi të lirë nga hipokrizia? A kemi një karakter të ndryshëm kur jemi në Kishë, në dukje përpara fqinjëve tanë besimtarë, nga ai që kemi në veprimtaritë tona të përditshme të biznesit?

A i mundësohet ndokujt të ketë pëlqim të padrejtë nga çka themi apo bëjmë ne, që të justifikojë veprimet e tij të këqija? Apo ngrihem i mbi çdo materializëm të tillë dhe i frymëzojmë të tjerët për gjëra më të mëdha?

Si udhëheqës, a jemi gjithnjë shembuj besimtarësh? A ngjallim dyshime në mendjen e njerëzve të tjerë me qëndrime të gabuara që mund të shfaqim?

A jemi të mirë dhe të vëmendshëm me të tjerët? A jemi të ndershëm? A bien veprimet tona ndesh në ndonjë mënyrë me figurën tonë si shërbëtorë të Perëndisë?

A jemi të gatshëm të falim? A jemi të drejtë? A kujtohemi që falja na jepet vetëm kur ne falim të tjerët?

A e praktikojmë Rregullin e Artë dhe u bëjmë të tjerëve atë që do donim të na bënin? E gjithë kjo i përshtatet figurës së një shërbëtori të vërtetë të Perëndisë.

Ne jemi barinj të grigjës së Perëndisë. Të asaj grigje që me më shumë siguri përfshin familjet tona si edhe anëtarë të tjerë të Kishës.

Duke qenë si Krishti vetë, ne do t'u mësojmë atyre të jenë si Krishti. Duke qenë të përkushtuar vetë, ne do t'u mësojmë atyre përkushtimin. Duke qenë të gatshëm të ndjekim programin vetë, ne do t'u mësojmë atyre të ndjekin udhëzimet.

Ne do t'u mësojmë atyre vlerat e frymëzimit të Shpirtit, duke e kuptuar se pa të nuk mund të jemi në sintoni me Perëndinë. Nëse nuk jemi në sintoni ne ngelemi me burimet tona të vockla dhe sa vlerë kanë realisht ato?

### Jini të bashkuar

Një nga karakteristikat më të spikatura të Zotit Jezu Krisht gjatë shërbesës së tij në vdekshmëri ishte uniteti i tij me Perëndinë. Ai dëshironte me zell që dishepujt e tij gjithashtu të vinin në atë rreth uniteti. Ai ishte thelbësor për misionin e tyre. Përpara vuajtjeve të tij ai u lut që dishepujt e tij të mund të ishin një, madje ashtu si ai dhe Ati i tij ishin një (shih Gjoni 17:20–21). Dhe nëpërmjet Jozef Smithit ai tha: "Nëse nuk jeni një, nuk jeni të mitë" (DeB 38:27).

Uniteti u bë një standard themelor për dishepujt e tij kudo. Ai është themeli i të gjithë suksesit tonë. Pa të, ne do t'i dorëzoheshim kundërshtarit.

Krishti është Princi i Paqes. Ne gjithashtu duhet të jemi lajmëtarë të paqes. Konflikti mund të na shkatërrojë nëse e lejojmë të shfaqet. Ai mund ta dëmtojë seriozisht Kishën. Ai shkatërroi Kishën e lashtë dhe ai mund të na zhdukë neve. A e kujtojmë atë që Zoti tha lidhur me grindjen?

"Dhe nuk do të ketë grindje mes jush, sikurse ka pasur gjer tani. ...

Vini re, kjo nuk është doktrina ime, që të nxis zemrat e njerëzve në zemërim, njëri kundër tjetrit; por, doktrina ime është kjo, që gjëra të tilla duhet të zhduken" (3 Nefi 11:28, 30).

A e kujtojmë çfarë e pengoi krijimin e qytetit të Sionit në ditët e Profetit Jozef Smith? Jozefi pati kërkuar Zotin në lutje të sinqertë për shkak të dëbimit të njerëzve tanë nga konteja Xhekson. Në përgjigje Zoti tha lidhur me shenjtorët:



“Vini re, unë ju them, kishite acarime dhe grindje, dhe zilira, dhe zënie, dhe dëshira ephshore dhe lakmitare mes tyre; si rrjedhim, prej këtyre gjërave ata i ndotën trashëgimitë e tyre.

Ata ishin të ngadalshëm për t’iu bindur zërit të Zotit, Perëndisë së tyre; si rrjedhim, Zoti, Perëndia i tyre, është i ngadalshëm për t’i dëgjuar lutjet e tyre, për t’iu përgjigjur atyre në ditën e shqetësimit të tyre.

Në ditën e paqes së tyre ata e morën me lehtësi këshillën time; por, në ditën e shqetësimit të tyre, për shkak të nevojës ndihen afër meje” (DeB 101:6–8). A ka traktat më të madh për bindjen?

### **Jini të bindur**

Zoti dha një shëmbëlltë të rëndësishme nëpërmjet Profetit Jozef duke i nxitur shenjtorët për një përkushtim më të madh, duke treguar përsëri se si kërkon të ndjekim udhëzimet e tij hyjnore. Ai tha:

“Një njeri fisnik pati një copë toke shumë të zgjedhur; dhe u tha shërbëtorëve të tij: Shkoni në vreshtin tim, madje në këtë copë toke të zgjedhur, dhe mbillni dymbëdhjetë pemë ulliri;

Dhe vendosni roje përreth tyre dhe ndërtoni një kullë, me qëllim që njëri të mund të shohë gjithë tokën përreth, për të qenë një rojë në kullë, që pemët e mia të ullirit të mos thyhen kur armiku të vijë për të prishur dhe për të marrë me vete frutin e vreshtit tim.

Tani, shërbëtorët e fisnikut shkuan dhe bënë ashtu siç i urdhëroi zoti i tyre dhe mbollën pemë ulliri e ndërton një gardh përreth dhe vunë roje e filluan të ndërtojnë një kullë.

Dhe ndërsa ende po ngrinin themelin e saj, ata filluan të thonë mes tyre: Dhe ç’i duhet zotit tim kjo kullë?

Dhe u këshilluan për një kohë të gjatë, duke thënë mes tyre: Ç’i duhet zotit tim kjo kullë, përdërisa është kohë paqeje?

A s’mund t’u jepen këto para këmbyesve? Sepse nuk ka nevojë për këto gjëra.

Dhe ndërsa nuk binin dakort me njëri-tjetrin, u bënë të plogësht dhe nuk ia vunë veshin urdhërimeve të zotit të tyre.

Dhe armiku erdhi natën dhe e theu gardhin; dhe shërbëtorët e fisnikut u ngritën dhe ishin të frikësuar e ia mbathën; dhe armiku i shkatërroi punët e tyre dhe i theu pemët e ullirit.

Tani, vini re, njeriu fisnik, zoti i vreshtit, i thirr shërbëtorët e tij e u tha, Pse! Cili është shkak i kësaj të keqeje të madhe?

A nuk duhej të kishit bërë madje siç ju kisha urdhëruar dhe–pasi ta kishit mbjellë vreshtin dhe të kishit ndërtonuar gardhin përreth e të kishit vënë roje mbi muret e tij–të ndërtonit një kullë gjithashtu e të caktonit një rojë mbi kullë dhe të vëzhgonit për vreshtin tim e të mos binit në gjumë, nga frika se armiku do të vinte tek ju?” (DeB 101:44–53).

Vini re dyshimet që lindën tek shërbëtorët në vreshtë. Dhe ç’i duhet Zotit tim kjo kullë? Ç’i duhet? Ç’i duhet?

A i ndodhin dyshime të tilla ndonjërit prej nesh? A thotë ndonjë nga ne, ç’i duhet Kishës kjo apo ajo? Ç’i duhet? Ç’i duhet?

Sa jetike është që ne të kemi një qëndrim në bindje të plotë me udhëzimet tona dhe t’i plotësojmë ato në hollësi!

Zoti gjithashtu na thotë: “Si rrjedhim, tani çdo njeri duhet ta mësojë detyrën e tij dhe të veprojë në thirrjen që është caktuar, gjithë zell” (DeB 107:99). Ne duhet të njohim biznesin tonë dhe të punojmë në të me gjithë zgjuarsinë e mendjeve tona dhe me të gjithë forcën e trupave tona.

### **Jini të përkushtuar**

Atëherë, cila është figura e një udhëheqësi të Kishës? Ajo duhet të jetë njësoj si ajo e çdo shërbestari tjetër të sinqertë të Krishtit.

A mund të jetë e ndryshme nga ajo e një Autoriteti të Përgjithshëm? A mund të jetë e ndryshme nga ajo e një përfaqësuesi të mirë rajonal, e një presidenti të mirë kunji, e një peshkopi të mirë, e një presidenti të mirë misioni apo e një presidenti të mirë kuorumi pleqsh?

A nuk jemi të gjithë shërbëtorët e tij të zgjedhur? A nuk jemi të gjithë nën të njëjtën besëlidhje të priftërisë? A kemi ne ndonjë privilegj të posaçëm? A është Perëndia i paanshëm?

A kemi ne ndonjë ambicie për vend, pozitë apo dallim në Kishë? A është një qëndrim i tillë si i Krishtit? A nuk mungon aty përulësia?

Nëna e bijve të Zebedit erdhi tek Zoti në kërkim të një vendi për Gjonin dhe Jakobin që të ishte mbi atë që gëzonin vëllezërit e tjerë. Zoti e qortoi atë për ambicie të tilla të pajustificueshme. “Kur i dëgjuan këto fjalë, të dhjetët të tjerët u indinjuan kundër të dy vëllezërve” (Mateu 20:24).

Shpëtimtari atëherë e bëri të qartë se nuk duhet të kishte pabarazi midis tyre dhe shtoi: “Por midis jush kështu nuk do të ndodhë; madje secili prej jush që do të dojë të bëhet i madh, qoftë shërbëtori juaj;

dhe kushdo prej jush që do të dojë të jetë i pari, qoftë skllavi juaj” (Mateu 20:26–27).

Në të gjitha rastet, përkushtimi ndaj detyrës është thelbi.

### Jini frytdhënës

Dhe më tej, Zoti na kërkon të jemi frytdhënës. Ai na urdhëron të japim shumë fryte. Këtë ai e ilustron me shëmbëlltyrën që gjendet në kapitullin e pesëmbëdhjetë të Gjonit. Atje Zoti u tregon shërbëtorëve të tij se si ta kryejnë punën. Atje ai krijon figurën e një shërbëtori të vërtetë të Perëndisë.

Ky kapitull fillon me një shëmbëlltyrë mbi vreshtën e Zotit. Ai thotë se Babai i tij është vreshtari, apo pronari, dhe atij i pëlqen të shkojë vetë tek hardhitë në vreshtë. Ai thotë se ne – punëtorët e tij – jemi si degët në hardhi dhe se duhet të japim shumë fryte në vreshtën e Zotit:

“Unë jam hardhia e vërtetë dhe Ati im është vreshtari.

Çdo shermend që nuk jep fryt në mua, ai e heq; kurse çdo shermend që jep fryt, ai e krasit që të japë edhe më shumë fryt.”

Pastaj ai skicon një tablo që duhet të jetë e njohur për të gjithë ne. Ai flet për krasitje të hardhisë që të prodhojë më shumë. Në vreshtën e tij ai na krasit neve – na krasit – na shenjtëron në mënyrë që të prodhojmë më shumë nga lloji i tij i frytit.

Ai flet pastaj për shermende që nuk prodhojnë fare sepse janë shkëputur nga pjesa kryesore e hardhisë. Dhe pse nuk prodhojnë ato në kushte të tilla? Sepse limfa ushqyese, limfa jetëdhënëse, ndërpritet nëse dega shkëputet nga hardhia. Ky fakt e bëri Zotin që t’u thotë shërbëtorëve të tij: “Qëndroni në mua dhe unë do të qëndroj në ju; sikurse shermendi nuk mund të japë fryt nga vetja, po që se nuk qëndron në hardhi, ashtu as ju, nëse nuk qëndroni në mua.”

Dhe pastaj ai shton: “Unë jam hardhia, ju jeni shermendet; kush qëndron në mua dhe unë në të, jep shumë fryt, sepse pa mua nuk mund të bëni asgjë.”

Ky është një mësim i madh. Sa kohë që jemi pranë Zotit dhe ushqehemi nga Shpirti i tij, ne japim shumë fryte. Por po të mos i *mbetemi tek* Zoti dhe të ushqehemi nga forca e tij, ne nuk mund të prodhojmë, ashtu si nuk mund të prodhojë një degë e prerë nga pema. Prandaj, ai thotë: “Sepse pa mua nuk mund të bëni asgjë.”

Për t’ia shtuar më shumë rëndësinë kësaj çështjeje, Zoti thotë: “Në këtë është përlëvduar Ati im, që të jepni shumë fryt, dhe kështu do të jeni dishepujt e mi.”

Por, ka edhe një mësim tjetër në këtë shkrim të shenjtë që duhet t’i kushtojmë shumë në vëmendje. Në vargun 16-të ai thotë:

“Nuk më keni zgjedhur ju mua, por unë ju kam zgjedhur juve.” Për çfarë qëllimi? “... [që] të shkoni dhe të jepni fryt.”

Por ka edhe më shumë. Jo vetëm që jemi zgjedhur nga ai, jo vetëm jemi shuguruar me qëllim që të japim fryt, por ne jemi thirrur dhe shuguruar gjithashtu që të punojmë në mënyrë të tillë që *fryti ynë të jetë i qëndrueshëm*.

Vini re fjalët e tij: “Nuk më keni zgjedhur ju mua, por unë ju kam zgjedhur juve; dhe ju caktova të shkoni dhe të jepni fryt, *dhe fryti juaj të jetë i qëndrueshëm*” [kursivet shtuar].

Çfarë do të thotë kjo? Thjesht atë që ne duhet të planifikojmë dhe të lutemi, dhe të punojmë për qëllimin që të mos ketë asnjë largim nga moskujdesi ynë, asnjë që të humbasë dëshminë, asnjë që të bëhet jo aktiv. *Fryti ynë duhet të jetë i qëndrueshëm*.

Pastaj figura e çdo shërbëtori të Perëndisë bëhet përsëri një çështje *sjelljeje*. Njeriu, ashtu siç mendon në zemrën e vet, ashtu edhe do të punojë.

Kjo Kishë është mbretëria e Perëndisë. Bota është fusha e tij ose vreshti i tij. Ne jemi punëtorët e tij të zgjedhur. Suksesi mund të jetë yni nëse qëndrojmë fort në Hardhi. Dhe nëse e bëjmë këtë, ai na jep premtimin e artë që është më i dëshirueshmi:

“Në qoftë se qëndroni në mua dhe fjalët e mia qëndrojnë në ju, kërkoni çfarë të doni dhe do t’ju bëhet, ...

Po të zbatoni urdhërimet e mia, do të qëndroni në dashurinë time, sikurse unë i zbatova urdhërimet e Atit tim dhe qëndroj në dashurinë e tij.

Këto gjëra jua kam thënë që gëzimi im të qëndrojë në ju dhe gëzimi juaj të jetë i plotë” (Gjoni 15:1–2, 4–5, 7–8, 10–11, 16).

## NDIHMË PËR STUDIMIN

- Sipas Plakut Petersen, cili është çelësi i udhëheqjes në Kishë?
- Pse duhet të kthehemi në besim me qëllim që të jemi shembuj të mirë për të tjerët?
- Cila është lidhja midis shembullit të një udhëheqësi dhe unitetit të një grupi?
- Çfarë na mëson Doktrina e Besëlidhje 4 mbi udhëheqjen?
- Çfarë parimi udhëheqjeje na jep Shpëtimtari duke na dhënë shembullin e Tij të “unitetit me Perëndinë?” Si mund ta zbatojmë këtë parim në udhëheqjen tonë?
- Cili paragraf në bisedën e Plakut Petersen mendon se e shpjegon më mirë parimin e udhëheqjes të të qenit frytdhënës? Shpjegojeni zgjedhjen tuaj.

# UDHËHEQJA DHE KËSHILLAT

“Dhe Perënditë u këshilluan mes tyre dhe thanë: Le të zbrezim e të formojmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë, sipas ngjashmërisë sonë” (Abraham 4:26).

## PARIM I UDHËHEQJES

Udhëheqësit mund të jenë më rezultativë kur përdorin këshillat në procesin e udhëheqjes.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Ati Qiellor kryeson mbi “këshillin e madh kryesues të universit”.
2. Kisha qeveriset nga këshillat.
3. Këshillat familjare janë këshillat themelore të Kishës.
4. Disa parime u mundësojnë udhëheqësve të kenë këshilla rezultative.

### KONCEPT 1: ATI QIELLOR KRYESON MBI “KËSHILLIN E MADH KRYESUES TË UNIVERSIT”.

#### KOMENT

Ati Qiellor i përdori këshillat në planifikimin dhe krijimin e kësaj bote dhe të botëve të tjera. Plaku Jozef Filding Smith, që ishte atëherë anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, shkroi se Perëndia Atë, Jezu Krishti dhe Fryma e Shenjtë “përbëjnë një Krye-Perëndi apo Këshill Suprem” (*Answers to Gospel Questions*, përmb. Joseph Fielding Smith Jr., 5 volume [1957–1966], 1:2). Plaku L. Tom Perri nga Të Dymbëdhjetët iu referua Kreut-Perëndi si “këshilli i madh kryesues i universit” (në Conference Report, prill 1998, f. 28; ose *Ensign*, maj 1998, f. 23).

Shkrimet e shenjta thonë se: “Këshill[i] i Perëndisë së Përjetshëm me gjithë perënditë e tjera” u mbloodh “përpara se kjo tokë të ishte” dhe bënë plane lidhur me qeverisjen e universit (shih DeB 121:31–32). Plaku Jozef Filding Smith shkroi: “Në këshillin e madh që u mbajt në qiell, Jezu Krishti pranoi vullnetarisht misionin e Shëlbuesit... Adami u zgjodh gjithashtu në po këtë këshill për të përmbushur rolin e tij si personi i parë i racës njerëzore” (*Answers to Gospel Questions*, 1:182).

Profeti Jozef Smith na mësoi: “Çdo njeri që ka një thirrje për t’u shërbyer banorëve të botës, është shuguruar pikërisht për atë qëllim në Këshillin e Madh të qiellit përpara se kjo botë të ishte” (*Teachings of the Profet Joseph Smith*, përzgjedh. Joseph Fielding Smith [1976], f. 365).

#### IDE MËSIMORE

I vini studentët të lexojnë shpejt Abraham 4–5 duke kërkuar se cili e planifikoi dhe e krijoi tokën. I ftoni ata të tregojnë çfarë zbuluan (vini re fjalë si *ne, ata* dhe *Perënditë*).

Përveç krijimit të tokës, çfarë bëri tjetër këshilli i Perëndive? (shih komentin).

I ndihmoni studentët të kuptojnë se Ati Qiellor dha shembullin për udhëheqësit kur Ai përdori këshillat në planifikimin dhe krijimin e kësaj bote dhe të botëve të tjera.

### KONCEPT 2. KISHA QEVERISET NGA KËSHILLAT.

#### KOMENT

Zoti e qeveris mbretërinë e Tij tokësore nëpërmjet këshillave. Plaku M. Rasëll Ballard, nga Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve theksoi se pas rivendosjes së ungjillit “Kisha u organizua në

kuorume dhe këshilla, me presidenca të ndryshme të caktuara ‘për të administruar në gjërat shpirtërore’ (DeB 107:8)” (*Counseling with Our Councils: Learning to Minister Together in the Church and in the Family* [1997], f. 39). Këto këshilla “koordinojnë e programojnë aktivitetet, mbledhin informacion, planifikojnë programe apo ngjarje të ardhshme dhe marrin vendime e zgjidhin probleme” (Daniel H. Ludlow, red., *Encyclopedia of Mormonism*, 5 vëllime. [1992], 3:1141; në *Counseling with Our Councils*, f. 5). Qëllimi i këtyre këshillave është që të ndihmojnë “fëmijët e Perëndisë të gëzojnë bekimet e plota të ungjillit” (*Counseling with Our Councils*, f. 10). Plaku Ballard shpjegoi:

“Ndër vite, format dhe modelet e qeverisjes dhe administrimit të Kishës janë përshtatur për t’iu përgjigjur ndryshimit të nevojave dhe kohëve. Por ato janë karakterizuar gjithmonë nga mbështetja në këshillat për përparimin e solidaritetit dhe të forcës...”

... Këshilli kryesues i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme sot është Presidenca e Parë. Ajo përbëhet nga Presidenti i Kishës dhe dy Këshilltarët e tij...

Pas Presidencës së Parë në autoritetin e Kishës vjen Kuorumi i Të Dymbëdhjetë Apostujve” (*Counseling with Our Councils*, f. 43–45).

### IDE MËSIMORE

Paraqisni fotografitë e Presidencës së Parë dhe të Kuoromit të Të Dymbëdhjetëve. Shpjegoni se këto këshilla, me ndihmën e Të Shtatëdhjetëve, udhëheqin Kishën. Diskutoni çfarë bëjnë këto këshilla për të drejtuar Kishën dhe për të na sjellë në Krisht.

Diskutoni disa nga këshillat që veprojnë në kulla dhe në lagje.

### KONCEPT 3. KËSHILLAT FAMILJARE JANË KËSHILLAT THEMELORE TË KISHËS.

#### KOMENT

Një këshill familjar është kur prindërit dhe fëmijët mblidhen për të shqyrtuar çështje të

rëndësishme familjare. Plaku M. Rasëll Ballard shkroi: “Këshilli themelor i Kishës është këshilli familjar” (*Counseling with Our Councils*, f. 154). Këshillat familjare shërbejnë për të njëjtin qëllim si edhe këshillat e tjera të Kishës (shih komentin për konceptin 2).

Plaku Ballard shkroi për “forcën potenciale të këshillit familjar në forcimin e lidhjeve familjare, ndërtimin e unitetit të familjes dhe krijimin e kujtimeve të mrekullueshme.

Plaku L. Tom Perri, nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve shpjegoi se ... në këshillat familjare, ... nënat dhe baballarët mund sigurojnë trajnim në çështje të tilla si ‘përgatitja për në tempull, përgatitja për mision, administrimi i shtëpisë, financat e familjes, përparimi në karrierë, arsimimi, përfshirja në komunitet, përmirësimi kulturor, sigurimi dhe kujdesi për pasuri të patundshme dhe vetjake, kalendarë planifikimi familjar, përdorimi i kohës së lirë dhe caktime punësh’. ... (“ ‘For Whatsoever a Man Soweth, That Shall He Also Reap’ ”, f. 9).

... [Këshilli familjar] mund të ndihmojë në vendosjen e rregullit në shtëpi, të japë një mjeedis për lehtësimin e ndjenjave të prekura, t’u japë prindërve një mjet të rëndësishëm me të cilin të luftojnë ndikimet e jashtme dhe të krijojnë një mundësi për mësim të thellë të së vërtetave të ungjillit” (*Counseling with Our Councils*, f. 148–149).

### IDE MËSIMORE

Diskutoni pse këshillat familjare janë këshillat themelore të Kishës. Diskutoni çfarë bëjnë këshillat familjare (shih komentin).

Ftojini studentët të ndajnë përvojat ku kanë marrë pjesë në një këshill familjar për të marrë një vendim të rëndësishëm apo për të përmbushur një detyrë të rëndësishme.

Shpjegojini që Ati Qiellor dha një shembull të udhëheqjes duke përdorur këshillat. Kisha qeveriset në çdo nivel nga këshilla. Anëtarë të familjeve gjithashtu mund të mblidhen në këshill për të përmbushur qëllimet e familjes.

#### **KONCEPT 4. DISA PARIME U MUNDËSOJNË UDHËHEQËSVE TË KENË KËSHILLA REZULTATIVE.**

##### **KOMENT**

Plaku M. Rasëll Ballard tha: “Kur veprojmë në një përpjekje të bashkuar, ne krijojmë sinergji shpirtërore që sjell efektshmëri apo arritje më të madhe si rrjedhim i veprimit apo bashkëpunimit të kombinuar, rezultati i së cilës është më i madh sesa shuma e pjesëve individuale” (në Conference Report, tetor 1993, f. 103; ose *Ensign*, nëntor 1993, f. 77). Më herët Plaku Ballard tha se udhëheqësit e familjes dhe të Kishës kanë nevojë “të përdorin dhe të drejtojnë forcën shpirtërore nëpërmjet këshillave” (në Conference Report, prill 1994, f. 32; ose *Ensign*, maj 1994, f. 25).

Plaku Ballard na mësoi: “ ‘Kur anëtarët marrin pjesë në këshilla, ata mësojnë mbi çështje organizative më të mëdha. Ata shohin udhëheqjen në veprim, duke mësuar si të planifikojnë, të analizojnë problemet, të marrin vendime dhe të koordinojnë midis programeve dhe organizatave të ndryshme të Kishës. Pjesëmarrja në këshilla ndihmon të përgatiten anëtarë për përgjegjësi të ardhshme udhëheqjeje.’ (“Priesthood Councils”, në Ludlow, *Encyclopedia of Mormonism*, 3:1141–1142) ...

... Kur më shumë njerëz ndihen përgjegjës për zgjidhjen e problemit, atëherë më shumë njerëz janë të gatshëm të bëhen pjesë e zgjidhjes ...

... Një nga forcat e mëdha të sistemit të këshillave është përshtatshmëria që jep ai për gjetjen dhe zbatimin e zgjidhjeve vendore për problemet vendore” (*Counseling with Our Councils*, f. 6, 15).

Plaku Ballard sugjeroi disa parime që janë të rëndësishme për udhëheqjen me këshilla:

- Udhëheqësit duhet të sjellin në këshill një ide për një drejtim në të ardhmen.
- Këshillat duhet të ofrojnë kohë për diskutimin e pikëpamjeve të ndryshme.
- Udhëheqësit duhet të respektojnë lirinë e zgjedhjes të anëtarëve të këshillit.
- Udhëheqësit duhet të japin udhëzime të qarta dhe të sakta.
- Udhëheqësit duhet të autorizojnë.

- Udhëheqësit duhet të japin shembullin për anëtarët e këshillit të tyre.
- Udhëheqësit duhet të shërbejnë me dashuri. (Shih *Counseling with Our Councils*, f. 23–36.)

Plaku Ballard gjithashtu dha sugjerime se si mund të punojë një këshill për të zgjidhur një problem:

- “Problemi është formuluar dhe shprehur qartë, por këshillit nuk i lejohej të qëndrojnë tek ajo se sa i vështirë është ai.”
- “Udhëheqësi i këshillit kontrollon drejtimin e diskutimeve pa e dominuar atë. Ai bën pyetje e kërkon opinione dhe pastaj ai dëgjon.”
- “Anëtarët e këshillit flasin nga këndvështrimi i tyre vetjak si individë dhe jo thjesht si përfaqësues të organizatave të tyre përkatëse.”
- Anëtarët e këshillit së pari “përcaktojnë rezultatin e dëshiruar përfundimtar dhe pastaj vendosin se si ta arrijnë atë”.
- “Në shqyrtimet e tij, këshilli kurrë nuk devijon larg nga misioni i Kishës: sjellja e shpirtit në Krisht nëpërmjet shpalljes së ungjillit, përsosjes së shenjtoreve dhe shëlbimit të të vdekurve.”
- “Anëtarët e këshillit nuk lejohet të harrojnë rëndësinë e ndikimit dhe shembullit të tyre vetjak.”
- “Sugjerime kërkohej nga secili, por vendimet përfundimtare i lihen udhëheqësit të këshillit, i cili mbështetet më shumë në frymëzimin sesa në opinionin vetjak në drejtimin e vendimeve të këshillit.”

(*Counseling with Our Councils*, f. 165, 168.)

##### **IDE MËSIMORE**

Pyetini studentët se çfarë është sinergjia. (*Sinergjizmi* është kur efekti i përgjithshëm është më i madh sesa shuma e pjesëve). E vini një student të lexojë thënien e Plakut M. Rasëll Ballard mbi sinergjizmin shpirtëror (shih komentin). Diskutoni pse ky parim është i vërtetë për këshillat dhe rendisni shembuj në dërrasë.

Diskutoni parime që udhëheqësit duhet të kenë parasysh kur punojnë me këshillat (shih

komentin). Krijoni një situatë hipotetike udhëheqjeje dhe diskutoni se si mund të zbatohen këto parime.

Rishihni sugjerimet e Plakut M. Rasëll Ballard për këshillat dhe i nxitni studentët t'i zbatojnë ato në këshillat e tyre.

## BURIME PËR MËSUESIN



**Plaku M. Rasëll Ballard**

*Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve*

*“Strength in Counsel”, në Conference Report, tetor 1993, f. 102–106; ose Ensign, nëntor 1993, f. 76–78*

### Këshillat në kishën e Zotit

... Perëndia thirri një këshill të madh në botën paravdekshmërisë për të paraqitur planin e Tij të lavdishëm për mirëqenien tonë të përgjithshme. Kisha e Zotit është organizuar me këshilla në çdo nivel, duke filluar me Këshillin e Presidencës së Parë dhe Kuorumin e Të Dymbëdhjetë Apostujve dhe duke u shtrirë në këshilla kunji, lagjeje, kuorumes, organizatash ndihmëse dhe familjare.

Presidenti Stefen L. Riçards tha:

“Gjenia e qeverisë së Kishës tonë është qeverisja nëpërmjet *këshillave*... Unë kam pasur mjaft përvojë sa ta njoh vlerën e këshillave. Zor se kalon një ditë që të mos shoh ... urtësinë e Perëndisë, në krijimin e këshillave... për të qeverisur Mbretërinë e tij...

... Unë nuk hezitoj t’ju siguroj juve, nëse do të përfshiheni në këshill siç pritet të bëni, Perëndia do t’ju japë zgjidhje për problemet që do t’ju dalin përpara” (në Conference Report, tetor 1953, f. 86).

### Si duhet të funksionojnë këshillat

Si anëtar i Të Dymbëdhjetëve, unë shërbej në disa këshilla dhe komitete të përgjithshme të Kishës. Unë takohem rregullisht me udhëheqës të shoqatave ndihmëse. Së bashku ne këshillohemi, kërkojmë në shkrimet e shenjta dhe lutemi për drejtim ndërsa përpiqemi të mësojmë se si organizatat ndihmëse mund të jenë më rezultative në bekimin dhe forcimin e anëtarëve të Kishës.

Në shumë drejtime, këshillat e përgjithshme të Kishës funksionojnë thujse njësoj me këshillat e kunjit dhe të lagjes. Të gjitha këshillat në Kishë duhet të inkurajojnë diskutimin e lirë dhe të hapur, duke diskutuar me njëri-tjetrin dhe duke u përpjekur të ketë një komunikim të qartë dhe të saktë. Këshillat duhet të diskutojnë objektiva dhe shqetësime me qëllim final mirëkuptimin e ndërsjelltë. Këshillat e kunjeve dhe të lagjeve janë vende ideale për udhëheqësit e të gjitha organizatave për të biseduar së bashku dhe forcuar njëri-tjetrin. Përqendrimi parësor i mbledhjeve të këshillit të kunjit dhe të lagjes duhet të jetë koordinimi i veprimtarive dhe i kujdestarisë, jo programimi i tyre në kalendar. Në këto mbledhje, udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse duhet të rishikojnë së bashku përgjegjësitë e tyre dhe të gjejnë mënyrat që programet e Kishës t’u ndihmojnë anëtarëve të jetojnë ungjillin në shtëpi. Individët dhe familjet e sotme kanë nevojë për ndihmë të urtë dhe të frymëzuar nga Kisha për të luftuar ligësitë e botës.

### Kërkoni sugjerime nga motrat në mbledhjet e këshillit

Në një mbledhje të këshillit kohët e fundit me presidencat e shoqatat ndihmëse të grave, motrat më treguan se shumë pak gra në Kishë tregojnë ndonjë interes që të duan të mbajnë priftërinë. Por ato duan të dëgjohen e të vlerësohen dhe duan të japin kontribute domethënëse për kunjet apo lagjet si dhe anëtarët e tyre që do t’i shërbejnë Zotit dhe do të ndihmojnë përmbushjen e misionit të Kishës.

Për shembull, jo shumë kohë përpara ne po bisedonim nëse ia vlen që të rinjtë të shërbejnë në misione. Presidentja Elein Xhek tha: “Ju e dini, Plaku Ballard, motrat e Kishës mund të kenë disa sugjerime të mira lidhur me mënyrën se si ta përgatisin më mirë rininë për misione, nëse thjesht do të pyeteshin. Në fund të fundit, ju e dini, ne *jemi* nënat e tyre!” Sugjerimet e motrave mund të ndihmojnë në masë të njëjtë lidhur me shkuarjen në tempull dhe një mori çështjesh të tjera për të cilat udhëheqësit e priftërisë po përpiqen.

Vëllezër, ju lutem sigurohuni që po kërkoni ndihmesën jetike nga motrat në mbledhjet tuaja të këshillit. I nxitni të gjithë anëtarët e këshillit

të paraqesin sugjerimet dhe idetë e tyre mbi mënyrën se si kunji dhe lagjja mund të bëhen më rezultative në shpalljen e ungjillit, përsosjen e shenjtoreve dhe shëlbimin e të vdekurve.

### **Të gjithë anëtarët e keshillit duhet të marrin pjesë**

Në mënyrë ideale të gjithë anëtarët e çfarëdo keshilli të Kishës apo keshilli familjar duhet të shfaqin shqetësimet e tyre dhe duhet të sugjerojnë zgjidhje të bazuara në parimet e ungjillit. Unë besoj se Kisha dhe familjet tona do të forcohen nëse presidentët e kunjeve dhe peshkopët do të përdornin mbledhjet e keshillit të tyre për t'u dhënë përgjigje pyetjeve se si të përmirësohen mbledhjet e sakramentit; si të përmirësohet nderimi; si të përqendrohemi tek fëmijët; si të forcohet rinia; si të ndihmohen beqarët/beqaret, përfshi prindërit e vetëm; si të mësohen dhe të shoqërohen kërkuesit dhe anëtarët e rinj, si të përmirësohet mësimdhënia e ungjillit dhe shumë çështje të ngjashme.

Gjatë gjysmës së dytë të këtij viti ne kemi mbajtur një takim të posaçëm trajnimi, kombinuar me konferencën e çdo kunji, për të diskutuar parimet morale të rinisë tonë. Ata që morën pjesë janë anëtarë të keshillave të kunjit dhe të lagjeve. Çdo pyetje që m'u drejtua gjatë diskutimit mund të diskutohet fare mirë në një mbledhje keshilli lagjeje. Dhe përsëri rrallë e ndiejnë ata që ngritën pyetjet se kanë pasur mundësi në mbledhjet e keshillit të lagjes të shtronin pyetjet e tyre, të shprehnin shqetësimet e tyre dhe të ofronin sugjerimet e tyre.

### **Krijoni sinergji shpirtërore në keshillat**

Në këto kohë të rrezikshme ne kemi nevojë për përpjekjen bashkëvepruese të burrave dhe të grave zyrtarë në Kishë, pasi kërkohet vigjilencë absolute nga ana e të gjithë atyre, të cilëve u është besuar të ndihmojnë në vëzhgimin e mbretërisë. Secili nga ne kemi përgjegjësi të mëdha vetjake, por po aq e rëndësishme është përgjegjësia që ndajmë me të tjerët për të ardhur së bashku në keshill në një përpjekje të bashkuar për të zgjidhur probleme dhe bekuar të gjithë anëtarët e Kishës tonë. Kur veprojmë në një përpjekje të bashkuar, ne krijojmë sinergji shpirtërore, që sjell efektshmëri apo arritje

më të madhe si rrjedhim i veprimit apo bashkëpunimit të kombinuar, rezultati i së cilës është më i madh sesa shuma e pjesëve individuale.

Moralisti i lashtësisë Ezopi, për ilustrimin e forcës së sinerjësë, përdori ngritjen e një shkopi dhe kërkimin e një vullnetari midis dëgjuesve të tij që mendonte se mund ta thyente. Sigurisht, vullnetari ishte në gjendje ta thyente një shkop lehtësisht. Pastaj Ezopi vuri më shumë shkopinj së bashku derisa vullnetari nuk mund t'i thyente. Morali i demonstrimit të Ezopit ishte i thjeshtë: Së bashku ne prodhojmë sinergji, që na bën shumë më të fortë sesa kur qëndrojmë vetëm.

### **Askush nuk duhet të qëndrojë vetëm**

Perëndia kurrë nuk ka synuar që fëmijët e Tij të qëndrojnë vetëm. Fëmijët kanë prindër dhe prindërit kanë Kishën, me shkrimet e shenjta, me profetët e gjallë e Apostujt dhe Frymën e Shenjtë që t'u ndihmojnë të kuptojnë parimet e përshtatshme dhe të veprojnë sipas atyre parimeve në përmbushjen e përgjegjësive të tyre prindërore.

Apostulli Pal na mësoi se Shpëtimtari e organizoi Kishën, e plotësoi me Apostuj, profetë dhe zyrtarë e mësues të tjerë, “për përsosjen e shenjtoreve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit, derisa të arrijmë të gjithë te uniteti i besimit” (Efesianëve 4:12–13).

Pali i krahasoi anëtarët e Kishës dhe përgjegjësitë e tyre të ndryshme me një trup:

"Sepse edhe trupi nuk është një gjymtyrë e vetme, por shumë ... .

Por Perëndia ka vënë çdo gjymtyrë të trupit si ka dashur...

Kështu, pra, janë shumë gjymtyrë, por një trup i vetëm.

Dhe syri nuk mund t'i thotë dorës: 'Unë nuk kam nevojë për ty'; dhe po ashtu koka nuk mund t'u thotë këmbëve: 'Unë nuk kam nevojë për ju'. ... dhe po ashtu koka nuk mund t'u thotë këmbëve: 'Unë nuk kam nevojë për ju'. ...

Dhe nëse vuan një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët vuajnë, kurse po të nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të” (1 Korintasve 12:14, 18, 20–21, 26).



Shkrimet e shenjta e thonë qartësisht se ndërsa thirrjet tona përkatëse mund të jenë të ndryshme dhe mund të ndryshojnë nga koha në kohë, të gjitha thirrjet janë të rëndësishme për funksionimin e Kishës. Ne kemi nevojë që kuorumet e priftërisë të shpallin vetë dhe të përmbushin kujdestarinë e tyre të autorizuar hyjnisht, ashtu siç kemi nevojë që Shoqata e Ndihmës, Fillorja, Të Rejat, Shkolla e së Dielës dhe komitetet e aktiviteteve të kryejnë funksionet e tyre jetike. Dhe ne kemi nevojë që zyrtarët dhe anëtarët e të gjitha këtyre organizatave të frymëzuara të punojnë së bashku, duke ndihmuar njëri-tjetrin sipas nevojës për përfitimin e individëve dhe të familjeve.

### **Sugjerime për këshilla më rezultative**

Kjo nuk është punë e burrit apo e gruas; kjo është e *gjitha* punë e Perëndisë, që përqendrohet në shlyerjen e Zotit tonë Jezu Krisht. Unë kam disa sugjerime të posaçme që, nëse ndiqen, besoj se mund të na ndihmojnë të jemi më rezultativë me familjet tona dhe në thirrjet tona në Kishë.

*Së pari, përqendrohuni në gjërat themelore.* Ne sigurisht kemi mësuar mbi këto gjëra themelore gjatë kësaj konference. Ata që japin mësim duhet të sigurojnë që doktrina të ruhet e pastër dhe se ajo jepet mësim. Jepni mësim nëpërmjet Shpirtit, duke përdorur shkrimet e shenjta dhe programin e miratuar. *Mos* paraqisni apo qëndroni në çështje spekulative apo të diskutueshme. Studioni mësimet e kësaj konference në mbrëmje familjare në shtëpi dhe në diskutime në familje; ato do të forcojnë shtëpitë tuaja. Në një botë që është e mbushur me mëkat, konflikt dhe pështjellim, ne mund të gjejmë paqe dhe siguri në njohjen dhe jetën sipas të vërtetave të zbuluara të ungjillit.

*Së dyti, përqendrohuni tek njerëzit.*

Koordinimi dhe grafiku kalendarik kanë kohën dhe vendin e vet, por ka me tepri mbledhje këshilli që fillojnë dhe mbarojnë atje. Në vend që të recitohet një përsëritje planesh dhe raportesh organizative, kaloni shumicën e kohës në mbledhje këshilli duke rishikuar nevojat e anëtarëve të veçantë. Kur bëhet kjo, konfidencialiteti është vendimtar. Anëtarët e këshillit duhet t'i ruajnë të gjitha çështjet që diskutohen në mbledhjet e këshillit në një konfidencë strikte.

*Së treti, nxitni shprehjen e lirë dhe të hapur.* Një shprehje e tillë është thelbësore nëse duhet të arrijmë qëllimin e këshillave. Udhëheqësit dhe prindërit duhet të vendosin një klimë që është favorizuese për të qenë i hapur, ku çdo person është i rëndësishëm dhe çdo opinion vlerësohet. Zoti këshilloi: “Njëri duhet të flasë në një kohë dhe të gjithë të dëgjojnë thëniet e tij, që kur *të gjithë* të kenë folur, *të gjithë* të jenë lartësuar” (DeB 88:122; kursivet shtuar). Udhëheqësit duhet të japin kohën e nevojshme për mbledhjet e këshillave dhe duhet të kujtohen se këshillat janë që udhëheqësit të dëgjojnë të paktën po aq sa edhe flasin.

*Së katërti, pjesëmarrja është një privilegj.* Me këtë privilegj vjen përgjegjësia – përgjegjësi për të punuar brenda parametrave të organizatës, për të qenë i përgatitur, për të treguar, për të mbrojtur fuqishëm pozitën që besoni se është e drejtë. Por, pikërisht po aq e rëndësishme është përgjegjësia për të mbështetur dhe mbrojtur vendimet përfundimtare të udhëheqësit të këshillit, madje edhe nëse nuk jeni plotësisht dakord.

Presidenti Dejvid O. Mek-Kei tregoi për një mbledhje të Këshillit Të Dymbëdhjetë Apostujve ku diskutohej një çështje me rëndësi serioze. Ai dhe Apostuj të tjerë ndienin fuqishëm mbi një drejtim të caktuar veprimi që duhej ndër marrë dhe ishin të përgatitur të shfaqnin ndjenjat e tyre në një mbledhje me Presidencën e Parë. Për befasinë e tyre, Presidenti Jozef F. Smith nuk pyeti mbi opinionin e tyre rreth çështjes, siç ishte zakoni i tij. Por, “ai u ngrit dhe tha: ‘Kjo është ajo që Zoti dëshiron’.

Edhe pse ajo nuk ishte saktësisht në përputhje me atë çka kishte vendosur”, shkroi Presidenti Mek-Kei, “Presidenti i Të Dymbëdhjetëve ... ishte i pari që u ngrit dhe tha: ‘Vëllezër, unë kërkoj që kjo të bëhet opinionin dhe vendimi i këtij Këshilli.’

‘Jam dakord’, tha një tjetër dhe vendimi ishte unanim. Nuk kaluan as gjashtë muaj përpara se urtësia e atij udhëheqësi të dukej” (*Gospel Ideals* [Salt Lake City: Improvement Era, 1953], f. 264).

Kur një udhëheqës këshilli arrin në një vendim, anëtarët e këshillit duhet ta mbrojnë atë me gjithë zemër.

*Së pesti, udhëhiqni me dashuri.* Jezusi na mësoi se urdhërimi i parë dhe më i madhi në ligj është: “Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde’ ... Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: ‘Duaje të afërmin tënd porsì vetveten’ ” (Mateu 22:37, 39).

Udhëheqësit e priftërisë duhet të udhëheqin nëpërmjet “bindjes, ... durimit, ... mirësjelljes e zemërbutësisë dhe ... dashurisë së pashtirur; ... mirësisë dhe diturisë së pastër” (DeB 121:41–42). Këto janë parimet që duhet të na udhëheqin në marrëdhëniet tona si fqinjë në Kishën e Jezu Krishtit.

Ata që mbajnë priftërinë nuk duhet të harrojnë kurrë se nuk kanë asnjë të drejtë ta tundin autoritetin e priftërisë si kopaçe mbi kokat e të tjerëve në familje apo në thirrjet e Kishës. Zoti i tha Jozef Smithit që “kur përpiqemi t’i mbulojmë mëkatet tona ose të kënaqim krenarinë tonë, ambicien tonë të kotë ose të ushtrijmë kontroll apo sundim, apo detyrim mbi shpirtrat e fëmijëve të njerëzve, në çfarëdo shkallë padrejtësie, vini re, qiejt tërhiqen; Shpirti i Zotit hidhërohet; dhe kur ai tërhiqet, Amen priftërisë ose autoritetit të atij njeriu” (DeB 121:37).

Me fjalë të tjera, kushdo që pretendon fuqi të posaçme nga qielli për qëllimet e veta egoiste dhe kërkon ta përdorë priftërinë në çfarëdo shkalle padrejtësie në Kishë apo në shtëpi, ai thjesht nuk kupton natyrën e autoritetit të tij. Priftëria është për shërbim, jo robërim; dhembshuri, jo detyrim; përkujdesje, jo kontroll. Ata që mendojnë ndryshe janë duke vepruar jashtë parametrevë të autoritetit të priftërisë.

Fatmirësisht, shumica e baballarëve dhe e zyrtarëve tanë të priftërisë udhëheqin me dashuri, ashtu siç bëjnë shumica e nënave dhe e udhëheqëseve të organizatave ndihmëse. Udhëheqja e bazuar në dashuri sjell forcë të pabesueshme. Është e vërtetë, ajo sjell rezultate të qëndrueshme në jetën e fëmijëve të Atit tonë.

### **Arrini konsensus dhe unitet të frymëzuar**

Perëndia ju bekoftë, vëllezër dhe motra, për të gjetur konsensus dhe unitet ndërsa këshilloheni së bashku në shërbimin tuaj ndaj njëri-tjetrit. Vetëm duke bërë kështu, mundet që Kisha dhe

familjet tona të fillojnë t’i afrohen potencialit të tyre të plotë për të bërë mirë midis fëmijëve të Perëndisë në tokë.

Unë e di se Perëndia jeton dhe se Jezusi është Krishti. Unë e di se ne mund të përmbushim punën e tyre më mirë në unitet dhe dashuri ndërsa jemi në këshill me njëri-tjetrin. Qofshim të bekuar që të veprojmë kështu është lutja ime e përlurur në emrin e Jezu Krishtit, amen.



### **Plaku M. Rasëll Ballard**

*Nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve*

*“Counseling with Our Councils”, në Conference Report, prill 1994, f. 31–34; ose Ensign, maj 1994, f. 24–26).*

### **Një motor i fazuar mirë**

Përpara se të thirresha si Autoritet i Përgjithshëm, unë merresha me biznes makinash, ashtu si babai im para meje. Gjatë viteve unë mësova të vlerësoj zhurmën dhe funksionimin e një motori të fazuar mirë. Për mua ajo është gati muzikore, nga zukatja e butë e një motori pa ngarkesë të buçitja dridhëse e një motori në ngarkesë të plotë. Fuqia që përfaqëson ai tingull është edhe më emocionuese. Asgjë nuk krahasohet krejt njësoj si të qëndrosh prapa timonit të një makine të shkëlqyer kur motori punon me rrotullime maksimale me pjesët e montuara që punojnë së bashku në një harmoni të përsosur.

Nga ana tjetër, asgjë nuk është më ngacmuese se një motor makine që nuk po punon siç duhet. Nuk ka rëndësi sa e bukur është ngjyra apo sa të rehatshme janë paisjet brenda, një makinë me një motor që nuk punon siç duhet është thjesht guaskë e një potenciali të porealizuar. Një motor makine do të funksionojë me vetëm një pjesë të cilindrave, por kurrë nuk do të shkojë aq larg apo aq shpejt, as udhëtimi nuk do të jetë aq i shtruar, siç ndodh kur është fazuar mirë.

### **Lagja me një cilindër**

Fatkeqësisht, disa lagje në Kishë po rrahin në vetëm disa cilindra, përfshi disa që përpiqen të veprojnë vetëm me një. Lagja me një cilindër

është lagjja ku peshkopi i trajton të gjitha problemet, merr të gjitha vendimet dhe ndjek çështjet në të gjitha detyrat. Pastaj, si një cilindër i tejpendorur në një motor makine, ai shpejt bëhet i paaftë për punë.

Peshkopët tanë kanë kërkesa të rënda mbi vete. Ata – dhe vetëm ata – mbajnë disa çelësa dhe vetëm ata mund të përmbushin disa përgjegjësi. Por ata nuk janë thirrur të jenë gjithçka, në çdo kohë, për të gjithë njerëzit. Ata janë thirrur të kryesojnë dhe të udhëheqin, dhe të shtrijnë dashurinë e Perëndisë tek fëmijët e Tij. Ati ynë Qiellor nuk pret që ata të bëjnë çdo gjë vetë.

E njëjta gjë është edhe për presidentët tanë të kunjit, të kuorumit të pleqve dhe të organizatave ndihmëse, dhe, për atë çështje, për nënat dhe baballarët. Të gjithë kanë kujdestari që kërkojnë shumë nga koha, talenti dhe energjia e tyre. Por asnjë nuk lihet ta bëjë vetëm. Perëndia, Organizatori Mësues, ka frymëzuar krijimin e një sistemi komitetesh dhe këshillash. Nëse kuptohet dhe vihet në përdorim siç duhet, ky sistem do të pakësojë ngarkesën mbi të gjithë udhëheqësit e veçantë dhe do ta zgjerojë arritjen dhe ndikimin e shërbesës së tyre nëpërmjet ndihmës së kombinuar nga të tjerë.

### **I përdorni me urtësi këshillat**

Gjashtë muaj përpara unë qëndrova në këtë foltore dhe fola mbi rëndësinë e sistemit të këshillave në Kishë. Unë fola mbi forcën e madhe shpirtërore dhe drejtimin e frymëzuar që vjen nga këshilla familjeje, lagjeje dhe kunji që drejtohen siç duhet. Shpirti vijon të më mësojë se sa jetike janë këshilla Kishe, që punojnë në mënyrë rezultative, për përmbushjen e misionit të Kishës. Për këtë arsye, unë kam qenë i paduruar të shoh se si u kuptuan vërejtjet e mia në tetor, veçanërisht nga peshkopët tanë besnikë dhe të zellshëm.

Gjatë seancave të trajnimit që kam drejtuar në vende të ndryshme që nga konferenca e fundit e përgjithshme, unë e kam përqendruar vëmendjen te këshilli i lagjes. Si pjesë e atij trajnimit, unë ftova një këshill lagjeje të merrte pjesë. Unë i dhashë peshkopit një problem mësimor mbi një familje pak aktive dhe i kërkoja të përdorte këshillin e lagjes për hartimin e një plani për ta aktivizuar këtë familje.

Pa përjashtim, peshkopi merrte menjëherë situatën përsipër dhe thoshte: “Këtu ka një problem dhe ja çfarë mendoj se duhet të bëjmë për ta zgjidhur”. Pastaj ai u ngarkonte detyra anëtarëve të ndryshëm të këshillit të lagjes. Ky ishte një shembull i mirë lidhur me autorizimin, mendoj, por ai as që filloi të përdorte përvojën dhe urtësinë e anëtarëve të këshillit për kërkimin e zgjidhjeve të problemit.

Në fund i kërkoja peshkopit të përqij për-sëri, vetëm këtë radhë të kërkonte ide dhe rekomandime nga anëtarët e këshillit të tij përpara se të caktonte ndonjë detyrë. Unë e nxita veçanërisht të pyeste motrat për idetë e tyre. Kur peshkopi hapi mbledhjen me anëtarët e këshillit dhe i ftoi ata të këshilloheshin së bashku, efekti ishte si të hapje portat e qiellit. Një rezervuar mendimesh dhe frymëzimesh befas filloi të derdhej midis anëtarëve të këshillit kur planifikonin për shoqërimin e familjes pak aktive.

Ndërsa vëreja po këtë skenar të luajtur përpara meje herë pas here gjatë gjashtë muajve të fundit, krijova bindjen se do të ishte e dobishme të flisja edhe një herë mbi rëndësinë e këshillave. Unë flas jo që të qortoj ata që nuk i kushtuan vëmendje serioze herën e fundit, por sepse ne kemi një nevojë urgjente për udhëheqës në Kishë, veçanërisht për presidentë kunji dhe peshkopë, për të përdorur dhe drejtuar forcën shpirtërore nëpërmjet këshillave. Problemet e familjes, të lagjes dhe të kunjit mund të zgjidhen nëse kërkojmë zgjidhje sipas mënyrës së Zotit.

Në përvojën time, jeta bekohet kur udhëheqësit përdorin me urtësi komitetet dhe këshillat. Ata e çojnë përpara punën e Zotit shumë më shpejt dhe më larg, ashtu si një makinë e cilësore punon me rendiment maksimal. Anëtarët e komitetit dhe të këshillit janë të bashkuar. Së bashku ata përjetojnë një udhëtim shumë më të këndshëm përgjatë autostradës së shërbimit të Kishës.

### **Tre komitete dhe këshilla të lagjes**

Për qëllimin tim sot, më lejoni të rishikoj tre komitete dhe këshilla të lagjes që gjithmonë duhet të ndjekin një program të parapërgatitur.

I pari është *komiteti ekzekutiv i priftërisë*. Ai përbëhet nga këshilli i peshkopit, udhëheqësi i grupit të priftërinjve të lartë, presidenti i kuorumit të pleqve, udhëheqësi i misionit të lagjes,

presidenti i Të Rinjve, sekretari ekzekutiv i lagjes dhe nëpunësi i lagjes. Ky komitet mblidhet çdo javë nën drejtimin e peshkopit për të shqyrtuar programet e priftërisë të lagjes, përfshirë historinë e tempullit dhe të familjes, punën misionare, ndihmat, mësimin e shtëpisë dhe aktivizimin e anëtarëve.

I dyti është *komiteti i ndihmave i lagjes*. Ai përfshin komitetin ekzekutiv të priftërisë dhe presidencinë e Shoqatës së Ndihmës. Ky komitet mblidhet të paktën një herë në muaj, përsëri nën drejtimin e peshkopit, për të shqyrtuar nevojat materiale të anëtarëve të lagjes. Vetëm peshkopi mund të caktojë burime ndihmash, por komiteti ndihmon në kujdesin për të varfrit duke planifikuar dhe koordinuar përdorimin e burimeve të lagjes, përfshirë kohën, talentet, aftësitë, materialet dhe shërbimin me dhembshuri nga anëtarët të lagjes. Në këtë dhe në mbledhje të tjera komiteti dhe këshilli, shpesh diskutohen çështje delikate, që kërkojnë konfidencialitet strikt.

I treti është *këshilli i lagjes*. Ai përfshin komitetin ekzekutiv të priftërisë; presidentët e Shoqatës së Ndihmës, Shkollës të së Dielës, të Të Rejave e të Fillores dhe kryetarin e komitetit të aktiviteteve. Peshkopi mund të ftojë të tjerë të marrin pjesë sipas nevojës. Ky këshill mblidhet të paktën një herë në muaj për të bashkërenduar planifikimin e të gjitha programeve dhe aktiviteteve të lagjes dhe për të këqyruar përparimin e lagjes në përmbushjen e misionit të Kishës. Këshilli i lagjes sjell së bashku një grup udhëheqësish të ndryshëm priftërie dhe të grave për t'u përqendruar në një gamë të gjerë çështjesh që ndikojnë tek anëtarët e lagjes dhe të komunitetit. Këshilli rishikon sugjerime nga mësuesit e shtëpisë dhe mësueset e vizitave...

### **Përdorimi i këshillave për të ndihmuar mbajtjen e të kthyerve**

Një shqetësim madhor i Autoriteteve të Përgjithshme është mungesa e mbajtjes në shoqërim të plotë të disa të kthyerve të rinj dhe të atyre që janë pak aktivë në Kishë. Nëse këshillat e lagjes funksionojnë siç duhet, çdo i kthyer i ri do të shoqërohet, do të ketë mësues shtëpie apo mësuese vizitash dhe do të marrë një thirrje të përshtatshme brenda pak ditësh pas pagëzimit. Pak aktivët do të marrin thirrje që i sigurojnë ata

se janë të nevojshëm dhe të dashur për anëtarët e lagjes...

### **Bëhuni një grup që zgjidh probleme**

Kur presidentët e kunjit dhe peshkopët lejojnë udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse, që Zoti i ka thirrur të shërbejnë me ta për t'u bërë pjesë e një grupi që zgjidh probleme, gjëra të mrekullueshme fillojnë të ndodhin. Pjesëmarrja e tyre zgjeron bazën e përvojës dhe të kuptimit, duke çuar në zgjidhje më të mira. Ju peshkopë i gjallëroni udhëheqësit e lagjes duke u dhënë shans të ofrojnë sugjerime dhe të dëgjojnë. Ju përgatitni udhëheqës të ardhshëm duke u lejuar atyre të marrin pjesë dhe të mësojnë. Ju mund të hiqni shumë nga barra që keni mbi shpatulla nëpërmjet kësaj lloji përfshirjeje. Njerëzit që ndihen përgjegjës për zgjidhjen e një problemi janë më të gatshëm të ndihmojnë gjetjen e një zgjidhjeje, duke e rritur shumë mundësinë për sukses.

Sapo këshillat e duhura të organizohen dhe vëllezërit e motrat të kenë mundësi të plotë të kontribuojnë, udhëheqësit e lagjes dhe të kunjit mund të shkojnë më tej se thjesht mbajtja e organizatave. Ata mund të përqendrojnë përpjekjet e tyre në gjetjen e mënyrave për ta bërë botën e tyre një vend më të mirë për të jetuar. Sigurisht, këshillat e lagjeve mund të shqyrtojnë tema të tilla si dhuna e grupeve me të rinj, siguria për fëmijët, degradimi i ndërtesave, apo fushatat e pastrimit në komunitet. Peshkopët mund të pyesin këshillat e lagjes: "Si mund të sjellim ndryshim në komunitetin tonë?" Një mendim dhe pjesëmarrje e tillë e gjerë në përmirësimin e komunitetit janë gjëra të drejta që të bëhen nga shenjtorët e ditëve të mëvonshme.

### **Si këshillohen Apostujt së bashku**

Gjatë tetë vjetëve e gjysmë të fundit unë kam shërbyer si anëtar i një këshilli me dymbëdhjetë burra. Ne vijmë nga mjedise të ndryshme dhe sjellim në Këshillin e Dymbëdhjetë Apostujve një gamë të ndryshme përvojash në Kishë dhe në botë. Në mbledhjet tona ne nuk ulemi thjesht përreth dhe të presim që Presidenti Hauard W. Hanter të na tregojë çfarë të bëjmë. Ne këshillohemi hapur me njëri-tjetrin dhe dëgjojmë njëri-tjetrin me respekt të thellë për aftësitë dhe

përvojat që vëllezërit tanë sjellin në këshill. Ne diskutojmë një gamë të gjerë çështjesh, nga administrimi i Kishës deri tek ngjarjet e botës dhe ne e bëjmë këtë kaq me sinqeritet dhe hapur. Ndonjëherë ne diskutojmë çështje për javë të tëra para se të arrijmë një vendim. Ne jo gjithnjë biem dakord gjatë diskutimeve tona. Por sapo merret një vendim, ne gjithnjë jemi edhe të bashkuar edhe të vendosur.

### **Dëgjoni dhe arsyetoni në këshilla**

Kjo është mrekullia e këshillave të Kishës: dëgjimi i njëri-tjetrit dhe dëgjimi i Shpirtit! Kur mbështesim njëri-tjetrin në këshillat e Kishës, ne fillojmë të kuptojmë se si Perëndia mund t'i marrë burrat dhe gratë e zakonshëm dhe të krijojë prej tyre udhëheqës të jashtëzakonshëm. Udhëheqësit më të mirë nuk janë ata që punojnë vetë deri në dërrmim duke u përpjekur ta bëjnë çdo gjë vetë; udhëheqësit më të mirë janë ata që ndjekin planin e Perëndisë dhe *këshillohen* me *këshillat* e tyre.

“Ejani, pra”, tha Zoti në një periudhë më të hershme ungjillore nëpërmjet profetit Isaia, “dhe të diskutojmë bashkë” (Isaia 1:18). Dhe në këtë periudhë ungjillore Ai e përsëriti atë këshillë: “Le të diskutojmë së bashku, që ju të mund të kuptoni” (DeB 50:10).

Le të kujtojmë se këshilli bazë i Kishës është këshilli i familjes. Baballarët dhe nënat duhet të zbatojnë me zell parimet që kanë diskutuar në

marrëdhëniet me njëri-tjetrin dhe me fëmijët e tyre. Kur veprojmë kështu, shtëpitë tona mund të bëhen si një copë qiell mbi tokë.

Vëllezër dhe motra, le të punojmë së bashku si kurrë më parë në kujdestaritë tona për të gjetur mënyra për ta bërë më rezultativ përdorimin e forcës së mrekullueshme të këshillave. Unë ju kërkoj që t'i shqyrtoni të gjitha ato që thashë mbi këtë temë në tetorin e kaluar dhe ato që thashë sot. Unë dëshmoj se ne mund të sjellim gjithë forcën e planit të zbuluar të Perëndisë për qeverisjen e ungjillit në shërbesat tona duke u këshilluar së bashku. Na bekoftë Perëndia që të qëndrojmë të bashkuar duke forcuar Kishën dhe anëtarët tanë, lutem unë në emrin i Jezu Krishtit, amen.

### **NDIHMË PËR STUDIMIN**

- Në çfarë kuptimi Kisha dhe familja janë një shtrirje e këshillit paratokësor në qiell?
- Cili duhet të jetë “përqendrimi parësor i mbledhjeve të këshillit të kunjit dhe të lagjes”?
- Çfarë është “sinergia shpirtërore”?
- Cilat janë disa shqetësime në të cilat këshillat e kunjit dhe të lagjes mund të përqendrohen siç duhet?
- Sipas Plakut Ballard, çfarë bëjnë udhëheqësit më të mirë të Kishës me këshillat e tyre?

## RËNDËSIA E DELEGIMIT

*“Por zgjidh në mes të të gjithë popullit disa njerëz të aftë që kanë frikë nga Perëndia, njerëz të besuar, që e urrejnë fitimin e padrejtë dhe vendosi mbi popullin si krerë të mijërave, krerë të qindrave, krerë të pesëdhjetrave dhe krerë të dhjetrave.*

*Dhe lejo që të jenë ata që do ta gjykojnë popullin në çdo kohë; ata do të të parashtrojnë çdo problem me rëndësi të madhe, ndërsa për probleme të vogla do të vendosin vetë. Kështu do të jetë më lehtë për ty, dhe ata do ta mbajnë peshën bashkë me ty” (Eksodi 18:21–22).*

### PARIME TË UDHËHEQJES

Udhëheqës të urtë përdorin parimin e delegimit për të ndihmuar ata të cilëve u shërbejnë të arrijnë qëllime të drejta dhe të bëhen më shumë si Jezu Krishti.

### KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Udhëheqës të urtë u delegojnë detyra dhe përgjegjësi kuptimplote atyre që udhëheqin.

#### KONCEPT 1: UDHËHEQËS TË URTË U DELEGOJNË DETYRA DHE PËRGJEGJËSI KUPTIMPLOTE ATYRE QË UDHËHEQIN.

##### KOMENT

Gjatë shërbesës së Tij në vdekshmëri, Jezu Krishti u delegoi përgjegjësi dishepujve të Tij dhe u dha atyre autoritet. Për shembull, Ai i autorizoi Apostujt e Tij të “shëro[jnë] të sëmurët, pastro[jnë] lebrozët, ngjall[in] të vdekurit, dëbo[jnë] demonët” (shih Mateu 10:5–8).

Apostulli Pal shkroi: “Dhe ai vetë i dha disa si apostuj, të tjerë si profetë, të tjerë si ungjilltarë dhe të tjerë si barinj e mësues,

për përsosjen e shenjtoreve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit” (Efesianëve 4:11–12).

Plaku Nil A. Maksuell, anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, shpjegoi se pas Ringjalljes së Krishtit, “Të Dymbëdhjetët ... kuptuan se ata nuk ishin thirrur të siguronin ushqim, por, përkundrazi, për të përhapur fjalën e Perëndisë nëpër botë. Prandaj, ata me urtësi deleguan detyrën e ndihmës tek të tjerë. Kështu nevojat e të vejave greke – që ishin të vërteta – u plotësuan, por pa sakrifikuar thirrjen më të lartë të Të Dymbëdhjetëve [shih Veprat e Apostujve 6:1–7]” (*We Will Prove Them Herewith* [1982], f. 110).

Profeti Jozef Smith dha shembullin e parimit të delegimit. Plaku Spenser J. Kondi, anëtar i Të Shtatëdhjetëve, vërejti: “Një forcë e madhe e Profetit ishte aftësia e tij për të deleguar dhe zhvilluar aftësi udhëheqëse tek ata që ishin përreth tij” (në Conference Report, mars–prill 1990, f. 35; ose *Ensign*, maj 1990, f. 28). Plaku Dallin H. Ouks, nga Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve, tha: “Një peshkop duhet të jetë një delegues i zoti, ose ai do të ndihet i mbytur nga pesha e përgjegjësive të tij apo i zhgënjyer duke parë aq shumë prej tyre të paplotësuara” (në Conference Report, prill 1997, f. 29; ose *Ensign*, maj 1997, f. 22).

Udhëheqësit e Kishës dhe të familjes mund të jenë edhe të gëzueshëm edhe kërkues. Fryma e Shenjtë forcon dhe gjallëron udhëheqësit, por udhëheqësit e urtë u delegojnë përgjegjësi njerëzve të cilëve u shërbejnë, sepse udhëheqësit nuk mund ta bëjnë çdo gjë vetë dhe sepse njerëzit zhvillohen më shumë kur bëhen pjesëmarrës.

Plaku Xhejms E. Faust, që ishte atëherë anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, na mësoi: “Një nga parimet e para që duhet të kemi parasysh është se puna e Zotit shkon përpara nëpërmjet detyrave. Udhëheqësit marrin dhe japin detyra. Kjo është një pjesë e rëndësishme e parimit të nevojshëm të delegimit” (në Conference

Report, tetor 1980, f. 50; ose *Ensign*, nëntor 1980, f. 34).

Plaku Nil A. Maksuell, atëherë anëtar i Presidencisë së Të Shtatëdhjetëve, sugjeroi arsyet e mëposhtme pse udhëheqësit ndonjëherë nuk arrijnë të delegojnë:

”1. Ne vërtet do të donim ta bënim atë vetë.

”2. Ne nuk jemi vërtet të gatshëm të përdorim kohën dhe talentet tona me qëllim që të trajnojmë të tjerët, që ata të mund të ndihmojnë.

”3. Ne nuk na pëlqen t’u kërkojmë të tjerëve që të ndihmojnë, duke harruar se marrja e ndihmës është po aq pjesë e ungjillit sa edhe dhënia e ndihmës.

”4. Neve na pëlqen të ndihemi pak të ngutur dhe të stresuar, sepse kjo na jep një ndjesi të gënjeshtërt të të qenit fisnikë.

”5. Ne themi se jemi të shqetësuar mbi ‘kontrollin e cilësisë’ nëse detyra është deleguar dhe ndonjëherë ka arsye të fortë për shqetësimin; herë tjetër, gjithsesi, ne në të vërtetë nuk shqetësohemi për detyra të kryera dobët, por të kryera tepër mirë.”

Plaku Maksuell na këshilloi: “Ndjesia që mund të kemi herë pas here si të mbytur nga detyrat ... është të paktën pjesërisht e shmangshme ... Ne mundemi, nëse zgjedhim më shpesh, të delegojmë, duke zhvilluar kështu të tjerët, përfshirë fëmijët tanë, më shumë dhe, në fund të fundit, duke pakësuar me këtë barrët e panevojshme mbi vete” (*Wherefore Ye Must Press Forward* [1977], f. 99–100).

Plaku Sterling W. Sill, që ishte atëherë Ndihmës i Të Dymbëdhjetëve, shkroi: “Një udhëheqës nuk e humbet autoritetin as përgjegjësinë e tij kur e delegon atë... Ai duhet të inspektojë; ai duhet të trajnojë; ai duhet të nxitë; ai duhet të mbikëqyrë atë të cilit i është dhënë përgjegjësia... Delegimi pa kontroll është papërgjegjshmëri” (*Leadership* [1958], f. 213).

#### IDE MËSIMORE

U kërkoni studentëve të përkufizojnë fjalën *delegoj*. (“T’i besosh dikujt tjetër një pjesë të përgjegjësisë tënde.”) Diskutoni se si zbatohet ky përkufizim në udhëheqjen në Kishë dhe në familje.

Ftojini studentët të gjejnë shembuj delegimi në shkrimet e shenjta. U thoni të tregojnë shembuj të delegimit të suksesshëm në kuadrin e familjes apo të Kishës. Diskutoni pse delegimi është një pjesë e rëndësishme e udhëheqjes në familje dhe në Kishë.

I ndani studentët në grupe të vegjël. Ftojini secilin grup të diskutojë epërsitë dhe mangësitë e delegimit. U thoni atyre të raportojnë konstatimet e tyre dhe pastaj i diskutoni ato si klasë.

Ftojini studentët të mendojnë sa i rëndësishëm është delegimi për udhëheqje rezultative. I nxitni ata të vërejnë se si udhëheqës në Kishë dhe në familje delegojnë përgjegjësi. Ftojini ata të mendojnë se çfarë përgjegjësish mundën dhe nuk mundën të delegojnë udhëheqësit dhe pse.

Diskutoni disa nga karakteristikat e deleguesve të suksesshëm. Për shembull, delegues të suksesshëm:

- U japin njerëzve detyra të qarta dhe të posaçme.
- Përcaktojnë çfarë duhet të bëhet, por jo saktësisht se si duhet bërë.
- U japin njerëzve autoritetin të përmbushin detyrat që u janë caktuar.
- Trajnojnë njerëz, nëse është e nevojshme, në aftësi që u nevojiten për të qenë të suksesshëm.
- Sigurojnë mjete dhe burime që u duhen njerëzve për të qenë të suksesshëm.
- Bëjnë mbikëqyrjen e duhur ndërsa njerëzit punojnë për të përmbushur detyrat e tyre.
- U japin sinqerisht kurajë dhe mbështetje njerëzve kur ata veprojnë mirë.
- Janë të gatshëm të japin këshillë dhe drejtim.
- Japin një mundësi për njerëzit që të raportojnë mbi detyrat që u janë caktuar.


Diskutoni çfarë mund të bëjnë udhëheqësit për t’u kujdesur që përgjegjësitë e deleguara të përmbushen. U thoni studentëve të lexojnë Eksodi 18:13–27. Diskutoni pyetje të tilla si:

- Çfarë shqetësimesh kishte Jethro lidhur me udhëheqjen e Moisiut?
- Si iu përgjigj Moisiu shqetësimeve të Jethros?

- Çfarë mund të mësojmë mbi udhëheqjen nga kjo përvojë e Moisiut?

Lexoni deklaratën e mëposhtme nga Presidenti Ezra Taft Benson, i cili ishte atëherë President i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve: “Kjo është organizatë e Zotit nëpërmjet së cilës ne veprojmë. Ne i kryejmë punët me punonjës vullnetarë – fëmijët e Atit tonë të cilët ai i do, pavarësisht nga gabimet dhe dobësitë e tyre. Nuk duhet të ketë forcë, shtrëngim apo frikësim në delegimin tonë. Që të jemi rezultativë, ne duhet të kërkojmë dhe të fitojmë Shpirtin nëse duhet të delegojmë me urtësi” (*God, Family, Country: Our Three Great Loyalties* [1974], f. 130).

## BURIME PËR MËSUESIN



**Presidenti N. Eldon Tanner**

*Këshilltar i Parë në  
Presidencinë e Parë*

*“The Message: Leading as  
the Savior Led”, New Era,  
qershor 1977, f. 4–7*

Me qëllim që të jemi udhëheqës apo mësues të suksesshëm (dhe unë do t’i përdor këto terma ndërkëmbyeshëm) në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, është e rëndësishme që çdo udhëheqës apo mësues të kuptojë plotësisht se ai është një fëmijë shpirtëror i Perëndisë dhe se ata që po udhëheq janë gjithashtu fëmijë shpirtërorë të Perëndisë. Është e rëndësishme gjithashtu që ata të cilët ai po i udhëheq të dinë dhe të kuptojnë se *ata* janë fëmijë shpirtërorë të Perëndisë dhe se kjo dije është me rëndësi në jetën e tyre. Ata duhet të kuptojnë se Perëndia është i interesuar për ta, do që ata të jetojnë ashtu siç duhet dhe është gati t’u përgjigjet lutjeve të tyre e t’i ndihmojë kurdo që është e mundur, nëse ata thjesht do të dëgjojnë.

Dikush ka thënë se udhëheqja lidhet me njëfarë guximi. Ajo është në thelb, në fund të fundit, tregimi i rrugës, dalja përpara, qëndrimi në krye të turmës, të kongregacionit, të një publiku prej mijëra vetësh pa portret, apo të shikimit mosbesues të vetëm një dyshuesi.

Çdokush është udhëheqës apo ka ndikim në jetën e të tjerëve edhe pse ai mund të mos e

kuptojë këtë. Çështja është: Çfarë lloj udhëheqësi do të jetë ai? Çfarë lloj ndikimi do të ketë ai?

Çdo individ duhet të marrë vendimin e vet lidhur me atë se çfarë lloji do të jetë. Ai duhet të jetë i vendosur të jetë i atij lloji që të mund të thotë siç tha Jezusi: “Eja e më ndiq dhe siç kam bërë unë, bëni edhe ju”, duke ditur që ai po udhëheq në rrugën e së vërtetës dhe të drejtësisë. Ky duhet të jetë qëllimi i çdo udhëheqësi.

Me qëllim që të udhëheqim ashtu siç udhëhoqi Jezusi, ne përballojmë shumë sfida. Një nga hapat e parë në përgjigje të këtyre sfidave është të kuptojmë se Krishti është model i udhëheqjes korrekte; dhe siç e pasqyrojnë shkrimet e shenjta jetën e tij dhe mësimet e tij, ato bëhen shembuj udhëheqjeje hyjnore. Që të udhëheqim siç udhëhoqi ai është e rëndësishme që të kërkojmë e të kuptojmë shkrimet e shenjta dhe t’i zbatojmë në jetën tonë. Ashtu siç tha Nefi, ne duhet t’i “përshita[sim] të gjitha shkrimet e shenjta për ne” (1 Nefi 19:23); dhe siç tha Zoti: “Të jetoni me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë” (DeB 84:44).

Në 3 Nefi ne lexojmë:

“Dhe të bekuar janë të gjithë ata që janë përndjekur për hir të emrit tim, pasi e tyrja është mbretëria e qiellit.

Dhe të bekuar jeni ju kur njerëzit do t’ju shajnë dhe përndjekin dhe do të thonë të gjitha të ligat në mënyrë të rreme kundër jush, për hirin tim.

Pasi ju do të keni gëzim të madh dhe do të jeni jashtëzakonisht të kënaqur, pasi i madh do të jetë shpërblimi juaj në qiell; pasi kështu i përndoqën ata profetët që qenë para jush.

Në të vërtetë, në të vërtetë, unë ju them juve, unë ju porosis që të jeni kripa e tokës, por në qoftë se kripa e humb shijen e saj, si do t’ia bëjë toka për kripë? Kripa, atëherë e tutje, nuk do të hyjë në punë për asgjë, veçse të flaket tej dhe të shkelet nga këmbët e njerëzve.

Dhe vini re, unë ju kam dhënë ligjin dhe urdhërimet e Atit tim, se do të besoni në mua dhe do të pendoheni për mëkatet tuaja dhe do të vini tek unë me zemër të thyer dhe me shpirt të penduar. Vini re, para jush ju keni urdhërimet dhe ligji është plotësuar.



Prandaj, ejani tek unë dhe shpëtohuni, pasi në të vërtetë unë ju them juve se, në qoftë se nuk zbatoni urdhërimet e mia që ju urdhërova në këtë kohë, ju nuk do të hyni në asnjë mënyrë në mbretërinë e qiellit.” (3 Nefi 12:10–13, 19–20.)

Kur Krishti erdhi në tokë për të shpëtuar njerëzimin që ata të mund të ktheheshin të jetonin përsëri me Atin e tyre në qiell, ai nuk tha: “Unë do t’i bindem këtij ligji, por nuk do t’i bindem atij ligji.” Ai nuk tha, lidhur me urdhërimet: “Këtë do ta bëj; atë nuk do ta bëj.” Megjithë përjetimin dhe dhimbjen, dhe vuajtjen e tij në Kopshtin e Gjetsemanit ai duroi deri në fund dhe dha jetën e tij që njeriu të mund të ketë pavdekësi dhe jetë të përjetshme.

Është aq e rëndësishme që ne të mësojmë të bindemi dhe të mbajmë urdhërimet e Perëndisë. Është thënë se bindja nuk është shenja e skllavit; ajo është një nga cilësitë kryesore të udhëheqjes.

Disa njerëz nuk ia dalin të bëhen udhëheqës të mëdhenj sepse ata nuk kanë mësuar të ndjekin udhëzime – madje mësimet e Jezu Krishtit. Me qëllim, atëherë, që të udhëheqim ashtu siç udhëhoqi Jezusi, ne duhet së pari të mësojmë të ndjekim Krishtin ashtu siç ai ndoqi Atin e tij në qiell. Ne duhet të mbajmë parasysh ato qëllime të përjetshme të cilat përmenda dhe si fëmijë shpirtërorë të Perëndisë të bëhemi më shumë si ai derisa të jemi të përsosur. Jo thjesht të besojmë në Krisht, por ta ndjekim atë. Le ta adhurojmë atë dhe gjithmonë të jemi të bindur ndaj mësimëve të tij.

Kur Jozef Smithin e pyetën se si i qeveriste njerëzit e tij aq mirë, ai u përgjigj: “Unë u mësoj atyre parimet e drejta dhe ata qeverisen vetë.” Ky është thelbi i qasjes së Zotit tek udhëheqja, duke nënkuptuar se ne duhet të sigurohemi që po japim mësim parimet e drejta me një dëshmi dhe kuptim të ungjillit. Të kuptuarit e parimeve të ungjillit mundëson pafund më shumë liri dhe rritje sesa vetëm trajnimi në procedura.

Kur u pyet për ndryshimin midis një komanduesi dhe një udhëheqësi, dikush shpjegoi se komanduesi i shtyn njerëzit e tij, ndërsa udhëheqësi u prin atyre. Dikush ka thënë: “Njerëzit janë si makaronat spageti: Nëse dilni përpara dhe tërhiqni, ata do t’ju ndjekin nga pas; por nëse ju

qëndroni prapa dhe shtyni, ato të gjitha do të mblidhen shuk.”

Një udhëheqës në Kishë është gjithashtu mësues dhe një nga mjetet më të mëdha në mësimdhënie është shembulli, mjeti që e përdori gjithnjë Krishti. Një burrë i urtë njëherë vërejti: “Veprimet tuaja flasin kaq fort sa që nuk mund të dëgjoj çfarë thoni.” Edhe pse mund të mos jemi të vetëdijshëm për këtë, mësimdhënia jonë nëpërmjet shembullit bëhet më bindëse sesa ajo që japim me synim nëpërmjet udhëzimit dhe ajo do të lërë një ndikim shumë më të qëndrueshëm tek vëzhguesi. Që të jetë udhëheqës apo mësues rezultat, njeriu duhet të tregojë dashuri dhe vërtet të ndiejë dashuri për personin që po përpiqet ta udhëzojë. Asnjë forcë nuk është aq motivuese sa forca e dashurisë. Krishti donte çdo njeri – të dobtin, mëkatarin, të drejtin. Ndonjëherë ata që kanë nevojë t’i duan më shumë janë ata që duken se e meritojnë më pak. Edhe pse mund të mos e vlerësojmë apo miratojmë atë që bën dikush, ne duhet përsëri të tregojmë dashuri për personin.

Në raste të tilla një udhëheqësi i duhet durim dhe mirëkuptim. Ai nuk mundet të veprojë gjithnjë me ngut dhe ai kurrë nuk duhet të reagojë me tepri. Të gjithë njerëzit nuk mund të lëvizin me ritmin e tij. Presidenti Jozef F. Smith tha:

“Tek udhëheqësit padurimi me tepri dhe një mendje e zyrtë janë thuajse të pafalshme dhe ndonjëherë kërkohet po aq kurajë të presësh sa edhe të vepros. Është për të shpresuar, atëherë, që udhëheqësit e njerëzve të Perëndisë dhe vetë njerëzit, nuk do të ndiejnë se duhet të kenë menjëherë një zgjidhje për çdo çështje që shfaqet për të prishur ritmin e shtruar të stilit të tyre.” (*Gospel Doctrine*, Deseret Book Co., 1939, f. 156.)

Një hap tjetër shumë i rëndësishëm në udhëheqje është delegimi. Atyre që u delegohet duhet t’u jepet një kujdestari kuptimplote. Caktimi i kujdestarisë është detyra e udhëheqësit. Çdo individ duhet të pranojë kujdestarinë e caktuar dhe të angazhohet në kryerjen e detyrave siç i është mësuar. Atij duhet t’i jepet autoriteti si dhe përgjegjësia. Sokrati thuhet të ketë thënë: “Çfarëdo detyre që do të më caktonit, unë do të vdisja njëmijë herë më parë se ta braktisja atë.”

Një udhëheqës nuk duhet të përpiqet kurrë që të bëjë punën e atij, të cilit i ka caktuar një detyrë. Siç ka thënë Presidenti Harlold B. Li: “Le t’i lëmë ata të bëjnë gjithçka brenda fuqive të tyre dhe ju qëndroni prapa dhe u mësoni si ta bëjnë atë. Unë mendoj se aty është sekreti i rritjes, të caktojme përgjegjësi dhe pastaj t’i mësojmë njerëzit tanë si ta mbajnë atë përgjegjësi.”

U jepni liri të bëjnë detyrën e tyre. Kurrë mos i kritikoni, por lavdëroni për suksesin dhe nxisni përpjekjet.

Ne duhet ta bëjmë çdo person të kuptojë rëndësinë e madhe të thirrjes së tij. Një udhëheqës nuk duhet të jetë kurrë person, të cilit i referohen apo mendohet si bos, por ashtu si dha mësim Shpëtimtari, një njeri që u shërben njerëzve. Ai tha: “Dhe më i madhi prej jush le të jetë shërbëtori juaj” (Mateu 23:11) dhe na dha shembullin e madh kur u lau këmbët dishepujve të tij. Ai tha gjithashtu: “Kush do të lartësojë veten, do të poshtërohet; dhe kush do të përulë veten, do të lartësohet”. (Mateu 23:12.)

Unë kujtoj Presidentin Hiber J. Grant të thoshte aq shpesh se ai nuk do t’i caktonte ndokujt një detyrë për të bërë një punë që ai vetë nuk do të ishte i përgatitur ta bënte.

Një udhëheqës i mirë shqetësohet për mirëqenien e ndjekësve të tij apo të atyre që u shërben. Si ministër kabineti në qeverinë e provincës së Albertës, mua më duhej të merrja shumë vendime të vështira. Unë gjithnjë pyesja veten: “Cila është më e mira për provincën, për njerëzit që do të ndiejnë efektet dhe për punonjësit e departamentit?” Unë gjithashtu diskutoja problemet me udhëheqësit e seksioneve të ndryshme të departamentit, veçanërisht me ata që prekeshin dhe i bëja të ndienin se ata po merrnin të paktën diçka nga përgjegjësia, pas së cilës gjithnjë shkoja tek Zoti për drejtim dhe e merrja atë, dhe isha në gjëndje të merrja vendime që ndryshe nuk do të mund t’i merrja.

Si udhëheqës ne duhet të kuptojmë se Zoti ka thënë: “Kjo është vepra ime dhe lavdia ime—të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut”. (Moisiu 1:39.) Ai tha gjithashtu: “Prandaj, ngaqë jeni vetëveprues, ju jeni në punën e Zotit; dhe çdo gjë që e bëni sipas vullnetit të Zotit, është puna e Zotit”. (DeB 64:29.)

Po, ne si udhëheqës *jemi* në punën e tij dhe duhet t’i kushtojmë vëmendjen më të madhe rritjes vetjake të çdo individit nëpërmjet mësimdhënies së parimeve të drejta dhe të përpiqemi ta udhëheqim atë individ të përgatitë veten për përjetësinë dhe jetën e përjetshme. Këtë duhet ta bëjmë nëpërmjet shembullit e udhëzimit dhe pastaj të përgatitemi ta ndihmojmë dhe ta mbështesim në përpjekjet e tij, por duhet ta lëmë atë të marrë vendimet e veta dhe ta drejtojë veten sipas lirisë së zgjedhjes që është dhuratë e tij.

Le të kujtojmë fjalët që Zoti i tha Jozef Smithit lidhur me kujdestarinë: “Kërkohet prej Zotit, nga dora e çdo kujdestari, të bëjë një rrëfim të kujdestarisë së tij, si në kohë, edhe në përjetësi.” (DeB 72:3.)

Kur një udhëheqës cakton një detyrë, ajo duhet të kuptohet qartë, me zonën e përgjegjësisë të përcaktuar qartë dhe pastaj individ duhet të jetë i lirë të veprojë dhe të përmbushë detyrën, me kohën e caktuar të vendosur për një raportim mbi përparimin apo përfundimtar. Një llogari duhet të jepet gjithnjë tek udhëheqësi dhe ai duhet ta presë një llogaridhënie të tillë.

Në administratën e Kishës mjete bazë për përgjegjshmërinë është intervista vetjake. Në se marrëdhënia midis të intervistuarit dhe intervistuesit është ashtu siç duhet të jetë, kjo mund të jetë një përvojë shumë shpërblyese për të dy palët, ku është rasti të jepet një vetëvlerësim dhe ku komunikimi duhet të jetë i hapur dhe konstruktiv. Ai është një mjedis ideal për të ofruar dhe marrë ndihmë dhe mbështetje.

Përvoja ime në qeveri dhe në botën e biznesit, si dhe në Kishë ka nxjerrë në pah këtë nevojë të madhe për delegim të përshtatshëm të autoritetit, ndjekjen lidhur me këtë dhe marrjen e një raportimi.

Ne mund të mbajmë parasysh shtatë hapa që Krishti ndoqi për delegimin.

I pari, organizimi i kishës që krijoi Jezusi ishte ndërtuar në një kuadër autoriteti të deleguar.

I dyti, në delegim Jezusi nuk bënte që detyrat të ngjanin të lehta, por bënte që të ngjanin emocionuese dhe sfiduese.

I treti, Jezusi u bëri të mundur atyre që thirri, të njihnin dhe të kuptonin plotësisht detyrat e tyre.

I katërti, Jezusi u dha besim të plotë të autorizuarve, ashtu siç i kishte dhënë atij ati i tij.

I pesti, Jezusi u dha atyre që thirri besnikërinë e tij dhe priste të tyren në këmbim.

I gjashti, Jezusi priste shumë nga ata të cilëve u delegonte përgjegjësi dhe ishte i përgatitur të jepte shumë.

I shtati, Jezusi na mësoi se kush udhëheq, duhet të ndjekë përparimin e atyre që u është deleguar përgjegjësi dhe të marrë raportim prej tyre, duke lavdëruar dhe bërë vërejtje sipas nevojës me një shpirt dashurie...

Xhorxh Uashington, në fjalën e tij të lamtumirës drejtuar bashkatdhetarëve të tij, i paralajmëroi kundër idesë se mund të kishin pasur një demokraci të madhe pa një besim dhe bindje të thellë në Perëndi...

Uinston Çerçilli theksoi: “Ne duhet të bëhemi të vetëdijshëm se flaka e etikës së krishterë është ende udhëzuesi ynë më i lartë... Përmbushja e detyrës shpirtërore në jetën tonë të përditshme është jetike për mbijetesën tonë”.

Në thelb ata po thonë të njëjtën gjë – shpresa jonë e vetme për madhështi qëndron te ndjekja e shembullit të Krishtit. Që të jetë një udhëheqës i madh, atëherë, njeriu duhet të bëjë sa vijon:

E para, ta shohë Shpëtimtarin tonë si shembullin e përsosur të udhëheqjes.

E dyta, të pranojë rolin e mësuesit dhe të shërbëtorit.

E treta, të kërkojë në shkrimet e shenjta për parime të drejta.

E katërta, të lutet për drejtim, të dëgjojë dhe të përgjigjet.

E pesta, të ndihmojë individët të zhvillojnë vetëqeverisjen.

E gjashta, të kërkojë llogari nga individët për punën e tyre.

E shtata, të shprehë vlerësim me vend.

E teta, të japë shembull vetjak në përputhje me atë që u mëson të tjerëve.

E nënta, të dëgjojë zërin e Presidentit të Kishës, i cili është profet i Perëndisë, dhe të ndjekë këshillën dhe shembullin e tij.

#### **NDIHMË PËR STUDIMIN**

- Sipas Presidentit Taner, çfarë duhet të bëjë një udhëheqës që të delegojë siç duhet?
- Si duhet të veprojë një udhëheqës lidhur me caktimin e përgjegjësive njerëzve dhe përcaktimin se si ata duhet t'i përmbushin ato përgjegjësi?
- Çfarë roli duhet të luajë intervista vetjake për përgjegjshmërinë? Cilat janë karakteristikat e një interviste të mirë vetjake?

## PARIME TË VENDIMARRJES

*“Në të vërtetë unë them, njerëzit duhet të përfshihen me zell në një kauzë të mirë dhe të bëjnë shumë gjëra me vullnetin e tyre të lirë e të shkaktajnë shumë drejtësi;*

*Sepse është në ta fuqia, me anë të së cilës ata janë veprues për veten. Dhe për aq sa njerëzit të bëjnë mirë, ata në asnjë mënyrë s’do ta humbasin shpërblimin e tyre” (DeB 58:27–28).*

### PARIME TË UDHËHEQJES

Aftësia për vendimmarrje të mirë është e nevojshme për një udhëheqje si ajo e Krishtit.

### KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Udhëheqësit duhet të jenë të aftë të marrin vendime të urta.

#### KONCEPT 1. UDHËHEQËSIT DUHET TË JENË TË AFTË TË MARRIN VENDIME TË URTA.

##### KOMENT

“Marrja e vendimeve është ndoshta gjëja më e rëndësishme që bëjnë ndonjëherë njerëzit”, na mësoi Presidenti Ezra Taft Benson, i cili ishte atëherë President i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve. “Asgjë nuk ndodh deri sa njeriu merr vendim...”

Fatmirësisht aftësia dhe gjykimi i nevojshëm për të marrë vendime mund të fitohen” (*God, Family, Country: Our Three Great Loyalties* [1974], f. 145). Shih seksionin Burime për Mësuesin për sugjerime nga Presidenti Benson mbi mënyrën e mësimit për të marrë vendime të urta.

##### IDE MËSIMORE

Diskutoni idenë që udhëheqësit duhet të marrin vendime të urta për të ndihmuar njerëzit të vijnë tek Krishti. Shpjegoni se ne të gjithë mund të përmirësojmë aftësinë tonë për të marrë vendime të urta.

Zgjidhni disa pika që i konsideroni të rëndësishme për marrje vendimesh si udhëheqës (shih seksionin Burime për Mësuesin) dhe i diskutoni ato me klasën.

Ndajeni klasën në grupe të vogla. I thoni secilit grup të dalë me një situatë hipotetike në të cilën një udhëheqës Kishë apo familjeje

duhet të marrë një vendim. (Për shembull, një këshill peshkopi mund të jetë i shqetësuar se anëtarë të lagjes nuk po vijnë në mbledhje në kohë, apo një familje mund të mos dijë ku të shkojë për pushime.)

Thojini secilit grup ta këmbëjë situatën e vet hipotetike me një grup tjetër. I ftoni grupet të zbatojnë parimet e marrjes së vendimit që diskutuat dhe të dalin me një vendim dhe plan veprimi. I thoni secilit grup të tregojë vendimin dhe planet e veta dhe se si ata arritën atje.

### BURIME PËR MËSUESIN



**Presidenti Ezra Taft Benson**

*President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve*

*“Suggestions on Making Decisions”, në God, Family, Country: Our Three Great Loyalties (1974), f. 143–153*

Vendimet tona na kanë bërë ata që ne jemi. Fati ynë i përjetshëm do të përcaktohet nëpërmjet vendimeve që ne do të marrim në vazhdim.

Vendimet e urta janë gurët e shkallëve të përparimit. Ato janë blloqet e ndërtimit të jetës. Vendimet janë pjesë përbërëse e suksesit. Për individët dhe institucionet ato shënojnë rrugën e përparimit. Mendja e individit apo mendja e përbashkët e këshillit, komitetit apo bordit të

drejtorëve vendos se cila do të jetë gjendja e tanishme dhe drejtimi i ardhshëm i individit apo institucionit.

Vendimet e urta do të tregojnë rrugën drejt përparimit.

Ne jetojmë në një botë të ligë. Kurrë nuk mbahet mend të ketë qenë kundërshtari kaq i mirëorganizuar dhe kurrë nuk ka pasur kaq shumë emisarë që punojnë për të. Si popull ne përballemi me ditë të vështira – ditë vendimesh urgjente, për të rinj dhe të moshuar.

Në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme ndeshemi me vendime jetike. Njerëzit tanë – kryefamiljarë, prindër, fëmijë – duhet të marrin vendime të rëndësishme. Ndhimë kërkohet dhe ndihma gjendet.

Si kishë ne mbajmë të vërtetat dhe ordinancat shpëtuese të cilat do të sjellin shpëtimin dhe ekzaltimin për pjesëtarët e racës njerëzore. Prandaj është së tepërmi e rëndësishme që udhëheqësit e kishës të marrin vendimet e drejta dhe t'i drejtojnë ata që kanë në vartësi në rrugët e së vërtetës e të drejtësisë drejt përmbushjes së qëllimeve tona, por gjithashtu familjet, lagjet, kunjet, misionet, Kishën dhe botën tonë.

Nëse duhet të marrim vendime të përshtatshme, si të Krishtit, duhet së pari të jetojmë në mënyrë të tillë që të mund ta kërkojmë dhe ta arrijmë atë forcë të padukshme, pa të cilën askush nuk mund të bëjë më të mirën e vet në vendimmarrje.

Një nga vendimet më të mëdha të kësaj epoke ishte kur djaloshi Jozef Smith vendosi që të ndiqte këshillën tek Jakobi: “Në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t'i jepet. Por le ta kërkojë me besim, pa dyshuar, sepse ai që dyshon i ngjan valës së detit, të cilën e ngre dhe e përplas era.” (Jakobit [Bibël] 1:5–6.)

Vetë shpëtimi i miliona burrave dhe grave në periudhën ungjillore të plotësisë së kohëve varet nga ai vendim! Ne duhet të kujtojmë se individët kanë rëndësi dhe se vendimet që marrin mund të ndikojnë shumë në jetën e të tjerëve.

Krahas burimeve qiellore, është e rëndësishme gjithashtu të kuptojmë se, përpjekja individuale dhe forca krijuese janë të nevojshme jo vetëm në zgjidhjen e problemeve të ditës për Kishën, por gjithashtu në rritjen dhe zhvillimin e atyre që duhet të marrin vendime.

Ka disa parime udhëzuese që do të ndihmonin udhëheqësit e kishës në marrjen e vendimeve edhe në vetë jetën e tyre personale edhe në përgjegjësitë e tyre të rëndësishme për udhëheqjen e të tjerëve në qëllimin e tyre përfundimtar të ekzaltimit në mbretërinë e Perëndisë.

Puna më e madhe e së cilës do të jetë marrja e vendimeve. Ndërsa një nga dhuratat më të mëdha të Perëndisë për njeriun është liria e zgjedhjes apo e drejta për të zgjedhur, ai i ka dhënë gjithashtu njeriut përgjegjësinë për këto zgjedhje. Ne mund të zgjedhim midis së mirës dhe së keqes. Ne e vendosim vetë jetën tonë në drejtim të suksesit apo të dështimit. Ne mundet jo vetëm që të zgjedhim qëllimet tona përfundimtare, por mundemi gjithashtu të përcaktojmë dhe të vendosim vetë, në shumë raste, mjetet me të cilat do t'i arrijmë ato qëllime dhe me zellin apo mungesën e tij të përcaktojmë shpejtësinë me të cilën ato mund të arrihen. Kjo kërkon përpjekje dhe energji individuale dhe nuk do të jetë pa kundërshtim apo konflikt.

Marrja e vendimeve është ndoshta gjëja më e rëndësishme që bëjnë ndonjëherë njerëzit. Asgjë nuk ndodh deri sa njeriu merr vendim. Edhe vetë bota u krijua si rezultat i vendimeve të Perëndisë. Perëndia tha: “... Në fillim krijova qiellin dhe tokën”, “Le të ketë dritë; dhe pati dritë”, “Le të ketë një kupë qiellore në mes të ujit, dhe kështu u bë...” (Moisiu 2:1, 3, 6.)

Fatmirësisht aftësia dhe gjykimi i nevojshëm për të marrë vendime mund të fitohen. Disa metoda dhe praktika mund të na sjellin të gjithëve zotësi më të madhe për të marrë vendime në situata të përditshme, të përjavshme dhe të përmuajshme.

Ka disa parime bazë të rekomanduara dhe të përdorura nga specialistë të kësaj fushe. Pranohet përgjithësisht se ka pesë hapa themelore në marrjen e vendimit:

1. Përcaktimi i problemit, rrezja e veprimit dhe rëndësia:
  - a. Çfarë lloj problemi është?
  - b. Cili është faktori kyç i tij?
  - c. Kur duhet ta zgjidhim atë?
  - d. Përse duhet ta zgjidhim?
  - e. Çfarë do të duhet për ta zgjidhur?
  - f. Çfarë vlere apo përfitimi vjen nga zgjidhja e tij?
2. Mbledhja e fakteve, analiza dhe përdorimi i tyre.
3. Zhvillimi dhe shqyrtimi i zgjidhjeve të mundshme për të arritur në konkluzione.
4. Vënia në veprim e vendimit me plane dhe kontrolle.
5. Ndjekja e rezultateve të vendimeve dhe veprimit.

Vendimet duhet të bazohen në parime të drejta dhe fakte. Një njohje e plotë e parimeve dhe e fakteve që lidhen me një problem të veçantë zakonisht çon në një vendim të lehtë dhe korrekt. Një njohje e plotë e fakteve që lidhen me problemin e mirëqenies, për shembull, kur shqyrtohet në lidhje me parimet themelore të mirëqenies, do ta sjellë peshkopin tek përgjigjja e drejtë në atë rast të veçantë. Një nga elementët më themelore në marrjen e vendimit është, si rrjedhojë, të kesh zotërimin e fakteve dhe të kuptosh e të jesh i familjarizuar me parimet e tyre bazë dhe themelore.

Për një shembull tjetër, një peshkop mund ta ndiejë se lagjja e tij duhet të jetë më mirë me punën e tempullit. Si e merr ai një vendim për këtë problem? Ai së pari do të donte të përcaktonte faktet duke pyetur dhe gjetur përgjigjet për disa çështje. Sa rekomandime tempulli kanë anëtarët e lagjes time? Si ndahet ky numër midis priftërinjve të lartë, ... pleqve dhe motrave? ... Si krahasohet lagjja ime ... me lagje të tjera në kunj? Edhe nëse krahasohet favorshëm, a mjafton aq mirë? Sa e rëndësishme është gjithsesi kjo punë? (Shih Malakia 4:5–6.) Përse e gjithë toka do të goditej nga mallkimi po të mos kishte ardhur Elia me çelësat e vulosjes që mbante?

Pas diskutimit të problemit dhe zgjidhjes së tij me këshilltarët e tij dhe me udhëheqësin e grupit

të priftërinjve të lartë, dhe ndoshta me gjithë komitetin ekzekutiv të lagjes, peshkopi do të vendoste atëherë për një drejtim veprimi. Ai do të shënonte hapat e ndryshëm për zbatimin e drejtimin të veprimit të vendosur, do ta vinte në veprim programin duke caktuar detyra dhe deleguar përgjegjësi dhe pastaj do të kujtohej t'i kontrollonte.

Mbi baza vetjake, një vendim për mospranimin e një cigareje apo një likerit të ofruar do të ishte i lehtë të merrej nëse dikush ka faktet, kupton parimet dhe konceptet themelore të Fjalës së Urtësisë dhe ka vendosur tashmë me mendjen e tij që do të mbajë dhe mbështesë këtë parim të zbuluar në mënyrë hyjnore.

Përsëri, nëse dikush kupton parimin, ai tashmë do ta dijë vendimin e drejtë kur përballet me një problem lidhur me moralitetin [seksual]. Gjithçka do të ketë nevojë nën presionin e momentit do të jetë vendosmëria për marrjen e vendimit që tashmë e di se është i drejti.

Një nga mënyrat më të mira për udhëheqësit që të kuptojnë parimet e drejta është të kenë një njohje dhe kuptim të plotë të shkrimeve të shenjta dhe të manualit përkatës. Shumë situata tashmë kanë dalë më parë, ndoshta shumë herë, dhe tashmë janë përcaktuar politika e procedura për trajtimin e problemit. Prandaj, është gjithnjë e urtë t'i referohesh dhe të jesh i familjarizuar me udhëzimet e shkruara ekzistuese dhe politikën e kishës për çështjet kur ato dalin.

Vendimet duhet të jenë në kohë. Ndonjëherë një mungesë vendimi për një pikë është në të vërtetë vendim me drejtim të kundërt. Ne kemi nevojë ta ndajmë mendjen. Elia i tha Izraelit të lashtë: “Deri kur do të lëkundeni midis dy mendimeve? Në qoftë se Zoti është Perëndia, shkoni pas tij; por në qoftë se përkundrazi është Baali, atëherë ndiqni atë”. Populli nuk tha asnjë fjalë.” (1 Mbretërit 18:21.)

Jozueu e mbrojti këtë parim kur mblodhi të gjithë pleqtë dhe gjyqtarët e fiseve të Izraelit në Sikem dhe u tha atyre, në fakt, që ta ndanin mendjen në atë ditë. Ai tha: “Dhe në rast se ju duket një gjë e keqe t'i shërbeni Zotit, zgjidhni sot kujt doni t'i shërbeni, o perënditë të cilëve u shërbyen etërit tuaj matanë lumit, o perënditë e

Amorejve, në vendin e të cilëve ju banoni sot; sa për mua dhe për shtëpinë time do t'i shërbejmë Zotit.” (Jozueu 24:15.)

Disa njerëz prirën të marrin vendim dhe pastaj nuk merren kurrë me të. Ata duan të lyejnë hambarin, të rregullojnë gardhin, të largojnë makineritë e vjetëruara apo të heqin atë barakë të vjetër, por koha e vendimit thjesht nuk vjen kurrë.

Disa prej nesh ndeshin një situatë të ngjashme në jetën tonë vetjake. Ne synojmë të paguajmë të dhjetë të plotë, të fillojmë të mbajmë Fjalën e Urtësisë, të bëjmë vizitat tona të para të mësimin të shtëpisë në fillimet e muajit. Gjithsesi, pa vendim të vërtetë të pasuar nga zbatimi, javët dhe muajt kalojnë dhe asgjë nuk përmbushet. Ne mund të arrijmë pa përpjekje deri në përjetësi me këto lloj prirjesh të mira. Kështu mungesa e vendimit bëhet vendimi ynë për të mos bërë ato gjëra të mira për të cilat kishim synimet më të mira. Zoti dukej që e ndjeu këtë dobësi tek fëmijët e tij, sepse tha: “Prandaj, nëse më besoni, ju do të punoni derisa të quhet e sotme.” (DeB 64:25.)

Merrni faktet – pastaj vendosni menjëherë. Si justifikim për shtyrjen e vendimeve, mos u mbështetni në modele të vjetra që përdorin disa njerëz, të tilla si “dua ta mendoj shtruar”. Ne nuk i marrim vendimet shtruar. Megjithatë, mos fluturoni në përfundime apo të bëni gjykime sa hap e mbyll sytë. Merrni faktet, sigurohuni për parimet bazë dhe peshoni pasojat. Pastaj vendosni!

Profeti Joel e njihte parimin e saktësisë në kohë që udhëheqësit e priftërisë duhet të kenë sot, pasi tani, ashtu si atëherë, e keqja është thujse kudo. Vendime të mira nevojiten. Joeli tha: “‘Ejani, zbrisni, sepse trokulli është plot, ... sepse e madhe është ligësia e tyre’. Turma pas turmash në Luginën e vendimit. Sepse dita e Zotit është e afërt, në Luginën e vendimit.” (Joeli 3:13–14.)

Vendimet për të cilat foli Joeli janë vendime që çojnë në ekzaltimin e përjetshëm. Ndhimofshim në tregimin e rrugës.

Vendime të urta arrihen zakonisht duke punuar, luftuar dhe duke u përpjekur vazhdimisht plot lutje. Përgjigjja e Zotit ndaj përpjekjes

jo rezultative të Oliver Kaudrit e bën të qartë këtë: “Por, vër re, unë të them se ti duhet ta studiosh atë tërësisht në mendjen tënde; më pas ti duhet të më pyesësh nëse është e drejtë dhe nëse është e drejtë, unë do të bëj që kraharori yt do të digjet përbrenda; si rrjedhim, do ta ndiesh që është e drejtë.” (DeB 9:8.)

Prandaj, le të fillojmë duke thënë se duke kërkuar me zell Atin tonë në qiell, duke pasur besim se ai do t’u përgjigjet lutjeve tona, është një bazë inkurajuese për të filluar. Jozef Smithi tha gjithashtu se Zoti nuk do të nxjerrë ujë nga një burim i tharë, prandaj ne duhet të bëjmë pjesën tonë. Ndonjëherë të tentosh të marrësh një vendim të drejtë kërkon shumë energji, studim dhe durim të madh.

Këtu janë disa sugjerime rezultative që udhëheqësit tanë mund t’i përdorin për të marrë ndihmë për vendimmarrje korrekte mbi veprimet që duhen kryer.

1. A është kuptuar qartë problemi? Shumë shpesh udhëheqësit tanë nuk kanë përcaktuar çfarë është për t’u vendosur. Problemi duhet të shprehet qartë në letër.

2. A është problemi i deklaruar vërtet i tillë? A po trajton udhëheqësi ynë simptomat apo shkaqet? Për shembull, një president kunji ishte i shqetësuar për mësimin e shtëpisë në kunj dhe donte të merrte disa vendime për ta përmirësuar atë. Të dhënat tregonin që çdo muaj vizitoheshin më pak familje. Presidenti i kunjit ishte i pakënaqur nga mësuesit e shtëpisë pa kuptuar se ai nuk po komunikonte siç duhej mbi një bazë vijueshmërie me peshkopët dhe me udhëheqësit e kuorumit mbi mësimin e shtëpisë dhe rëndësinë e tij. Problemi i vërtetë nuk ishte aktiviteti i ulët i mësimin të vizitave; vështirësia ishte komunikimi i pamjaftueshëm midis presidentit të kunjit dhe vartësve të tij. Sapo presidenti e kuptoi dhe e korrigjoi vështirësinë, mësimi i vizitave u përmirësua shumë në kunjën e tij.

3. A “ndihet” saktësisht problemi? Ne në Kishë jemi të hapur ndaj frymëzimit e duhet ta kërkojmë atë dhe Ati ynë në qiell do të na lejojë të dimë nëse problemi për të cilin jemi shqetësuar është ai që kërkon vendim. Frymëzimi është një aspekt i rëndësishëm në një vendimmarrje.

4. I bëni diagnozën problemit. Problemi duhet të analizohet dhe të ndahet në pjesët e tij. Gjykimi i shëndoshë dikton që çështjet për të cilat duhet vendosur duhet të shkruhen dhe të renditet çdo aspekt. Vlerësoni të gjithë situatën, duke parë sa më shumë përvojën e kaluar dhe të tashme. Qëndroni me mendje të hapur.

5. Vlerësoni alternativat e mundshme. Xhastis Benxhamen Nethën Kardozo i Gjykatës së Lartë [të Shteteve të Bashkuara] tha: “Ka tek secili prej nesh një model nga priremi që i jep koherencë dhe drejtim mendimit dhe veprimit.” Faktet e përzgjedhura duhet të vlerësohen dhe të renditen me kujdes sipas rëndësisë së tyre me aq sa i shohim ne. Si ndikohen shenjtoret duhet të jetë shqetësim parësor.

6. Lutuni dhe agjëroni për frymëzim. “Këshillohu me Zotin për të gjitha veprimet e tua dhe ai do të drejtojë për të mirë...” (Alma 37:37.) Pas një vlerësimi të përshtatshëm të situatës, lutja dhe agjërimi duhet të vijnë pastaj si hapi final përpara vendimit. Dëgjoni për një përgjigje. Tepër shpesh ne lutemi pa dëgjuar.

7. Merrni vendimin. “Vendim-marrja është një punë e vetmuar”, tha miku im i mirë Klarens B. Randall, ish-kryetar i Inland Steel Company, “dhe sa më e madhe shkalla e përgjegjësisë, aq më intensive vetmia.” Pasi ndiqen gjashtë hapat e përmendura më sipër, gjithsesi, shumica e vendimeve që vëllezërit tanë të priftërisë do të marrin, do të jenë në më të mirën.

8. Përcaktoni si të përmbushni vendimin. Veprimi duhet të pasojë vendimin. Duhet që procedurat e përmbushjes të renditen dhe të caktohen detyra.

9. I ndiqni dhe i rivlerësoni. Një vëlla i mirë tha: “Nëse një vendim ka ardhur nga një frymëzim, atëherë përse ta vlerësojmë?” Rrethanat ndryshojnë dhe me ndryshimin vjen koha për të rishikuar dhe, të paktën nganjëherë, për ta rifilluar procesin e vendim-marrjes nga e para. Në çdo rast, ndjekja për të parë nëse po bëhet puna, duhet të jetë pjesë e procedurës.

Bashkëpunëtorët tanë do të marrin vendime më të mira në thirrjet e tyre nëse do të ndjekin këto nëntë hapa. Por kujtohuni, ndërsa Zoti do të

na ndihmojë në vendim-marrje, ai pret që ne të bëjmë detyrën tonë të shtëpisë.

Cilat janë provat që mund të zbatohen mirë lidhur me një drejtim veprimi të propozuar – një vendim në pritje? Këtu janë gjashtë:

1. A mund të vonojë apo dëmtojë ai përparimin shpirtëror apo moral?

2. A mund të krijojë kujtime të pakëndshme apo shqetësuese?

3. A është në kundërshtim me vullnetin apo urdhërimet e zbuluara të Perëndisë? “Unë, Zoti, lidhem kur ju bëni çfarë ju them; por kur nuk e bëni çfarë ju them, ju nuk keni premtim.” (DeB 82:10.)

4. A mund të dëmtojë ai cilindo individ, familje apo grup?

5. A do të mundet vendimi ta bëjë më të mirë një njeri apo një shok lidhur me ligjet e Perëndisë? Për shembull, duke jetuar Fjalën e Urtësisë, neve na premtohet se “do të gjej[m]ë urtësi dhe thesare të mëdha diturie, madje thesare të fshehura”. (DeB 89:19.)

6. A mund të vijë një bekim nga ky veprim i veçantë? “Ka një ligj, të shpallur në mënyrë të pakthyeshme në qiell, përpara krijimit të kësaj bote, mbi të cilin të gjitha bekimet bazohen— Dhe kur ne fitojmë ndonjë bekim nga Perëndia, është me anë të bindjes ndaj atij ligji mbi të cilin ai bazohet.” (DeB 130:20–21.)

Më lejoni, në përfundim, të paraqes dhjetë pikat në vijim për t’u mbajtur parasysht nga udhëheqësit si ndihmë për një vendim-marrje të urtë:

1. Kërkoni për drejtim nga Zoti për marrjen e vendimeve.

2. A e ndieni që kraharori ju digjet përbrenda pasi ta keni marrë vendimin?

3. A përputhet ai me fjalët e profetëve – domethënë të Presidentëve të Kishës, veçanërisht të Presidentit të gjallë?

4. Disa vendime janë thjesht çështje e një gjykimi të mirë dhe thjesht dalja në një vendim. Për shembull, në Doktrina e Besëlidhje, Zoti u tregon vëllezërve se ai nuk shqetësohet nëse ata do



të shkojnë nga toka apo deti, përderisa ata shkojnë. (Shih DeB 61:22.)

5. Ka pak raste kur vendimi nuk mund të merret menjëherë, sepse Zoti do që të sjellë faktorë të tjerë në vëmendjen e vendim-marrësit. Në atë rast, njeriu duhet të mësojë të presë Zotin apo, siç do të thoshte Zoti: “Ndaluni dhe pranoni që jam Perëndi”. (Psalmet 46:10.)

6. Në vendime me rëndësi vendimtare, agjërimi i kombinuar me lutjen mund të sjellin njohuri të madhe shpirtërore.

7. Ndërsa zakonisht këshillohet përpjekja për të pasur pamje të gjerë të vendimit që merrni, ndonjëherë Zoti do t’ju frymëzojë të merrni vendime vetëm të përkohshme, që do t’ju çojnë drejt një qëllimi për të cilin vetëm ai e di. Njeriu nuk duhet të ngurrojë kurrë të marrë të tilla vendime. Uillford Udraf [Presidenti i katërt i Kishës] iu desh të merrte një numër nga ato vendime që i kërkonin të thoshte: “Nuk e di, përveçse që Zoti më urdhëroi” [shih Moisiu 5:6]. Nefi u kthye në Jeruzalem pa e ditur saktësisht se cili do të ishte plani i tij i veprimit.

8. Presidenti Harold B. Li tregon në librin e tij *Decisions for Successful Living* (faqe 45), mbi bisedën me një udhëheqës të kishës, i cili ndonjëherë, duke u përpjekur të merrte vendim për një çështje të dhënë, do të thoshte me vete: “Çfarë do të bënte Jezusi në këtë situatë?” Kjo do të thotë, sigurisht, se një njeri do të duhet ta njohë Jezusin mjaft mirë nëpërmjet studimit dhe jetës së drejtë që të mund ta drejtojë me zgjuarsia atë pyetje.

9. Njeriu duhet gjithnjë të sigurojë që të konsultohet me Shpirtin kur merr vendime. Me fjalë të tjera, ai duhet ta mbajë portën hapur në rast se Shpirti dëshiron të diktojë një tjetër drejtim nga ai që mund të kishte ndjekur natyrshëm.

Brigam Jangu tha në një rast se donte të bënte diçka, por që Shpirti i diktoi ndryshe.

10. Është gjithnjë mirë të dish çfarë kanë bërë udhëheqësit e tjerë të Kishës në marrjen e vendimeve për gjëra të ngjashme. Kjo është pse, të paktën pjesërisht, Profeti Jozef bëri që të mbahen shënime për mbledhje të ndryshme. Prandaj njeriu duhet të studiojë të dhënat, profetët dhe historinë e Kishës.

Ne jemi të angazhuar në një punë ku nuk mund të dështojmë – qoftë vendim-marrje apo tjetër – nëse bëjmë pjesën tonë. Zoti nuk do të na lejojë të dështojmë. Kjo është puna e tij. Këta janë fëmijët e tij dhe ne jemi thirrur të punojmë me ta dhe ai i do ata. Ky është programi i tij me të cilin ne punojmë, autoriteti i tij, dhe ai do të na lartësojë ne – po, kur të nevojitet, madje edhe përtej aftësive tona natyrore. Unë e di këtë dhe falënderoj Perëndinë për këtë njohuri dhe bekim të paçmueshëm.

#### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Çfarë komentesh të Presidentit Benson na ndihmojnë të kuptojmë sa të rëndësishme janë vendimet e urta për jetën tonë të përrjetshme?
- Cili nga “pesë hapa[t] themelore në marrjen e vendimit” duket më i rëndësishëm për ju në zhvillimin tuaj si udhëheqës? Shpjegoni përgjigjen tuaj. (*Shënim*: Nëse e përdorni këtë pyetje në klasë, pyesni diçka më pak vetjake, të tillë si: “Përse secili nga këto pesë hapa është i rëndësishëm në marrjen e vendimit?”)
- Përse është e rëndësishme që vendimet të bazohen në “parime të drejta dhe fakte”?
- Si mund të provojmë vendimet tona për të parë nëse janë të drejta?

# DREJTIMI I MBLEDHJEVE TË SUKSESSHME

*“Dhe mbledhjet e tyre bëheshin nga kisha, sipas mënyrës së shfaqjes së Shpirtit dhe nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë; pasi, sikurse fuqia e Frymës së Shenjtë i bënte ata të predikonin ose të nxitnin, ose të luteshin, ose të kërkonin, ose të këndonin, madje, ashtu bëhej” (Moroni 6:9).*

## PARIME TË UDHËHEQJES

Qëllimi i mbledhjeve të Kishës dhe të familjes duhet të jetë që të ndihmojnë njerëzit të bëhen më shumë si Krishti.

## KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Ne bëjmë mbledhje të Kishës dhe të familjes për të ndihmuar njerëzit të arrijnë qëllime të denja dhe të vijnë tek Jezu Krishti.
2. Ne mund të mësojmë të planifikojmë dhe të drejtojmë mbledhje rezultative.

### **KONCEPT 1. NE BËJMË MBLEDHJE TË KISHËS DHE TË FAMILJES PËR TË NDIHMUAR NJERËZIT TË ARRIJNË QËLLIME TË DENJA DHE TË VIJNË TEK JEZU KRISHTI.**

#### KOMENT

Gjatë shërbesës së Tij në vdekshmëri, Jezu Krishti u takua shpesh me dishepujt e Tij dhe të tjerë (shih Mateu 5:1; Marku 2:2; Lluca 4:14–15; Gjoni 6:3). Ai gjithashtu takoi pasuesit e Tij në tokat e Librit të Mormonit pas Ringjalljes së Tij (shih 3 Nefi 12). Në periudhën tonë ungjillore Ai udhëzoi Jozef Smithin që shenjtorët duhet “të mblidhe[n] së bashku shpesh” (DeB 20:55).

Peshkopi Robert L. Simpson, që ishte atëherë Këshilltar në Këshillin e Peshkopit Kryesues, tha: “Duke u përpjekur fort të njohim Perëndinë, Atin, dhe birin e tij, Jezu Krishtin, ne duhet të njihemi mirë me veprat standarde të kishës; ne duhet të marrim pjesë në mbledhjet ashtu siç përcaktohet nga profetët tanë të ditëve të sotme, që zemrat dhe mendjet tona të mund të mbushen me mësimet e së vërtetës dhe shpirtin e dëshmisë, siç e sjellin të tjerët dhe, herë pas here, vetë ne, kur thirrëmi apo kur e ndiejmë ta bëjmë këtë. Kështu ne formojmë një dëshmi, një

bindje se Perëndia është” (*The Powers and Responsibilities of the Priesthood*, Brigham Young University Speeches of the Year [31 mars 1964], f. 3).

Presidenti Spenser W. Kimball na mësoi: “Shmangni prirjen e programimit të mbledhjeve të tepërta në ditën e shabatit. Kur bëni mbledhjet tuaja të rregullta, i bëni sa më shpirtërore dhe rezultative që të jetë e mundur. Mbledhjet nuk duhet të bëhen me ngut as me rrëmbim, sepse ato mund të planifikohen në një mënyrë që mundëson përmbushjen e qëllimeve të tyre të shenjta pa vështirësi” (në Conference Report, prill 1981, f. 62; ose *Ensign*, maj 1981, f. 45).

#### IDE MËSIMDHËNIEJE

I pyesni studentët: Përse kemi kaq shumë mbledhje në Kishë dhe me familjet tona? Si ndodh që disa mbledhje janë më rezultative sesa të tjerat?

Lexoni thënien e mëposhtme të Presidentit Ezra Taft Benson: “Pjesëmarrja besnike në mbledhjet e Kishës sjell bekime që ju nuk mund t’i merrni në asnjë mënyrë tjetër” (në Conference Report, prill 1986, f. 56; ose *Ensign*, maj 1986,

f. 44). U kërkoni studentëve të rendisin disa nga mbledhjet e rëndësishme në Kishë dhe shpjegoni se si pjesëmarrja në këto mbledhje mund të sjellë bekime.

U thoni studentëve se ka mbledhje që kërkohen dhe mbledhje që janë të dobishme por që nuk kërkohen. Ka mbledhje ku ne adhurojmë dhe mbledhje ku ne planifikojmë aktivitete. Ka mbledhje formale dhe mbledhje jo formale. Ka mbledhje ku publiku është i mirëpritur dhe të tjera ku vetëm ata që plotësojnë standardin e denjësisë mund të marrin pjesë. Shpjegoni se udhëheqësit që mbajnë cilëndo nga këto mbledhje mund t'i përdorin ato për të ndihmuar njerëzit të arrijnë qëllime të denja dhe të vijnë në Krisht (shih komentin). Në planifikimin dhe mbajtjen e mbledhjeve dhe të aktiviteteve, udhëheqësit duhet të kenë kujdes të mos bien ndesh me shtëpinë, që është vendi më rezultativ për të dhënë mësim dhe për ta mësuar ungjillin.

## KONCEPT 2. NE MUND TË MËSOJMË TË PLANIFIKOJMË DHE TË DREJTOJMË MBLEDHJE REZULTATIVE.

### KOMENT

Udhëheqësit e Kishës planifikojnë dhe drejtojnë një shumëllojshmëri mbledhjesh. Këto mund të jenë për adhurim, udhëzim apo planifikim. Profetët e ditëve të mëvonshme na mësojnë se familjet duhet të mblidhen çdo javë në mbledhje familjare në shtëpi. Këtu prindërit dhe fëmijët nxitin njëri-tjetrin të jetojnë parimet e ungjillit dhe të diskutojnë çështje familjare.

Një hap i hershëm në planifikimin e një mbledhjeje të mirë përfshin kuptimin e qëllimit të saj. Për shembull, një peshkop që planifikon një mbledhje sakramenti duhet të kuptojë se qëllimi i kësaj mbledhjeje është të merret sakramenti, të adhurohet, të mësohet ungjilli, të kryen ordinancat të tilla si konfirmimi, të bëhet kujdes për punët e lagjes dhe të forcohen shpirtshmërisht anëtarët. Pasi ta kuptojnë qëllimin e mbledhjes, udhëheqësit mund të kërkojnë mënyrën më të mirë të arritjes së tij.

Plaku M. Rasëll Ballard, nga Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve dhe këshillën e mëposhtme lidhur me mbledhjet në përgjithësi:

- “Shihni që rendi i ditës i shkruar ... të përqendrohet kryesisht tek njerëzit më tepër se tek programet.”
- “Qëllimet e mbledhjes duhet të jenë të qarta dhe ajo duhet të fillojë e të mbarojë në kohë.”
- “Lejoni kohë të mjaftueshme për diskutimin e nevojave të njerëzve.”
- “Pasi dëgjoni me kujdes dhe sinqerisht rekomandimet [e të pranishmëve], merrni një vendim apo caktoni një detyrë që do të rezultojë në një drejtim veprimi të posaçëm, të matshëm.”
- “I merrni me lutje vendime të tilla.”
- I kërkoni dikujt “të marrë përgjegjësi për çdo detyrë [dhe] të ‘kthehet për raportim’ në një datë për të cilën bihet dakord.”
- “Kur delegohet një detyrë, ajo normalisht duhet të komunikohet më shumë në termat e ‘çfarë’ sesa ‘si’; që do të thotë se personi, që do ta marrë përsipër, duhet të jetë përgjegjës për rezultatin që duhet arritur më shumë sesa për metodat e veçanta që do të përdoren.”

*(Counseling with Our Councils: Learning to Minister Together in the Church and in the Family [1997], f. 124–125.)*

### IDE MËSIMORE

Duke përdorur materialin në koment dhe vetë përvojën tuaj, diskutoni si planifikohen dhe drejtohen mbledhje rezultative të Kishës dhe të familjes. Ndajeni klasën në grupe të vogla. I thoni secilit grup të bëjë një skicë një faqëshe që t'i ndihmojë të planifikojnë dhe drejtojnë mbledhjet. I ftoni grupet të shpjegojnë skicat e tyre.

### BURIME PËR MËSUESIN



**Presidenti Boyd K. Paker**

*President Veprues i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve*

*The Unwritten Order of Things, Brigham Young University devotional, 15 tetor 1996*

Unë po ju flas sot si mësues. Unë mendoj për ndikimin e një mësuesi që e kam njohur më se

pesëdhjetë vjet më parë. Siç ndodh shpesh, ndikimi i atij mësuesi nuk lidhej me lëndën që na mësonte. Doktor Shefer ishte profesor i matematikës në Universitetin Shtetëror të Uashingtonit në Pullman, Uashington. Ai ishte krejt i zakonshëm në pamje. Unë nuk e mbaj mend emrin e tij, por nuk kam për të harruar kurrë të parën gjë që ai tha ditën e parë që u takuam.

Ishte gjatë Luftës së II Botërore. Ne po bënim një trajnim për pilot dhe ishim dërguar në universitet për atë që na thanë se do të ishte një kurs mjaft i shkurtër për meteorologjinë, motin, navigimin, fizikën, aerodinamikën dhe tema të tjera teknike. Ne menduam se titulli “*Crash course*” (kurs ‘përplasjeje’) nuk ishte shumë inkurajues për studentë pilotë. Fjala *intensiv* do të kishte qenë më mirë.

Presioni ishte i tmerrshëm sepse ata që mbeleshin në kurs do të hiqeshin nga programi i pilotëve. Unë isha në konkurrencë me kadetë, shumë prej të cilëve kishin qenë në kolegji; disa prej tyre kishin pasur një trajnim të përparuar, ndërsa unë mezi kisha kaluar shkollën e mesme.

Doktor Shefer duhej të na çonte nga aritmetika elementare në matematikë thjesht në punë javësh. Unë mendoja se ishte diçka e pashpresë, deri në ato pak minutat e para në mësimin e parë. Ai e filloi mësimin me këtë deklaram: “Ndërsa shumë nga ju kanë kryer mësim në kolegji, madje kurse të përparuara në atë që ne do të studiojmë, qëllimi im është të mësoj fillestarët. Unë u kërkoj atyre që e njohin lëndën të jenë të durueshëm kur unë t’u mësoj bazat atyre që nuk i njohin.” I nxitur nga ajo që tha dhe më shumë nga mënyra e tij e mësimdhënies, unë qeshë në gjendje ta kaloja kursin me një lehtësi të arsyeshme. Ndryshe do të kishte qenë e pamundur.

Kur vendosa të bëhem mësues, shembulli i Dr. Sheferit më frymëzoi të përpiqesha të bëja më të mirën me mundësitë e mia që të jepja mësim të vërtetat bazë e të thjeshta në mënyrën më të kuptueshme. Unë kam mësuar se sa e vështirë është të thjeshtëzosh.

Vite pas lufte, u ktheva në Universitetin Shtetëror të Uashingtonit dhe gjeta Dr. Sheferin. Ai, sigurisht, nuk më mbante mend. Unë isha thjesht një nga qindra kadetët në mësimin e tij.

Unë e falënderova për çka më kishte mësuar. Aritmetika dhe matematika më ishin fshirë shumë kohë përpara, por jo shembulli i tij si mësues.

Kështu, duke ndjekur atë shembull, sot dua t’ju tregoj diçka mbi Kishën. Gjërat që do t’ju tregoj nuk janë shpjeguar në shkrimet e shenjta, edhe pse ato janë në përputhje me parimet që mësohen në shkrimet e shenjta.

Një parim është një e vërtetë e qëndrueshme, një ligj, një rregull që mund ta adoptoni që t’ju ndihmojë në marrjen e vendimeve. Në përgjithësi parimet nuk jepen me shumë udhëzime të posaçme. Ato ju lënë të lirë të bëni përshtatje dhe të gjeni rrugën tuaj me një të vërtetë të qëndrueshme, një parim, si spirancë.

Gjërat që do t’ju tregoj nuk janë shpjeguar në manualet tona dhe as në manuale të tjera. Edhe po të ishin, shumica nga ju nuk keni manuale – as manualet për Priftërinë Melkizedeke apo Shoqatën e Ndihmës dhe të tjera – sepse ato u jepen vetëm udhëheqësve.

Unë do të flas mbi atë që unë e quaj “rregulli i pashkruar i gjërave”. Mësimi im mund të titullohet “Gjërat e Zakonshme mbi Kishën të Cilat Çdo Anëtar Duhet t’i Dijë”. Megjithëse ato janë gjëra shumë të zakonshme, ato janë, gjithsesi, shumë të rëndësishme! Ne marrim disi me mend se secili i njeh tashmë të gjitha gjërat e zakonshme. Nëse i njihni, ju duhet t’i keni mësuar ato nëpërmjet vëzhgimit dhe përvojës, sepse ato nuk janë shkruar askund dhe nuk jepen mësim në klasa. Kështu, ndërsa vazhdojmë, nëse ju jeni ata që e dini gjithçka, jini të durueshëm ndërsa unë po mësoj ata që nuk e dinë gjithçka – dhe merrni një sy gjumë.

Themeli bazë i njohjes dhe dëshmisë nuk ndryshon kurrë – dëshmia se Perëndia, Ati, jeton, se Jezusi është Krishti, se Fryma e Shenjtë na frymëzon, se ka pasur një rivendosje, se plotësia e ungjillit dhe e njëjta organizatë që ekzistonte në kishën e lashtë na janë zbuluar neve. Ato të vërteta janë dhënë mësim kudo dhe kurdoherë – në klasat tona, në shkrimet e shenjta, në manualet dhe udhëzuesit – në çdo gjë që bëjmë.

Doktrina dhe udhëzimet themelore mbi organizimin e Kishës gjenden po ashtu në

shkrimet e shenjta. Përveç këtyre, ka një burim tjetër të njohjes lidhur me atë që e bën Kishën të funksionojë: Ne mësojmë nga përvoja dhe vëzhgimi. Nëse ju mësoni mbi këto gjëra që nuk janë të shkruara, rregullin e pashkruar të gjërave, ju do të kualifikoheni më mirë për të qenë udhëheqës – dhe ju do të bëheni udhëheqës. Pozitat më të rëndësishme të udhëheqjes janë në shtëpi – babai, nëna, bashkëshortja, bashkëshorti, vëllai dhe motra më e madhe.

Pastaj, në Kishë, pozitat e udhëheqjes dhe mundësitë e mësimdhënies janë të disponueshme si askund gjetkë në botë.

Ndërsa gjërat mbi të cilat do të flas nuk janë të shkruara, ato vërtet mësohen krejt lehtësisht. Thjesht jini vigjilent ndaj rregullit të pashkruar të gjërave dhe tregoni interes për to dhe do të shihni se do të rritet aftësia juaj dhe vlera juaj përpara Zotit.

Përpara se t’ju jap disa shembuj të këtij rregulli të pashkruar gjërash, më lejoni t’ju kujtoj çfarë ka thënë Zoti: “Shtëpia ime është një shtëpi rregulli, thotë Zoti Perëndi” (DeB 132:18; kursivet shtuar). Dhe ai i tha profetit të tij: “Dhe shikoni, që të gjitha këto gjëra të jenë bërë në *urtësi* dhe *rregull*; pasi nuk është e nevojshme që një njeri duhet të vrapojë më shpejt sesa ai ka fuqi. Dhe përsëri, është e domosdoshme që ai duhet të jetë i zellshëm, që kështu të mund të fitojë çmimin; prandaj të gjitha gjërat duhet të bëhen në *rregull*” (Mosia 4:27; kursivet shtuar).

Pali u tha korintasve se “*të gjitha*” gjërat duhej “të bëhe[shi]n sikur ka hije dhe me rregullsi” (shih 1 Korintasve 14:40; kursivet shtuar). Ne do të kthehemi atje pas pak.

Gjërat që do t’ju tregoj nuk janë aq strikte saqë Kisha të coptohet nëse nuk do të zbatohen në mënyrë strikte gjithë kohën. Por ato vendosin një theks, një standard, dinjiteti e rregulli dhe do të përmirësojnë mbledhjet dhe punën në mësimin që bëjmë; ato do të përmirësojnë aktivitetet. Nëse i dini dhe i kuptoni, ato do të përmirësojnë shumë jetën tuaj.

Mbledhjet tona duhet të drejtohen në mënyrë të tillë që anëtarët të mund të gjallërohen shpirtërisht dhe të qëndrojnë në harmoni me Shpirtin kur ndeshen me sfidat e jetës. Ne duhet të krijojmë

kushte në të cilat anëtarët, nëpërmjet frymëzimit, të mund të zgjidhin problemet e tyre. Ka gjëra të thjeshta që ndihmojnë lidhur me këtë dhe gjëra që pengojnë. Alma na mësoi: “nëpërmjet gjërave të vogla dhe të thjeshta gjëra të mëdha bëhen; dhe shpeshherë mjetet e thjeshta ngatërrojnë të urtët” (Alma 37:6).

Po ju jap si shembull të parë të këtij rregulli të pashkruar të gjërave një gjë kaq të thjeshtë si kjo: Ai që kryeson në një mbledhje duhet të ulet në presidium dhe të qëndrojë pranë atij që drejton. Është pak e vështirë të kryesosh një mbledhje që nga masa e pjesëmarrësve. Ai që kryeson është përgjegjës për drejtimin e mbledhjes dhe ka të drejtë e përgjegjësi të marrë frymëzim, dhe mund të nxitet të rregullojë apo korrigjojë diçka që vazhdon në mbledhje. Kjo është e vërtetë qoftë nëse është mbledhje organizate ndihmëse e kryesuar nga motrat apo çfarëdo nga mbledhjet tona.

Një president i ri kunji ndonjëherë do të pyesë: “A duhet të ulem në presidium në çdo mbledhje në kunj? Nuk mund të ulem me familjen time?” Unë i them atij: “Kur ju kryesoni, ju duhet të uleni në presidium”. Unë tundohem të them, por nuk e them: “Unë nuk mund ta kem atë privilegj, pse ta kesh ti?”

Një shembull tjetër: Nëse vëreni Presidencinë e Parë, ju do të shihni se këshilltari i parë gjithnjë ulet në të djathtë të presidentit; këshilltari i dytë në të majtë. Ai është një demonstrim i të bërit të gjërave “sikur ka hije dhe me rregullsi”, siç na tregoi Pali. Zakonisht, por jo gjithnjë, nëse zyrtari kryesues flet, kjo do të bëhet në fund të mbledhjes. Pastaj mund të bëhet sqarim apo korrigjim. Unë e kam pasur këtë përjetim shumë herë në mbyllje të mbledhjeve: “Në rregull, vëllëzër apo motra dikush tha këtë e atë dhe jam i sigurt se ata donin të thoshin këtë e atë”.

Një tjetër shembull: Ne nuk aspirojmë thirrje të caktuara në Kishë dhe as kërkojmë të lirohemi. Ne jemi thirrur në detyra në Kishë nëpërmjet frymëzimit. Edhe nëse thirrja paraqitet e pagoditur, nuk është e urtë që ne ta refuzojmë. Ne duhet ta mendojmë që thirrja vjen nga Zoti. Neni i pestë i besimit na tregon se “një njeri duhet të thirret nga Perëndia, me anë të profesisë dhe me anë të vënies së duarve prej atyre që

janë në autoritet, për të predikuar Ungjillin dhe për të administruar ordincat e tij”.

Nëse rrethanat e bëjnë të vështirë që të vazhdoni të shërbeni, jeni i lirë të këshilloheni me udhëheqësin që ju ka thirrur. Ne nuk e thërresim veten dhe ne nuk e lirojmë veten. Ndonjëherë një udhëheqës apo mësues e pëlqen rëndësinë e një pozite kryesuese aq shumë saqë, edhe pasi ka shërbyer për një kohë të gjatë, nuk do që të lirohet. Kjo është shenjë se një lirim është në kohë.

Ne duhet të bëjmë ashtu siç na bëhet thirrje. Ne duhet të pranojmë thirrjet dhe të pranojmë lirim nga i njëjti autoritet.

Kur Presidenti J. Ruben Klark u thirr si këshilltar i dytë në Presidencinë e Parë pasi kishte shërbyer për shumë vite si këshilltar i parë, ai u përgjigj në Asamblenë Solemne, ku u krye mbështetja e Presidencisë së Parë të re: “Në shërbim të Zotit, nuk ka rëndësi *ku* shërben por si. Në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, personi merr vendin ku është thirrur rregullisht, vend që personi as e kërkon as i shmanget” [në Conference Report, prill 1951, f. 154; kursivet shtuar]. Kisha kishte marrë një mesim shumë të vlefshëm në rregullin e pashkruar të gjërave.

Unë mësova vite më parë se ne nuk zgjedhim ku shërbejmë – ne thjesht i përgjigjemi thirrjes. Shpejt pas martesës sonë, unë u thirra si ndihmës i nëpunësit të kunjit. Peshkopi im nuk donte të më lironte si mësues të Doktrinës së Ungjillit. Ai më tha se kisha shumë më tepër për të ofruar si mësues sesa në detyrën shumë të pacaktuar si ndihmës nëpunës kunji. Por ai e dinte se, sipas rregullit të pashkruar të gjërave, presidenti i kunjit kryesonte dhe se thirrja e tij kishte përparësi.

Unë nuk mund t’ju tregoj gjithçka mësova në atë thirrje. Unë qeshë në gjendje të shihja se si punon një presidencë. Unë isha dëshmitari në zbulësë për thirrjen dhe lirim nga zyrtarëve të kunjit dhe të lagjes. Duke vërejtur presidentin e kunjit tonë, unë mësova nëpërmjet vëzhgimit dhe përjetimit shumë gjëra që nuk janë në manual. Ishte në atë thirrje që unë takova për herë të parë anëtarë të Të Dymbëdhjetëve dhe të tjerë Vëllezër kur ata vinin në konferencë. Ishte një kohë trajnimit në rregullin e pashkruar të gjërave.

Ndodhesha dikur në një aeroplan me Presidentin Kimball, i cili, më duket, shërbeu për 19 vite si nëpunës kunji. Një anëtar që ishte në kunj atëherë ndodhej në aeroplan. Ai më tha: “Nëse do ta dija se nëpunësi i kunjit tonë do të bëhej President i Kishës, do ta kisha trajtuar shumë më mirë”.

Vëllai Kimball shërbente në të vërtetë si këshilltar i dytë në presidencinë e kunjit kur nëpunësi i kunjit u largua. Ata thirrën një nëpunës dhe ai nëpunës u largua. Vëllai Kimball mori përsipër përgjegjësinë. Vëllai Melvin J. Ballard erdhi në konferencë dhe ai tha: “Ju nuk duhet të jeni këshilltar i dytë dhe nëpunës kunji në të njëjtën kohë. Zgjidhni ku doni të jeni më mirë”.

Vëllai Kimball nuk ishte mësuar të bënte zgjedhje. Ai donte që t’ia thoshte Vëllai Ballard, por Vëllai Ballard tha: “Jo, zgjidhni ju”. Kështu, Vëllai Kimball tha: “Unë kam një makinë shkrimi. [Shumë pak njerëz kishin makina shkrimi atëherë.] Unë e njoh sistemin. Unë mendoj se mund të jap një ndihmesë më të madhe nëse qëndroj si nëpunës kunji”. Dhe ashtu u bë.

Në ato ditë nëpunësi i kunjit merrte një shumë të vogël të hollash, diçka të vogël mujore apo tjetër, mendoj për të blerë furnizime. Një motër, që e njihte mirë atë, shkroi dhe tha: “Spenser, unë jam befasuar me ju – që merrni një thirrje thjesht sepse aty përfshihen para”. Pastaj ajo tha: “Nëse nuk ndryshoni qëndrim, brenda dy muajsh, ju do të largoheni nga Kisha”. Vetëm se ajo ishte pak jashtë në përca-ktimin e kohës!

Tani një shembull: Në një rast Plaku Harold B. Li kryesoi një konferencë të kunjit tonë. Midis seancave ne patëm një drekë në shtëpinë e Presidentit Zandëll. Dona dhe unë arritëm pak vonë, sepse patëm shkuar në shtëpi të shihnim fëmijët tanë të vegjël. Plaku Li kishte ardhur tek makina të merrte diçka prej saj dhe ishte në trotuar kur arritëm. Jam i sigurt se ne ishim dukshëm të emocionuar që kishim rastin të flisnim personalisht dhe të shtrëngonim duart me një Apostull. Ai bëri me shenjë nga shtëpia dhe tha, duke folur për presidencinë e kunjit që ishin mbledhur atje: “Ata janë njerëz të shkëlqyer. Mos neglizhoni kurrë të mësoni nga njerëz të tillë si

këta”. Dhe unë kisha mësuar diçka nga rregulli i pashkruar i gjërave prej një Apostulli.

Ka aq shumë që mund të mësoni duke vrotuar udhëheqës me përvojë në lagjet dhe kunjët ku jetoni. Ka aq shumë që mund të mësoni duke dëgjuar vëllezërit dhe motrat më të moshuar, që kanë pasur një jetë të tërë përvojë në shkollën e të pashkruarave.

Një shembull tjetër: Ka një rend gjërash lidhur me atë se ku shkojmë për këshillë apo bekime. Është e thjeshtë – ne shkojmë tek prindërit tanë. Kur ata nuk na gjenden më, nëse është bekim, atëherë mund të shkojmë tek mësuesi ynë i shtëpisë. Për këshillë, ju shkoni tek peshkopi juaj. Ai mund të zgjedhë t’ju dërgojë tek udhëheqësi i tij epror – presidenti i kunjit. Por ne nuk shkojmë tek Autoritetet e Përgjithshme. Ne nuk u shkruajmë atyre për këshillë apo të mendojmë se dikush me një post më të rëndësishëm do të japë një bekim më të frymëzuar. Nëse mund ta mësojmë këtë gjë në Kishë, një fuqi e madhe do të qëndronte mbi ne.

Presidenti Jozef F. Smith na mësoi se, nëse do të ketë sëmundje në një shtëpi dhe do të jenë të pranishëm “apostuj, apo madje anëtarë të presidencës së parë të Kishës, ... ati është atje. Është e drejta e tij dhe është detyra e tij të kryesojë” (*Gospel Doctrine*, f. 286).

Ka një “rrugë anasjelltas” të autorizuar për peshkopin, presidentin e kunjit, Autoritetin e Përgjithshëm dhe cilindo tjetër në linjën tonë të autoritetit. Ajo është në lutje tek Ati ynë në Qiell. Nëse e bëjmë atë, në shumicën e rasteve ne do t’i zgjidhim problemet tona.

Një parim tjetër: Zbulesa në Kishë është vertikale. Ajo në përgjithësi kufizohet në ndarjet administrative apo gjeografike apo kufizimet e shënuara për atë që është thirrur. Për shembull, një peshkop, që po përpiqet të zgjidhë një problem, nuk do të marrë zbulesë duke u këshilluar me një peshkop nga një lagje apo kunj tjetër, me të cilin mban lidhje, apo me të cilin mund të punojë në zyrë.

Përvoja më ka mësuar se zbulesa vjen nga lart, jo anash. Sado që dikush përkrah nesh mund të duket me më shumë përvojë, apo më i

moshuar, apo sado më shpirtëror, është më mirë të shkohet lart nëpërmjet kanaleve të duhura.

Parimi: Një tipar parësor i një udhëheqësi të mirë është të jetë pasues i mirë. Në një mbledhje me peshkopë, një peshkop i ri dhe luftarak një herë më pyeti: “Si t’i bëj njerëzit të më ndjekin? Unë kam thirrur nëntë motra për t’u bërë presidente të Fillores dhe asnjëra nuk ka pranuar.” Pati humor të mirë dhe një shpirt të këndshëm në mbledhjen që e bëri atë një moment ideal për mësimdhënie. Unë u përgjigja se dyshoja nëse ai pati “thirrur” ndonjë nga nëntë motrat. Ai duhet vetëm t’i kishte pyetur apo ftuar ato.

Unë i thashë se nëse do të ishte lutur dhe këshilluar sinqerisht me këshilltarët lidhur me atë që duhej të kryesonte Filloren, motra e parë do ta kishte pranuar thirrjen. Ndoshta ai mund të kishte zbuluar në intervistë disa arsye përse nuk ishte e këshillueshme apo në kohë për atë motër të shërbente dhe e shmangte atë nga shërbimi. Por sigurisht jo më shumë se një apo dy motra. Nëse aq shumë motra e refuzonin thirrjen, diçka ishte jashtë rregullit – rregullit të pashkruar.

Ngaqë kishte një shpirt aq të mirë në mbledhje, unë i thashë: “Peshkop, unë di diçka tjetër për ju. Ju nuk jeni ndjekës i mirë, apo jo? A nuk jeni ju që gjithnjë jeni në mëdyshje për atë çfarë kërkon presidenti i kunjit nga peshkopët e tij?” Peshkopët e tjerë në dhomë filluan të qeshin mbyturazi dhe tundnin kokën – ai ishte. Ai qeshi mbyturazi dhe tha se mendonte që ajo ishte e drejtë. Unë thashë: “Ndoshta shkaku që anëtarët tuaj nuk e ndjekin udhëheqësin e tyre është sepse ju nuk i ndiqni tuajët. Një tipar thelbësor i një udhëheqësi në Kishë është ndjekja vërtetësisht dhe besnikërisht. Ai është thjesht rregulli i gjërave – rregulli i pashkruar i gjërave.”

Kur isha i ri, Plaku Spenser W. Kimball erdhi në konferencën tonë dhe tregoi këtë përvojë. Kur ishte president kunji në Saford të Arizonës, atje ishte i paplotësuar posti i presidentit të Të Rinjve në kunj, pasi atëherë ishte krijuar. Ai e la një ditë detyrën, shkoi disa hapa në rrugë dhe pati një bisedë me pronarin e një biznesi. Ai tha: “Xhek, a do të të pëlqente të ishe president i kunjit për organizatën e Të Rinjve?”

Xheku u përgjigj: “Oh, Spenser, besoj se nuk e ke për mua.”

Spenseri u përgjigj: “Sigurisht për ty. Ti shkon mirë me të rinjtë.” Ai u përpoq ta bindte, por burri nuk e pranoi.

Më vonë atë ditë, pasi mendoi për dështimin e tij dhe më në fund duke kujtuar çfarë kishte thënë Jakobi në Librin e Mormonit – “duke marrë më parë këtë detyrë nga Zoti” (Jakobi 1:17) – ai u kthye tek Xheku. Duke e thirrur atë “vëlla” dhe me mbiemër, ai tha: “Ne kemi një vend bosh në zyrën e kunjit. Këshilltarët dhe unë e kemi diskutuar; ne jemi lutur lidhur me të për disa kohë. Të dielën ne u gjunjëzuam së bashku dhe i kërkua Zotit frymëzim mbi atë se cili duhet të thirrej për këtë post. Ne morëm frymëzimin se ju duhet të thirreni. Si shërbëtor i Zotit, unë jam këtu për ta dhënë atë thirrje.”

Xheku tha: “Mirë, Spenser, nëse e thoni kështu...”

“Po, unë po e them kështu.”

Ju e dini përfundimin. Të ndihmon po të ndjekësh rregullin e duhur të gjërave, madje dhe rregullin e pashkruar.

Unë kam në tavolinën time një letër nga një vëlla që është shumë i shqetësuar sepse nuk ishte thirrur siç duhej në detyrë. Ai e pranoi thirrjen dhe është i gatshëm të shërbejë, por ai tha se peshkopi i tij nuk u konsultua me bashkëshorten e tij së pari dhe nga ana tjetër nuk e trajtoi siç duhej.

Kur t'i përgjigjem, unë do të përpiqem t'i mësoj atij diçka nga rregulli i pashkruar i gjërave në lidhje me të qenit pak i durueshëm me atë se si gjërat bëhen në Kishë. Në seksionin e parë të Doktrina e Besëlidhje, Zoti paralajmëroi çdo njeri të “flasë në emër të Perëndisë, Zotit, madje Shpëtimtarit të botës” (DeB 1:20). Unë mendoj t'i theksoj atij se ai mundet një ditë të jetë peshkop, i mbingarkuar me probleme në lagje dhe me një ngarkesë shtesë përkujdesjesh personale dhe t'i sugjeroj që ai të japë tani ato që do të vlerësonte t'i merrte atëherë.

Një pikë tjetër rregulli: Peshkopët nuk duhet t'ua dorëzojnë organizimin e mbledhjeve anëtarëve. Ata nuk duhet t'ua dorëzojnë organizimin e

funeraleve apo të lamtumirave të misionarëve familjeve. Nuk është rregulli i duhur i gjërave që anëtarët apo familjet të presin të vendosin cili do të flasë dhe për sa kohë. Sugjerimet janë në rregull, sigurisht, por peshkopi nuk duhet t'ua lërë mbledhjen atyre. Ne shqetësohemi për prirjen që po ndodh në mbledhjet tona.

Funeralet mund dhe duhet të jenë mbledhja më shpirtërore dhe më e rëndësishme. Ato po bëhen një ribashkim jo formal i familjes përpara anëtarëve të lagjes. Shpesh Shpirti dëbohet nga përvoja humoristike apo shaka kur koha mund t'i kushtohet mësimi të gjërave të Shpirtit, madje gjërave të shenjta.

Kur familja këmbëngul që disa anëtarë të familjes të flasin në funeral, ne dëgjojmë mbi të vdekurin në vend të Shlyerjes, Ringjalljes dhe premtimeve ngushëlluese të zbuluara në shkriemet e shenjta. Tani është në rregull të kesh një anëtar të familjes që flet në funeral, por nëse ndodh kjo, vërejtjet e tyre duhet të jenë në përputhje me frymën e takimit.

Unë u kam thënë Vëllezërve të mi se në ditën kur të mbahet funerali im, nëse cilido prej atyre që do të flasin do të flasë për mua, unë do të [ngrihem] dhe do t'i korrigjoj. Ungjilli është që të predikohet. Unë nuk di grumbullim ku kongregacioni të jetë në një gjendje më të mirë gati-shmërie për të marrë zbulesë dhe frymëzim nga një folës sesa në një funeral. Ky privilegj po na hiqet sepse ne nuk kuptojmë rregullin e gjërave – rregullin e pashkruar të gjërave – që lidhet me administrimin e Kishës dhe marrjen e Shpirtit.

Peshkopët tanë nuk duhet të lejojnë t'ua dalë nga dora kontrolli i mbledhjeve tona. Kjo vlen edhe për mbledhjet tona të lamtumirës së misionarëve. Ne jemi thëllësisht të shqetësuar që ato janë bërë tani një lloj ritakimi përpara anëtarëve të lagjes. Thëllësia e trajnimit shpirtëror dhe mësimi që mund të vazhdonte, po humbet. Ne kemi dështuar të kujtojmë se ka një mbledhje sakramenti dhe se peshkopi kryeson.

Ka shumë gjëra që mund të thuhesh për çështje të tilla si veshja e rrobave më të mira të së dielës. A e dini çfarë do të thotë “veshja më e mirë e së dielës”? Kështu ndodhte zakonisht. Tani shohim gjithnjë veshje më informale, madje



të shkujdesura, në mbledhjet tona madje në mbledhje sakramenti, që çon në sjellje jo formale dhe të shkujdesur.

E kam bezdi kur shoh në një program mbledhjeje sakramenti se marrin pjesë Liza dhe Billi, dhe Dejvi. A nuk duhet të jetë Elizabeta dhe Uilliami, dhe Dejvidi? Më bezdis më shumë të kërkohet mbështetje për Bakun apo Baçin apo Çakun në këshillin e lartë. Unë thjesht them: “Nuk mund të kemi emrat e plotë në një dokument kaq të rëndësishëm?” Ka një formalitet, një dinjitet, që po e humbasim – dhe kjo është një kosto e madhe. Ka diçka për të cilën Pali tha se gjërat duhen bërë “sikur ka hije dhe me rregullsi”.

Mirë, ka aq shumë që dua t’ju tregoj lidhur me rregullin e pashkruar të gjërave, por pastaj këto janë gjëra që ju duhet t’i mësoni vetë. Nëse vetëm mund t’ju vendosim në rrethana ku të filloni të vëzhgoni, të filloni ta merrni atë trajnim, atëherë ju do të mësoni se si duhet të funksionojë Kisha dhe pse ajo funksionon ashtu. Ju do të gjeni se ajo përputhet me parimet që janë shkruar në shkrimet e shenjta. Nëse thjesht do të “mblidhni vazhdimisht si thesar në mendjet tuaja fjalët e jetës”, Zoti do t’ju bekojë dhe do t’ju japë “në çastin e duhur” atë që duhet të thoni dhe atë që duhet të bëni (DeB 84:85). Mësoni mbi këtë shembull të madh – mësimet që na vijnë thjesht nga vrojtimi dhe pjesëmarrja.

Shpejt pasi Spanja ishte hapur për predikimin e ungjillit, unë ndodhesha në Barcelonë. Dy nga misionarët e parë të dërguar në Spanjë, u dërguan në Barcelonë për të filluar predikimin e ungjillit në qytet. Ata i kishin bërë kërkesë Presidentit Smith Grifin për dyzet karrige. Ai ishte në Paris në atë kohë dhe nuk e dinte përse i donin dyzet karriget kur nuk kishin anëtarë. Ai ngurroi të shpenzonte, por mendoi se duhej t’i inkurajonte misionarët. Kështu dha miratimin për dyzet karrige.

Kur arritëm në sallën e mbledhjes, lart në një ndërtesë biznesi, të dyzet karriget ishin mbushur. Atje kishte njerëz në këmbë. Pleqtë e kishin rregulluar që i kthyeri i tyre i parë në besim, një

burrë mesatar në moshë që punonte në një treg peshku, të drejtonte mbledhjen. Ne vërenim kur ata i mësonin atij çfarë të bënte, ndonjëherë duke u ngritur që t’i pëshpëritnin.

Vëllai Baish i emocionuar e drejtoi mbledhjen me ndihmën e tyre. Pastaj, kur u ngrit për ta mbyllur, Shpirti i Zotit ra mbi të dhe ai predikoi me forcë të madhe dhe disi gjatë. Ishte një dëshmi e frymëzuar, një moment i paharrueshëm. Dy pleqtë e rinj, të dy të kthyer në besim nga Amerika e Jugut, kishin mësuar në njëfarë mënyre diçka nga rregulli i pashkruar i gjërave. Ata po e vendosnin Kishën në vend me rregullin e duhur në Barcelonë. Tani ka katër kunje në atë qytet.

Dhe ashtu vazhdon. Zoti përdor shenjtorë të zakonshëm, të thjeshtë, të kryejnë punën e tij.

*A s’ është çudi që princa dhe mbretër*

*Dhe klounë që lodrojnë në arena me tallash  
Dhe shi njerëz të thjeshtë si unë dhe ti  
Janë ndërtues në përjetësi?*

*Secilit i është dhënë një çantë veglash,*

*Një masë pa formë dhe një libër rregullash,  
Dhe secili duhet të ndërtojë para se jeta të  
shkojë,*

*Një bllok pengues ose gur lartësues.*

—R. L. Sharpe, “Stumbling-Block or Stepping Stone”

Kisha do të vazhdojë dhe ajo vazhdon pikërisht sepse anëtarët e thjeshtë mësojnë nëpërmjet vrojtimit, mësojnë duke dhënë mësim, mësojnë nga përvoja. Në radhë të parë, ne mësojmë sepse ne motivohemi nga Shpirti. Një ditë, sigurisht, ju që jeni të rinj tani do të udhëhiqni Kishën. Nëse në kohën deri atëherë do të mësoni dhe studioni rregullin e pashkruar të gjërave, fuqia Zotit do të jetë mbi ju deri në fund që ju të mund të jeni shërbëtorë i dobishëm.

Unë dëshmoj se kjo është Kisha e Tij, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, dhe që, siç ka thënë Zoti, të gjithë “të mund të flas[in] në emër të Perëndisë, Zotit, madje Shpëtimtarit të botës” (DeB 1:20).

Unë lutem për bekimet e tij për ju dhe ju dëshmoj në emrin e Jezu Krishtit, amen.

### **NDIHMË PËR STUDIMIN**

- Si i mësojmë gjërat e rëndësishme mbi Kishën, të cilat nuk janë në shkrimet e shenjta apo në manualët e Kishës?
- Pse mendoni se ne jemi më të vlefshëm për punën e Zotit kur mësojmë “rregullin e pashkruar të gjërave”?
- Pse duhet që personi kryesues i një mbledhjeje të ulet në presidium gjatë mbledhjes?
- Pse nuk është e përshtatshme që një udhëheqës në Kishë të kërkojë të lirohet nga një thirrje?
- Pse nuk duhet që një peshkop të shkojë tek peshkopi i një lagjeje tjetër për këshillim mbi zgjidhjen e një problemi në lagjen e tij?
- Kush duhet të planifikojë mbledhjet e sakramentit gjatë të cilave flasin misionarë që largohen dhe familjet e tyre? Përse?

## SHQYRTIMI I VETVETES

*“Unë ju them juve, a mund ta shikoni drejt Perëndinë në atë ditë me një zemër të kulluar dhe me duar të pastra? Unë ju them, a mund të shikoni drejt, duke pasur shëmbëlltërinë e Perëndisë të gdhendur mbi pamjen tuaj?” (Alma 5:19).*

### PARIME TË UDHËHEQJES

Shqyrtimi i vetvetes i ndihmon udhëheqësit të sjellin njerëz tek Jezu Krishti.

### KONCEPTE PËR MËSIMIN

1. Shqyrtimi i vetvetes është i rëndësishëm për udhëheqësit e familjes dhe të Kishës.

### KONCEPT 1. SHQYRTIMI I VETVETES ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR UDHËHEQËSIT E FAMILJES DHE TË KISHËS.

#### KOMENT

Udhëheqësit duhet të mendojnë rregullisht mbi denjësinë e tyre për t’u udhëhequr nga Shpirti dhe mbi atë se sa mirë i zbatojnë parimet e shëndosha të udhëheqjes. Shkrimet e shenjta na mësojnë mbi rëndësinë e shqyrtimit të vetvetes. Nefi arsyetoi: “Dhe pse duhet t’i dorëzohem mëkatit, për shkak të mishit tim? Po, pse duhet t’u hap udhë tundimeve, që i ligu të ketë vend në zemrën time, të shkatërrojë paqen time dhe të hidhërojë shpirtin tim? Pse jam unë i zemëruar për shkak të armikut tim?” (2 Nefi 4:27). Alma e pyeti popullin e Zarahemlës: “A keni lindur shpirtërisht nëpërmjet Perëndisë? A keni marrë shëmbëlltërinë e tij në pamjen tuaj? A e keni provuar këtë ndryshim të madh në zemrat tuaja? ...

Dhe tani vini re, unë ju them juve, vëllezërit e mi, në qoftë se keni provuar një ndryshim të zemrës dhe në qoftë se ju keni ndier të këndonit këngën e dashurisë shëlbuese, unë do t’ju pyesja, a ndiheni kështu tani?” (Alma 5:14, 26). Jozef Smithi i ri po mendonte mbi “dobësinë dhe papërsosmëritë” e tij dhe po i lutej Zotit për falje kur engjëlli Moroni iu shfaq për herë të parë (shih Joseph Smith—Historia 1:28–33)

Profetët modernë dhe udhëheqësit e Kishës na kanë mësuar gjithashtu për rëndësinë e shqyrtimit të vetvetes. Presidenti Gordon B. Hinkli, që

ishite atëherë Këshilltar në Presidencinë e Parë, këshilloi: “Çdo mbledhje sakramenti duhet të jetë një festë shpirtërore. Ajo duhet të jetë një kohë për meditim dhe shqyrtim të vetvetes, një kohë për të kënduar këngë perlëvdimi për Zotin, një kohë e përtëritjes së besëlidhjeve me atë dhe me Atin tonë të Përrjetshëm, një kohë për të dëgjuar fjalën e Zotit me nderim dhe vlerësim” (në Conference Report, tetor 1982, f. 66; ose *Ensign*, nëntor 1982, f. 47).

Plaku Rasëll M. Nelson, anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, na mësoi: “Peshkatari i urtë i kontrollon rrjetat e tij rregullisht. Po të diktohet ndonjë e çarë, ai e riparoi difektin pa vonesë. Një thënie e vjetër anglo-saksone na mëson se ‘një qepje në kohë shmang nëntë shqepje’. Zbulesa e shkruar na jep një udhëzim të ngjashëm. Zoti ka thënë: ‘Kujtohu, pra, se nga ke rënë, pendohu, dhe bëj veprat e para’ (Zbulesa 2:5).

Nëse jemi të urtë, ne vlerësojmë përditë fijet vetjake të ndershmërisë. Ne gjejmë çdo dobësi dhe e riparojmë. Vërtet, ne kemi një detyrim për të vepruar kështu...

Lutja vetjake private është një kohë e mirë për shqyrtim të vetvetes. Lutja e mëngjesit mund të përfshijë një thirrje për ndershmëri, dëlirësi, virtyt apo thjesht për të qenë në shërbim të të tjerëve. Në mbrëmje, mund të ketë një kontroll tjetër të shpejtë mbi të gjitha ato tipare. Ne lutemi për ruajtjen e ndershmërisë sonë shpirtërore, pastaj punojmë për të. Nëse gjendet ndonjë

difekt, ne do të duam të fillojmë procesin e riparimit të menjëhershëm që do të na mbrojë nga shpërbërja e mëtejshme e një cilësie shpirtërore të kërcënuar.

Shqyrtimi i vetvetes bëhet më mirë në shumë hapa të vegjël, duke i bërë vetes pyetje të tilla si:

- Çfarë bëjmë kur kemi bërë një gabim? A e pranojmë gabimin dhe kërkojmë falje, apo e mohojmë dhe bëjmë fajtorë të tjerët?
- Çfarë bëjmë kur jemi në një grup ku nxiten ide apo aktivitete të gabuara? A e miratojmë gabimin nëpërmjet heshtjes tonë, apo mbajmë qëndrim?
- A jemi tërësisht të vërtetë me punëdhënësit tanë, apo jemi më pak se besnikë?
- A e mbajmë ditën e shabatit, i bindemi Fjalës së Urtësisë, nderojmë atin dhe nënën tonë?
- ... Si reagojmë kur dëgjojmë të folur dashakeqas kundër shërbëtorëve të vajosur të Zotit? A i nderojmë të gjitha [besëlidhjet tona]? Apo lejojmë përjashtime dhe e mendojmë sjelljen tonë në përshtatje me parapëlqimet tona?
- Si e mbajmë fjalën tonë? A mund t'u besohet premtimeve tona? ...

... Diagnoza e përshtatshme është thelbësore për trajtim të përshtatshëm. Zoti na dha një siguri të mrekullueshme: 'Pasi ti ke parë dobësinë tënde, do të bëhesh i fortë' (Ethëri 12:37). Por dëshira për forcë nuk na bën të fortë. Ajo kërkon besim dhe punë për të lidhur një fije të dobësuar të ndershmerisë.

Ne e dimë procesin e vetëndreqjes që quhet pendim" ("Integrity of Heart", *Ensign*, gusht 1995, f. 21).

### IDE MËSIMORE

Shpjegoni çfarë do të thotë *shqyrtim i vetvetes* ("një shqyrtim i mendimeve dhe ndjenjave të veta të një njeriu" *Merriam-Webster's Collegiate Dictionary*, botimi i 10-të [1993], "introspection", f. 615)). Diskutoni pse shqyrtimi i vetvetes është i rëndësishëm për udhëheqësit e kishës dhe të familjes.

Kërkojuni studentëve të përmendin shembuj të shqyrtimit të vetvetes në shkrimet e shenja (shih 1 Mbretërit 19:14–13; Mateu 4:1–11; dhe

shembujt në koment). Diskutoni se si shqyrtimi i vetvetes shpesh pasohet nga një bekim.

U tregoni studentëve deklaratën e Presidentit Gordon B. Hinkli në koment mbi shqyrtimin e vetvetes në mbledhjet e sakramentit. Diskutoni disa nga pyetjet që Plaku Rasëll M. Nelson sugjeroi t'ia bëjmë vetes gjatë shqyrtimit të vetvetes.

U thoni studentëve se është e rëndësishme për udhëheqësit të mendojnë mbi marrëdhënien e tyre me Zotin, përgjegjësitë e tyre, njerëzit të cilëve u shërbejnë e kështu me radhë. Diskutoni me studentët tuaj pyetje që mund t'ia drejtojmë vetes kur mendojmë mbi denjësinë tonë dhe thirrjet tona si udhëheqës. Sugjeroni që ata të zhvillojnë zakonet e të menduarit mbi pyetje si këto.

### BURIME PËR MËSUESIN



**Presidenti Spenser W. Kimball**

*President i Kishës*

"*Jesus: The Perfect Leader*",  
*Ensign*, gusht 1979, f. 5–7

Ka shumë më tepër gjëra për të thënë mbi udhëheqjen e mrekullueshme të Zotit Jezu Krisht nga sa mundet ndoshta të përfshijë çfarëdo artikulli apo libri, por unë dua të theksoj disa tipare dhe aftësi që ai i demonstroi aq përsosmërisht. Po këto aftësi dhe cilësi janë të rëndësishme për ne të gjithë nëse duam të kemi sukses në mënyrë të qëndrueshme si udhëheqës.

### Parime të pandryshueshme

Jezusi e dinte cili ishte dhe përse ai ishte këtu në këtë planet. Ajo do të thoshte se ai mund të udhëhiqte me forcë më shumë sesa me pasiguri apo dobësi.

Jezusi vepronte mbi një bazë parimesh apo të vërtetash të pandryshueshme më shumë sesa duke i krijuar rregullat në rrugë e sipër. Kështu, stili i tij i udhëheqjes jo vetëm ishte korrekt, por gjithashtu i qëndrueshëm. Ka aq shumë udhëheqës laikë sot që janë si kameleonë; ata e ndryshojnë pamjen dhe pikëpamjet për t'iu përshtatur situatës – që priret vetëm t'i ngatërrojë shokët dhe ndjekësit, që nuk mund të jenë të sigurt se

çfarë kursi po ndiqet. Ata që kapen pas pushtetit në dëm të parimit shpesh përfundojnë në bërjen e thujtë gjithçkaje për ta bërë të përhershëm pushtetin e tyre.

Jezusi tha disa herë, “Eja e më ndiq”. Programi i tij ishte më shumë “bëni siç bëj unë” sesa “bëni çka them unë”. Shkëlqimi i tij i lindur do t’ia lejonte të vinte në veprim një pamje verbuese, por ajo do t’i kishte lënë ndjekësit e tij shumë mbrapa. Ai ecte dhe punonte me ata të cilëve duhej t’u shërbente. Udhëheqja e tij nuk ishte një udhëheqje jashtë kontaktit personal. Ai nuk kishte frikë nga miqësitë e ngushta; ai nuk kishte frikë se afërsia me të do t’i zhgënjente ndjekësit e tij. Tharmi i një udhëheqjeje të vërtetë nuk mund të ngrejë të tjerë, veçse kur jemi bashkë dhe u shërbejmë atyre që duhet të udhëhiqen.

Jezusi qëndroi vetë i virtytshëm dhe kështu, kur afërsia e tij me njerëzit u lejonte atyre ta preknin palën e veshjes së tij, virtyt mund të rridhte prej tij. (Shihni Marku 5:24–34.)

### **Të kuptuarit e të tjerëve**

Jezusi ishte një udhëheqës që dëgjonte. Ngaqë ai i donte të tjerët me një dashuri të përsosur, ai dëgjonte pa nënvleftësim. Një udhëheqës dëgjon jo vetëm të tjerët, por gjithashtu ndërjegjen e tij dhe shtysat e Perëndisë.

Jezusi ishte një udhëheqës i durueshëm, lutës, i dashur. Kur Pjetri nxori shpatën dhe goditi shërbëtorin e priftit të lartë, duke i prerë veshin e djathtë, Jezusi tha: “Fute shpatën tënde në mill” (Gjoni 18:11). Pa u inatosur apo turbulluar, Jezusi me qetësi shëroi veshin e shërbëtorit (shih Lluka 22:51). Qortimi i tij për Pjetrin që i butë, por i prerë.

Ngaqë Jezusi i donte ndjekësit e tij, ai ishte në gjendje të ishte i kuptueshëm për ta, të ishte i çiltër dhe i drejtpërdrejtë me ta. Ai e qortonte ndonjëherë Pjetrin sepse e donte dhe Pjetri, një njeri i madh, ishte në gjendje të rritej nga ky qortim. Ka një varg të mrekullueshëm në librin e Fjalëve të urta që kemi të gjithë nevojë ta kujtojmë:

“Veshi që e dëgjon kritikën e jetës ka për të qëndruar bashkë me të urtët.

Kush nuk pranon qortimin e përcmon vetë shpirtin e tij, por ai që dëgjon qortimin bëhet më i urtë.” (Fjalët e Urta 15:31–32.)

Është udhëheqës i urtë apo ndjekës i urtë ai që mund të përballojë “qortimet e jetës”. Pjetri mundej ta bënte këtë sepse ai e dinte që Jezusi e donte dhe kështu Jezusi ishte në gjendje ta rriste Pjetrin për një vend apo përgjegjësi shumë të lartë në mbretëri.

Jezusi e shihte mëkatën si gabim por gjithashtu ishte në gjendje ta shihte mëkatën si të lindur prej nevojave të thella dhe të paplotësuara tek mëkatuesi. Kjo e lejonte atë të dënonte mëkatën pa dënuar individin. Ne mund të shfaqim dashurinë tonë për të tjerët edhe kur jemi thirrur t’i korrigojmë ata. Ne duhet të jemi në gjendje të shohim thellë në jetën e të tjerëve që të mund të shohim shkaqet themelore për dështimet dhe të metat e tyre.

### **Udhëheqje vetmohuese**

Udhëheqja e Shpëtimtarit ishte vetmohuese. Ai e vuri veten dhe nevojat e veta në plan të dytë dhe u shëbeu të tjerëve përtej thirrjes së detyrës, pa u lodhur, me dashuri, efektivisht. Kaq shumë probleme sot në botë vijnë nga egoizmi dhe egocentrizmi, ku mjaft njerëz bëjnë kërkesa të vrazhda nga jeta dhe nga të tjerët me qëllim që të plotësojnë kërkesat e tyre. Kjo është një përmbysje e plotë e parimeve dhe praktikave të ndjekura që përsosmërisht nga ai shembull i përsosur udhëheqjeje, Jezusi i Nazaretit.

Udhëheqja e Jezusit theksoi rëndësinë e të qenit mendjehollë me të tjerët, pa kërkuar t’i kontrollosh ata. Ai përkujdesej për lirinë e ndjekësve të tij për zgjedhje. Madje atij, në ato çaste që kishin aq shumë rëndësi, iu desh të zgjidhte vullnetarisht për të kaluar nëpër Gjetseman dhe të varej mbi kryq në Kalvar. Ai na mësoi se nuk mund të ketë rritje pa liri reale. Një nga problemet me udhëheqjen manipuluese është se ajo nuk buron nga dashuria për të tjerët, por nga nevoja për t’i përdorur ata. Udhëheqës të tillë përqendrohen në nevojat dhe dëshirat e veta dhe jo në nevojat e të tjerëve.

Jezusi kishte këndvështrim perspektiv mbi problemet dhe njerëzit. Ai ishte i aftë të bënte me kujdes përlllogaritje afatgjatë të rezultatit dhe

ndikimit të shprehjeve, jo vetëm tek ata që do t'i dëgjonin ato në çast, por mbi ata që do t'i lexonin 2.000 vite më pas. Kaq shpesh ndodh që udhëheqës laikë sulen për zgjidhjen e problemeve, në kërkim të ndaljes së dhimbjes së tashme, duke krijuar kështu vështirësi e dhimbje edhe më të madhe për më vonë.

### **Përgjegjësia**

Jezusi e dinte si të përfshinte dishepujt e tij në procesin e jetës. Ai u dha atyre gjëra të rëndësishme dhe të veçanta për t'i bërë për zhvillimin e tyre. Udhëheqës të tjerë janë përpjekur të jenë aq gjithëkompetentë saqë janë përpjekur ta bëjnë çdo gjë vetë, duke shkaktuar rritje të vogël të të tjerëve. Jezusi u beson mjaft ndjekësve të tij për ta ndarë punën e tij me ta, që ata të mund të rriten. Ky është një nga mësimet më të mëdha të udhëheqjes së tij. Nëse mënjanojmë të tjerë me qëllim që ta shohim një punë të kryer më shpejt dhe efektivisht, puna mund të bëhet në rregull, por pa rritjen dhe zhvillimin e ndjekësve që është me aq rëndësi. Ngaqë Jezusi e di se kjo jetë është e qëllimshme dhe se jemi vendosur mbi këtë planet për të punuar dhe për t'u rritur, rritja atëherë bëhet një nga qëllimet e mëdha të jetës si edhe mënyrë. Ne mund të reagojmë për korriginimin e të tjerëve me dashuri dhe dobishëm kur bëhen gabime.

Jezusi nuk trembej t'u bënte kërkesa atyre që udhëhiqte. Udhëheqja e tij nuk ishte nënvleftësuese apo pa forcë. Ai kishte kurajën ta thërriste Pjetrin dhe të tjerët të linin rrjetat e peshkimit dhe ta ndiqnin atë, jo pas stinës së peshkimit apo pas kapjes së radhës, por tani! Sot! Jezusi u tregoi njerëzve se ai besonte tek ata dhe tek mundësitë e tyre dhe kështu ai ishte i lirë t'u ndihmonte atyre të rrisnin aftësitë e tyre për arritje të reja. Kaq shumë udhëheqje laike është nënvleftësuese dhe, në shumë mënyra, përbuzëse ndaj njerëzimit, nga që ajo i trajton njerëzit si të ishin për t'u përkëdhelur dhe mbrojtur përgjithnjë. Jezusi besonte tek ndjekësit e tij, jo vetëm për atë që ata ishin, por për atë çfarë kishin mundësitë që të bëheshin. Ndërsa të tjerët do ta kenë parë Pjetrin si peshkatar, Jezusi mundi ta shihte atë si një udhëheqës të fuqishëm fetar – kurajoz, të fortë – që do të linte shenjën e vet mbi një pjesë të madhe të njerëzimit. Duke i dashur të tjerët, ne mund t'u

ndihmojmë të rriten duke u bërë kërkesa të arsyeshme por reale.

Jezusi u dha njerëzve të vërteta dhe detyra që përputheshin me aftësitë e tyre. Ai nuk i hutoi ata me më shumë sesa mund të administronin, por u dha mjaft që të rrisnin aftësitë. Jezusi kishte parasysh gjërat themelore në natyrën njerëzore dhe në sjelljen e ndryshimeve të përherëshme, jo ndryshime thjesht kozmetike.

### **Përgjegjshmëria**

Jezusi na mësoi se jemi përgjegjës jo vetëm për veprimet, por gjithashtu për vetë mendimet tona. Kjo është aq e rëndësishme për ne që ta mbajmë mend. Ne jetojmë në një epokë që thekson "sigurimet e aksidentëve me pafajësi" – dhe "pafajësi" gjithashtu në sjellje të tjera njerëzore. Përgjegjshmëria nuk është e mundur, sigurisht, pa parime të pandryshueshme. Një udhëheqës i mirë kujton që është përgjegjës përpara Perëndisë si dhe atyre që i udhëheq. Duke kërkuar përgjegjshmëri nga vetja, ai është në një pozitë më të mirë, si rrjedhim, që të kujdeset që të tjerët të jenë përgjegjës për sjelljen dhe punën e tyre. Njerëzit priren të zbatojnë një standard të vendosur nga udhëheqësit e tyre.

### **Përdorim i urtë i kohës**

Jezusi gjithashtu na mësoi sa e rëndësishme është ta përdorim urtësisht kohën. Kjo nuk do të thotë se nuk mund të ketë kurrë ndonjë kohë të lirë, sepse duhet të ketë kohë për të menduar dhe për rifreskim, por nuk duhet të ketë shpërdorim të kohës. Si e menaxhojmë kohën ka shumë rëndësi dhe ne mund të jemi menaxherë të mirë të kohës pa qenë të furishëm apo të tejzellshëm. Koha nuk mund të riciklohet. Kur shkon një çast, ai ka shkuar realisht. Tirania e vogëlsive qëndron në zhvendosjen e njerëzve dhe të çasteve që vërtet kanë rëndësi. Një vogëlsi i mban peng gjërat shumë të rëndësishme dhe ne e lejojmë tiraninë të vijojë tepër shpesh. Menaxhimi i urtë i kohës është realisht menaxhimi i urtë i vetvetes.

### **Udhëheqja laike**

Ata individë të cilët i duam, i admirojmë dhe i respektojmë më shumë si udhëheqës të familjes njerëzore konsiderohen të tillë nga ne pikërisht

sepse ata mishërojnë, në shumë mënyra, cilësitë që Jezusi kishte në jetën e tij dhe në udhëheqjen e tij.

Anasjelltas, ata udhëheqës në histori, që kanë pasur kryesisht ndikim tragjik mbi njerëzimin, ishin të tillë pikërisht sepse u mungonin thuajse në çfarëdo shkalle cilësitë e Njeriut të Galileesë. Atje ku Jezusi ishte vetmohues, ata ishin egoistë. Atje ku Jezusi ishte i shqetësuar për lirinë, ata ishin të shqetësuar për kontrollin. Atje ku Jezusi ishte i shqetësuar për shërbimin, ata ishin të shqetësuar për statusin. Atje ku Jezusi u përgjigjej nevojave të vërteta të të tjerëve, ata shqetësoheshin vetëm për nevojat dhe dëshirat e tyre. Atje ku Jezusi ishte i shqetësuar për zhvillimin e dishepujve të tij, ata përpjekeshin të manipulonin të vdekshmit. Atje ku Jezusi ishte i mbushur me dhembshuri të barazpeshuar me drejtësi, ata ishin aq shpesh të mbushur me ashpërsi dhe padrejtësi.

Ndoshta të gjithë ne nuk do të jemi shembull i përsosur udhëheqjeje, por të gjithë ne mund të bëjmë një përpjekje serioze drejt afrimit tek ai ideal i madh.

### **Potenciali ynë**

Një nga mësimet e mëdha të Njeriut të Galileesë, Zotit Jezu Krisht, ishte se ju dhe unë kemi brenda nesh mundësi pafund. Në nxitjen që të jemi të përsosur siç është i përsosur Ati ynë në Qiell, Jezusi nuk po na tallte apo vinte në lojë. Ai po na tregonte një të vërtetë të fuqishme mbi mundësitë tona dhe mbi potencialin tonë. Ajo është një e vërtetë thuajse tepër e vështirë për t'u kuptuar. Jezusi, që nuk mund të gënjente, u përpoq të na tregonte të ecnim më tej nëpër rrugën e ngushtë drejt përsosjes.

Ne nuk jemi ende të përsosur si Jezusi, por nëse njerëzit përreth nuk do të na shohin në përpjekje dhe përmirësim, ata nuk do të mund të na shohin si shembull, por do të na shohin si jo plotësisht seriozë lidhur me gjërat që duhen bërë.

Secili prej nesh ka më shumë mundësira për të bërë mirë dhe për të qenë i mirë ngasa do të përdorim ndonjëherë. Këto mundësira janë gjithandej rreth nesh. Çfarëdo madhësie që të ketë rrethi ynë i tanishëm i ndikimit rezultativ, nëse do të përmirësonim sadopak punën tonë, ai rreth

do të zmadhohej. Ka shumë individë që presin t'i prekim dhe t'i duam nëse kujdesemi mjaft sa ta përmirësojmë punën tonë.

Ne duhet të kujtohemi se ata vdekatarë që takojmë në parkingje, zyra, ashensorë dhe kudo tjetër, janë ajo pjesë e njerëzimit që Perëndia na ka dhënë ta duam dhe t'i shërbejmë. Do të ketë pak dobi për ne të flasim për vëllazërinë e përgjithshme të njerëzimit, nëse nuk mund t'i respektojmë ata, që janë gjithandej rreth nesh, si vëllezër dhe motra. Nëse përjetimet tona në vdekshmëri duken modeste apo aq të vogla, ne duhet të kujtojmë shëmbëlltyrën që na dha Jezusi, ku na kujtonte se madhështia nuk është gjithnjë çështje madhësie apo shkalle, por e cilësisë së jetës të njeriut. Nëse veprojmë mirë me talentet tona dhe me mundësitë rreth nesh, kjo nuk do të kalojë pa u vënë re nga Perëndia. Dhe ata që veprojnë mirë me mundësitë që u jepen, edhe më shumë do t'u jepet!

Shkrimet e shenjta përmbajnë shumë shembuj të mrekullueshëm udhëheqësish, të cilët, ndryshe nga Jezusi, nuk ishin të përsosur, por përsëri ishin shumë rezultativë. Kjo do të na bënte shumë mirë nëse do t'i lexonim ata – dhe t'i lexonim shpesh. Ne harrojmë se shkrimet e shenjta na paraqesin shekuj përvoje udhëheqëse, dhe, madje më e rëndësishme, parimet e pandryshueshme me të cilat udhëheqja e vërtetë duhet të veprojë për të pasur sukses. Shkrimet e shenjta janë manuali i udhëzimeve për të qenë udhëheqës.

### **Udhëheqësi i përsosur**

Unë nuk bëj apologji që t'ju jap diçka nga përmeshjet e Jezu Krishtit atyre që kërkojnë sukses si udhëheqës.

Nëse do të ishim në kulm të suksesshëm, këtu kemi modelin tonë. Të gjitha cilësitë fisnikëruese, të përsosura dhe të bukura të pjekurisë, të forcës dhe të kurajës gjenden në këtë person të vetëm. Ndërsa një turmë e madhe kërcënuese, e armatosur deri në dhëmbë, erdhi ta burgoste atë, ai u përball vendosmërisht me ta dhe tha: “Kë kërkon?”

Turma, e befasuar, murmuriti emrin e tij: “Jezusin Nazareas”.

“Unë jam”, u përgjigj Jezusi Nazareas me krenari dhe kurajë – dhe me forcë: ushtarët “u zmbropsën dhe ranë për dhe”.

Ai pyeti për herë të dytë: “Kë kërkoni” dhe kur ata shqiptuan emrin e tij, ai tha: “Ju kam thënë se unë jam; prandaj nëse më kërkoni mua, i lini këta [dishepujt e tij] të shkojnë”. (Gjoni 18:4–8.)

Ndoshta gjëja më e rëndësishme që mund të them mbi Jezu Krishtin, më e rëndësishme se gjithçka tjetër që kam thënë, është se ai jeton. Ai vërtet mishëron të gjitha ato virtyte dhe tipare të cilat na i tregojnë shkrimet e shenjta. Nëse mund të arrijmë ta dimë këtë, ne atëherë do të dimë të vërtetën qendrore mbi njeriun dhe universin. Nëse ne nuk e pranojmë atë të vërtetë dhe atë realitet, atëherë nuk do të kemi parime të pandryshueshme apo të vërteta të mrekullueshme me të cilat ta jetojmë jetën në lumturi dhe shërbim. Me fjalë të tjera, ne do të na duket shumë e vështirë të jemi udhëheqës të rëndësishëm po të mos e njohim të vërtetën mbi udhëheqësin e përsosur, Jezu Krishtin, dhe ta lejojmë që ai të jetë drita me të cilën ne shohim rrugën!

#### NDIHMË PËR STUDIMIN

- Çfarë tha Presidenti Kimball mbi udhëheqësit që e ndryshojnë pozicionin e tyre për t’iu përshtatur situatës?

- Pse është e rëndësishme që udhëheqësit t’u shërbejnë atyre që udhëheqin?
- Për çfarë duhet të dëgjojnë udhëheqësit, përveç zërit të atyre që udhëhiqen prej tyre?
- Çfarë mund të përmbushin udhëheqësit që i duan ata që udhëheqin, që udhëheqësit e tjerë nuk mundin?
- Në çfarë mënyrash është manipulative udhëheqja që i shërben vetes? Përse është e gabuar për udhëheqësit e Kishës dhe të familjes t’i shërbejnë vetes?
- Si përfitojnë njerëzit kur udhëheqësit e tyre u japin delegime?
- Çfarë u mëson Jezu Krishti udhëheqësve mbi atë se si t’i shohin njerëzit që udhëheqin?
- Ndaj kujt janë përgjegjës udhëheqësit?
- Çfarë do të thotë Presidenti Kimball me “tirani e vogëlsive”?
- Zgjidhni një udhëheqës laik që e admironi dhe gjeni shembuj në të cilat ky person shfaq disa veçori të Jezu Krishtit si udhëheqës.
- Sipas Presidentit Kimball, si mund të bëhemi udhëheqës më të mirë?





KISHA E  
JEZU KRISHTIT  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME

